

**UNITED  
NATIONS**  
United Nations  
Interim  
Administration  
Mission  
in Kosovo



**NATIONS UNIES**  
Mission  
d'Administration  
Intérimaire des  
Nations Unies au  
Kosovo

**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT**

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**TRANSKRIPTI  
I MBLEDHJES SË SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË  
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 1 dhe 6 SHTATOR 2006**

**TRANSKRIPT  
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,  
ODRŽANE DANA 1. i 6. SEPTEMBRA 2006.GOD.**

---

***SHTATOR-SEPTEMBAR 2006***



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**RENDI I DITËS**


1. Raportimi i grupit negociator për ecurinë e bisedimeve për statusin e Kosovës.

**DNEVNI RED**

1. Izveštavanje pregovaračke grupe o kretanju razgovora o statusu Kosova.

**AGENDA**

1. The report of the negotiator group for the negotiation progress for the Status of Kosova



Seanca filloi punën në orën 9,00  
Seancën e kryesoi kryetari i Kuvendit Kolë Berisha  
Seanca ka vetëm një pikë të rendit të ditës:

*Raportimi i Grupit Negociator të Kosovës për ecurinë e bisedimeve për statusin final të Kosovës*

KRYETARI – Lus deputetët t'ni zënë vendet në sallë.

I nderuari president i Kosovës z. Sejdiu, të nderuar kolegë deputetë, i nderuari kryeministër z. Çeku dhe kabineti qeveritar, të nderuar të pranishëm, mirë se keni ardhur në seancën plenare për të cilën kemi paraparë vetëm një pikë të rendit të ditës.

**1. Raportimi i Grupit Negociator të Kosovës për ecurinë e bisedimeve për statusin final të Kosovës**

Për të mos humbur kohë së pari fjalën e ka paraqitësi i kërkesës. Unë e citova rendin e ditës.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI - Z. kryetar, zotërinj deputetë. Unë sot nuk do të flasë as në emër të partisë e as në emër të grupit dhe as në emrin tim. Sot flas në emër të popullit shumicë të Kosovës. Unë konsideroj se populli i Kosovës nuk është i interesuar absolutisht për raportin e këtij grupi, kërkesë dhe vullnet i popullit të Kosovës është që sot të shkarkohet Grupi Negociator ,ose grupi i ndarjes së Kosovës dhe që Kosova të shpallet shtet i pavarur dhe sovran sot, në qoftë se ky Kuvend dyshon në vullnetin e këtij populli le të organizojë referendum. Ju faleminderit!

KRYETARI – Ju faleminderit! Urdhëroni z. Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar i Kuvendit, z. kryetar i Kosovës, z. kryeministër, Delegacioni i unitetit, zonja dhe zotërinj deputetë. Duke ju përshëndetur më lejoni që edhe me këtë rast t'ju përkujtoj se për shkak të sëmurjes dhe të vdekjes së z. Ibrahim Rugovës- 12 muajt e fundit kanë qenë shumë të vështirë për LDK-në, por edhe për shumicën e qytetarëve të saj. Në këto rrethana Delegacioni i Unitetit vazhdoi rrugën ndërkombëtare të aranzhimeve institucionale për pakicat si kusht të fuqishëm ndërkombëtar për pavarësi dhe sovranitet të vendit tonë. LDK-ja e Kosovës dhe brenda saj Grupi Parlamentar i LDK-së mbështet përpjekjet vendore dhe ndërkombëtare për sigurim të plotë të të drejtave të njeriut në Kosovë, pa dallimi të përkatësisë etnike. Duke mbështetur garantimin institucional të të drejtave të pakicave sipas standardeve ndërkombëtare rikonfirmojmë përcaktimin se organizimi eventuale i pushtetit lokal në vija etnike nuk është qëndrim i LDK-së.



Lidhja Demokratike e Kosovës druan për pasojat të një pranimi apo të një imponimi të tillë. Duke shprehur falënderimin për bashkësinë ndërkombëtare, në veçanti për vendet e Grupit të Kontaktit dhe NATO-n, si dhe të fqinjëve tanë në mbështetje të procesit për pavarësi dhe sovranitet të plotë të vendit tonë, jemi të interesuar të dëgjojmë nga Delegacioni i Unitetit lidhur me ecurinë e bisedimeve dhe pikëpamjet për zbatim të ashtuquajturit paket statusor në muajt në vijim. Ju faleminderit z. kryetar i Kuvendit.

KRYETARI – Ju faleminderit z. Gashi, që të mos humbim kohë dëshiroj t'ia jap fjalën presidentit të Kosovës dhe njëkohësisht kryetar i Grupit Negociator të Kosovës profesor doktor Fatmir Sejdiu.  
Urdhëroni z. president.

**FATMIR SEJDIU PRESIDENT I KOSOVËS – Fiala e Presidentit Sejdiu para deputetëve të Kuvendit të Kosovës e mbaitur më 1 shtator 2006 lidhur me rrjedhën e bisedimeve të deritashme**

I nderuari kryetar i Kuvendit të Kosovës z. Berisha,

I nderuar kryeministër Çeku dhe Ministra të Qeverisë së Kosovës,  
Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Delegacionit të Kosovës dhe në vazhdimësi bashkë edhe me anëtarët e Delegacionit t'ju drejtohem ju, deputetë të Kuvendit të Kosovës, me një fjalë lidhur me zhvillimet e procesit të bisedimeve për status të Kosovës dhe të udhëhequr nga Presidenti Ahtisaari, të cilit i është dhënë mandati i tillë me vendimin e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Ju bëj me dije se Ekipi i Unitetit nëpërmjet delegacioneve përfaqësuese të tij ka prezentuar qëndrimet e veta në takimet e Vjenës për katër tema bosht të cilat janë trajtuar në shtatë takime të deritashme në Vjenë si dhe takime të tjera me vetë drejtuesin e këtyre bisedimeve Presidentin Ahtisaari të cilat janë mbajtur në Prishtinë para pak ditësh.

Pokështu Delegacioni i Kosovës në nivelin më të lartë të përfaqësimit politik ka marrë pjesë në një takim në Vjenë ku ka shprehur qëndrimet e veta lidhur me të ardhmen e Kosovës duke artikuluar fuqishëm vullnetin politik të popullit të Kosovës për pavarësinë dhe sovranitetin e plotë të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Dua të theksoj se Ekipi i Unitetit me gjithë strukturën e tij të brendshme të organizimit duke filluar nga Grupi Politik Strategjik dhe ekipet e specializuara për çështje kushtetuese-juridike, çështje ekonomike, çështjet e trashëgimisë kulturore, çështjet e të drejtave dhe lirive të komuniteteve, në përbërjen e të cilave ka të angazhuar ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë ka përgatitur dhe prezantuar në mënyrën më

serioze qëndrimet e Kosovës nëpërmjet të dokumenteve dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejt në bisedime.

Prandaj, këto dokumente të përgatitura deri tani i keni para jush dhe reflektojnë qëndrimet tona, të marra si rezultat i analizës gjithëpërfshirëse dhe shumëdimensionale që ka bërë Delegacioni i Kosovës dhe gjitha ekipet e tjera, dhe se vendimet e prezantuara janë marrë me konceptus të plotë nga anëtarët e Ekipës së Unitetit.

Bisedimet më të gjata gjer tani (pesë takime) dhe takime të tjera në nivel ekspertësh janë zhvilluar lidhur me çështjet e decentralizimit të pushtetit në Kosovë dhe shumë aspekte të gërshetuara brenda këtij procesi.

Çështje të veçanta të debatuar më së shumti kanë qenë ato që kanë të bëjnë me formimin e komunave të reja në Kosovë, kompetencat dhe funksionet e tyre themelore me një fokus të veçantë në çështjen e kompetencave të deleguara që kanë të bëjnë me financat lokale, kujdesin shëndetësor dhe sekondar, arsimimin e lartë, policinë dhe drejtësinë, si dhe çështja e bashkëpunimit midis komunave.

Delegacioni i Kosovës në bisedimet lidhur me decentralizimin është mbështetur gjithmonë në dokumentin e tij themelor 'Parimet themelore të Reformës së Pushtetit Lokal' të 14 shkurtit 2006 i cili si i tillë edhe do të jetë pjesë e marrëveshjes për statusin e ardhshëm të Kosovës. Bazuar në kriteret e parapara në "Parimet themelore të reformës së pushtetit lokal në Kosovës", në vazhdim të procesit është nxjerrë edhe dokumenti i radhës për krijimin e komunave të reja në Kosovë. Në këtë dokument (i cili është punuar nga ekspertët si vendorë ashtu edhe ndërkombëtarë), janë paraqitur kriteret për krijimin e komunave të reja.

Platforma e Kosovës për Reformën e pushtetit lokal, është e bazuar në një varg parimesh të cilat reflektojnë frymën e dokumenteve kryesore relevante ndërkombëtare mbi qeverisjen lokale sip, janë Parimet Evropiane të Subsidiaritetit, Karta Evropiane për Qeverisje Lokale, Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe dokumente e konventa tjera relevante.

Komunitat e Kosovës do të gëzojnë kompetenca të gjëra duke filluar nga zhvillimi ekonomik dhe aspekte financiare, planifikimi urban, shërbimet publike, arsimi, shëndetësia dhe disa aspekte të përkujdesjes sociale. Pokështu do të ketë kompetenca të caktuara edhe në fushën e policisë siç është zgjedhja e komandantëve të stacioneve në bazë të propozimit të Ministrit të Rendit dhe kjo duhet të reflektojë strukturën etnike brenda komunës, reflektimi i kësaj strukture ka të bëjë edhe me përbërjen e gjyqtarëve.

Ky nivel i kompetencave duhet vi nënshtrohet legjislacionit të Kosovës duke mos cënuar asnjëherë kompetencat e parapara përmes këtij legjislacioni për pushtetin qëndror, në relacion edhe me pushtetin lokal.

Të nderuar deputetë,

Në dokumentin bazik janë ofruar edhe elemente të tjera që kanë të bëjnë me kompetencat e komunave të Kosovës.

Çështje e veçantë në këtë drejtim është çështja e bashkëpunimit midis komunave të Kosovës, bashkëpunimit tejkufitar të tyre, pra edhe me komunat e Serbisë. Në këtë aspekt duhet theksuar se Delegacioni i Kosovës ka qëndrimin e vet të palëkundur se ky bashkëpunim duhet të mbështetet në legjislacionin e Kosovës, Konventën e Madridit dhe Kartën Evropiane për Vetë-Qeverisje Lokale dhe me marrëveshje bilaterale midis Qeverisë së Kosovës dhe qeverive të vendeve të tjera, pra edhe të Serbisë.

Duke pasur parasysh kriteret e miratuara për formimin e komunave të reja siç është numri prej 5,000 banorëve, qëndrueshmëria financiare dhe përbërja etnike e komunave, Delegacioni i Kosovës ka qëndrimin e vet përfundimtar për formimin e pesë komunave të reja dhe shtimin për disa parcela kadastrale të një komune ekzistuese, ku ka një shumicë të komunitetit serb.

Me këtë qasje kemi dëshiruar që të kontribuojmë në drejtim të integritetit sa më të madh të komunitetit pakicë serb në proceset vendimmarrëse, pra edhe në nivelin lokal të vendimmarrjes. Aspektet tjera të veçanta rreth zhvillimeve të bisedimeve në këtë temë u janë raportuar më herët në Kuvend. Këtu duhet ndarë qëndrimin e Delegacionit të Kosovës për çështjen e Mitrovicës për të cilën kemi theksuar se mund të organizohet 'Një Qytet me dy komuna' që do të udhëhiqeshin nga një bord i përbashkët administrativ i obligueshëm si organ ekzekutiv, në përbërje prej shtatë anëtarësh, nga tre përfaqësues nga secila komunë, pra të komuniteteve që u takojnë dhe një përfaqësues ndërkombëtar i cili edhe do të jetë udhëheqës i përkohshëm i këtij bordi administrativ.

Komuna e re e Mitrovicës së Veriut do të funksionojë si komunë e rregullt duke gëzuar kompetencat komunale sikurse edhe komunat e tjera. Përfundimisht kësaj komune do t'i jepen kompetenca shtesë në sferën e kujdesit shëndetësor dhe arsimimit të lartë, por duke iu nënshtruar plotësisht legjislacionit të Kosovës. Delegacioni i Kosovës ka zhvilluar edhe bisedime konkrete lidhur me çështjet ekonomike që kanë të bëjnë kryesisht me çështjen e borxheve të jashtme dhe pasurive të jashtme, çështjet e pronës dhe të drejta të tjera, interesat dhe detyrimet, pensionet, depozitat bankare të ngrira në valuta të jashtme, kërkesat e tjera të individëve për kompensim dhe humbjet kolektive.

Tema që ka të bëjë me trashëgiminë kulturore dhe religjioze pokështu është trajtuar në dy takime të gjertanishme dhe edhe pse nuk është arritur ndonjë pajtim sikur edhe për temat e mëparme, nga takimi i fundit me Presidentin Ahtisaari dhe analizën e bërë nga ana e Delegacionit të veçantë të Kosovës që është marrë me këtë çështje është theksuar se ka elemente të përputhshme të cilat Delegacioni i Kosovës i ka në konsideratë për shqyrtim të mëtejme në mënyrë që sa më shpejtë të mbyllet kjo temë.

Në kW kuadër, qëndrimet e Delegacionit të Kosovës lidhur me aspektet e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, historike dhe religjioze janë fundamentalisht të mbështetura në dokumentet ndërkombëtarë dhe në parimet e UNESCO-s mbi mbrojtjen e këtyre monumenteve.

Si çështje e veçantë në vazhdimësi është shtruar çështja e krijimit të zonave mbrojtëse rreth këtyre monumenteve. Delegacioni i Kosovës ka shtruar propozimin se ky parim mund të aplikohet për 14 kisha dhe manastire ortodokse serbe. Me këtë rast ka përcaktuar edhe hapësirat e mundshme mbrojtëse të cilat nuk mund të çënojnë në asnjë mënyrë pronën private përreth tyre, por që megjithatë me ligj të veçantë duhet të përcaktohet mënyra e mbrojtjes së tyre. Propozimet e palës serbe (0 mënyrën se si i kanë shtruar ata (40 objekte dhe hapësira me qindra hektarë përreth tyre) janë të papranueshme.

Lidhur me të gjitha këto tema të shtruara Delegacioni i Kosovës duke pasur parasyshë dokumentin themelor që i ka ofruar për bisedime i është përmbajtur dhe do Vi përmbahet parimit se 'nuk ka marrëveshje përderisa nuk ka marrëveshje të përgjithshme' që nënkupton realizimin e pavarësisë dhe sovranitetit të plotë të shtetit të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Kaptinë të veçantë të bisedimeve paraqet çështja e trajtuar në takimin e Vjenës dhe që ka të bëjë me të drejtat e komuniteteve pakicë në Kosovë.

Delegacioni i Kosovës punën e tij e ka mbështetur në Dokumentin Themelor të përgatitur nga ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë në takimet e shumta të organizuara me përfaqësuesit e subjekteve politike të përfaqësuara në Parlament, udhëheqësit e Grupeve Parlamentare të tyre dhe përfaqësuesit e komuniteteve pakicë. Këtë dokument e keni sot para vetes dhe si i tillë është miratuar nga Delegacioni i Kosovës. Nga përmbajtja e këtij dokumenti vlen të veçohet kujdesi i përkushtuar për integrimin e komuniteteve, pjesëmarrjen e tyre me përfaqësim të garantuar në Parlamentin e Kosovës, pjesëmarrjen e tyre në bazë të marrëveshjes politike me Qeverinë e Kosovës dhe parashikimi i mekanizmave përcjellës për mbrojtjen e interesave vitale të tyre. Kjo posaçërisht vë në shprehje në proceset vendimmarrëse që kanë të bëjnë me miratimin e disa ligjeve specifike përmes të cilave në veçanti duhet të ketë kujdes edhe për komunitetet pakicë. Bie fjala ligji për gjuhët, ligji kundër diskriminimit, ligji për liritë fetare dhe ndonjë ligj tjetër i cili është i parashikuar me këtë dokument.

Pokështu në këtë prizëm shikimi i është përkushtuar kujdes edhe strukturës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në kuadrin e së cilës duhet të jetë një panel i veçantë që do të trajtojë pokështu çështje të veçanta që kanë të bëjnë me interesat vitale të komuniteteve pakicë.

Të nderuar deputetë,



Duke respektuar përcaktimin tonë për të qenë pjesë aktive dhe konstruktive e të gjithë procesit të bisedimeve, me datën 24 të muajit korrik me utesë të Presidentit Ahtisaari, Delegacioni i Kosovës ka marrë pjesë në një takim të organizuar nga ai dhe ekipi i tij (UNOSEK) në të cilin kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Grupit të Kontaktit, përfaqësuesit e SHBA-së dhe të Unionit Evropian. Në këtë takim, ku ka marrë pjesë edhe Delegacioni i Serbisë, është hapur çështja e statusit politik të Kosovës.

Ju bëj me dije se qëndrimi i Delegacionit të Kosovës i shprehur në këtë takim ka qenë dhe mbetet prezantimi i vullnetit politik të Kosovës për pavarësinë dhe sovranitetin e plotë të Kosovës. Këtë qëndrim e kemi shprehur duke respektuar pikërisht në plotëni qëndrimet e Kuvendit të Kosovës të shprehur përmes Rezolutës së tij se 'pavarësia e Kosovës është e panegociueshme'.

Me këtë rast ju njoftoj se përmes prezantimit të përgjithshëm me fokus të veçantë për nevojën e përfundimit sa më të shpejtë të këtij procesi me pavarësimin e Kosovës dhe njohjen e saj ndërkombëtare, po kështu përmes debatit të mëvonshëm kemi kundërshtuar me argumente qasjet që përfaqësuesit e Serbisë i kanë ofruar për të ardhmen e Kosovës dhe pozitën e saj juridike-politike.

Është e qartë se nuk jemi përputhur dhe as që mund të përputhemi asnjëherë me vizione të tilla. Aq më tepër, Serbia nuk e ka të drejtën të përcaktojë formula për statusin e Kosovës Potencoj me këtë rast atë që e theksova edhe në takimin e Vjenës sikur që kanë theksuar edhe anëtarët e tjerë të delegacionit se konceptet e Prishtinës dhe Beogradit, mund të kuptohen edhe kështu: Serbia dëshiron që të na qeverisë dhe të vazhdojë sundimin e saj kolonial në Kosovë, ndërsa Kosova dhe populli i saj dëshiron të qeverisë me vetëveten.

Të nderuar deputetë,

Një theks të veçantë, përveç evidencimit të gjithë rrugëtimit tonë për liri dhe pavarësi të përcjellur me ngjarje të përgjakshme përgjatë dekadave dhe veçanërisht me gjenocidin e v. 1999 ndaj popullit shumicë të Kosovës, ia kemi përkushtuar vendosmërisë sonë për të ndërtuar një shtet modern dhe demokratik që në të njëjtën kohë do të thotë paqe dhe stabilitet afatgjatë në të gjithë rajonin.

Delegacioni i Kosovës në Vjenë, në unitet të plotë dhe palëkundshëm, ka shprehur përcaktimin e vet për një Kosovë evropiane në miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Por, në të njëjtën kohë kemi dhënë garancionet tona më për të ardhmen e përbashkët në Kosovën e pavarur të të gjithë qytetarëve, pra të shumicës dhe të pakicës.

Duke i kushtuar rëndësi të veçantë këtij procesi të bisedimeve për çështjet e lartëtheksuara Delegacioni i Kosovës ka insistuar dhe insiston që ky proces të përmbillet tani dhe të jetë pjesë e kontributit të drejtpërdrejt për definimin e statusit politik të Kosovës, përkatësisht pavarësimin e plotë të Kosovës që është vullnet i popullit të saj.

Në këtë drejtim ne do të bashkëpunojmë ngushtë me Presidentin Ahtisaari dhe ekipin e tij, me Grupin e Kontaktit dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë. Është në interes të Kosovës dhe qytetarëve të saj që viti 2006 të jetë vit i pavarësimit dhe i njohjes ndërkombëtare të saj.

Të nderuar deputetë,

Duke lënë hapësirë të drejtpërdrejt për kontributin paralel të të gjithë anëtarëve të tjerë të Delegacionit, përkatësisht të Ekipit të Unitetit në këtë Kuvend, ashtu siç edhe jemi marrë vesh bashkarisht, dëshiroj t'ju falënderoj për vëmendjen dhe mbështetjen që i keni dhënë dhe po i jepni punës së Delegacionit për realizimin sa më të shpejtë të qëllimit të përbashkët që kemi; pavarësimin dhe sovranitetin e plotë të vendit tonë - Kosovës.

Ju faleminderit!

KRYETARI - Ju faleminderit z. president. Ftoj kryeministrin Çeku si anëtar të Grupit të Unitetit që ta marrë fjalën.

AGIM ÇEKU KRYEMINISTËR - anëtar i Grupit të Unitetit. I nderuari z. president, i nderuari kryetar i Kuvendit të Kosovës, të nderuar deputetë, të nderuar ministra kolegë, të nderuar të pranishëm.

Që nga fillimi i bisedimeve për statusin përfundimtar të Kosovës, një ndër prioritetet kryesore të Qeverisë ka qenë fuqizimi dhe mbështetja e procesit politik nëpër të cilin po kalon Kosova, gjithnjë duke pasur parasysh objektivin madhor - pavarësinë sa më të shpejtë të vendit tonë. Me gjithë se momenti në të cilin gjendemi sot, niveli i përgjithshëm i zhvillimit ekonomik, social është faktor rëndues i të gjithë këtij angazhimi, Qeveria ka arritur që përkrah fuqizimit të aktiviteteve të tjera qeverisëse të arrijë sukses edhe në avancimin e procesit politik të Kosovës. Qeveria e Kosovës është pjesëmarrës i barabartë në Grupin Negociator që udhëhiqte nga presidenti Sejdiu dhe po ashtu Qeveria ka një pjesëmarrje të fuqishme të ministrave, zëvendëskryeministrave dhe të zyrtarëve të tjerë në grupin politik dhe në grupe të tjera ekspertësh. Konsideroj se pjesëmarrja jonë ka qenë konstruktive dhe thelbësore dhe pikërisht si e tillë kjo pjesëmarrje ka sjell një kualitet të konsiderueshëm në punën e tërësishme të Delegacionit të Kosovës në raport me zhvillimin e procesit në tërësi. Puna jonë në Grupin Negociator, me Grupin Politik strategjik dhe me grupet e ekspertëve është vetëm njëra nga fushat mbështetëse të procesit, ndonëse në fokus të çdo ngjarje në Kosovë sot është statusi i Kosovës dhe rugëtimi ynë drejt realizimit të aspiratave tona, proceset e tjera siç është procesi i standardeve dhe implementimi i tyre kanë qenë dhe janë boshti kurrizor jo vetëm i definimit të statusit politik të Kosovës, por njëkohësisht edhe i marrëdhënieve të Kosovës me bashkësinë ndërkombëtare. Roli mbështetës i Qeverisë së Kosovës për procesin negociator, si dhe roli i saj ekzekutiv në prodhimin e fakteve të pamohueshme politike i bëjnë të posaçme rolin dhe rëndësinë që Qeveria ka gjatë këtij procesi. Vlerësimi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara z. Kofi Anan, i Grupit të Kontaktit, por edhe i Këshillit të Sigurimit në qershor të këtij viti se institucionet e Kosovës, tregojnë rezultate konkrete në implementimin e standardeve, është ndër indikatorët më

relevantë dhe më të fuqishëm që tregon për shkallën e seriozitetit dhe të efektshmërisë së Qeverisë së Kosovës. Mesazhet e mëhershme dhe tani ngapak të harruara nga bashkësia ndërkombëtare se progresi në implementimin e standardeve është përcaktues jo vetëm me shpejtësinë e procesit të definimit të statusit, por gjithsesi edhe me kualitetin e statusit përfundimtar të Kosovës tanimë janë zhdukur nga fjalori politik i zyrtarëve ndërkombëtarë.

Arsyeja për këtë qëndron në faktin se Qeveria e Kosovës ka arritur sukses të pamohueshëm në këtë drejtim. Prandaj sot implementimi i standardeve nuk duket më sfidë e pa kalueshme. Vlerësimi i sapopërpiluar teknik i standardeve edhe po ashtu dinamika e treguar në implementimin e plotë të trembëdhjetë kërkesave të Grupit të Kontaktit janë edhe një dëshmi e fuqishme dhe e pakontestueshme në këtë drejtim. Ky vlerësim i pa publikuar ende është dokument bazë i seancës së ardhshme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Kosovën që do të mbahet më 11 shtator të këtij viti. Përmbajtja e këtij vlerësimi është si argument më shumë i prodhimit të fakteve të reja, i prodhimit të realiteteve të reja, por mbi të gjitha është një dokument konfirmues i përcaktimit tonë për një Kosovë çfarë të gjithë e dëshirojmë.

Për të qenë edhe më i saktë në shpjegimet e thelbit të implementimit të standardeve, të nderur deputetë të Kuvendit të Kosovës, unë e përsëris edhe një herë para jush atë që e kam thënë edhe disa herë më parë.

Së pari: Përmes standardeve ne synojmë integrimin e pakicave në jetën politike, ekonomike shoqërore dhe publike të Kosovës dhe së dyti synojmë avancimin e standardeve të gjithmbarshme të Qeverisë së Kosovës në aspektin e ekonomisë, të sundimit të ligjit të së drejtës pronësore të stabilizimit të procesit demokratik, të gjitha këto janë elemente esenciale drejtë ngritjes së kualitetit të jetës së qytetarëve të Kosovës.

Këto dy synime të përmbledhura janë fundamentale në të mirë të popullit të Kosovës, por në të njëjtën kohë, pa dyshim, ato janë edhe insistim ynë për t'i bindur miqtë tanë ndërkombëtarë secionet e Kosovës gjithë spektri politik dhe i gjithë populli i Kosovës janë po aq sa të sinqertë dhe këmbëngulës aq edhe të aftë për të ndërtuar një shtet dhe një shoqëri demokratike tolerante funksionale të qëndrueshme dhe stabile.

Një vend që shumë shpejtë dhe me plotë krenari do të sundojë dhe të jetë partner i barabartë i bashkësisë së kombeve të lira, Qeveria ka për detyrë që të gjejë zgjidhje praktike dhe afatgjata për problemet e vendit. Ne kështu e kemi kuptuar edhe procesin e bisedimeve për statusin përfundimtar të Kosovës, procesi i bisedimeve në Vienë ka qenë pikërisht në shërbim të gjetjes së zgjidhjeve funksionale për shtetin e pavarur të Kosovës. Gjatë gjithë këtij procesi Qeveria i ka ndjekur me përpikëri parimet e përbashkëta të Delegacionit të Kosovës për negociatën se të gjithë zgjidhjet duhet të garantojnë funksionalitetin e shtetit të Kosovës në territorin e tij dhe pa asnjë dilemë egoje të synojë akomodimin e pakicave dhe adresimin e shqetësimeve të tyre, qofshin reale apo të supozuara, pa larguar shikimin për asnjë qastë nga shqetësimet dhe preokupimet e popullatës shumicë. Në lidhje me këtë Qeveria e Kosovës ka qenë dhe është e vetëdijshme se duhet me çdo kusht të ruhet besimi i popullit të Kosovës në procesin në të



cilin gjendëmi. Unë shpresoj sinqerisht se kjo seancë e sotme do të jetë një arsye më shumë që njerëzit tanë të besojnë që Ekipi i Unitetit i udhëhequr nga presidenti Sejdiu dhe me këtë kontekst edhe unë dhe Qeveria e Kosovës do të jemi përfundimisht konsekuent drejtë realizimit të synimit tonë të drejtë dhe fisnik për krijimin e një Kosove të lirë të pavarur demokratike.

Dy kanë qenë çështjet kryesore që e kanë preokupuar opinionin publik dhe politik të Kosovës: decentralizimi dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore fetare në Kosovë. Për decentralizimin ne kemi ndjekur parime të njëjta siç i thashë më lart dhe si i tha edhe presidenti duke mbështetur Ekipin Negociator me të dhëna me ekspertizë, por edhe me angazhim të drejtëpërdrejtë. Qëllimi ynë është që të bëjmë të mundur vetëqeverisjen lokale për pakicat me fokus të veçantë për atë serbe, por që në të njëjtën kohë të ruhen funksionaliteti i shtetit dhe qeverisja demokratike në tërë Kosovën. Ne besojmë që jemi në rrugë të mirë që t'i realizojmë synimet tona dhe t'u mundësojmë pakicave t'i realizojnë të drejtat e tyre të plota në shtetin e pavarur të Kosovës që gjithsesi do të jetë edhe shtet i tyre. Kosova dhe shqiptarët në përgjithësi kanë qenë dhe janë model, besoj ,në gjithë botën për tolerancën fetare. Trashëgimia kulturore dhe fetare nuk do të kishin qenë temë kështu siç janë sot sikur të mos kishte ndodhur marsi 2004. nëpërmjet bisedimeve për mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe fetare ne po dëshmojmë se populli ynë nuk ka asnjë dilemë rreth kësaj çështjeje. Marsi 2004 ka qenë një fatkeqësi, por kurrsesi vullnet i popullit të Kosovës. Në anën tjetër zhbërja e asaj fatkeqësie edhe pse e kushtueshme në aspektin financiarë në atë kohorë dhe mbi të gjitha në atë emocional nuk do t'i cenojë të drejtat e asnjë qytetari të Kosovës në asnjë aspekt as në atë ekonomik dhe as në atë pronësor.

Në fund të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës dua ta them se udhëheqja e urtë e vendosur dhe e guximshme e Ekipit të Unitetit nga presidenti Sejdiu dhe pjesëmarrja aktive dhe konstruktive e të gjithë anëtarëve të Grupit është garanci për sukses në këtë proces. Po ashtu, dua ta falënderoj bashkësinë ndërkombëtare ,posaçërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Unionin Evropian, Grupin e Kontaktit për mbështetje të vazhdueshme të Kosovës, pa një mbështetje të tillë Kosova nuk do të kishte mundur t'i bëjë hapat që i ka bërë deri më tani. Ju faleminderit!

**KRYETARI** – Ju faleminderit z. kryeministër.

Njoftoj se seanca ka filluar më 83 deputetë .

Fjalën e radhës e ka anëtari i Grupit të Unitetit z. Hashim Thaçi.

**DEPUTETI HASHIM THAÇI** – anëtar i Grupit të Unitetit. Zonja dhe zotërinj, i nderuari kryetar i Parlamentit Kolë Berisha, i nderuari z. president, deputetë të nderuar dhe qytetarë të respektuar të Kosovës, të nderuar mysafirë.

Më lejoni fillimisht t'i shpreh mirënjohje presidentit Ahtisari, ambasadorit Rohan dhe ekipit të tyre për përkushtimin e treguar gjatë procesit të statusit. Falënderoj Grupin e Kontaktit për mbështetjen e vazhdueshme, në veçanti kontributin konkret të zyrave diplomatike në Prishtinë, pastaj edhe angazhimin e drejtëpërdrejtë të UNMIK-ut, por edhe KFORI-it. Zonja dhe zotërinj . informimi i sotëm nga Ekipi i Unitetit mendoj se duhet të



ndodhte edhe më herët, por kjo nuk ndodhi, por megjithatë është mirë që po ndodh sot. Jemi ftuar si Ekip Negociator për të informuar për procesin e bisedave me komunitetin ndërkombëtar, për fat të keq sot Ekipi i Unitetit nuk është ekip i votuar që e mori besimin nga Kuvendi i Kosovës sot e para një viti, kjo po reflektohet në punën tonë. Ekipi i Unitetit fillimisht kishte mandat, -fuqi, legjitimitet përfaqësime dhe adresa politike e qytetare të përgjegjësive marrëse dhe llogaridhënëse. Ndryshimet kadrovike nuk e kanë kapur reflektimin e parashikuar në punën e Ekipeve Negociator, Ekipi i Unitetit të nderuar deputetë papritmas u ndodh para dilemave të mëdha, u dobësua fuqia vendimarrëse, megjithëkëtë Ekipi i Unitetit ka bërë punë në kontinuitet, ka prezantuar qëndrimet e përbashkëta që ka menduar që janë më të mirat, por në veçanti ka bashkëpunuar mirë me bashkësinë ndërkombëtare, Ekipi i Unitetit ka marrë vendime të urta. Gjatë procesit negociator në momente të veçanta dhe delikate janë vërejtur tendenca dhe prije mediale të individualizimit të punëve apo vrapit të keq në formën e grabitjes së suksesit të Ekipeve të Unitetit ose të distancimit nga ndonjë lëshim që është bërë në punë. Të qenit sot në procesin negociator si do që të jetë nesër, pozicioni i tij politik nuk duhet të vazhdojë të keqpërdoret nga askush për nevojat e konsumit politik apo betejave politike brenda partiake. Ky moment politik dhe historik është më tepër i rëndësishëm për popullin tonë se sa karriera politike e çdo individ. Uniteti ruhet dhe kultivohet duke investuar angazhim, përkushtim, seriozitet dhe vendosmëri dhe kulturë që ka vetëm një qëllim të lartë interesin e vendit dhe të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Pavarësia dhe krijimi i shtetit të Kosovës është obligim që rrjedhë nga vullneti i qytetarëve, është obligim i Grupit të Unitetit, ta zyrtarizojë. Kosova ka fituar lirinë fizike dhe politike, pra pavarësinë në qershor të vitit 1999, sot ne duhet ta mbrojmë këtë të arritur dhe ta zyrtarizojmë. Partia Demokratike e Kosovës është duke marrë pjesë në mënyrë aktive dhe të përkushtuar në këtë proces historik. Objektiv jetësor i secilit nga ne duhet të jetë ndërtimi i shtetit të Kosovës dhe jo ardhja apo ruajtja me çdo kusht e pushtetit.

Ne sot përballemi me kritika të qytetarëve dhe shoqërisë së lirë të hapur për rol pasiv opozitar, por dua t'ua bëjë me dije të gjithëve se unë dhe PDK-ja kemi shumë arsye të jemi aktiv në këtë proces, arsyet nuk vihen në interesat e kufizuara politike, të luftës për pushtet e karrierë, por për të ardhmen e vendit, perspektivën më të mirë të qytetarëve tanë që ka vetëm një emërues zyrtarizimin ndërkombëtar dhe realitetit të ri të shtetit të Kosovës, për çka dje kemi luftuar si komb i tërë dhe sot po punojmë.

Liria dhe pavarësia e Kosovës është meritë e sakrificës së çdo qytetari të Kosovës, përulemi me respekt para kësaj vlere të sakrificës gjithë qytetare për çlirimin e Kosovës dhe ndërtimin e shtetit të ri të Kosovës. Mbi çdo interes momental, pushtet dhe Qeveri është përkushtimi dhe vendosmëria jetësore për ndërtimin e shtetit të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Duhet kuptuar se të qenit e opozitës në Grupin e Unitetit nuk i krijon imunitet keqeverisjes aktuale, kjo është duke e varfëruar qytetarin në shkajshmëri ekzistenciale dhe duke pasuruar grupe dhe individë të politikës lidhur me krimin e organizuar. Nuk e justifikon Qeverinë për shkallën e lartë të korrupsionit, nuk e justifikon Qeverinë për gjendjen alarmante në shëndetësi dhe degradimet ekstreme në arsimin kosovar, nuk e

arsyeton degradimin e vazhdueshëm të zhvillimit ekonomik dhe privatizimin aktual me parametra antiekonomikë për zhvillimin e vendit, nuk e justifikon Qeverinë që sot Kosova është në terr, papunësia është enorme, nuk e justifikon mos angazhimin për kategoritë sociale, pensionistët, invalidët e luftës dhe të punës, të hendikepuarit që jetojnë në mëshirën e fatit apo të ndihmave sociale.

Të nderuar deputetë,

Dëmet dhe pasojat e kësaj qeverisjeje janë evidente edhe në pozicionin aktual politik të negociimit. Deri në një masë janë duke u zbehur edhe pozicioni negociues i palës Kosovare. E ripërseris se PDK-ja si opozitë do të vazhdojë të punojë dhe kërkojë edhe nga të tjerët ta forcojnë angazhimin dhe procesin bisedues për arritjen e marrëveshjes për shtetin e Kosovës. PDK-ja si opozitë demokratike do t'i vërë në pah kritikën e bazuar dhe faktet për keq-qeverisjen. Në të njëjtën kohë duke punuar që për çështjen e statusit ta ruajë unitetin kombëtar, qytetar dhe politik.

Të nderuar deputetë,

Të nesërmen pas marrëveshjes për status Grupi Negociator e humb çdo kuptim, duhet të pushojë së funksionuari. Të nderuar deputetë në Kosovë duhet të fillojë të funksionojë demokracia. Qeveria duhet ta ketë adresën e vet të përgjegjësive llogaridhënëse para qytetarëve. Opozita, po ashtu, adresën dhe ofertën e vet alternative për të ardhmen më të mirë të Kosovës. Znj. dhe z. duhet ta forcojmë rolin vendimarrës të Kuvendit të Kosovës. Parlamenti i Kosovës duhet ta ketë rolin aktiv në procesin aktual historik. Kushtetuta e re e Kosovës duhet të nxirret shpejt, pas definimit të statusit, duhet t'u ikim improvizimeve të ngurta politike, kjo kushtetutë duhet të miratohet me rastin më të mirë nëpërmjet referendumit qytetar, apo së paku 2/3 të Kuvendit të Kosovës. Të nderuar deputetë. Është detyrë dhe obligim ynë që të ndërtojmë Kosovën shtet, që punon drejt krijimit të identitetit të vet qytetar dhe shtetëror, ku të gjithë qytetarët do të jenë shtetas të barabartë me të drejta të dyshitetësisë me marrëveshje bilaterale apo trilaterale, shtet që bashkëpunon me të gjithë fqinjët me respektim të sovranitetit dhe integritetit territorial të njëri – tjetrit, anëtar i Kombeve të Bashkuara, integritetit Evropian dhe NATO-s. Kosova duhet t'i ketë simbolet e veta shtetërore që do të pasqyrojnë identitetin qytetar të saj. Kosova – vend dhe shoqëri me demokraci qytetare, Kosova e pavarur me shoqëri shumetnike dhe me shumë fe, kundër diskriminimit në baza të identitetit etnik, gjinor, racor ose fetar, në mbrojtje të të drejtave të pakicave, shtet ku gjuha shqipe dhe gjuhët e komuniteteve do të kenë trajtimin adekuat kushtetues. Nënshkruese e Kartës Evropiane të të drejtave të njeriut dhe e paktit për të drejtat civile dhe politike dhe traktateve të tjera relevante. Vend ku sundon ligji me legjislacion për interes të të gjithë qytetarëve, me kushtetutë dhe përputhje me ato të shteteve demokratike perëndimore, me gjyqësi të pavarur, të paanshme dhe të përgjegjshme. Kosova me kufij ekzistues, me garanci të sigurisë nga NATO-ja, duke përfshirë ngritjen dhe zhvillimin e forcës mbrojtëse të Kosovës të integruar në NATO. Pjesë e përpjekjeve ndërkombëtare kur terrorizmit, krimi të organizuar dhe trafikimit. Kosova me ekonomi të zhvilluar – euro si valutë, marrëveshje të tregtisë së lirë me vendet fqinje dhe me vendet e tjera, respektim dhe mbrojtje me ligj të pronës private, lehtësim të investimeve ndërkombëtare, krijimit të

kuadrit favorizues për ndërmarrjen e lirë dhe biznesin e vogël dhe të mesëm, rrethana favorizuese për diasporën kosovare. Kosova më qeverisje funksionale dhe të efektshme, me shërbim civil modern dhe profesional, me status të mbrojtur me ligj, reforma zgjedhore me aplikimin e listave të hapura, Parlament të përgjegjshëm ndaj nevojave të të gjithë qytetarëve, paga në sektorin publik konkurrenente me atë në sektorin privat, shoqëri aktive civile, media të lira dhe të pavarura. Kosova shtet që kujdeset për mirëqenien sociale, që ofron asistencë për qytetarët që nuk kanë mundësi t'i përmbushin nevojat elementare për veten dhe familjet e tyre. Pensione të rregulluara me ligj, standarde evropiane të shëndetësisë, arsimit dhe sigurisë në punë, përkujdesje për invalidët e luftës dhe të punës. Shtet që mbron trashëgiminë kulturore, të të gjithë qytetarëve që siguron kthim të qëndrueshëm dhe të sigurt të të gjithë refugjatëve në shtëpitë dhe pronat e tyre.

Reformimi i pushtetit lokal sipas parimeve integruese qytetare dhe marrëveshjes, Kosova do ta mirëpret angazhimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të NATO-s, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian, për garantimin e paqes, të sigurisë, asistencën e vazhdueshme ndërkombëtare në forcimin e institucioneve demokratike, gjyqësore dhe civile, asistencën e vazhdueshme ndërkombëtare për rimëkëmbjen dhe zhvillimin e ekonomisë dhe të infrastrukturës. Do t'i forcojmë raportet shumë të mira me fqinjët tanë, Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi, jemi të përcaktuar edhe për raporte të fqinjësisë së mirë edhe me Serbinë. Zonja dhe zotërinj, statusi politik i Kosovës nuk është çështje e debatit juridik apo kushtetues. Statusi i Kosovës nuk është i lidhur me regjimet në Beograd apo me ndërrimet e pushteteve në Serbi, Kosova nuk ka qenë dhe nuk është pjesë e Serbisë, Serbia ka qenë me dhunë e pranishme në Kosovë. Në Kosovë ka pasur luftë, në këtë luftë ka pasur fitues dhe humbës, është sakrifikuar një popull i tërë për çlirimin dhe lirinë e Kosovës, Serbia ka kryer gjenocid në Kosovë, ky është argumenti për pavarësinë e Kosovës.

Kosova e re duhet të jetë shtet i ndërtuar në themele të forta të vlerave demokratike të qytetërimit perëndimor. Kosova nuk do të jetë shtet vetëm për shqiptarët, por për të gjithë qytetarët e saj, Kosova e pavarur me Mitrovicë të bashkuar. Pavarësia e Kosovës është zgjidhje reale dhe integruese, pavarësia e Kosovës ka procesin e stabilitetit dhe perspektivën evropiane për gjithë rajonin, pavarësia e Kosovës është vendim politik i cili buron nga vullneti i qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran, pavarësia është zgjidhja e vetme për Kosovën. Ju faleminderit, z. Surroi

**KRYETARI** – Ju faleminderit z. Thaçi, fjalën e ka z. Surroi, anëtar i Grupit të Unitetit.

**DEPUTETI VETON SURROI** – anëtar i Grupit të Unitetit. I nderuar z. kryetar i Kuvendit, i nderuar z. kryetar Sejdiu, anëtar të Ekipit të Unitetit, zonja dhe zotërinj deputetë, mysafirë të nderuar.

Pothuajse në 10 muajt e fundit kemi punuar në detyrë të veçantë për krijimin e një projekti të ri që ka të bëjë me marrëdhëniet ndërmjet popullit shumicë në Kosovë dhe komuniteteve që gjenden me pakicë numerike. Qëllimi ynë afatgjatë ka qenë që të ndërtojmë një cilësi të re marrëdhëniesh, një cilësi që nuk e kemi pasur deri më tani, një cilësi e cila do të reflektojë qëndrueshmërinë e shtetit të pavarur të Kosovës dhe të



marrëdhënieve ndëretnike në të. Kemi përdorur disa nocione ose disa parametra fillestarë. I pari është nocioni liberal i ndërtimit të shtetit të qytetarëve të Kosovës, por njëkohësisht duke pranuar se në atë shtet liberal të qytetarëve ekzistojnë interesa të komuniteteve etnike, interesa që duan të integrohen në rregullimin e ardhshëm kushtetues juridik të Kosovës. Nocioni i dytë ose pikënisja e dytë ka qenë që ekziston një realitet demografik dhe atë duhet respektuar, ai realitet demografik flet për një përqindje prej 90 të popullit shumicë dhe 10 të komuniteteve pakicë, realitet politik që rrjedh nga procesi negociator, nga tërë historia paraprake është po ashtu se në definimin e statusit një vëmendje e veçantë i dedikohet komunitetit serb në rregullimin e këtyre marrëdhënieve. Pikënisje ka qenë evoluimi i përhershëm i nocioneve të së drejtës apo të mbrojtjes së komuniteteve në Evropën e sotme. Natyrisht dhe pashmangshmërisht baza fillestare ose nocioni komiza e madhe e rregullimit të këtyre marrëdhënieve ka qenë momenti historik. Ky është i vetmi moment historik, në të cilin kemi mundësi t'i rregullojmë marrëdhëniet pa dhunë dhe pa ndrydhjen e dhunës, kjo është hera e parë që populli shumicë, populli i përndjekur mund të ofrojë njohjen e garancive për komunitetet që gjenden me pakicë. Ky moment historik është i veçantë jo vetëm për Kosovën, por për shumë popuj të tjerë evropianë.

Në duar e keni dokumentin që është platformë për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve pakicë, Në metodologji jemi nisur nga përgjigjet e pyetjeve që na i ka paraqitur z. Ahtisari për atë se si mendojmë se do të dukej Kosova e ardhshme në kuptimin e mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve. Jemi nisur nga një parim i thjeshtë konsultativ, kemi filluar të konsultohemi me njëri-tjetrin dhe kemi kaluar në disa runde konsultimesh, qoftë në Kosovë, qoftë në Durrës, qoftë në Selanik me ndihmën e madhe të Qendrës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve dhe z. Veler personalisht ishte dhe është i angazhuar në këtë drejtim. Jemi përpjekur ta krijojmë një konsensus në ndërmjet partive politike shqiptare të përfaqësuara në Grupin e Unitetit, në mënyrë që çështjet që i prezantojmë si qëndrime ndaj komuniteteve pakicë, të kenë legjitimitetin e nevojshëm të shumicës dhe natyrisht jemi përpjekur që gjuha të jetë më e përafërt me gjuhën e Unosekut të ekspertëve të z. Ahtisari, si produkt është dokumenti që e keni në dorë. Mos harroni, ky është produkt që nuk reflekton vetëm dëshirën e njërës palë as vetëm projeksionin teorik të asaj se çka mund të bëhet, por përfshin atë që është produkt i marrëveshjes, i marrëveshjes së shqiptarëve, i marrëveshjes ndërmjet komunitetit shumicë dhe komuniteteve që gjenden me pakicë numerike dhe në fund është produkt i marrëveshjes në masë të madhe edhe me Bashkësinë Ndërkombëtare.

Në këtë dokument do të shihni se baza e mbrojtjes, shtylla kurrizore e mbrojtjes së ardhshme të drejtave të komuniteteve pakicë, është ligji i veçantë kushtetues, që duhet ta kalojë Kuvendi, një ligj i veçantë kushtetues për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, me këtë ligj të veçantë të drejtat e komuniteteve bëhen pothuajse të pandryshueshme. Kjo është garanci e fortë për të gjitha ato komunitete pa marrë parasysh se çfarë është numri i tyre. Po ashtu si kategori e re në sistemin tonë kushtetues juridik shpresojmë që të jetë kategoria e interesit vital ku definohet taksativisht se çka është interesi vital i komuniteteve për që gjë do të duhet një sistem tjetër i vendimarrjes, çka është interesi vital dhe mbetet i pandryshuar nga raportet politike. Brenda këtij interesi (vital) do të shihni se sa e ndërlikuar është kjo, është përdorimi i gjuhëve, ku në dokumentin tonë

kemi propozuar dhe për këtë krenohem se ka qenë pjesë e konsensusit të përgjithshëm edhe shqiptarë edhe të gjitha komuniteteve që si gjuhë që do të përdoren në komunikim zyrtar në nivelet komunale, do të jenë edhe gjuha boshnjake, gjuha turke edhe gjuha rome. Për fat të keq ka pasur keqkuptim në Kuvend, por besoj se kjo do të tejkalohet dhe do të reflektojë atë që është konsensus i përgjithshëm.

Instrumentet e mbrojtjes së komuniteteve do të jenë: Në legjislativ nëpërmjet përfaqësimit të garantuar dhe jo të rezervuar. Jemi përpjekur ta thëllojmë pak mënyrën si është rregulluar në të kaluarën në Kornizën Kushtetuese, ndonëse mendojmë se duhet të ketë të drejta afirmative për komunitetet, nuk mendojmë se në të ardhmen me sistemet e kaluara komunitetet të përfaqësohen me 30 apo më shumë deputetë të Kuvendit, kemi saktësuar një procedurë që u jep të drejta të plota së paku 20 vende të garantuara komuniteteve dhe shpresojmë se kjo do të ndikojë dhe do të stimulojë pjesëmarrjen e tyre në zgjedhje, në mënyrë që të rritet edhe numri i deputetëve. Kemi futur çelsin e dyfishtë të Badenterit për interesat vitale e kjo do të thotë se asnjë ligj që ka të bëjë me interesat vitale të qytetarëve që gjenden në pakicë nuk mund të ndryshohet nëse për të nuk voton shumica e deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe shumica e anëtarëve të komuniteteve pakicë që gjenden në Kuvend në ditën e votimit.

Kemi integruar ose do të përpiqemi t'i integrojmë në sistemin e ardhshëm kushtetues – juridik Këshillin Konsultativ të Komuniteteve që ky këshill të jetë pranë Zyrës së Kryetarit të Kosovës dhe të ketë mandat të unifikimit ashtu siç e ka edhe Zyra e kryetarit të interesave të komuniteteve dhe të popullit shumicë dhe kemi futur një qeverisje të re komunale që është nënkryetari i kuvendit komunal nga radhët e komuniteteve pakicë.

Në ekzekutiv përgjigjja jonë ndaj kërkesave të zyrës së Unosekut ka qenë se dokumentet e ardhshme kushtetuese juridike të Kosovës nuk mund të përmbajnë formulime të ministrive etnike, Qeveria e ardhshme e Kosovës nuk mund të jetë e parapërcaktuar sipas etnive. Kjo duhet të varet nga marrëveshjet politike, dhe nga koalicionet që bëhen, mirëpo meqë ka ekzistuar një trysni, duke u mbështetur në të drejtat e fituara jemi pajtuar që në procesin e zbatimit të marrëveshjes për statusin e Kosovës të respektohet maksimalisht, në dy mandate, formula e deritanishme e Kornizës Kushtetuese. Po ashtu kemi futur një procedurë të veçantë për zgjedhjen e shefit të policisë që do të respektojë konsultimin me komunitetet që gjenden në atë komunë.

Në gjyqësor kemi pasur propozime të nduarnduarta, njëri prej tyre edhe më i rëndi ka qenë që të formulohet një formë e atillë e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në të cilën gjykatësit shqiptarë do të ishin me pakicë. Ne kemi propozuar forma alternative të mbrojtjes të të drejtave të interesave vitale nëpërmjet formimit, siç e ceku edhe kryetari Sejdiu, të panelit për interesa vitale pranë Gjykatës Kushtetuese që do të merret ekskluzivisht me çështje që kanë të bëjnë me shkeljet eventuale të të drejtave vitale. Po ashtu në vend të propozimeve dhe trysnisë që të formohen gjykata etnike të apelit, në këtë rast një gjykatë e veçantë etnike në Mitrovicë, ne kemi propozuar të mos ketë dhe gjyqësori të jetë i unifikuar, mirëpo në çështjet që kanë të bëjnë me nacionalitete të ndryshme paneli i gjykatësve të reflektojë atë gjendje ose atë realitet.

Na kanë mbetur për datën 8 disa pika kontesuese që janë tri ,që ende kanë mbetur pa u zgjidhur. Është insistimi ynë në pjesëmarrje në Kuvend të jenë të drejtat e garantuara e jo të rezervuara, të mos ekzistojë gjykatë e apelit e veçantë për komunitetet ose etnifikim i gjykatës dhe është insistimi ynë që pjesëmarrja në Qeveri të mos ketë demonacion etnik. Këto janë tri çështje që ende duhet t'i sqarojmë me Unosekun më 8. Kemi kërkuar nga z. Ahtisari që këtë dokument t'ia dorëzojë delegacionit të Beogradit. Mendojmë se Beogradi mund t'i integrojë kërkesat e veta, t'i mbrojë interesat e komunitetit serb në Kosovë nëpërmjet përmirësimeve eventuale në dokumentin tonë, por brenda konceptit të raporteve ndërmjet popullit shumicë dhe komuniteteve që gjenden në pakicë. Kanë mbetur dy çështje po ashtu të pasqaruara në këtë moment në dokumentin tonë. E pari ka të bëjë me karakterin e zgjidhjes së çështjes së Mitrovicës, ku ne insistojmë në unifikim të qytetit nëpërmjet dy komunave dhe një bordi administrativ, aty ka mbetur se çfarë do të jetë roli i administratorit ndërkombëtar karshi mbrojtjes së interesave të komuniteteve dhe çështja e dytë ,që ka mbetur e pasqyruar në tërësi, jo vetëm për këtë, por edhe për të gjitha dokumentet e tjera janë roli dhe karakteri i pranisë së ardhshme ndërkombëtare në Kosovë, si do t'i reflektojë injierencat e ardhshme ndërkombëtare në mënyrën e funksionimit dhe të implemimentimit të marrëveshjes për status politik. Ne mendojmë se këto të drejta nuk mund të kufizohen dhe se evolimi i të drejtave është pjesë e një procesi evropian dhe në të gjithë këtë rrugëtim jemi konsultuar, në mënyrë të përhershme me përfaqësuesit politikë të Luginës së Preshevës, ne mendojmë se nuk mund të bëhet një reciprocitet, se do të ishte një moment shumë i mirë për Serbinë që të reflektojë dhe të futet në një garë pozitive për njohjen e të drejtave të shqiptarëve në Luginën e Preshevës në bazë të asaj çka ofrojmë ne për zgjidhjen e të drejtave të komuniteteve. Ju faleminderit!

**KRYETARI** – Ju faleminderit z. Surroi, fjalën e ka deputeti Gjergj Dedaj.

**DEPUTETI GJERGJ DEDAJ** – Faleminderit z. kryetar. Fillimisht dua të paraqes një mospajtim që nuk ma keni dhënë fjalën në fillim, sepse konsideroj se materialin e kemi marrë shumë vonë, duke hyrë në sallë. Janë disa qindra faqe dhe ai nuk mund as të shfletohet, lëre më të lexohet për disa minuta, d.m.th nuk kemi materie për çka do të bënim një debat. Kjo është e padrejtë, mund të them, që u bëhet të gjithë deputetëve dhe u pamundësohet një debat konstruktiv. I nderuari z. president, z. kryeministër, anëtar të ekipit të Unitetit, si po thoni edhe pse 17 parti politike janë në Kuvendin e Kosovës, i përfaqësoni vetëm 4 parti politike, nëse do të paraqes disa pikëpamje që do të bien ndesh me ato çka u thanë edhe me ato që shpeshherë thuhet edhe në media, mos e shihni për të madhe, kam të drejtë si qytetar, si deputet, t'i shpreh shqetësimet e mia dhe do ta shfrytëzoj rastin që t'i shpreh ashtu si unë i mendoj dhe ashtu si unë i perceptoj.

Disa herë, meqë i takoj brezit të politikanëve, nëse mund të quhemi politikanë të viteve '90 jemi të mashtruar, i takoj brezit që thuhej republikës e republika që 16 vjet nuk është askund. Kam pasur rastin, fatin ose fatkeqësinë që të jem aty me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes në Paris, ku u tha se mbas tre vjet pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje do të respektohet vullneti i popullit të Kosovës. Kjo nuk ndodhi, u bënë 7 vjet dhe nuk po ndodh. Të mos i përmend premtimet që na bëheshin gjatë fushatave zgjedhore. Qeveria që është tash në pushtet në koalicion në vitin 2004 thoshte votoni për ne në vitin



2005 do ta bëjmë shtetin e pavarur të Kosovës, do ta bëjmë realitet pavarësinë e Kosovës. As kjo nuk ndodhi të nderuar deputetë. Thoshin votoni për ne do ta bashkojmë Mitrovicën e ju keni të drejtë të qeshni, por vetëm atyre që kanë dëshirë dhe që ndihen shumë komodë, se unë jam shumë liberal. Kjo nuk po ndodh, por po ndodh ndarja e Mitrovicës. Ne mund ta mashtrrojmë popullin si të duam mund t'i formulojmë këto formulimet tona politike, t'i maskojmë si të duam, por në Mitrovicë po bëhen dy komuna e një bord është paraparë një mbikëqyrës ndërkombëtar, tash shtrohet pyetja me largimin e atij ndërkombëtar, de facto dhe de jure do t'i kemi dy Mitrovica, të mos flasim për një katalog premtimesh që i kanë bërë partitë politike gjatë fushatave zgjedhore dhe mund ta marrim atë katalog prej "A" deri në "ZH" besoni asnjë nuk e keni përmbushur. Po t'jua përmendësh të gjithë do të bindeni të, por meqë jeni deputetë dhe liderë, të gjithë e kuptoni dhe e dini se nuk i keni përmbushur. Më vonë u formua edhe Grupit Negociator pikërisht në këtë Kuvend. Ekipi Negociator, deputetët nuk e kemi mandatuar asnjëherë për të biseduar me Beogradin, disa herë u kam dëgjuar, bile edhe fëmijët e Kosovës te shtëpitë ju kanë dëgjuar. Statusi i Kosovës është i panegociueshëm. Pikërisht shkua në Vjenë pa e marrë mandatin, pa e shtruar këtë çështje në këtë Kuvend se a mund të bisedohet me Beogradin për statusin politik të Kosovës dhe nuk ma merit mendja se në Vjenë keni biseduar me presidentin Tadiç, me kryeministrin Koshtunica dhe me liderët e Serbisë për çështje të kampionatit botëror që pikërisht mbahej në atë muaj, por aty janë shtruar çështjet e statusit politik të Kosovës dhe kjo është një shkelje e premtimeve tuaja, kjo është një shkelje e vullnetit politik të qytetarëve të Kosovës dhe mbi të gjitha kjo është një shkelje e sovranitetit të Kuvendit të Kosovës që reflekton vullnetin e qytetarëve të Kosovës dhe votën e lirë të tyre. E di se nuk ju pëlqen partive që jeni në Grupin Negociator, por unë propozoj që të shpallet moratorium i Ekipit Negociator të Kosovës ose që është edhe më e rëndësishme, të shkarkohet nga Kuvendi i Kosovës, të hyjë në procedurë të shkarkimit Ekipi Negociator i Kosovës, për shkak të këtyre shkeljeve, për shkak se nuk e ka marrë asnjëherë mandatin para asnjë takimi dhe nuk e ka bërë raportim eksplisit dhe nuk ka mundësuar debat në Kuvendin e Kosovës për të gjitha këto lëshime, njëkohësisht propozoj që deputetët e nderuar, kurse unë e shoh se ka shumë defekt kjo që jemi zgjedhur me lista të mbyllura dhe nuk mund të dalim jashtë vijës partiake, ta shtrojmë çështjen e mocionit të votëbesimit, kryeministrin Çeku, për presidentin Sejdiu dhe për kryetarin e Parlamentit z. Berisha, se ndoshta kam të drejtë ose ndoshta nuk kam të drejtë, ndoshta mund ta fitojë vetëm një votë. Vota ime do të jetë se nuk do t'ia jap më besimin, por është me rëndësi t'u jepet mundësia deputetëve të Kuvendit të Kosovës, është shumë demokratike të deklarojmë për këtë votëbesim, sepse me Serbinë me sa di unë i kemi kryer të gjitha çështjet me gjak në vitin 1999. Serbia është humbëse në Kosovë me vrasjen e djemve, e prindërve tanë dhe pikërisht tash Ekipi Negociator mund me të thotë me një papërgjegjësi të paparë dëshiron që këtë fitore me gjak që e ka bërë populli i Kosovës ta vërë në tryezën e bisedimeve dhe të pazareve të ndryshme që është e papranueshme, është e mëkatueshme, e dëmshme dhe do të prodhojë pasoja për të ardhmen e Kosovës. Njëkohësisht propozoj që ky Kuvend të shpallë urgjentisht pavarësinë e Kosovës, të fillojë procedurën për hartimin e Kushtetutës së Kosovës dhe njëkohësisht t'i lusim qendrat ndërkombëtare në botë, në SHBA dhe në Evropë, Këshillin e Sigurimit që ta njohin pavarësinë e Kosovës, para se të bëhet shumë vonë. Pra, çdo ditë është duke u vonuar pikërisht me fajin e Ekipit Negociator që nga ky moment nuk e ka besimin tim si deputet i Kuvendit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI – Ju faleminderit! Fjalën e ka Gjylnaze Syla si paraqitëse e kërkesës.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA - I nderuari z. president, kryetar i Kuvendit të Kosovës, z. kryeministër, z. Thaçi, z. Surroi, mysafirë dhe deputetë të nderuar.

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së të falënderoj Ekipin e Unitetit për raportin. Nga ky raport është e qartë se ekipi i Unitetit ka punuar me seriozitet dhe përkushtim. Megjithatë kemi një vërejtje për Kryesinë e Kuvendit të Kosovës lidhur me sigurimin e dokumentacionit me kohë. Si grup konsiderojmë se dokumentacioni është dashur të sigurohej më parë që deputetët të mund ta shqyrtojnë. Të nderuar deputetë, momenti i tanishëm është kyq dhe duhet të reflektojë unitetin e mëtejme, urtinë, maturinë dhe pjekurinë e Delegacionit të Kosovës, por edhe të gjithë neve. Ky moment vendimtar gjithashtu kërkon intensifikimin e përpjekjeve dhe përkushtimin edhe më të madh politik në realizimin e projektit të popullit të Kosovës për Kosovën shtet sovran dhe të pavarur. Pritjet tona janë se përcaktimi i statusit të Kosovës konform vullnetit të popullit të Kosovës do të bëhet në fund të këtij viti. Në këtë perspektivë dëshiroj t'i shtroj tri çështje. Është me rëndësi që Ekipi i Unitetit t'i kuptojë pikëpamjet e anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit që përfaqësojnë popullin e Kosovës, pavarësia do të arrihet, por duhet të jemi të kujdesshëm. Koha deri në përfundimin e procesit dhe në përcaktimin e statusit të Kosovës do të jetë një presion i madh për të gjithë ne dhe me siguri posaçërisht në Delegacionin e Kosovës që të pajtohet me propozimet ndërkombëtare. Ne gjithmonë do të jemi mirënjohës ndaj bashkësisë ndërkombëtare për kontributin e vazhdueshëm dhënë Kosovës në veçanti të SHBA-ve, Bashkësisë Evropiane, NATO-s, Grupit të Kontaktit, nuk kemi asnjë dyshim në qëllimet e mira të bashkësisë ndërkombëtare ose të atyre që na bindin të bëjmë lëshime më të mëdha në çështjen e decentralizimit, të gjithë e duam zgjidhjen në fund të kësaj faze, por progresi i arritur deri më tani mund të rrezikohet nëse bisedimet për decentralizim udhëhiqen nga parimi etnik i cili mundëson krijimin e komunave në baza etnike, për më tepër kjo mund të rrezikojë stabilitetin e tërë rajonit. Qasjen e Ekipit të Unitetit që brenda tërësisë së Kosovës të arrihet realizimi maksimal i të drejtave për minoritetet Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështet plotësisht, por duhet të merret parasysh funksionaliteti i shtetit të Kosovës si tërësi dhe shtet demokratik. Jemi ne qytetarët e Kosovës që duhet të jetojmë me pasojat e zgjidhjes dhe jemi ne që do të paguajmë çmimin nëse zgjidhja nuk është e realizueshme ose nëse shkakton rritjen e problemeve të sigurisë, të atyre sociale, politike dhe ekonomike në të ardhmen. Jemi thellë të bindur se ky Kuvend nuk do ta miratojë kurrë propozimin që në mënyrë fundamentale do të dobësonte shtetin e ardhshëm të Kosovës. Ne nuk duhet dhe nuk do ta miratojmë zgjidhjen me të cilën Beogradi sfidon shtetin e pavarur të Kosovës, që do të lejojë sundimin e ligjit në një pjesë të shtetit të pavarur të Kosovës, por jo në pjesë të tjera dhe as nuk do t'i miratojmë aranzhimet kushtetuese që janë barrë permanente dhe e pamëshueshme për financat tona publike. Të gjithë qytetarët e Kosovës duhet të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta, gjithashtu duhet të jenë besnik të shtetit të Kosovës, t'i respektojnë institucionet demokratike të shtetit dhe ligjet e shtetit të vet. Ne duhet të jemi të vendosur për çështjet kyçe që kanë të bëjnë me të ardhmen e popullit të Kosovës. Kjo është çështja e parë.

Çështja e dytë është e lidhur me të parën. Mbështetja jonë për minoritetet duhet të jetë edhe më e fuqishme dhe me përkushtim më të madh, por duhet të kujtojmë gjithmonë



kontekstin e kësaj mbështetje, konteksti është shteti i pavarur i qytetarëve të barabartë. Kjo nuk është një zgjidhje tjetër e përkohshme që lë hapësirë negociimesh në të ardhmen, krijimi i një përceptimi të tillë nuk do ta fuqizonte pozitën e minoriteteve. Pozita e minoriteteve në Kosovë mund të sigurohet me zgjidhjet që janë të zbatueshme, praktike, të drejta që respektojnë sovranitetin e shtetit të Kosovës. Grupi Parlamentar i AAK-së inkurajon dhe përkrah Delegacionin e Kosovës në përpjekjet e tij që propozimet për zgjidhjen e problemit të Mitrovicës të mundësojnë ri integrimin e qytetit të Mitrovicës, kjo është çështja e dytë.

Çështja e tretë dhe e fundit është gjithashtu e lidhur me dy të parat. Kushtetuta për shtetin e pavarur e sovran të Kosovës është në radhë të parë përgjegjësi e Kuvendit të Kosovës. Ekipi i Unitetit mund të sjellë propozime dhe sugjerime, por është Kuvendi ai që bart përgjegjësinë fundamentale, Kushtetuta është shprehje e vullnetit të popullit dhe buron nga ai dhe jo nga procesi i negociatave. I nderuari z. kryetar, Grupi Parlamentar i Aleancës mbështet plotësisht Delegacionin e Kosovës në punën e mëtejme të tij, por në ditën vendimtare çdo vendim për të ardhmen e Kosovës merret nga Kuvendi i Kosovës ashtu siç qëndron në Rezolutën për ri konfirmimin e vullnetit të popullit të Kosovës, për Kosovën shtet sovran dhe të pavarur. Ju faleminderit!

**KRYETARI – Meqenëse një numër i konsiderueshëm yni ka ftesë për të marrë pjesë në ndërrimin e komandës së KFORI-t sot jap pauzë deri në orën 13.**

*Fillimi i seancës pas pauzës në orën 13.10*

KRYETARI - Lus deputetët që t'i zënë vendete e tyre që t'ia fillojmë punës. Vazhdojmë me diskutime. Fjalën e ka Emrush Xhemajli.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – Përshëndetje z. kryetar i Kuvendit, anëtar të grupit për statusin e vendit, z. Sejdiu, Çeku, znj. ulëse e z. Thaçi, z. Surroi, të nderuar të pranishëm.

Ne në Lëvizjen Popullore të Kosovës kemi një mendim ndryshe nga ajo që zakonisht u tha për temën që kemi sot. Ju z. të grupit për statusin e vendit keni në mandat të dyshimtë sa i përket bisedimeve për statusin e vendit edhe sot e kësaj dite nuk u dit se kush votoj pro, kush kundër e kush u përmbajt kur u votua në Kuvend Ekipi për statusin e vendit. Ju keni hyrë në bisedime me Beogradin pa shprehur Serbia më të voglën keqardhje për masakrat dhe okupimin e Kosovës, Për më tepër kjo ka ndodhur në kohën kur ajo vazhdon me shumë sukses luftën kundër Kosovës. Ju e keni rehabilituar dhe legjitimuar dhe amnistuar Serbinë për krimet që ka bërë dhe keni lënë gojëhapur kundërshtarin, pse të kërkojë falje Serbia kur kjo nuk i kërkohet pikërisht nga ata që pa kurrfarë kushti janë ulur në tavolinë në anën tjetër. Pse Serbia s'e njeh realitetin e krijuar në Kosovë dhe vullnetin e qytetarëve të Kosovës, kur këtë nuk e ka kusht për marrëdhënie me Kosovën. E trimëruar tash Serbia jo vetëm që nuk kërkon falje, por kërkon që falje t'i kërkojnë të tjerët. E keni dëgjuar që tash kërkon që falje t'i kërkoj Ahtisari për disa shprehje që ai po i përdor. Me Beogradin ju po bisedoni në kundërshtim me vullnetin e popullit të Kosovës dhe me Rezolutën e 17 nëntorit 2005 të Kuvendit të Kosovës që ka deklaruar të panegociueshme pavarësinë e Kosovës. Secili takim me palën serbe është duke e zbehur çështjen e pavarësisë ,sepse këto takime po reflektojnë mesazhe tragjike për Kosovën.

Viktima dhe agresori janë bërë një. Asnjë gjykatë në botë nuk do t'i zinte besë të dëmtuarit se nuk mund të jetojë bashkë me dëmtuesin kur botat i sheh së bashku çdo ditë si dy partnere që kanë fituar status të njëjtë para gjykatës.

Ju keni dhënë mesazh të pasaktë dhe e keni hutuar edhe bashkësinë ndërkombëtare, ju keni lënë përshtypje se gjoja ka mundësi të negociohet e të bashkëjetojë edhe para pavarësisë së Kosovës me Serbinë dhe kur ju jeni sjell kështu çka pritët prej tjerëve sado miq që t'i kemi. Nga Kuvendi keni pasur mandat të zbatoni atë që është miratuar këtu për 5 pilot- njësitë në baza të afërimit të shërbimeve më afër qytetarëve, ndërsa në kundërshtim me këto projekte që janë edhe ashtu të dështuara ju keni hyrë në tema të tjera, duke përdorur terminologjinë e decentralizimit që në fakt nuk është i tillë. Ju më nuk mund të dilni nga ujërat e ndarjes së vendit në baza territoriale e etnike, duke u siguruar konflikt jo vetëm këtyre, por edhe gjeneratave që ende nuk kanë lindur. Ju keni qenë në gjendje dhe nuk keni dashur t'i sqaroni situatat dhe të mbronni qëndrimin para të caktuarve të OKB-së, ju keni pranuar standarde e kriteret e dyfishta të dëmshme për vendin, keni pranuar të diskutohet për lidhjet vertikale të disa komunave të Kosovës me Beogradin që përbëjnë përafërsisht 5% të popullatës që sipas disa ndërkombëtarëve qenka në rregull dhe qenka standard, kriter dhe nuk keni qenë në gjendje të kërkonit të njëjtin kriter për Kosovën, lidhje vertikale me shumicën e banorëve të Kosovës që duhet t'i ketë Kosova Lindore, si dhe lidhje vertikale pasi që po bëka të Kosovës dhe të Maqedonisë me Shqipërinë. Pa reaguar ndaj dhunës policore që është duke ushtruar ndaj atyre që po protestojnë kundër jush, ju i jeni bashkangjitur kësaj dhune, madje duke e kuptuar dëshirën tuaj për paqe të rrejshme në kohën kur ishte këtu Ahtisari, nëse e keni marrë vesh, policia i rrahu protestuesit edhe pasi i ka futur në burg, duke kryer vepra penale që dënohen edhe me ligje ndërkombëtare.

Ju po e mbani këtë proces të negociatave me anashkalim të procedurave në Kuvend dhe mashtrim edhe me dhunë e me të burgosur politikë. Ju po i gënjoni qytetarët e Kosovës edhe pse e dini se nuk është fjala për pavarësi, por për status të vendit **me tutor**. Kosova po projektohet të jetë e pavarur, po aq sa mund të jetë i pavarur një person i pavarur për veprim i deklaruar në kohën kur gjykata dhe mjeku i caktojnë disa persona të tjerë **tutorë** për t'u kujdesur dhe për të marrë vendime në emër të tij.

LPK-ja propozon që të pushojë dhe të mos vazhdojë më mandati i personave që janë në grupin për statusin e vendit. Për t'u realizuar vullneti i qytetarëve të Kosovës pika e parë duhet të pezullohen bisedimet me Beogradin dhe me Serbinë. Të organizohet referendum në Kosovë për statusin e vendit, pas referendimit për Kosovën të vazhdojë dialog me ata që do ta respektonin vullnetin e popullit të Kosovës dhe të vendosen raporte, jo si këto sot, por raporte të sinqerta në pajtim me vullnetin e popullit të Kosovës me bashkësinë ndërkombëtare. Propozimet që u shtruan këtu nga deputetët Bislimi dhe Gjergj Dedaj dhe këto propozime që i bëra unë ju lutem të votohen me votim elektronik. Ju faleminderit!

**KRYETARI** - Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Jakup Krasniqi.

**DEPUTETI JAKUP KRASNIQI** – Z. kryetar, z. kryetar i Kosovës, kryeministër dhe anëtarë të Grupit Negociator.

Para se ta marr fjalën z. kryetar mendoj se nuk e keni udhëhequr mirë seancën e sotshme pas fjalëve të paraqitura nga anëtarët e Grupit Negociator nëse shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së nuk e ka dashur fjalën, fjalën është dashur ta merrte shefi i Grupit

Parlamentar të PDK-së. Ky është një rend dhe një rregull që duhet të respektohet, në fund të fundit duhet ta respektoni fuqinë politike të grupeve parlamentare në Parlament dhe nuk dëshiroj që kjo të përsëritet edhe ndonjëherë tjetër.

Grupi Parlamentar i PDK-së e mbështet këtë formë të komunikimit të Grupit Negociator me Kuvendin dhe me opinionin publik të Kosovës. PDK-ja dhe Grupi Parlamentar i saj edhe pse në fillim i kemi pasur vërejtjet tona serioze, ne nuk kemi qenë e as nuk jemi opozitë e këtij procesi tepër të rëndësishëm për të sotmen dhe për të ardhmen e Kosovës, madje mund të themi se tani ky proces është shumë më i ndritshëm se në fillimin e tij. Roli i opozitës në këtë proces ka qenë i rëndësishëm për të mos thënë mjaft përcaktues. Ne edhe pse shpesh nuk ishim të kënaqur me nivelin e përfaqësimit të interesave të qytetarëve të Kosovës, kemi qenë të angazhuar sinqerisht dhe seriozisht në këtë proces. Angazhimi ynë ka qenë dhe vazhdon të jetë vetëm në shërbim të shtetit të pavarur dhe sovran, asnjë arsye tjetër, as nuk na ka obliguar dhe as nuk na obligon të jemi pjesë e tij, për faktin se ky është vullneti i popullit shumicë të Kosovës, i shqiptarëve, ky është vullneti i luftëtarëve të lirisë, i dëshmorëve të kombit, ky është vullneti i komandantit legjendar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Adem Jasharit dhe i tre brezave të Jasharajve që u flijuan për liri që është rast unik në historinë e përbotshme ku njëkohësisht bien tre breza për lirinë e vendit të vet, pa të cilët nuk do të ndodhnin proceset demokratike të kësaj dekade, nuk do të ndodhnin as këto negociata e as kjo pritje e madhe me të drejtë për shtetin ligjor. Jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij procesi, po ashtu jemi të vetëdijshëm edhe për vështirësitë objektive e subjektive që e kanë përcjell këtë proces që do të hapë perspektiva të reja e të shumta për Kosovën dhe për qytetarët e saj. Për PDK-në dhe për Grupin Parlamentar dhe për qytetarët e Kosovës, pavarësia e Kosovës është arritur në qershorin e vitit 1999, atëherë kur Ushtria Çlirimtare e Kosovës me përkrahjen politike dhe ushtarake të vendit të demokracisë perëndimore e çliroi Kosovën nga forcat kriminele të regjimit të Beogradit, duke i dhënë fund një herë dhe mirë politikës së dëbimit dhe të shfarosjes, të gjenocidit mbi shqiptarët që ishin bërë në kontinuitet qytetarë shumicë të Kosovës nga pushtuesi për më shumë se një shekull. Gjatë këtyre viteve, sidomos gjatë këtij procesi, Grupi Negociator dhe të gjitha segmentet mbështetëse u angazhuan seriozisht për t'i treguar komunitetit ndërkombëtar e veçanërisht Këshillit të Sigurimit, Grupit të Kontaktit, Bashkimit Evropian, se drejtuesit politikë të Kosovës e sidomos të shumicës shqiptare dhe të komuniteteve pakicë dhe të serbëve ishin të gatshëm që fatkeqësitë e djeshme t'i linin prapashpine edhe pse ato janë shumë të dhimbshme. Këtë po e bëjmë për hir të së ardhmes që në asnjë formë nuk bënë ta përsërit të kaluarën e afërt. Për këtë edhe i kishim ofruar vizionin tonë për shtetin ligjor të Kosovës para se të fillonte ky proces. Neve na vjen keq që komuniteti pakicë i serbëve të Kosovës vazhdon të jetë pengesë e proceseve të reja demokratike, sidomos pengesë e njohjes ndërkombëtare të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës. Ne jemi të bindur se Grupi Negociator i Kosovës u ka bërë qytetarëve serbë të Kosovës, ka tejkaluar të gjitha standardet e njohura ndërkombëtare për vetëqeverisjen lokale dhe të drejtën e komunitetit pakicë. Ne këtë e shohim si vullnet të mirë të shumicës në Kosovë, si çmim të lartë që duhet të bëjnë forcat politike me qytetarët e Kosovës për njohjen ndërkombëtare të shtetit të Kosovës, prandaj shfrytëzoj rastin që edhe nga kjo tribunë e Kuvendit të Kosovës t'u bëjë thirrje qytetarëve serbë të Kosovës që sigurinë ta kërkojnë në Prishtinë e jo në Beograd, që atë ta ndajnë me të gjithë të tjerët në Kosovë se ata për më shumë se 100 vjet nuk garantuan siguri për ta dhe për shumicën në Kosovë, nuk krijuan shtet ligjor e



perspektivë demokratike, këtë nuk mund ta bëjnë as sot e as nesër, ata duhet ta ndërpresin bojkotin dhe të na bashkohen në këtë proces.

Ju që drejtuat dhe morët pjesë në këtë proces besojmë se as deri më tani nuk keni negociuar me përfaqësuesit serbë të Beogradit për pavarësinë, se nuk e kishit as mandatin për këtë, por ndoshta kemi përfillur tej mase partneritetin e Beogradit në raport me të drejtat dhe liritë e qytetarëve serbë të Kosovës për të drejtat nacionale demokratike që do t'i kenë në shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës. Konsiderojmë se oferta e Grupit Negociator të Kosovës është serioze dhe i ka ngritur në nivel më të lartë standardet për qytetarët pakicë që i ofron secili vend demokratik në Evropë, ndërsa drejtuesit e sotshëm të politikës serbe në Beograd, nacionalizmin e tyre agresiv janë duke e përdorur për vota e jo për siguri e përmirësim të jetës së serbëve në Kosovë. Grupi Parlamentar i PDK-së është i bindur se në raport me komunitetin ndërkombëtar, Grupi Negociator i Kosovës, përveç ofertës së ofruar duhet t'i ketë edhe këto kërkesa garantuese:

1. Tërësinë territoriale të Kosovës me sovranitet,
2. Kosova me njohje ndërkombëtare dhe ulëse në OKB,
3. Kosova me ushtrinë e saj profesionale,
4. Mitrovica qytet me dy njësi komunale,
5. Financimi i komunave për kokë të banorëve të saj,
6. Reciprocitetin.
7. Për çdo gjë që do ta gëzojnë serbët e Kosovës, ta kenë edhe shqiptarët në Kosovën Lindore në Serbi dhe kudo ku ata jetojnë dhe janë pakicë.
8. Bashkimi Evropian aty ku është edhe vendi ynë të marrë përgjegjësinë për funksionimin e pushtetit në shtetin e ardhshëm të Kosovës.

E thashë këtë të fundit se po të shikohet harta e formimit të komunave të reja serbe në Kosovë del se serbët gati në asnjë komunë nuk janë pakicë, kurse shqiptarët janë pakicë në komunat serbe në Kosovë. Ne nuk e kemi bindjen se me ndarje në baza etnike kemi ngritur shkallën e sigurisë për qytetarët e Kosovës, e as detajizimin në kuptimin më të mirë të fjalës. Enklavizimi nuk është zgjidhje demokratike as decentralizim, këtë përgjegjësi duhet ta marrim e ta ndajmë edhe me të tjerët, me aleatët e fuqishëm të ndryshimeve demokratike që po bëhen në Kosovë.

Ajo që ne kërkojmë nga Grupi Negociator është që anëtarët e këtij trupi si individë dhe si kolektiv ta ngenë shkallën e komunikimit e të përgjegjësisë si në raport me vetveten dhe interesin nacional, ashtu edhe në raport me të tjerët. Ata në prezantimet e ardhshme duhet të jenë më të përgatitur sesa ishin në prezantimin e korrikut të vitit 2006 në Vjenë.

Të nderuar anëtarë të Grupit Negociator: Do ta keni mbështetjen e Grupit Parlamentar të PDK-së në procesin e njohjes ndërkombëtare të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës dhe në të ardhmen do të na obligojnë vetëm deteyrimet që dalin nga ky proces e që do ta respektonin vullnetin e qytetarëve shumicë për shtet të pavarur, për shtet ligjor. Ju faleminderit.

**KRYETARI** – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

DEPUTETI NAIT HASANI – I nderuar kryetar unë e kërkoja fjalën që herët pikërisht sepse në sallën e Kuvendit desha t'ju pyes juve si kryetar i Kuvendit, Ekipin Negociator dhe deputetët se nga kush frikësohen që edhe në sallë brenda të ketë truproje në sallë. Për këtë e kam kërkuar fjalën më parë, kurse Ekipi Negociator sigurisht nga ose deputetët prej tyre.j tyre.

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Melihate Tërmkollli

DEPUTETJA MELIHATE TËRMKOLLI - Faleminderit z. kryetar, të nderuar deputet, i nderuari kryetar, të nderuar të Grupit Negociator.

Sot dëgjuam disa cilësi shumë interesante për pozitën aktuale të Kosovës, atë që presidenti Rugova e thoshte vazhdimisht se Kosova de facto është e pavarur dhe kërkohet njohja formale e pavarësisë, PDK-ja bënte shaka, përfaqësuesit e saj vazhdimisht e thoshin se jemi vazhdimisht ende të okupuar, sot për fat të mirë e thonë pikërisht atë që e thoshte presidenti Rugova se Kosova de facto është e pavarur.

Do të thosha që Grupi i Unitetit sot paraqiti zhvillimin e procesit të bisedimeve dhe unë mendoj se grupi ka një koordinator i cili do të duhej të paraqiste qëndrimin e gjithë grupit për zhvillimin e procesit të negociatave dhe për zhvillimin e procesit të bisedimeve, ndoshta nuk prish punë pse këtu paraqiten 4 zëra, do të prishte punë sikur këta zëra do të ishin zëra të punëve dhe të mos ishin të koordinuar dhe të mos ishin shprehje e fushatës individuale apo partiake. Z. Thaçi bëri këtu një fushatë partiake individuale dhe në vend të kësaj do të ishte shumë mirë që z. Thaçi para institucioneve, para Parlamentit edhe para qytetarëve të Kosovës të jepte një shpjegim çfarë ka biseduar në Vjenë në takim të veçantë, në emër të bisedimeve dhe kjo do të ishte e z. Thaçit, që është dashur ta paraqiste para këtij institucioni më të lartë të vendit edhe para qytetarëve të Kosovës, po e përjashtoj atë se me cilat mjete keni shkuar, a me mjete të buxhetit të Kosovës që janë të parapara për bisedime apo diçka tjetër dhe po del se para këtij Kuvendi shumë shpejt mund të na vijnë përfaqësuesit edhe të grupeve të tjera teknike, të grupit të administratës, përbëhet nga njerëzit e përjashtuar, që janë larguar nga shërbimi civil për shkelje të rënda ligji dhe që udhëheqin buxhetin e bisedimeve prej 8 milion €. Çështja të cilën dua ta shtroj këtu është se a po rrëshqet procesi i decentralizimit në parimet dhe në kufijtë etnikë? Grupi dhe kryetari në fjalën e tyre ta thonë se jo, realiteti thotë ndryshe. Realiteti thotë, por edhe unë mendoj që Grupi ka detyrim ta thotë realitetin në institucione, në Kuvend edhe para qytetarëve ta thotë realitetin për decentralizimin dhe për gjithë procesin, sa është kjo në funksion të pafajësisë dhe sa e dëmton kjo pavarësinë e Kosovës, unë mendoj se është detyrim i Grupit ta thotë të vërtetën, ajo që realisht po ndodh është në funksion të pavarësisë së Kosovës, apo e dëmton këtë proces dhe së fundi unë përkrah plotësisht fjalën e kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së që ripërcaktimi i kufijve në vija etnike, nuk përkrahet nga LDK-ja. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Z. kryetar i Kuvendit, z. president i Kosovës, z. kryeministër i Kosovës, z. anëtar të Grupit të Unitetit për bisedimet rreth statusit të Kosovës.

Unë i mora me vete dy dosje nuk do ta lexoj asnjërin, por vetëm t'ju them se dallimi ndërmjet tyre është i madh. Në njërin i kam dy dokumente legjitime të nxjerra në Kuvend, që kanë të bëjnë me këto bisedime dhe në dosjen tjetër të madhe i kam materialet që u janë dhënë deputetëve të Kuvendit vetëm sot në mëngjes dhe që kanë të bëjnë me bisedimet. Dua të them se ishte një insistim legjitim dhe i domosdoshëm që Grupi i Unitetit të raportonte në Kuvend për rrjedhat e deritashme dhe për rezultatet eventuale. Kryesia e Kuvendit kishte menduar dhe kishte vendosur të mos bëheshin fjalime politike, rezyme politike, hyrje politike, por të vlerësohej puna e bërë, prandaj kishim kërkuar materiale në dorë. Materialet na kanë mbërritur sot dhe unë kam pasur idenë që nuk kam mund ta thosha më parë, por tashmë hymë në bisedime, në diskutime dhe se vlen ta them, por më duhet ta përmend se kam pasur idenë që meqë ka ndodhur kjo që ka ndodhur njerëzit që referuan për grupin e Unitetit të flasin sot e deputetëve t'u jepën dy ditë që t'i lexojnë këto dokumente dhe të flasin përmendësh. Është vullneti i deputetëve që pranojnë të flasin kështu, kurse e drejta ime këtu shpëputet dhe dikujt i sugjeroj se si të sillet.

Jemi këtu dhe thashë se ky Kuvend rreth problematikës që po diskutojmë ne deri sot i ka të legjitimuara vetëm dy dokumente, një është ai që ish-presidenti Rugova e kishte bërë në shtatorin e vitit 2005, duke krijuar një grup për bisedime si thuhej atje eventuale për statusin e Kosovës. Ju lutem lexoni mirë tekstat që ju kanë dhënë mandatet dhe kishte propozuar një strukturë të këtij grupi që është quajtur nga dëshira shqiptare për unitet, Grupi i Unitetit, një strukturë e cila nuk ka ndryshuar kurrë, mirëpo ka ndërruar ajo që quhet përbërje njerëzore dhe ka ndërruar më se përgjysmë 3 prej 5 me atë që quhet fuqi e Zotit dhe fuqi politike. Pse po e theksoj këtë? Sepse duhet gjithmonë t'u kthehemi dokumenteve burimore të shkruara, sepse fjalët po i merr shpejt era, pra nga Grupi i mandatuar ose i formuar nga Rugova kanë mbetur vetëm 2 udhëheqësit e partive opozitare, ndërsa përfaqësuesit e të tri funksioneve të institucioneve kryesore janë ndërruar. Njëri prej referuesve nga Grupi i Unitetit mua më duket se Thaçi e tha, le të më korigjojë nëse gaboj, me këto ndërrime ka humbur fuqia vendosëse, M'u duk interesante kjo, sepse do të kisha dëshirë ta dëgjoja këtë vlerësim në shtator vjet prej Thaçit e jo tash, por edhe tash e ka një kuptim. Në anën tjetër dokumenti i dytë është një që lidhet me këtë problematikë. Në Rezolutën që e ka nxjerrë në nëntorin e vjetëm Kuvendi i Kosovës rikonfirmohet vullnetin politik të popullit të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran dhe sa i përket kësaj problematike i ka dy nenet e fundit, t'i quaj unë obligative, nga ana e Kuvendit. Neni 9 thotë: "Kuvendi i Kosovës konfirmon se vullneti i popullit të Kosovës për pavarësi është i panegociueshëm", kurse neni 10: "Duke e mbështetur Delegacionin e Kosovës do të përcjellë gjithë procesin e punës së tij dhe çdo vendim për të ardhmen e Kosovës do të ratifikohet në Kuvend apo nëpërmjet referendumit". Ky është neni 10 dhe tutje thotë: "Kjo rezolutë paraqet bazën juridike dhe politike për platformën e Delegacionit të Kosovës për pavarësinë e Kosovës" e ju z. deputet dhe ju shefa ose përfaqësues në Grupin e Unitetit mund të logjikoni vetë, puna e deritashme e Grupit të Unitetit a i ka përcjellë këto suaza, a është brenda mandatit që keni, a doni mandat të ri për punën që ju bëtë deri tash dhe që keni bërë dhe eventualisht që doni në të ardhmen. Nga ajo që unë di dhe me këtë dosje që kemi marrë sot dhe po ju them se e kam lexuar sa kishte mundësi për të lexuar edhe pa e marrë sot, sepse të gjitha gazetat e Kosovës që i sponsoron ose ndikon Grupi i Unitetit me njerëzit e vet i shpallin këto materiale para se t'i shohin deputetët, kështu që nuk është problem i madh kush do të jetë sistematik dhe



marrë, po ju them se i kam parë para se sot në mëngjes tregojnë që bisedimet duhet të flasin qartë, jemi në Kuvend dhe e kam përsëritur edhe herave të tjera të mos bëjmë diplomaci të lartë në Kuvendin e Kosovës, të gjitha bisedimet në tri - katër fushat që i ka bërë Grupi i Unitetit deri më tash janë bisedime për pozitën e minoriteteve në Kosovë ,duke e pasur parasysh në radhë të parë minoritetin serb, të gjitha fushat kjo është esenciale ta dinë deputetët edhe qytetarët, Grupi i Unitetit deri sot nuk ka biseduar kurrë për shumicën për asgjë. Grupi i Unitetit kurrë nuk ka biseduar për statusin final të Kosovës ,sepse në njërin anë nuk i është dhënë ajo e drejtë nga rezoluta e Kuvendit të Kosovës, në anën tjetër edhe s'i ka pyetur askush, as nuk kanë mbërri në situatën që këta të shtyhen për statusin e Kosovës. Unë e di se në diskutet thashetheme ,që e popullojnë politikën e Kosovës ku flitet në mënyrë jo formale jo më gjerësisht se për punën formale thuhet se neve na është premtuar se na e kemi pavarësinë, por dëgjona ju të merremi vesh se ajo është punë e kryer. Pse kush ka thënë, neve na kanë thënë në biseda private, në politikë në këso situatash bisedat private janë zero, ato mund t'i pranojë njeriu që i ka thënë dhe mund të shprrallohet me to ,se nuk t'i kam thënë unë hiq, kështu që ato bien në ujë. Ne ,pra, kemi bisedime të deritashme për statusin e pakicave me theks të veçantë për statusin e serbëve në Kosovë, por ne nuk kemi kurrfarë artikulimi të qartë për statusin e Kosovës dhe ta zëmë që është thënë se statusi i ardhshëm i Kosovës është pavarësia e Kosovës, shtet sovran dhe i pavarur.Kjo është e vërteta lakuriqe për politikën ku kemi mbërri sot.

Unë i respektoj dhe kam respekt të madh për mundin që është bërë të diskutohet për pakicat në shtetin e Kosovës, ndonëse ne kemi thënë se për këto probleme do të duhej të bisedohej vetëm në shtetin e pavarur të Kosovës, sepse çdo gjë përpara është paragjykim, por ne kemi hyrë në traset e këtij gjykimi ose paragjykimi dhe kemi bisedime në nivelin e decentralizimit që përkthyer në punën e deritashme të Ekipit të Kosovës është krijimi i komunave me shumicë serbe. Kjo është e vërteta, emri decentralizim një herë ka dalë si emër i dytë për transformimin e pushtetit lokal, por nuk është,Ne tash kemi prapë decentralizim që unë për vete nganjëherë, pasi qendër nuk ka dhe them po ndahet bashkësia, sepse pushtet qendror pos improvizimeve ne nuk kemi pasur në Kosovë nën UNMIK-un. Ju e dini të gjithë, atëherë ne tash po decentralizojmë në të vërtetë, puna ka qenë ndërtimi i komunave me shumicë serbe, kurse tash numrin nuk dua ta them ,i keni nëpër dokumente, arsyen nuk dua ta them, interpretimi im është që është bërë një kirurgji tokësore e Kosovës me premisa të banimit me shumësi etnie që nuk është punë e mirë dhe që këtu në kuptimin parimor edhe u tha nga dy tre vetë që nuk është punë e mirë dhe nuk është e pëlqyeshme për Kosovën, sepse në fund të fundit ,sepse asaj i bie nëse kemi realitete të sotme që të legjitimohen enklavat që nuk është punë e mirë fare, as për shqiptarët e as për serbët, kjo do të thotë që ato që kanë ndodhur me punën e decentralizimit janë në të vërtetë esencialisht provë që të enklavizohen minoritetet, konkretisht serbët që të krijojnë një jetë paralele politike tutje, që të financohen në mënyrë të ndryshme dhe më në fund që të dirigjohen dhe të bëhen instrument i Beogradit, në mënyrë të institucionalizuar ata edhe tash janë instrument, por atëherë bëhen lojalë. Punë tjetër është se në raport me këtë problemi i një pakoje të madhe të të drejtave të minoriteteve që pretendon njëfarë kushtetute parakushtetutë e minoriteteve e çuditshme. Unë po ju them, e kamë lexuar pikë për pikë, s'ka të bëjë me liritë, këtu ka të bëjë me krijimin e pabarazive, këto institucionalisht në të gjitha nivelet ligjsohen pabarazia edhe përfaqësimi është jo proporcional edhe vota e deputetëve në këtë Parlament s'do ta ketë

të njëjtën vlerë ,sepse do të ketë votim të dyfishtë edhe në komuna do të ketë pushtet që do të jetë pak a shumë i dyfishtë dhe më në ë fund do të kemi edhe propozime të organeve inekzistente deri më sot në legjislacion dhe në Qeverinë e Kosovës do të ketë këshillin konsultativ që bëhet organ qeveritar, a i bashkëngjitet kryetarit apo kryeministrit nuk ka rëndësi fare dhe në anën tjetër propozohet ligjit kushtetues. Këto krijojnë, në mënyrë institucionale, pa barazi. Dikush e tha para meje po i shkelim standardet, kush jemi ne t'i shkelim standardet, për mirë apo për keq, po ne a po themi se duam standarde evropiane, norma evropian, as nuk duam të rrimë mbi e as nën, duam barazi qytetare dhe shanse të barabarta në Kosovë. Kjo është Evropë nëse doni, shkelja e standardeve për ose kundër nuk është shkelje e standardeve edhe kur i merr njeriut me zor dhe i jep me zor është shkelje e standardeve ,sepse e dëmton tjetrin- shumicën, mos e simplifikoni mbështetjen në dokumenteve kulturore vetëm në mbrojtjen e atyre që janë monumente fetare. Ky është një simplifikim dhe ai dokument është në rregull veçse është i simplifikuar, duhet të zgjerohet në të gjitha monumentet kulturore të Kosovës që nuk janë as veç kisha e as veç xhamia, por janë diçka edhe më thellë se këto dyja, sepse ky është një vend me një trashëgimi kulturore antike, mesjetare dhe moderne dhe në fund unë e çmoj dëshirën e Ekipit që ta thotë dhe të flasë lirisht për punën e vet, sepse është normale dhe unë i përgëzoj që ata bëhen shumë më funksionalë në të ardhmen, vetëm unë po ju them haptas para deputetëve në sy, mënyra si punojnë këta -në vullnetarisht- pa kurrfarë rregulloreje, mënyra se si janë shumuar në segmente të veta të ndryshme pa kritere të shfaqura në Parlament, mënyra si janë shoshitur variantet e mendimeve deri këtu, mua më shpie jo të dyshoj, por t ë kërkojë prej tyre të bëhen konstitucionalë dhe të bëhen sistematik. Ne do t'i thërrasim prapë këtu, ne nuk kemi çka bisedojmë për vendimet pasi të merren. Kuvendi i Kosovës do t'i thërrasë ata, kur i thërret nuk e di, ata e kanë obligim të vijnë këtu, të raportojnë dhe të mos bëjnë propagandë, fjalimet e tyre që i kanë mbajtur sot janë 90% propagandistike, le të thonë ata çka të dunë. Ju faleminderit!

**KRYETARI** – Fjalën e ka deputeti Nazim Jashari.

**DEPUTETI NAZIM JASHARI** – I nderuar kryetar i Kuvendit, të nderuar anëtarë të Qeverisë, të nderuar anëtarë të Grupit të Unitetit, të nderuar kolegë deputetë dhe mysafirë të nderuar.

Është mirë që më në fund mund të bisedojmë për një çështje që është esenciale dhe tejet e rëndësishme për të ardhmen e Kosovës, për procesin negociator që po kalon Kosova dhe duhet këtu ta bëjmë një sqarim themelor. Është e vërtetë që ky debat sot është mundësuar nga koalicionit qeveritar, sepse dy grupet që e përbëjnë Grupin qeveritar LDK-ja dhe AAK-ja ,e kanë kërkuar këtë debat, por duhet t'i njoftoj qytetarët, por edhe juve të nderuar kolegë deputetë, që më 27 korrik e kemi pasur një seancë, në të cilën ka raportuar kryetari Sejdiu që e ka mbajtur një referim, që ne si grup opozitar e kemi kërkuar këtë debat, por z. kryetar i Kuvendit na ka thënë se debat mund të kemi, pra kërkesa për debat ka qenë e mëhershme dhe është mirë që grupet që e përbëjnë shumicën në Kuvend i janë bashkangjitur kërkesës sonë për debat dhe kur e kanë marrë këta të drejtën kanë kërkuar këta sigurisht se fuqia politike është e pakalueshme, vullneti i popullit është vullneti i zotit. Këtu z. Sabri Hamiti ngriti dy dosje edhe unë e kam ndërmend t'i ngre dy dosje, një është për decentralizimin dhe pjesa për aspektet e tjera të negociimit, pra këto janë dokumente që na janë servuar neve këtu në këtë Kuvend. Për aspekte e tjera të negociimit



e kemi gjithë këtë material për decentralizimin e kemi vetëm një fletushkë të vogël që mund të quhet çkado përveç raport jo, datën e ka 20 shkurt të vitit 2006, është miratuar në Deleagacionin e Kosovës më 14 shkurt të vitit 2006, kurse qenka dorëzuar me 20 shkurt 2006. Ky është raporti i Ekipit të Unitetit ose më mirë të them i grupit të punës për decentralizimin që udhëhiqet nga zëvendëskryeministri z. Lutfi Haziri që është përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës, nuk janë këtu as Alush Gashi, znj. Sylja qenka këtu fatmirësisht, janë dy grupet që e përbëjnë shumicën qeverisëse në Kosovë dhe që të dy u distancuan nga procesi i decentralizimit që po ndodh në Kosovë ose që po negociohet në kuadër të procesit të negociimit edhe znj. Sylja edhe z. Gashi hoqën dorë nga procesi i decentralizimit. Për mua kjo mund të quhet hipokrizi politike, sepse kur një proces udhëhiqet nga zëvendëskryeministri, nga përfaqësuesi i LDK-së dhe njëkohësisht hiqet dorë nga ai proces, heqja dorë bëhet duke e shkarkuar zëvendëskryeministrin e jo duke e hedhur fajin kuturu në hava sikur topin.

U tha këtu se bisedimet në Kosovë po reduktohen në bisedime për pozitën e pakicave. Po, të nderuar kolegë deputetë, thelbi i këtyre bisedimeve është njohja e së drejtës së Kosovës për t'u përfaqësuar në arenën ndërkombëtare, njohja e së drejtës së Kosovës për t'u ulur në radhë me shtetet e civilizuar dhe për ta thënë fuqishëm fjalën e vet. Deri më sot këtë të drejtë nuk e kemi pasur, pavarësisht jemi përpjekur ta përsërisim të premtëve pavarësinë e Kosovës ose kemi thënë që Kosova u lirua në vitin 1999. Ne ende nuk e kemi të drejtën të ulemi në radhën e shteteve të civilizuar dhe ta themi fjalën tonë vetë dhe fuqishëm, këtë të drejtë do të na njohin vetëm atëherë kur ne të japim shembuj dhe dëshmi se jemi të gatshëm ta marrim atë përgjegjësi, posaçërisht se do të jemi të gatshëm ta marrim përgjegjësinë në raport me pakicat që i kemi brenda vendit tonë dhe ka qenë krejtësisht e kuptueshme që procesi negociator në Kosovë do të ketë të bëjë pikërisht me pozitën e pakicave, sepse ato janë të pambrojtura. Realisht, pakicat në çdo shoqëri janë të pambrojtura, kështu kemi qenë deri dje, sepse kemi qenë pakicë në një shtet më të madh ne kemi qenë pakicë, jemi trajtuar si pakicë dhe jemi rrahur si pakicë, prandaj nuk ka qenë aspak e habitshme insistimi i bashkësisë ndërkombëtare që pikërisht statusi i pakicave të garantohet nëpërmjet këtij procesi të zgjidhjes së statusit final të Kosovës, pra hutia, habia ose grimasat që krijohen këtu për këtë fakt për mua janë krejtësisht të pakuptimta. Pikërisht njohja e të drejtave të pakicave dhe garantimi i të drejtave të pakicave i jep të drejtën shumicës për të marrë përgjegjësinë për të ardhmen, por këtë fakt e kemi pasë të ditur të gjithë, prandaj tash po vendosem në pozicionin e opozitës në Kuvendin e Kosovës qysh kur ka filluar procesi i decentralizimit në Kosovë në ato bisedime paraprake në mandatin e kaluar kur në mënyrë shumë më intensive me Qeverinë e z. Haradinaj dhe me ministrin e pushtetit lokal z. Lutfi Haziri e më pastaj me Qeverinë e z. Bajram Kosumi dhe me ministrin e Pushtetit Lokal përsëri z. Lutfi Haziri ne si opozitë e kemi ngritur zërin fuqishëm që të mos ecet përpara qorrazi, sepse ky proces është një proces që detyrimisht do të shtrohet në tryezë dhe ku detyrimisht do të obligohemi të bëjmë një prerje ndryshe nga ajo që zotërinjtë në fjalë pretendonin që duke ua hedhur serbëve të Parteshit dhe serbve të Graçanicës t'i marrin me vete në Ekipin Negociator.

Të nderuar kolegë deputetë, politika e Beogradit është politikë e rryer 130 vjet i kanë shtetësi në kontinuitet dhe t'i vjen radha që z. Haziri apo Kosumi t'ua hedh atyre me

mashtrime është absurde dhe tepër tendencioze, prandaj futja qorrazi në këtë proces të decentralizimit na ka shkaktuar dëm, sepse ne kemi hyrë në këtë proces me dy komuna ( flasim për Parteshin dhe Graçanicën ) janë dhënë që në fazën e parë të decentralizimit edhe Graçanica edhe Parteshi dhe janë dhënë thjesht thuaja se asgjë nuk po ndodh, për kundër të gjitha vërejtjeve, përkundër të gjitha vërejtjeve nga deputetët edhe të koalicionit qeveritar, por edhe me shumicë të opozitës, prandaj mua më duket shumë e pamoralshme, shumë e pahijshme nga ana e z. Hamiti, nga ana e znj. Sylja, nga ana e z. Gashi që sot i çojnë duart nga procesi i decentralizimit dhe përpiqen që t'ia lënë dikujt kopilin në derë ose thjesht ta gjuajnë në ndonjë kontier se faji qenka diku i papërcaktuar. Përgjegjësinë e kemi të gjithë ne këtu së bashku, vendimet kur janë marrë, pavarësisht që janë marrë me shumicën e votave edhe ne që jemi në opozitë këtu ndoshta është dashur të reagojmë më fuqishëm dhe të bëjmë përpjekje edhe më të mëdha që ta ndalim atë proces, por nuk e kemi bërë "e bajshim me shëndet," jam shumë i pakënaqur me raportin për decentralizimin, me informatat që na janë dhënë lidhur me kundërthëniet që ekzistojnë në këtë proces lidhur me kompetencat që thuhet dhe nuk marrim vesh asgjë, pak e dha z. Surroi, kurse të tjerët nuk e panë fare të udhës të futen në kundërshtitë e procesit dhe në kundërthëniet e procesit, pra për ta gjithëka ishte në rregull, gjithëka shkonte si është më së miri, në procesin e decentralizimit ka shumë kundërthënie. Këto kundërthënie nuk janë thënë para këtij Kuvendi, as me shkrim e as me gojë sot, prandaj unë e quaj plotësisht të dështuar këtë raport dhe e quaj plotësisht jo të drejtë raportimin e shumicës së anëtarëve të Unitetit. Mendoj se do të duhej që të kërkohej një raport i veçantë për decentralizimin ku do të na jepeshin saktësisht të gjitha zhvillimet lidhur me këtë proces edhe kërkesat, edhe obligimet edhe detyrimet e komunave të reja, edhe kompetencat e komunave të reja, cila komunë ka të drejtë të formojë universitet e cila nuk ka të drejtë, ne këtu nuk dëgjuam asgjë. Pra ne këtu duhet ta kemi një informacion më të plotë dhe duke e pasur atë informacion edhe të bisedojmë, kjo kështu është joserioze, por ne si Kuvend po e lejojmë derisa ne si Kuvend e lejojmë sigurisht që të tjerët e praktikojnë. Ju faleminderit!

**KRYETARI** – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

**DEPUTETI HYDAJET HYSENI** – Faleminderit z. kryetar, dhe do të më pëlqente që diskutimin ta bëja diskutim, por e kisha kërkuar fjalën pas raportimeve të përfaqësuesve të grupit të Unitetit për të bërë një propozim procedural, prandaj edhe si të tillë po e them edhe tash edhe pse me vonesë. U morëm vesh se do përshëndetur gatishmëria që të vihet dhe të raportohet në Kuvend, është raportuar edhe më herët, por kësaj radhe disa pak më mirë, pak edhe me materiale, por përsëri pa raport të shkruar dhe materialet përsëri të mangëta, jo të plota, jo complete, kjo është vërejtja mbi të cilën unë mendoj se ne do të duhej edhe të ndërtonim zgjidhjen për seancën e sotme dhe për debatin e sotëm. Çështja është tepër serioze, tepër e përgjegjshme, tepër e rëndësishme që mund të bisedohet fët e fët e disi me mangësi e dyshume që lënë të kuptosh se po luhet njëfarë loje. Unë propozoj që debati të ndërpritet, të na sigurohet e gjithë materiali i nevojshëm, të na lejohet edhe kohë që të përgatitemi siç thanë edhe parafolësit dhe që ne të vazhdojmë javën e ardhshme, mendoj se vetëm në këtë mënyrë ky Kuvend mund të jetë në nivelin e përgjegjësisë dhe misionit që ka. Ju lutem z. kryetar që si propozim të tillë edhe ta hidhni në votë.

KRYETARI – Si propozim të tillë duhet përfaqësuesi i Grupit Parlamentar. Vazhdojmë më tutje. Fjalën e ka Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – I nderuari z. kryetar i parlamentit, i nderuari kryeministër, të nderuar anëtar të Grupit të unitetit, ministra, deputetë të nderuar, nuk e kam zakon të dal në foltore, por nga respekti që e kam, të ndaj Grupit të Unitetit mos flas prapa shpinës së tyre dola të jem ballë për ballë me ta.

Ne sot po diskutojmë për një dokument që na është dhënë sot në mëngjes, para se të filloj kjo seancë plenare dhe të diskutojmë lidhur me këtë dokument, para së gjithash unë nuk e preferoj që ky dokument, para së gjithash unë nuk e preferoj që ky dokument në të ardhmen të merr emërtimin ligj kushtetues, por ligj mbi të drejtat e komuniteteve, natyrisht pas hartimit të kushtetutës së re për Kosovën. Duhet të jemi të gjithë të vetëdijshëm dhe të vëmendshëm se në çdo shoqëri të organizuar popullata shumicë qëllimisht po i iki komunitetit, komuniteti është imponim që na është imponuar gjatë negociatave sepse dokumenti zyrtar ndërkombëtar i quan pakicat pakica kombëtare, por ne nuk duhet t'i quajmë pakicë kombëtare prej Bashkësisë Ndërkombëtare ashtu siç e definoi dokumenti ndërkombëtar, konventa ndërkombëtare, por i quajmë komunitete pakicë na detyrën që t'ju sigurojmë të gjitha të drejtat që janë të garantuara me ligj, këtë gati secili prej nesh e kemi thënë dhe askush nuk mund të thotë se nuk ka qenë i gatshëm për hir të pavarësisë së Kosovës që komunitetit pakicë t'ia garantoj të gjitha të drejtat që janë të parapara me standarde dhe konventa ndërkombëtare dhe pikërisht synimi ynë ka qenë që një dokument për të drejtat e komuniteteve pakicë ta bëjmë mbi parimet e atyre standardeve. Që është e vërteta ne në raste të caktuar ai kemi tejkaluar edhe ato standarde, por edhe principet e demokracisë, një qytetar një votë, fjala është për votimin e dyfishtë në Parlament për ligjet që i mbrojnë interesat vitale, ani le të jetë edhe kjo ashtu. Mirëpo ne duhet të synojmë që të miratojmë një dokument final, mos të jetë ky dokument final i cili pastaj do të jetë si një projektligj për të drejtat e komuniteteve sepse si i tillë dallon shumë nga një dokument tjetër për të cilin nuk u fol këtu fare. Është një dokument që është hartuar në Kembrixh e që është miratuar nga Grupi i Unitetit në prill të këtij viti dhe e ka pasur velën e konfidencialitetit me qenë se u vendos që seanca të mbahet me dyer të hapura gjë që e përshëndes, por në fillim jam hamend se për shkak të konfidencialitetit kamë menduar se duhet të mbahet seanca me dyer të mbyllura, por pasi kjo velo u hoq atëherë duhet të diskutohet edhe për ecuritë se si ka pasuar transformim apo ndryshim ky dokument për të cilin sot po diskutojmë, pas miratimit të atij dokumenti të prillit nga Grupi i Unitetit nga grupi i UNOSEK-ut, përkatësisht ekspertët e Ahtisarit kanë ardhur pyetje shtesë në të cilat është kërkuar që Grupi i Unitetit të përgjigjet në ato pyetje shtesë, ne si ekspert të fushës së drejtësisë jemi përgjigjur në ato pyetje shtesë, dua t'ju njoftoj se cilat kanë qenë ato pyetje shtesë, pyetja ka qenë: "Përbërja e Kuvendit, përfaqësimi në Qeveri, procedurat e interesave vitale, përbërja e gjyqësisë ndryshe nga Gjykata Kushtetuese, pastaj çështja e organizmave dhe organeve të tjera për monitoring, implementim dhe zbatim të të drejtave të komuniteteve, mekanizmat dhe organet e tjera, kriteri për të drejtën e përdorimit të gjuhës së komunitetit në institucionet e Kosovës dhe në jetën publike, mundësitë ekonomike për anëtarë të komuniteteve jo shumicë" dhe këto kanë qenë të gjitha që janë kërkuar, ne kemi dhënë përgjigje për të gjitha dhe përgjigja e jonë si ekspertë dallon nga dokumenti të cilin e kemi marrë sot, por është çështje e Grupit të Unitetit të merr vendime politike dhe t'ia jap kornizën finale dokumentit për të cilin më



pastaj unë mendoj se ai dokument final duhet të kaloj në Parlament, të miratohet në Parlament e më pastaj të përfundohet procesi i negociatave.

Kamë disa vërejtje konkrete, unë do të flas më shumë për fushën e drejtësisë, por para së gjithash t'ju them se deri sa ishte përfaqësues special në Kosovë z. Shtajner na janë dhënë standardet të cilat kemi qenë të detyruar t'i përmbushim për të filluar procesi i negociimit për statusin e Kosovës. Në mesin e atyre standardeve askund nuk ka figuruar standardi mbi decentralizimin dhe na doli tash decentralizimi si standard mbi standardet dhe si çështje kryesiale, po është e vërtetë se decentralizimi duhet të bëhet me pakicën nëse pa komunitetin pakicë sepse pushteti lokal gjithsesi duhet t'i afrohet qytetarit, por jo mbi baza etnike, ju lutem ky decentralizim çfarë supozohet të bëhet tash të gjitha komunat e reja me strukturë populative të komunitetit pakicë shtrihen ose në rrugët magjistrale ose në afërsi të rrugëve magjistrale e ne të gjithë jemi dëshmitar të asaj se kurdo që i është cekur komunitetit pakicë na kanë bllokuar ato rrugë dhe ne kemi mbetur të mbyllur si në një gëzhgjë dhe tash çfarë decentralizimi është koncipuar dhe është hartuar të bëhet vërtetë është decentralizim pikërisht mbi principet nacionale, pse s'u bë asnjë decentralizim pos Junikut për popullatën shumicë, a nuk i nevojitet as popullatës shumicë shërbimi i pushtetit lokal me qenë më afër qytetarit, gjithsesi i nevojitet, tash janë krijuar edhe korridore dhe kërkohen edhe do lidhje vertikale, janë të papranueshme dhe shqetësuese për ne sepse atëherë ne do ta fitojmë njëfarë pavarësie, por do ta fitojmë edhe një shtet jofunksional e nuk është qëllimi as i bashkësisë ndërkombëtare as i yni si shoqëri e organizuar që të ndërtojmë një shtet jofunksional, shtet invalid.

Tash po kaloj në pjesën tjetër që më së shumti mua më intereson. Pjesa e sistemit gjyqësor. Si duket me inercion të decentralizimit të pushtetit lokal ka shkuar edhe decentralizimi i pushtetit gjyqësor, mos harroni zotëri se pushteti gjyqësor është pushtet në vete, se pushteti gjyqësor, segmenti i drejtësisë është shtyllë e veçantë e një shteti dhe çfarë e kemi atë segment të tillë do ta kemi edhe shtetin. Në dokumentin të cilin sot po e shoh, në të vërtetë mbrëmë e kam marrë edhe pse më 26 vetë kam punuar deri në orën 5,00 pas dite në këtë dokument nuk e kam pasur rastin ta marrë më parë, por sot e kam marrë thuhet se do të themelohen gjykata në territoret ku komunitetet jo shumicë e përbëjnë shumicën që do të thotë decentralizimi i gjyqësorit. Në çdo komune të re që themelohet duhet t'ia themelojmë edhe gjykatën dhe t'ia çojmë te dera e shtëpisë, kjo në gjyqësi nuk tolerohet, jo e prish unitetin e sistemit gjyqësor, sistemin gjyqësor e kemi të ndërtuar. Në faqen 29, pika 4 thuhet se përveç komunave ku janë të themeluara, d.m.th. ku ekzistojnë gjykatat e qarkut që janë 5 komuna, një gjykatë e qarkut apo gjykatë e qarkut gjithashtu duhet të themelohet në komuna që gjenden 20 km. apo më shumë larg selisë së Gjykatës së Qarkut nën juridiksion bie ajo gjykatë përkatëse e atij territori, d.m.th. kërkohet të themelohen edhe gjykata të qarqeve si gjykata instanciale të gjykatave themelore apo të gjykatave komunale për komunitete pakicë, që do të thotë se ne po futemi në ujërat e segregacionit, po ndahemi. Ju lutem, kjo nuk duhet të ndodhë, sepse jemi shtet në transicion të dyfishtë, në transicion prej komunizmit, në transicion prej luftës, tash po shkojmë në një drejtim krejt tjetër, prandaj ju kisha lutur që për gjykatat të pyetet Këshilli Gjyqësor Prokurorial që ky t'i japë rekomandimet dhe ky kuvend ta bëjë emërimin apo zgjedhjen e gjyqtarëve dhe të prokurorëve e jo siç thuhet në dokument që në një farë mënyre nuk është drejtpërdrejt e thënë, por për derë të vogël është futur edhe

të kërkohet mendimi i komunitetit pakicë prej nga vjen gjyqtari i komunitetit pakicë, ai gjyqtar do të jetë i varur prej komunës prej të cilës është propozuar dhe në këtë mënyrë edhe parimi i pavarësisë së gjyqësorit do të rrënohet. Ju faleminderit!.

KRYETARI – Fjalën e ka deputeti Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar është kërkesa e shumë deputetëve që për shkak të materialit të marrë me vonesë seanca të vazhdon të hënën, ne biseduam edhe me shefin e Grupit Parlamentar të LDK-së dhe jemi ra në dakord që të ndërpritet seanca dhe të vazhdon të hënën.

KRYETARI – Në këtë rast në bazë të rregullës 30 paragrafi 4 mocioni për ta mbyllur debatin mund të shtyhet vetëm nga shefat e grupeve parlamentare dhe votohet menjëherë në përputhje me rregullat, prandaj nëse ka mbështetje edhe nga grupet e tjera parlamentare hidhet në votë.

Gjylnaze Syla e ka fjalën në emër të AAK-së

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Z. kryetar, unë edhe më parë e kërkova fjalën për replikë me z. Nazim Jashari dhe pastaj do ta them edhe vendimin e Grupit Parlamentar të Aleancës për mbylljen e debatit të sotëm, por një herë do t'i përgjigjem z. Nazim Jasharit.

Z. Jashari nuk është hera e parë që ne reagojmë për fenomene që nuk janë në interes të përgjithshëm dhe do të reagojmë edhe në të ardhmen. Ju duhet t'i merrni dhe t'i lexoni transkriptet për t'ia rikujtuar vetes se ne kemi reaguar për decentralizimin edhe kur ka qenë debati për decentralizimin edhe në të ardhmen do të ndodhë kjo, por ne kur debatojmë debatojmë me argumente.

Sa i përket hipokrizisë, më vjen keq t'jua them se nuk e lejon edukata ime, por ju jeni hipokrit, kërkoi falje që e them këtë, por në mendjen time ngelni hipokrit. Ju faleminderit. Sa i përket Grupit Parlamentar edhe Grupi Parlamentar i Aleancës pajtohet që debati të vazhdojë të hënën.

KRYETARI - Nazim Jashari, kërkon replikë.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Unë po dal dhe po të shikoj në sy z. Syla se kur të them hipokrizi politike, unë e arsyetoj pse je pjesë e Qeverisë, çdo reagim të bërë a të pabërë të Qeverisë dihet si bëhet. Ju jeni në koalicion qeveritar, mund të tërhiqeni nga koalicioni nëse nuk jeni të kënaqur me punën e Qeverisë, mund ta tërhiqni një ministër nga koalicioni dhe mund të bëni që një Qeveri të bjerë, kjo është mënyrë e reagimit në politikë, nuk ka tjetër, kurse kur i lanë duart nga procesi i decentralizimit të cilin e keni udhëhequr ju dhe e keni filluar me kryetarin e partisë suaj e tash i lani duart prej saj atëherë nuk di si t'i thuhet asaj përpos se hipokrizi politike.

KRYETARI – Ju lutem një sqarim rreth propozimit të z. Krasniqi. Në rregullën 30 ,paragrafi 7 mocioni për ta shtyrë debatin, për ta shtyrë seancën, për ta kaluar një çështje në komision ose për ta mbyllur debatin duhet të ketë mbështetjen e së paku një grupi

parlamentar para se të debatohet, d.m.th është dashur në fillim të seancës është dashur të bëhet kjo, ne kemi filluar debatin rreth kësaj çështje.  
Fjalën e ka Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar, pasi që ju bazoheni në procedura të Kuvendit, sipas procedurës çdo material në rutinë e deputetëve duhet të jepet 3 deri 5 ditë përpara, gjë të cilën ju s'e keni bërë, ne kemi pasur mirëkuptim për tërë procesin, për rrethanat në të cilat punojmë dhe e kemi pranuar këtë dëshmi pa dokumente. Paraqitja e dëshmisë ka ngritur shumë çështje për të cilat deputetët janë shumë të interesuar që të kontribuojnë, por mendoj se është shumë nëse ju kërkoni që ne ta përmbyllim debatin pa na dhënë mundësi t' i lexojmë dokumentet që na i keni ofruar, andaj z. kryetar i Kuvendit mendoj se është korrekte që të na jepni mundësi që për disa ditë, qoftë edhe gjatë vikendit ta studiojmë këtë material shumë të rëndësishëm për ne, që të mund të japim kontribut. Të gjithë diskutuesit janë në favor të mbështetjes së Delegacionit të Unitetit që t' i mbrojnë interesat e qytetarëve të Kosovës në të mirë dhe paqe të stabilitetit në rajon, andaj kam shumë drojë që nëse ju nuk e përfillni kërkesën e tri grupeve parlamentare ju mund të mbeteni në sallë vetëm. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit z. Gashi. Unë nuk kam kërkuar as shtyrjen e seancës, as mbylljen e debatit, nga deputetët u kërkua ajo dhe unë e dhashë sqarimin se në çfarë faze mund të bëhet ajo. Urdhëroni shefat e grupeve parlamentare mund të merreni vesh dhe mund të votojmë për te.  
Kërkon fjalën Teuta Sahatqija.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQJA – Faleminderit z. kryetar. Sa i përket kërkesës së grupeve parlamentare edhe ne nuk jemi kundër kërkesës së grupeve të mëdha parlamentare dhe furnizimit të deputetëve me dokumentacion i cili është i nevojshëm për diskutim, por ky dokumentacion i cili na ka ardhur sot në kutitë tona që sot e kemi marrë është i pamjaftueshëm, dokumenti i decentralizimit është jashtëzakonisht i pamjaftueshëm, prandaj nëse shtyhet debati, në qoftë se vazhdon debati të hënën kërkojmë që brenda ditës së sotme të plotësohet dokumentacioni i decentralizimit dhe të bihet i plotë.

KRYETARI – Ju faleminderit fjalën e ka Gjezair Murat.

POSLANIK DŽEZAIR MURAT - Poštovani predsjedniče u dosadašnjoj debati diskutanti su bili većinom poslanici, parlamentarna grupa 6+ nije u prilici ni preko šefa grupe da diskutuje i kada je došao red na njega onda je došlo do obrta. Mi imamo razloga više za odlaganje ove sednice i nastavak u ponedjeljak, jer mi nismo imali nikakav prevod za danas, dakle bez prevoda, što je jedan od osnovnih načela da nam se obezbedi da bi smo mogli ravnopravno da učestvujemo u raspravi, ali prije toga je trebalo šef parlamentarne grupe 6+ takođe da podnese uvodno izlaganje vezano za izlaganja koja smo danas čuli a potom da se ide na glasanje odnosno na prihvatanje dosadašnjih predloga šefova grupa, to je ravnopravnost da bi svi bili zastupljeni, jer je šef grupe za integraciju danas imao diskusiju tako da smo jedini bez iznjašjavanja uvodnih izlaganja



članova jedinstvene ekipe, dakle nakon našeg izlaganja posle toga možete ići na usvajanje da li će se odložiti debata za ponedeljak ili ne.

Nakon ovoga ja tražim reč da se o današnjem uvodnom izlaganju izjasnim kao šef parlamentarne grupe 6+.

KRYETARI – Urdhëroni.

DŽEZAIR MURAT - Poštovani predsedniče, uvaženi članovi pregovaračke ekipe, kolege poslanici, i gosti kojih je malo ostalo, ja sam dužan da pozdravim inicijativu koja je dovela do ove današnje po svima nama veoma značajne debate i mi smo učesnici jedne debate gde je kroz prizmu pregovaračkog procesa se gojori mnogo i o ostaloj problematici bez koje ova rasprava ne bi bila moguća, kao što sup rava manje brojnih zajednica, o čemu smo danas čuli čitavu jednu lepezu različitih mišljenja, od izlaganja koleginice Sulja koja je rekla da je konačno potrebno da od načelnih obećanja predemo na ostavarivanje prava manjinskih zajednica preko diskusije g-dina Jašarija koji se takođe posvetio pravima manjinskih zajednica. Da ne govorimo o međunarodnim predstavnicima koji stalno govore o ovome do mišljenja kolege Sabrija Hamitija koji se zalagao danas za ugrožena prava većinske zajednice, ja to razumem i vi imate pravo na to, ali smo više govorili o pravima manjina. Hoću reći da je danas bilo reči i o decentralizaciji i mnogo toga, o budućem zakonu o pravima manjina i kompetencijama institucija Kosova itd, itd. Kao i o važnom problemu celovitosti teritorije Kosova. Ja ću spomenuti veliki propust koji je napravljen prema tim istim predstavnicima manjina kojima tek danas podeljen materijal, ali bez prevoda, i ponoviću ono što sam i rekao mi smo dodatno na ovaj način obespravljani, govoriti o jednoj ovako važnoj problematici, a bez adekvatnog prevoda, ja ne znam ko je za to kriv, ali sigurno da krivaca ima. Današnji izlagači veoma su se razlikovali u izlaganjima iako su svi članovi jedne te iste, odnosno jedinstvene pregovaračke ekipe, što nam nameće jednu nejasnu sliku postignutih rezultata u procesu pregovaranja, pa se postavlja pitanje, kolika je ova ekipa jedinstvena. Gospodo, zajednice koje predstavljam, dakle bošnjačka i turska, su odmah nakon rata prihvatajući novu realnost Kosova učestvovala u svim izbornim procesima od 2001 lokalnih izbora zaključno sa 2004 kada su bili drugi parlamentarni izbori, i kažem i na lokalnom i na centralnom nivou smo izabrali legitimne predstavnike, čime smo dali multietnički karakter izbora. Integracijom u novo kosovsko društvo u svim njegovim porama ulažući maksimalne napore sa većinskom i ostalim zajednicama, spremni smo da taj teret zajednički nosimo, stvarajući prosperitetno društvo koje će ući u evropske integracije. To su trajni zadaci kojima smo se posvetili, ali zajedno sa svim ostalim građanima bez obzira na bilo kakve razlike koje postoje. Početak kao i tok pregovora o budućem statusu dočekali smo spremno smatrajući to svojim neotuđivim pravom ali i obavezom. Pozdravili smo odluku o početku pregovora kao i formiranje pregovaračkog tima uz primedbu da ga treba dopuniti i predstavnicima ostalih zajednica nazavši ga tada nepotpunim, lično ja kao tada član Predsedništva Skupštine Kosova, što i danas ponavljam u brojnim kontaktima sa čelnicima kosovskih institucija u nastupima, u medijima kao i u mnogobrojnim međunarodnim susretima, mi smo nebrojano puta ponovili ovaj isti izraz nepotpun pregovaračke tim bez učešća predstvanika ostalih zajednica. I dalje mislimo da to stoji i mi, ja to želim ponovo ovde da istaknem da svoje

interese najbolje možemo implementirati u pregovorima kao i u budućim Ustavu direktnim odnosno neposrednim učešćem nimalo ne sumnjajući u dobre namere pregovaračkog tima Kosova. Ne vidimo baš nikakve razloge ili bojazni od našeg učešća niti po interese Kosova ili po interese većinske zajednice nego naprotiv ja tvrdim da bi to bio kvalitet više za sve na Kosovu. Napominjem da je predstavnik manjinskih zajednica u Beču učestvovao u više navrata, ali u nekoj neobaveznoj ili kako u nekim novinama je pisalo rezervnoj formi i to kada se nije raspravljala tematika o pravima manjina, a onda kada je ona došla na dnevni red odlazi samo jedan predstavnik manjina ne sumnjajući ni u njegove kvalitete ni u njegove namere niti u sposobnost ili dobronamernost, smatram da ako se govori o pravima manjina onda legitimni predstavnici tih istih manjina moraju biti tu, zašto bi onda bili birani ako ne budu u prilici da se bore za svoja prava tamo gde je to potrebno, tamo gde je to pred očima međunarodne zajednice i tamo gde se oni predstavljaju kosovarima, a potom predstavnicima zajednica koje jesu. To je alfa i omega zaštite i prava i ostvarivanja prava manjinskih kako to mnogi ovde govori i ja ću upotrebiti, mada smo se dogovorili da koristimo manjinske zajednice, što je jednom rekao g-din Suroi. Shvatajući taj period teškim i veoma složenim minismo želeli proces decentralizacije da politizujemo ostavljali smo ga za kosovke institucije i mislim da je to od nas bilo pošteno, smatrajući da neće biti odlagan i ne zanemarivan za ostale zajednice kako nekada kažete nesrpske, izraz koji je rogovotan i koji nam ne priliči. Ispada da kao manjinama teku med i mleko na osnovu današnjeg izlaganja i stavova jednog od članova pregovaračkog tima zaduženog upravo za konsultativni savet, da Bog da da je tako, na osnovu onoga što smo danas čuli, ali nažalos nije, ima razlika između mišljenja, stavova ali i stvarnosti nažalost one postoje. Članovi konsultativnog saveta su do sada učestvovali na tri konferencije u Draču, Solunu i Skoplju i ovaj izlagač je bio učesnik svih tih konferencije i dokumenat koji smo koncipirali, predat je gospodinu Ahtisariju u ruke, a da predstavnici manjina i učesnici tih konferencija nisu ga ratifikovali niti su videli ovaj dokumenat. Na osnovu površnog uvida bez prevoda uočio sam mnogo razlika između onog što smo se dogovorili i onoga šta taj dokumenat sadrži. Ja ću izneti samo jedan primer pomenuću garantovana i rezervisana prava. Na izgled slične reči na albanskom možda postoje i veće razlike u ovim terminima ali ja ću reći da napomenutim konferencijama smo se dogovorili o rezervisanim, a ne garantovanim pravima, garantovana prava nas limitiraju. Ja želim to da kažem da mi neželimo ništa od onoga što sadrži Ustavni okvir, ali ni manje od toga i mi smo se tako dogovorili u Solunu, ja znam nakon poduže rasprave na konferenciji u Solunu da smo kao i svi doneli odluku da se ipak zadrže rezervisana, a ne garantirana prava. Ja ne bih voleo da o tome polemishem sa bilo s kim ali sam spreman u nekoj drugoj formi da ne bi vas zarnarao. Poslnicima Skupštine je manje više poznato da je Parlamentarna grupa 6+ koalicioni partner LDK i Aak inače dobro je informisan g-din Jašari kao da to danas nije znao, ja ne sumnjajući u njegove namere, možda je to u nekom drugom kontekstu pominjao, ja se izvinjavam g-dine Jašari, ali ste uvek govorili o LDK i AAK a mnogi, odnosno većina zna da koalicionu Vladu ove Skupštine čine LDK, AAK i 6+. Nwkada se ovom formulacijom i istinom pred međunarodnjacima kitimo. Nekada to svesno pričutkujemo a izgleda da se nekada i stidimo toga zavisno od situacije u kojoj se nalazimo. Ja to želim ovde da podsetim i mislim da ovo nije daleko od istine, ja ću vam sada reći da smo mi upravo našim glasovima u ovoj Skupštini u drugom sazivu birani su i pokojni predsednik, današnji predsednik, tri premijera, počev od Vlade premijera haradinaja do Vlade g-dina



Çekua, zatim dva predsjednika uvek glasovima Parlamentarne grupe 6+, a zauzvrat šta smo dobili ništa više nego što Ustavni okvir predviđa. Kada su neka osetljiva pitanja malo se ima sluha, a svima su nam usta multietničnosti i prava manjina po najvišim standardima, ja ću ovo sada pod znacima navoda staviti, podsetiću vas, veliki je raskorak između verbalnih ili načelnih obećanja i podrške i istinske primene i realizacije istih. Ako to ne visimo ima onih koji to vide. Mi ćemo kao i do sada gospodo ostati dosledni na putu za okruživanja interesa svih građana Kosova, ali za uzvrat u najmanjoj ruku očekujemo dađ se naši interesi, zahtevi ne zaobilaze jer njihovim ostvarivanjem svi biti dobitnici, nepotrebno je da navodim da kada su u pitanju naša prava u kojima se govori kao na današnjoj debati prije svega naša rječ treba da bude vjerodavna. Hvala!

KRYETARI – Ju faleminderit. Të përgatitemi për votim për shtyrje të seancës për të hënë. A kanë propozim për ndonjë datë tjetër grupet parlamentare? Ju lutem.  
Z. Gashi a keni propozim për të cilën datë të shtyhet.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Z. kryetar, propozimi ynë është t'u jepet kohë deputetëve në leximin e materialeve, ne e pranojmë vendimin e Kryesisë së Kuvendit për cilën ditë ju si Delegacion i Unitetit mund të jeni të pranishëm fizikisht në debat. Nëse anëtarët e Delegacionit të Unitetit kanë obligime që nuk mund të jenë këtu ne e kemi atë mirëkuptim dhe e pranojmë ditën, nëse ajo ditë është e hënë që mund të vazhdohet debati, neve na vjen mirë, por nëse nuk mund të vazhdohet debati ju konsultohuni dhe ne e pranojmë atë ditë.

KRYETARI – Z. Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Ne mendojmë se e mërkura është vonë, mund të jetë dita e hënë apo e martë, por mendoj se dita e hënë është më e mirë, sepse më 6 dhe 7 apo 7 dhe 8 një pjesë e Delegacionit do të jetë në Vjenë.

KRYETARI – Fjalën e ka Gjylnaze Syla.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – E hëna mendoj se është dita më e përshtatshme për të vazhduar debatin.

KRYETARI – Ora ju lutem.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Ashtu si thamë edhe më parë për ne nuk ka rëndësi a është e hënë apo e marte, si të vendosë shumica. Për ne është me rëndësi që dokumentacioni të jetë komplet.

KRYETARI – Xhezair Murat e ka fjalën.

POSLANIK DŽEZAIR MURAT – Mi takođe prihvatamo u ponedeljak kao i većina šefova grupa.

KRYETARI – Fjalën e ka Ferid Agani.

DEPUTETI FERID AGANI – Z. kryetar ne mbështesim shtyrjen e kësaj seance për të hënën. Me atë që mbështes kërkesën e shëfes së Grupit Parlamentar ORA-s që dokumenti i decentralizimit të plotësohet së paku me dokumentin që është publikuar sot në gazetën ditore.

KRYETARI – Më shumë kishte propozime për të hënën.

Vë në votim shtyrjen e seancës për ditën e martë, votim elektronik dhe votojmë tash:

Për ..... 56

Kundër ..... 8

Miratohet propozimi.

*Shihemi të martën në orën 10..*

Vazhdimi i seancës plenare më 6.9.2006.

KRYETARI I KUVENDIT TË KOSOVËS KOLË BERISHA- Mirëmëngjesi dhe mirë se erdhët në seancën plenare vazhdim i seancës së datës 1 shtator të vitit 2006.

Fillimisht më lejoni t'ju njoftoj se termini i mbajtjes së kësaj seance është shtyrë për sot me vendimin e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës e me kërkesë të disa anëtarëve të Grupit Negociator për shkak të obligimeve që i patën paraparë më parë.

Mendoj se edhe kjo shtyrje do të jetë në funksion të një përgatitjeje më të mirë për mbledhjen e sotme, duke llogaritur se edhe materialin e keni marrë me kohë.

Ndonëse kisha planifikuar që fjalën time ta thosha në mbyllje të debatit, për shkak të disa specifikave nga seanca e kaluar raportin tim po e paraqes tani në hapje të seancës së sotme.

Meqenëse unë vazhdimisht po jua jap fjalën juve, sot po ia jap vetes.

I nderuari president i Kosovës, z. Sejdiu,

I nderuari kryeministër Çeku dhe ju kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar mysafirë dhe ju që në vazhdimësi i përcillni punimet e Kuvendit të Kosovës dhe me korrektësi raportoni për to

Të nderuar përfaqësues të mediave dhe të pranishëm të tjerë,

Zonja dhe zotërinj,

Fillimisht, si anëtar i Grupit i Unitetit, e pranoj se ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Grupit të Unitetit dhe Kuvendit lidhur me procesin e negociimit, por, po ashtu, dua t'ju siguroj se kërkesa e Grupit Parlamentar të LDK-së, e shoqëruar më pas edhe nga ajo e

AAK-së, për ta ftuar Grupin e Unitetit që të raportojë para jush për punën e tij të deritashme, është mirëpritur edhe nga Kryesia e Kuvendit edhe nga Grupi i Unitetit. Këtë e dëshmon edhe prezenca e të gjithë anëtarëve të Grupit në këtë sallë edhe ditën e premtë edhe sot, si dhe gatishmëria e tyre për të raportuar dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve tuaja të mundshme.

Të nderuar kolegë,

Të gjithë jemi të vetëdijshëm se, siç thuhet, e mira e së mirës do të ishte sikur problemi i Kosovës të ishte zgjidhur para një shekulli që ne sot të merremi me diçka tjetër.

Por, realiteti është ky që është dhe na ka rënë fati, apo fatkeqësia që edhe ne, sikundër edhe shumë të tjerë para nesh, të merremi me këtë problem, madje të bëjmë përpjekje ta përmbyllim një herë e përgjithmonë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Do të mund të jemi gjenerata më fatlume, brezi më me fat dhe më i privilegjuar në histori, po që së do t'ia dalim ta përmbyllim me sukses këtë proces – procesin e pavarësisimit të Kosovës, për të cilin është derdhur një det i tërë gjaku nëpër shekuj dhe assesit nuk do të lejojmë të jemi gjenerata më fatkeqe, brezi më i mallkuar, për mosrealizim të aspiratave tona shekullore.

Deputetë të nderuar,

Është e vërtetë se e tërë puna e bërë deri më tani, si dhe ajo që do të bëhet tani e tutje, deri në momentin kur si dokument i shkruar do të miratohet ose do të refuzohet nga ky Kuvend, e mban vulën e këtij Grupi – pra, të Grupit të Unitetit.

Ndërkaq, pas miratimit apo refuzimit në këtë Kuvend, atëherë i tërë procesi e merr vulën e Kuvendit.

Por, lë të dihet se, si të thuash, një armatë e tërë njerëzish që, në forma dhe në cilësi të ndryshme, qoftë si grup politik-strategjik, qoftë si pushtet lokal, qoftë si ekspertë të fushave të caktuara, qoftë edhe si përfaqësues të Këshillit Konsultativ me minoritetet, janë angazhuar dhe kanë dhënë kontributin e tyre në këto bisedime.

Dhe, konsideroj se ndjenja e përgjegjësisë për rolin që kanë, i ka përcjellë në çdo moment, jo vetëm anëtarët e Grupit të Unitetit, por edhe të gjithë ata që në çfarëdo cilësie janë involvuar në këtë proces.

Së këndejmi, duhet ta pranojmë se në seancën plenare të së premtës, kur debatohej për punën e Grupit të Unitetit, pati diskutime me tone kritike, me kualifikime të ashpra në adresë të GU.

Duke shfrytëzuar temën, që si e tillë paraqet terren shumë të rrëshqitshëm, thjesht dhe qartë, shihet se kishte edhe tendenca të tilla që e denigrojnë dinjitetin njerëzor, kombëtar, intelektual e institucional të anëtarëve të Grupit.

Mendoj se me ato paraqitje as me atë gjuhë, nuk i ndihmohet as Grupit as procesit në përgjithësi.

Duhet kuptuar shqetësimin tuaj si shqetësim, sepse bëhet fjalë për çështjen më të rëndësishme, më jetike, më kapitale për Kosovën.



Por, nuk mund të kuptohet shqetësimi si tendencë, jo për korrigjim, për dhënie ndihme, për përmirësim të asaj që është bërë, nëse është bërë keq, por që, megjithatë ende nuk e ka marrë formën e prerë, por, thjeshtë, për diskreditim.

Të nderuar kolegë,

Kosova është këtu, siç thuhet, e tëra dhe e bëra.

Është e paprekur dhe GU nuk e ka shitur, as që do ta shesë asnjë pëllëmbë të saj.

Nuk kemi nënshkruar asgjë, nuk kemi vulosur asgjë, nuk kemi bërë kurrfarë pazaresh me të dhe as që mund ta bëjmë një gjë të tillë.

Për kureshtjen tuaj, po citoj vetëm një paragraf të dokumentit të parë që i është dhënë z. Ahtisari dhe i është bërë me dije se, citoj: "Delegacioni i Kosovës u qaset bisedimeve për reformën e pushtetit lokal duke u mbështetur në qëndrimin se nuk mund të ketë marrëveshje për asnjë element të pakos për zgjidhjen e statusit përfundimtar, përderisa të mos arrihet marrëveshja për pakon në tërësi" – përfundon citati.

Këtij parimi i jemi përmbajtur dhe do të vazhdojmë t'i përmbahemi deri në fund.

Kolegë të nderuar,

Duhet të thuhet, po ashtu, se duke pasur parasysh përvojën e hidhur dhjetëvjeçare të dialogut me Serbinë, që nga fillimi i këtij procesi, ne, jo vetëm që kemi qenë shumë skeptikë, por jemi përpjekur t'ia bëjmë me dije edhe bashkësisë ndërkombëtare se kjo mënyrë e zgjidhjes së statusit, vështirë se do të japë rezultate të duhura.

Prandaj edhe kemi kërkuar njohjen formale të pavarësisë së Kosovës,

Ju kujtohet se, mu nga ky Kuvend, kemi bërë deklarata e rezoluta për njohjen e pavarësisë së Kosovës. Por, siç e dini, në vend se të akceptohej kërkesa jonë legjitime, pra, njohja formale e pavarësisë së Kosovës, deklaratat dhe rezolutat tona, me një shpejtësi prej rrufeje, ende pa dalë ne nga kjo sallë, shpalleshin nul. Por, ne jemi të përkushtuar t'u mbetemi besnik përcaktimeve tona të shprehura edhe nëpërmjet tyre.

Jam i sigurt se ju e dini që ne, megjithatë, është dashur dhe duhet t'i ruajmë miqtë tanë që u gjendën pranë nesh në momentet më kritike.

Prandaj pranuar preferimin e tyre që, pikërisht nëpërmjet negociimit të zgjidhet statusi i Kosovës, por me garanci se ky negociim do të bëhet me bashkësinë ndërkombëtare e jo me Serbinë dhe vetëm për çështje teknike.

Dhe, siç u pa më vonë në praktikë, vërtet negociimi nuk u zhvillua me palën serbe, por kryesisht me atë ndërkombëtare, ose në prani të saj dhe po ashtu, vetëm për çështje teknike, që natyrshëm linden si pasojë juridike e statusit.

Të nderuar deputetë,

ndërkombëtare. Sado të rëndësishme të jenë ato dhe protagonistët e tyre, duke i shndërruar qytetarët në spektatorë në emër të asaj që po ndodh në qendrat botërore të vendosjes lidhur me çështjen e Kosovës. Kjo politikë ka elemente të politikës së aktit të kryer dhe për këtë për mua është e papranueshme.

Të nderuar anëtarë të Grupit të Unitetit, është shumë e qartë se përkundër synimeve tuaja më të mira dhe punës së madhe që keni bërë në vitin e kaluar janë duke u rishikuar hartat administrative e Kosovës përgjatë vijave etnike, ju thoni se kjo nuk do të lejohet por me këtë rast mos e harroni faktin se vendimin përfundimtar për këtë do ta marrë Këshilli i Sigurimit dhe jo ky Kuvend. Unë e kam shumë të qartë se duke falë diplomacive të shteteve të Bashkësisë Evropiane dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, çështja e Kosovës është në rrugë të zgjidhjes dhe se pa ndihmën e këtyre faktorëve ndërkombëtarë ne as nuk do të ishim sot ku jemi. Njëkohësisht mund të kuptojë edhe mungesën e iniciativave origjinale politike. Politika ndërkombëtare, padyshim, kërkon bashkëpunim, përgjegjshmëri dhe ndjeshmëri, mirëpo njëkohësisht kërkon edhe vendosmëri, urti dhe originalitet të veprimit, me qëllim që zgjidhja përfundimtare të jetë e qëndrueshme dhe në dobi të të gjithëve, pa përjashtim.

Më vjen keq të konstatoj se rezultat i politikës pasive Grupi i Unitetit nuk ka arritur që ofertën e tij zemërgjerë kur komunitat e reja, ku pakica serbe do të ketë shumicën si dhe kompetencat e zgjeruara deri në kufijtë e minishteteve t'i balancojë me çfarëdo garancie ndërkombëtare, se popullata shumicë shqiptare dhe qytetarët e përkatësive të tjera etnike, do të gëzojnë sovranitetin e plotë në shtetin e pavarur të Kosovës.

Pyetja që mua më mundon më së shumti a është paramenduar situata kur përkundër dëshirës më të mirë të miqve tanë ndërkombëtarë Këshilli i Sigurimit t'ia imponojë Kosovës zgjidhjen administrative për decentralizimin dhe të tjera që gjenden në ofertën tuaj ose shumë të mundshme edhe më të pafavorshme, ndërsa njëkohësisht ta cungojë sovranitetin e popullit të Kosovës, si në substancë, ashtu edhe në kohëzgjatje., me formula të ndryshme të pavarësisë së kushtëzuar me sovranitet të kufizuar. Kush na garanton se në përfundim të procesit të përcaktimit të statusit politik të Kosovës, sovraniteti i Kosovës do të sigurohet me ulëse në organizatën e Kombeve të Bashkuara, veçanërisht kur është shumë e qartë kur zgjidhja përfundimtare, pa asnjë dyshim, do të imponohet nga Këshilli i Sigurimit.

Të nderuar anëtarë të Grupit të Unitetit, besoj se e keni të qartë se pa sigurimin e shkallës së plotë të sovranitetit zgjidhjet politike dhe administrative të dërguara nga ju - UNOSK-u për, të cilat ju jeni dakorduar me konsensus, do të paraqesin derë të hapur për përkeqësimin e situatës së sigurisë në Kosovë edhe të stabilitetit në rajon. Shpresoj që edhe faktori ndërkombëtar e ka këtë të qartë. Vetëm shteti i pavarur i Kosovës me sovranitet të plotë të siguruar me ulëse në Organizatën e Kombeve të Bashkuara do të na mundësojë që me sukses të ballafaqohemi me sfida të veçanta brenda një shteti asimetric dhe në masë të madhe jofunksional që është duke u projektuar si rezultat i bisedimeve teknike në Vjenë. Vetëm në këtë rast mangësitë e këtij modeli gjithnjë me punë të madhe dhe kreative do të mund të shndërrohen në përparësi duke e bërë Kosovën model të shtetit ku mbretërojnë drejtësia, siguria dhe bashkëjetesa konstruktive qytetare e cilësuar

për tolerancë ndëretnike dhe ndërfetare. Duke pasur parasysh përfundimin e shpejtë të procesit të bisedimeve teknike në Vjenë, i dhe fazën e ardhshme të bisedimeve, do të zhvillohet kryesisht në selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork dhe me qëllim që procesi i deritanishëm i bisedimeve të fitojë një kualitet përmbajtësor në bazë të rregullës 29, pika 2 të Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës. Si çështje urgjente e parashtrij propozimin e Partisë së Drejtësisë të mbështetur nga Grupi Parlamentar për Integrim që Kuvendi i Kosovës në këtë seancë të nxjerrë deklaratë me të cilin i informon shtetet, Grupin e Kontaktit dhe anëtarë të tjerë të Këshillit të Sigurimit, se propozimet e ofruara nga Grupi i Unitetit gjatë bisedimeve teknike në Vjenë do të mbështeten nga Kuvendi i Kosovës vetëm në rastin kur Kosovës do t'i garantohet sovraniteti i plotë me sigurimin e përfaqësimit të saj si shtet i pavarur në Organizatën e Kombeve të Bashkuara me të drejta të barabarta si të gjitha shtetet e tjera anëtare të OKB-së.

Me këtë mendoj se do të arrihet ekuilibri i domosdoshëm i interesave politike të popullatës shumicë në Kosovë dhe komuniteteve të tjera etnike minoritare, duke përfshirë atë serbe.

Të nderuar deputetë. Unë ju lutem që me rastin e përcaktimit për këtë çështje të jemi unikë dhe për një moment t'i harrojmë ngjyrimet partiake dhe interesat afatshkurtra politike. Palës kosovare në periudhën e ardhshme i nevojitet iniciativë e fuqishme politike, përkrahje e kësaj deklaratë të Kuvendit të Kosovës nga shtetet e Grupit të Kontaktit dhe bashkësia e gjerë ndërkombëtare do të siguronte zhvillim pozitiv të ngjarjeve dhe do të ishte tregues se bashkësia ndërkombëtare si edhe ky Kuvend janë të interesuar për zgjidhje afatgjatë dhe të drejtë të çështjes së Kosovës. Në të kundërtën më duhet të shpreh brengosjen time të thellë për ardhmërinë e vendit tonë. Në rast se nuk sigurohet përfaqësimi i plotë dhe i menjëhershëm i Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, ndërsa njëkohësisht na imponohen zgjidhjet që deri më tani Grupi i Unitetit i ka propozuar si qëllimira dhe në funksion të zgjidhjes së problemit, atëherë Kosova si strukturë shtetërore asimetrike dhe jo funksionale me kantonet e ndërlihdura në korridore monoetnike serbe, shumë shpejtë do të shndërrohet në vatër jo të stabilitetit, në burim të tensioneve të vazhdueshme dhe të krizave të përditshme. As nuk dua të mendoj se kushdoqoftë ka dëshirë që në zemër të Evropës të krijohet situata e Lindjes së Mesme, mirëpo saktësisht mundësitë për këtë në rrethana të tilla do të jenë të mëdha, mjaftohcmi të kthehet shikimi vetëm disa vjet prapa dhe shumë gjëra do të na bëhen të qarta.

Për të mirën e popullit të shumëvujtur të Kosovës, për hir të paqes dhe të stabilitetit në rajon situata e tillë duhet të parandalohet me çdo kusht.

I nderuari kryetar i Kuvendit ju lutem që propozimin e Partisë së Drejtësisë të mbështetur nga Grupi Parlamentar për Integrim, urgjentisht ta hedhni në votim. Në rast se propozimi miratohet mund ta paraqes edhe projekttekstin e kësaj deklaratë që më tutje mund të harmonizohet nga kryetarët e grupeve parlamentare. Ju faleminderi!



KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi.

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI – Z. kryetar, zotërinj të Grupit Negociator, kolegë deputetë, zotërinj ministra. Nga materialet që na janë dhënë u vërtetua puna voluminoze dhe me përgjegjësi që e ka bërë Grupi Negociator dhe me këtë u sqaruan shumë dyshime rreth procesit të negociatave të cilat kanë lindur te populli dhe te shumica e deputetëve për shkak se nuk ishin informuar për rrjedhën dhe përmbajtjen e procesit negociator. Informatat i kemi marrë nga mediat duke i dëgjuar deklaratat sportive për suksesin e Grupit Negociator. Me çudi pyeteshim se çfarë domethënie kishin këto deklaratat dhe kujt i nevojiteshin, besoj se në të ardhmen transparenca aq sa është e nevojshme do të hyjë në agjendën e punës së Grupit Negociator dhe me këtë jo vetëm që do të na mundësojë edhe neve deputetëve si anëtarë të institucionet më të larta të Kosovës që të mos ndjehemi të përjashtuar nga ky proces jetik për Kosovën, por edhe do të na jepet mundësia që të vlerësojmë se a do t'ia japin përkrahjen Grupit Negociator në kohën e duhur. I kuptoj vështirësitë e shumta me të cilat përballen anëtarët e Grupit Negociator, si edhe stresin e mundshëm nga presioni që ju bëhet nga bashkësia ndërkombëtare, dëshira e madhe që të plotësohet vullneti i popullit të Kosovës dhe kërkesat e palës serbe e cila ka për qëllim pengimin e formimit të shtetit të Kosovës e nëse nuk e arrin këtë edhe gjymtimin e tij dhe ndoshta është shumë lehtë të kritikohen vendimet e tyre, por shpresojmë se këto vërejtjet e mia që do t'i bëjë tani të merren si të menduarit kritik i cili ka për qëllim të përkrahë dhe ta risë vendosmërinë e Grupit Negociator që së bashku të krijojmë shtet të orientuar nga demokracia, politikisht stabil, ekonomik të zhvilluar, ta krijojmë Kosovën evropiane. Gati në të gjitha shtetet e Evropës Perëndimore decentralizimi është kryer me lehtësi pas një tradite të gjatë shtetërore, duke u bazuar në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale. Te ne negociatat për decentralizim po bëhen pa u përcaktuar më parë se çfarë shteti do të jemi, për këtë as që është biseduar duke u imponuar tejkalimi i parimeve të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale.

Edhe pse është premtuar se nuk do të ketë ndarje territoriale dhe etnike në realitet këto dy çështje kanë rol të rëndësishëm në procesin negociator se kanë qenë bazë për krijimin e komunave të reja. Edhe zonat mbrojtëse për rreth manastireve aq të mëdha do të pengojnë lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës, p.sh. janë zonat rreth kishave të Deçanit dhe Patriarkanës së Pejës nëpër të cilat kalojnë rrugët e rendit të parë. Rruga është interes i përgjithshëm e jo interes i kishës.

Në shtetet e mëdha, si është Italia kjo ndoshta është edhe gjë normale, por në një vend të vogël si është Kosova e prish funksionimin e jetës normale të qytetarëve të saj. Në kërkesat maskimaliste të palës serbe për krijimin e një numri të madh të komunave të cilat në të shumtën e rasteve ishin absurde edhe pse janë kundërshtuar nuk është reaguar me oferta minimale, në mënyrë që të arrihet një mes, por është reaguar me një zemëgjerësi në kuptimin e dhënies së kompetencave komunave të banuara me popullatë serbe, duke e rrezikuar funksionalitetin e shtetit të ardhshëm. Dhënia e kompetencave me fushat e gjyqësisë, të prokurorisë dhe të policisë dhe nëse merret parasysh që pushteti qendror nuk ka të drejtë t'i anulojë vendimet komunale, atëherë këto komuna do ta kenë

atributin e një shteti. Me këtë shkelën dokumentet bazë, sipas të cilave është bërë decentralizimi në shtetet tjera të Evropës.

Kontrollin e mjeteve financiare, kontrollin nga ana e pushtetit qendror, pa marrë parasysh, kontrollin e mjeteve financiare të komunës dhe ta bëjë komuna pa kurrfarë kontrolli nga ana e pushtetit qendror, pa marrë parasysh se pos taksave komunale dhe granteve do të financohen edhe nga buxheti qendror. Me këtë u jepet mundësia komunave të veprojnë në mënyrë të pavarur duke i marrë parasysh vetëm interesat e veta komunale e jo të shtetit në përgjithësi. Në përgjithësi nga të gjitha dokumentet e dhëna për negociatën vërehet diskriminim pozitiv i tepërtë për palën serbe. Kjo vetëm se nuk është jodemokratike, por do të krijojë te popullata shumicë një ndjenjë se po i bëhet padrejtësi dhe pakënaqësia do të ketë kohëzgjatje. Zgjedhjet mund të jenë edhe të imponuara, por atëherë do të dihej se nuk janë bërë me vullnetin e palës kosovare. Ju faleminderi!

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit, fjalën e ka Remzie Nimani

**DEPUTETJA REMZUE NIMANI** – I nderuari president i Kosovës, i nderuari kryetar i Kuvendit, i nderuar kryeministër, të nderuar anëtarë të Grupit Negociator, ministra kolegë deputetë dhe të pranishëm në sallë.

Në lidhje me propozimin për decentralizimin në komunën e Mitrovicës, sipas parimit një qytet dy komuna dua të paraqes disa shqetësime apo brengë që po e preokupojnë popullatën e Mitrovicës, por edhe më gjerë.

I nderuari Grup i Unitetit, në materialin të afruar nga ju ceket se Mitrovica Veriore, Graçanica dhe Shtërpca do të jenë përgjegjëse për shëndetësinë sekondare. Kjo është e kuptueshme për Graçanicën dhe Shtërpçën, mirëpo Mitrovica "Veriore" prapë them promovohet në qendër shëndetësore apo qendër rajonale për shëndetësi për komunat veriore. Kjo nënkupton themelimin e një komune politike në veri të Kosovës.

Shtrohet pyetja ku do të sigurojnë përkujdesjen sekondare shëndetësore banorët e Mitrovicës Jugore, dihet se spital nuk kemi. E njëjta gjë që vlen edhe për arsimin e lartë pasi që Universiteti në veri të Mitrovicës do të jetë qendër e shkollimit për serbët. Shqetësimi im është edhe për zonat kadastrale. Përderisa për komunat e reja që do të formohen si Graçanica Novobërda, Parteshi etj. janë prezantuar zonat kadastrale, pse nuk janë prezantuar edhe për Mitrovicën. Ku do të mbesin fshatrat që i takojnë kësaj komune të re, si Suhodolli, Vitimriçi, Gushavci dhe Vinarci që është dashur t'i përkasin ose të përfshihen në komunën e re të Mitrovicës. Kjo të jep të kuptosh se serbët nuk janë të interesuar të formojnë komunë multietnike, por monoetnike. Edhe një pyetje.

Me formimin e komunës Mitrovica Veriore a do t'u mundësohet shqiptarëve që të kthehen në pronat e tyre prej nga janë dëbuar me dhunë nga paramilitarët serbë. Për këtë kemi fakte sa të duash, sepse ndodhi edhe tragjedia më 3 e 4 shkurt 2000.

Të nderuar të pranishëm në sallën e Kuvendit të Kosovës, shqiptarët që jetojnë në lagjet veriore të Mitrovicës edhe 7 vjetë pas përfundimit të luftës në asnjë moment nuk e kanë ndierë veten të lirë dhe nuk e kanë gëzuar lirinë e Kosovës. Mbështetur në të dhënat e lartëcekura lus Grupin Negociator ta rishqyrtojë edhe një herë rastin e Mitrovicës „nëse për asgjë tjetër të mos mbetet komunë njëetnike. Ju faleminderit“

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Ju njoftoj se në sallë janë 77 deputetë. Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi.

**DEPUTETI RAMDAN KELMENDI** – Faleminderit. I nderuari kryetar i Kuvendit, i nderuari presidenti i Kosovës, i nderuari kryeministër, të nderuar anëtarë të Grupit Negociator, të nderuar ministra të pranishëm, kolegë deputetë dhe të pranishëm të tjerë.

Në seancën e kaluar me vëmendje të theksuar e përcolla raportin e Grupit Negociator lidhur me ecurinë e bisedimeve në nivelet më të larta për statusin e Kosovës. Personalisht mbështes përpjekjet e Grupit Negociator, angazhimin edhe individual dhe kontributin e dhënë për ecuri lidhur me proceset e pavarësisë së Kosovës mbështetur në kërkesat gjithëpopullore dhe në Rezolutën e Kuvendit të Kosovës me mandatin burimor të theksuar dhe të themeluar nga presidenti tanimë i ndjerë dr. Ibrahim Rugova. Të them realisht kam pritur informacione të plota më të hollësishme, më të sakta dhe jo vlerësime aq të përgjithësuara lidhur me proceset politike. Në tërësi po ashtu i përkrah qëndrimin dhe vlerësimin e Grupit Parlamentar të LDK-ës për paraqitjen, por nuk pajtohem me atë që në këtë situatë dhe në këto rrethana politike të krijojmë kriza politike, kriza qeveritare apo institucionale sepse ato para së gjithash do të ishin të dëmshme për ne.

I nderuari kryetar, të nderuar të pranishëm,

Unë diskutimin tim do ta përqendroj në dy çështje dhe lidhur me këtë do ta kisha kërkuar vëmendjen në tërësi në Grupin Negociator dhe në veçanti të ekspertëve, sepse do ta elaboroj çështjen e trashëgimisë kulturore dhe çështjen e parimit themelor të pushtetit lokal apo parimet e decentralizimit.

Lidhur me pikën e parë do të theksoj se në materialin që e kemi marrë këtu kemi një hartë që nuk e di se sa është lexuar, kuptuar apo analizuar. Në këtë është paraparë një objekt kishtar, ortodoks të shndërrohet në Manastir dhe të marrë pronën e familjes së Buletinit, pronë që kurrë nuk ka ekzistuar dhe shfrytëzuar. Këtu përpara kam një dokument të datës 16.8.1945 ku familjes Buletini i konfiskohet tërë pasuria që sot i jepet këtij objekti si nacionalist, si armik i pushtetit komunist dhe këtë duke cituar Kapllan Buletinit, Pajazitit dhe familjes së Faik Buletinit. Këto dokumente duhet t'u shërbejnë Grupi Negociator dhe ekspertëve si dëshmi se prona nuk është e shenjtë dhe e patjetërsuar dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet. Në veçanti në këtë hartë tri fshatra Kelmend dhe Buletin dhe Zhazhë hyjnë në zonën e mbrojtur, një territor që përfshin më se 16 kilometra katëror. Kësaj nuk i duhet më shumë koment përveç se Grupit të ekspertëve për të tërhequr vërejtjen se çka praton dhe çka pretendohet të arrihet, kur në të njëjtën kohë ky objekt kishtar është shumë i ri në krahasim me këtë pamje të qytetit të Mitrovicës së pjesës veriore dhe kjo xhami është 182 vjet më e vjetër se kisha ortodokse



në fshatin Boletin që pretendon ta marrë tërë pasurinë e tri fshatrave në zonë. Dhe kisha dëshiruar që po ashtu një objekt në Banjaskë të hyjë në mbrojtje të trashëgimisë kulturore për të cilën ne asnjë nuk kemi kundërshtim, por harrohet që në Banjaskë kanë jetuar, kanë pronën shqiptarët dhe atje janë hamami, varrezat e shqiptarëve, teqja, kroi, po e përsëris kroi dhe mulliri i Isufit dhe xhamitë të cilat jo që nuk janë diskutuar, por nuk janë përmendur fare si objekte me vlerë trashëgimore shqiptare ku tani bëhet luftë për hapësirë gjeografike dhe për kilometra.

Do të ndalem pak në parimet themelore të pushtetit lokal.

Vlerësoj se grupi i ekspertëve ka tejkaluar kompetenca, është filluar në qeverinë e Bajram Rexhepit dhe është pranuar nga të gjitha qeveritë për procesin e decentralizimit, pa u lëshuar në esencë çka përmban, cili është qëllimi pa analiza profesionale juridike dhe pa e shpjeguar reformën e pushtetit lokal, decentralizimin dhe në fund krijimin e komunës së Mitrovicës, gjegjësisht komunës Veriore. Njoftoj të pranishmit se në Mitrovicë kanë jetuar në prag të luftës 149 mijë e 820 qytetarë, pra në vitin 1999 prej tyre 89 % shqiptarë dhe 11% të tjerë. Decentralizimi në Mitrovicë është kryer në vitin 1986 kur është krijuar komuna e Zubin Potokut, komunë tipike serbe, ndërsa është ndaluar me të gjitha dokumentet se nuk kemi arsye të krijojmë komuna njëetnike, komunën e Barës, me 47 fshatra. Në vitin 1996 Kuvendi i Serbisë krijon komunën e Zveçanit në mënyrë të njëanshme, një komunë e cila sot pretendon ta marrë edhe tërë veriun e Kosovës me 18.9% të territorit dhe me një popullatë prej më se 78% shqiptare, e cila nuk jeton tanimë në trojet e veta, sepse 23 mijë e 820 shqiptarë nuk mund të kthehen në pjesën veriore. Në veçanti grupi i ekspertëve që ka punuar për çështjen e decentralizimit në tërësi, punon në kundërshtim me urdhëresën administrative të qeverisjes së komunave të Kosovës 2000/45 ku për territorin për hapësirën dhe për njësitë kadastrale vendos vetëm Kuvendi dhe jo ky grup negociator apo grupi i ekspertëve. Të gjitha këto duhet të jenë bazë dhe argument i madh për punën e mëtutjeshme dhe në veçanti në tërësi paraqes shqetësimin që paraqiti parafolësi se komuna e Mitrovicës në kuptimin organizativ të tanishëm ndahet me lumin Ibër që askund në botë të gjithë kufijtë që kanë pësuar me zona malore dhe lumenj kanë përcjellë konflikte të pazgjidhshme përjetësisht, prandaj edhe propozimi që është aprovuar nga Grupi Negociator nga ish- kryeministri Bajram Rexhepi është i padrejtë dhe i paqëndrueshëm, sepse krijon komunë tipike njëetnike në të cilën të gjitha etnitetet e tjera dhe në veçanti shumica shqiptare nuk do të ketë mundësi ta realizojë asnjë të drejtë, duke përfunduar se asnjëherë deri më tani nuk është biseduar për pozitën e shqiptarëve në veri dhe në lagjet veriore, për pozitën e atyre që jetojnë në pjesë e tjera të Kosovës dhe që janë në gjendje të mjeruar, si refugjatë për investimet 3.2 milion që bënë Serbia për të blerë pronat e shqiptarëve dhe për asnjë cent dhe asnjë shtëpi të ndërtuar nga buxheti i Kosovës në pjesën veriore. Lus edhe një herë Grupin Negociator dhe komisionin e ekspertëve që nëse dëshiron t'i ketë të gjitha këto të dhënat të argumentuara unë mund t'ua prezantoj me dëshmi dhe me një dosje prej 83 faqeve, e cila vërtet do t'i ndihmojë shumë për ta konstatuar të vërtetën në bisedatat e mëtutjeshme. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ramë Buja, le të përgatitet deputeti Bajram Kosumi.



DEPUTETI RAMË BUJA – Të nderuar kolegë deputetë, i nderuari z. kryetar,  
Grupi i Unitetit, qeveritarë të nderuar.

Unë nuk do të ndalem shumë në atë që u tha, por do të përpiqem të them diçka që të ndihmoj këtë debat të vonuar dhe nuk do të ndalem te Grupi Negociator a ka legjitimitet apo nuk ka, sepse në fakt duhet ta konkludoni vetë ju se ky Grup Uniteti është votuar në pesëshen e dikurshme dhe tanimë tre nga ata nuk janë dhe janë dy, vetëm dy që e përbëjnë atë Grup Unitetit.

Por duhet të ndalem në gjëra të tjera që është dashur t'i ketë parasysh Grupi i Unitetit për të mos pasur shqetësimin se po na lodh shumë si deputet, sepse s'kemi gjë më prioritare e esenciale se të merremi me çështjen e negociatave që po zhvillohen për fatin e nesërm të Kosovës dhe të na vij edhe para Vjenës edhe pas Vjenës, çdo seancë dhe çdo mbledhje të mbajtur në Vjenë, pa asnjë problem, na bien dokumente në vazhdimësi dhe gjithsesi ne t'i shqyrtojmë dhe të mos e ketë barrën, të mos e mbajë barrën mbi supet e veta atë që s'i takon ta mbajë një barrë të lehtësuar, duke u mbështetur në gjithë njëqind e sa deputetëve të Parlamentit të Kosovës. Megjithatë duhet t'i falënderojmë që duan ta marrin barrën vetë, nuk duan ta ngarkojnë Parlamentin dhe gjithsesi barra na kishte takuar të gjithëve dhe meritat këtyre. Por unë dua t'ju them edhe një gjë që të ndalem aty ku jam, besoj me njohuri më të plota dhe të sqaroj diçka që edhe e dinë, por edhe ta risqaroj.

Është folur këtu që decentralizimi ka filluar, ka filluar kur ka filluar, unë ju them që bazat e fillimit të decentralizimit dhe të vërjes mbrapshtë të çështjeve janë te 2000/45. Ju kujtohet ,dua t'ju rikujtoj një farë ministri pat dhënë dorëheqje atëherë pikërisht për 2000/45 për të mos qenë këto pozicione për t'i legjitimuar enklavizimet e Kosovës apo getoizimin.

Por vazhdimësia ka qenë është thënë këtu të nderuar deputetë nga Qeveria e Bajram Rexhepit. Është edhe një e vërtetë tjetër, por e vërteta qëndron se në Qeverinë e Bajram Rexhepit dhe në atë kohë është insistuar në një decentralizim të mirëfilltë për faktin se kur s'janë përmendur krijimi i komunave të reja, por krijimi i njësive nënkommunale që nënkupton decentralizim të mirëfilltë, por ofrim të shërbimit afër qytetarit, sepse harta evropiane për decentralizimin në fakt për pushtetin lokal e ka një shpjegim shumë të shkurtër, ofrim i shërbimit më afër qytetarit asgjë më shumë. Dhe decentralizimi "që tani quhet decentralizim" e që s'ka të bëjë asgjë me decentralizimin, ama bash asgjë me decentralizimin, por ka të bëjë me getoizimin, ndarjen dhe krijimin e territoreve dhe rrugëve blu siç është kërkuar në ato 8 pikat famoze të Çoviqit. Ju e dini mirë, për fatin e keq dhe ky veprim i tanishëm ka adresë, ka pushtetin lokal, ka ministrin Haziri dhe është fare e ditur, ju lutem, nëse i keni shikuar dokumentet me kujdes atëherë ka ndryshim dokumenti i hartuar për Grupin Politik, anglisht dhe shqip ka ndryshim, ka ndryshim faza tjetër ku ka kaluar nga Grupi Politik për në Grupin e Unitetit dhe ka ndryshim përsëri kur ka kaluar nga Grupi i Unitetit për t'ju dorëzuar Ahtisarit. Ky shqetësim, ju lutem, keni parasysh analizoni dhe shihni a është për t'u trazuar shumë. Ne si grup parlamentar kemi shfaqur shqetësimin tonë.

Edhe më 20 maj të këtij viti kur është debatuar për decentralizimin kemi thënë: ky nuk është decentralizim as nuk ka të bëjë me decentralizimin dhe ne në këtë decentralizim

të quajtur po krijojmë një punë të shumëfishtë që nesër duhet ta bëjë, sepse Kosova e nesërme e pavarur do të duhet t'i hyjë harmonizimit të akteve dhe të të drejtave që duhet të garantojë për minoritetet dhe komunitetet, por edhe të ristrukturojë pushtetin vendor në Kosovë. Ne duhet ta bëjmë punën e sizifit përsëri, sepse kjo pavarësi kush e ka iniciuar, kush e ka vazhduar dhe kush po përpiqet ta përmbyllë është mbrapsht e bërë, është mbrapshtë e bërë ju lutem dhe është keq për ata që duan të getoizohen tepër keq, është keq për ata që duan të enklavizohen, në rend të parë për rininë serbe, pastaj për ne si parlamentarë dhe për gjithë Kosovën. Ju e dini mirë. Dua vetëm t'ju rikujtoj Serbia asnjëherë nuk ka bërë luftë për ide, për ideologji, por ka bërë luftë për territore. Merrme dhe shihë hartën dhe do ta shihni se cila është tendenca e bërjes së komunave të reja, pse e bënë atë, që nesër të ketë legjitimitet mbi territoret e caktuara që të thotë apo ta bosnizojë Kosovën, ju lutem. Andaj, kishta thirrur vëllazërisht dhe shoqërisht Grupin e Unitetit që këtë gjë ta ketë parasysh se bosnizimi i Kosovës ka mundësi të ndodhë dhe po ju them se Bosna nuk është zgjidhur, ajo ka mbetur e varur e varur akoma pa u zgjidhur dhe barrë për komunitetin ndërkombëtar dhe për ta dhe nuk duam të jemi Bosnja e dytë. Kryetari i Parlamentit e tha një fjalë jo për të polizuar me të, nuk kemi nënshkruar asgjë. Po të kishim biseduar kur të ishte nënshkruar ai do të ishte: kofini pas të vjelave, nuk kishim pasur pse të bisedojmë, por po bisedojmë duke konsideruar se mund t'u ndihmojmë edhe Grupi Negociator, sepse është barrë, po e përsëris, tepër e rëndë.

Duhet t'ju rikujtoj edhe një gjë se shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së atë ditë kur filluam debatin, patë thënë se ne të Partisë Demokratike të Kosovës edhe pse nuk e patëm votuar Grupin Negociator për hir të proceseve të Kosovës, kryetari ynë është aty dhe ka bërë punën serioze konsideroj në këtë Grup, por shefi i Grupit Parlamentar tha: Ne të Grupit Parlamentar të PDK-së propozojmë që Kosovës të mos i cenohen në asnjë mënyrë pavarësia e sovraniteti, jemi për të, jemi për ulëse në Kombet e Bashkuara gjithsesi, Kosova ta ketë gjithsesi ushtrinë profesionale të saj, çështja e subfinancimit të komunave të jetë në bazë të numrit të banorëve, dhe gjithsesi të përmendet çështja e reciprocitetit dhe të drejtat e pakicave në këto bisedime, të mos na vijë turp ta përmendim reciprocitetin, sepse kemi do komuna, kemi disa njerëz, kemi një numër të caktuar dhe shumë bile të njerëzve. Unë dua t'ju rikujtoj Rezolutën e Kuvendit të Kosovës, që u përfol, u shpërfol, u hezitua dhe më në fund u votua. Megjithatë a jemi ne, nuk po e ndaj Grupin Negociator në kuadër të pikës 10 në veçanti të Rezolutës të caktuar, Duhet ta shikojmë mirë këtë çështje dhe me respekt për zotin Agani, për propozimet që pati, por desha t'ju rikujtoj edhe një herë këto propozime tona dhe pasi të sublimohen dhe të bëhen bashkë dhe të votohen në këtë Parlament, do të ishte më e mirë. Diçka që dua t'ju rikujtoj dhe shpreh dilemën time, mos paqa të drejtë – lëvizjet e fundit që i dini ju bashkë dhe e dija unë kanë bërë që të shtrohet dilema se çka me Grupin e Unitetit. Unë dua t'ju përshëndes!

**KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA** – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi, le të përgatitet deputeti Mark Krasniqi

**DEPUTETI BAJRAM KOSUMI** – I nderuari kryetar i Kuvendit të Kosovës, i nderuari President, kryeministër, anëtarë të Delegacionit të Kosovës për bisedime, të nderuari deputetë.

- Fillimisht më lejoni të theksoj se e mirëpres faktin që Kuvendi i Kosovës debaton bashkë me delegacionin e Kosovës për procesin e statusit final të Kosovës dhe bëhet një debat kaq përmbajtësor edhe në kohë i gjatë. Po ashtu theksoj se është në favor dhe është në të mirën tonë që Kuvendi i Kosovës të marrë rol gjithnjë e më të madh në fazën e përfundimit të bisedave për statusin final të Kosovës, të involvohet gjithnjë e më shumë në të gjitha propozimet, dokumentet që diskutohen dhe miratohen nga delegacioni i Kosovës për bisedime, po ashtu mirëpres që procesi i bisedave për statusin final është duke u zhvilluar mbi parimet e Grupit të Kontaktit të miratuara në prill të vitit 2005 dhe në janar të vitit 2006, që kanë qartësuar thellësisht se çfarë do të jetë statusi final i Kosovës në të ardhmen dhe të angazhohemi fuqimisht që ky proces të vazhdojë mbi ato parime pa u lëkundur dhe procesi të përfundojë në këtë vit, në vitin 2006 dhe të mos ketë asnjë lloj prolongimi që do të ishte rreziku më i madh për tërë procesin. Bisedimet për statusin final të Kosovës, sadoqë janë të mirëpritura, po ashtu edhe krijojnë shqetësime, por në fakt janë bisedime jo për fatin a do të bëhet a nuk do të bëhet shtet Kosova, por për tri tema të tjera, për pozitën e komunitetit serb në shtetin ardhshëm të Kosovës, për marrëdhëniet shtetit të Kosovës dhe të shtetit të Serbisë në të ardhmen dhe për prezencën ndërkombëtare pas statusit final dhe marrëdhëniet e Kosovës me Unionin Evropian në të ardhmen, por që të tri këto tema e kanë në fokus shtetin e Kosovës. Natyrisht, kryetema ose tema më e nxehtë për të gjithë neve dhe për qytetarët e Kosovës është pozita e komunitetit serb në Kosovë. Kjo krijon shqetësime, ndoshta për shkak të inercionit nga tradita, për shkak të frikës se mund të ketë zgjidhje të kompromisit që e dëmtojnë Kosovën dhe interesin e Kosovës në të ardhmen. Prandaj, unë propozoj që në këtë temë e cila me të drejtë krijon shqetësim te qytetarët edhe Kuvendi i Kosovës, por në radhë të parë Delegacioni i Kosovës të qartësojë një kompromis parimor, që do të jetë pastaj vlerë matëse për të gjitha zgjidhjet që ofrohen për komunitetin serb. Ky kompromis do të mund të ishte një po, për çdo kërkesë të bashkësisë ndërkombëtare ose të komunitetit serb në Kosovë, një po për aq sa ajo kërkesë dhe zgjidhje nuk e dëmton bërjen dhe funksionalitetin e shtetit të ardhshëm të Kosovës, kjo do të thotë një po e fuqishme, por njëkohësisht një jo për çdo kërkesë që i dëmtojnë bërjen, funksionalitetin dhe stabilitetin e shtetit të ardhshëm të Kosovës.

Më lejoni tash, që në kontekst me këtë kompromis parimor ta quaj kështu, në kontest të kësaj poje të rivlerësojmë edhe një herë disa prej propozimeve që janë ofruar ose janë diskutuar në dokumentet për statusin final të Kosovës. Nën një është i pakalueshëm krijimi i komunave etnike ose ndarja e komunave të Kosovës mbi bazë të kriterit territorial, etnik e tjera. Ndarja territoriale ose etnike e komunave, siç u tha nga disa parafolës, nuk krijon siguri në radhë të parë për komunitetin serb që jeton në ato komuna dhe këtë çështje duhet ta diskutojmë bashkë me UNOSEK-un dhe ta argumentojnë ekspertët tanë dhe delegacioni ynë fuqimisht, por po ashtu krijimi i komunave të reja nuk lehtëson jetën e qytetarëve në ato komuna, nuk ofron vendimmarrje më afër qytetarit, por shpeshherë ndodh e kundërta. Unë po e përmend këtu një shembull korrekt: banorët e fshatit Koretishtë të Gjilanit sot e kanë ndërtesën e komunës vetëm 3 kilometra larg, për çdo dokument ata duhet të udhëtojnë tre kilometra deri te komuna etj. nëse ndodh të bëhet realitet propozimi për komunën e Artanës do të thotë Novoberdës. banori i Koretishtës do të shkojë te ndërtesa e komunës 15 kilometra dhe në këtë rast është e kuptueshme pse politikanët serbë po e kërkojnë diçka të tillë, ata kanë interesa politike, por mendoj se delegacioni i Kosovës, Qeveria e



Kosovës, deputetët e Kuvendit të Kosovës do të organizojnë takime me qytetarët e Koretishes dhe t'i pyesin ata: A dëshirojnë që në të ardhmen ta kenë ndërtesën e komunës 3 kilometra larg apo dëshirojnë ta kenë 15 kilometra larg në një vend malor dhe duhet të merret mendimi i tyre dhe të vendoset ashtu. Çështja e dytë është, që të rivlerësohet edhe një herë në kontekst me atë ponë që thashë është ndarja e Mitrovicës në dy komuna. Kjo e ka trilluar procesin zgjidhjes, por besoj se nuk ka krijuar një bazë të mirë për zgjidhjen e problemit të Mitrovicës. Është e kotë fjalia në tekstet, diku në dokumentet e Delegacionit të Kosovës ku thuhet se Bordi do të bëjë pas tre vjetësh përcjellje që ta ribashkojë qytetin. Ndarja, e legjitimon për një kohë të gjatë ndarjen mbi baza etnike të Mitrovicës. Do të ishte ndoshta mirë të propozohet ose që të shkohet me një variant më të shtifikuar dhe më të drejtë ndarja e qytetit në tri komuna, në katër komuna, ose në pesë komuna, por jo me lumin Ibër për kufi. Mund të bëhen tri komuna, njëra e ka shumicën shqiptare, njëra e ka shumicën serbe dhe tjetra të ketë një shumicë të barabartë shqiptare, boshnjake dhe serbe, por është me rëndësi që lumi Ibër si kufi etnik të eliminohet, të mos ekzistojë në zgjidhjet përfundimtare.

Çështjet tjera, që duhen të rivlerësohen janë kompetencat e partneritetit të komunave, është shumë e çuditshme se në dokumentet e fundit përmendet shumë, gati çdokund ku përmendet komuna, përmendet edhe partneriteti i komunave. E kam fjalën për dokumentin e UNOSEK-ut, për pyetësorin e z. Ahtisari etj. Në një farë mënyre institucioni i partneritetit të komunave gati se e ka krijuar bazën e vet politike dhe juridike edhe pse formalisht ende nuk është thënë po. Partneriteti i komunave mund të jetë i tillë, por nuk mund të ketë Bord ekzekutiv. Lus Delegacionin e Kosovës se qysh e kanë bërë prej fillimit të ngulë këmbë që partneriteti i komunave të mos ketë kompetenca. Partneriteti i komunave mund të diskutojnë, mund të t'i koordinojnë gjërat mes veti, mund t'i harmonizojnë politikat, por nuk mund të kenë një trup ku marrin vendime, të kenë një buxhet ku e ndajnë për ekzekutimin e atyre vendimeve dhe të kenë një bord ekzekutiv që t'i ekzekutojnë ato vendime, sepse de facto kjo është ndarje, por mbi bazat e tjera e jo territoriale, por mbi bazat e pushtetit të pushtetit në Kosovë. Krijimi i dy pushteteve do të jetë Qeveria e Kosovës që është përgjegjëse për Kosovën dhe do të jetë Bordi ekzekutiv i partneritetit të komunave që do të ketë përgjegjësi në shumë sfera në komunat e banuara me serbë dhe kjo do të jetë vatrë e krizave të mëvonshme.

Çështja tjetër është, unë do ta quaja ndarja e pjesëshme e sovranitetit me një shtet tjetër ose me Serbinë. Në pyetësorin e fundit të UNOSEK-ut është bërë kjo pyetje: Sa është e gatshme Prishtina që të ketë dhe çfarë bashkëpunimi të ketë me Beogradin në mbikëqyrjen e kompetencave dhe realizimin e kompetencave të komunave. Përgjigjja është e mirë e Delegacionit të Kosovës. Nuk ka bazë për kurrfarë bashkëpunimi, por kemi vëmendjen; kjo është dera nga mund të hyjë ndarja e sovranitetit në mes të Kosovës dhe të Serbisë dhe një gjë e tillë nuk do të pranohet në asnjë mënyrë.

Ka edhe disa tema të tjera që unë sot nuk do t'i përmend, siç është kontrolli mbi universitetin publik në gjuhën serbe. Pra, është shumë e paqartë të jetë një komunë apo tri-katër komuna ose zonat e zgjeruara tepër shumë sigurisë rreth kishave e tjera, por unë po kaloj tash te një temë tjetër te metodologjia e punës së Delegacionit të Kosovës. Mungesa e informacionit për bisedat për statusin final shqetëson qytetarët e Kosovës dhe kur qytetarët kur nuk kanë informacionin edhe ka reagime të pritura ose të papritura. Prandaj, Kuvendi i Kosovës besoj fuqimisht e përkrah Delegacionin e



Kosovës, e përkrah procesin e bisedave për statusin final dhe kërkoj të involvohet edhe më shu

më në këtë proces.

**KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA** – Ju faleminderit! Fjalën e ka Mark Krasniqi, le të përgatitet deputeti Mahir Yagcilar

**DEPUTETI MARK KRASNIQI** - I nderuari kryetar, të nderuar qeveritarë dhe deputetë. Ju përshëndes të gjithëve përzemërsisht. Ne kemi qenë gjithmonë dhe jemi që të zgjidhet problemi në mënyrë paqësore me negociata, me marrëveshje, por duket se faktori ndërkombëtar këto negociata, këto marrëveshje i ka kuptuar shumë keq. Me lëshimin për të palës kosovare, d.m.th. në favor të Serbisë. Duket se këtu po përdhelet me tepër Serbia sesa po luftohet për të drejtat e pakicave kombëtare në Kosovë. Më tepër po luftohet nga ana e Serbisë për lëshimin për faktorit ndërkombëtar e jo e negociatorëve tanë se Serbia të ketë sa më shumë ingjerenca në territorin e Kosovës. Serbia haptas po thotë dhe po bën rezoluta, kushtetuta dhe ku ta dimë çka bën në Parlamentin e vet, se nuk njihet Kosova si shtet i pavarur kurrë, sepse në këtë mënyrë, s'i thotë Koshtunica, 15% të territorit të shtetit do të ndahet prej shtetit, do të thotë prej Serbisë. Duket se Koshtunicës nuk i ka thënë askush prej Grupit Negociator si erdhën këto 15% në kuadër të Serbisë? Si erdhën, kjo është tokë shqiptare me shëkuq qysh se e ka krijuar Zoti deri më sot dhe këtu 15% e shumë pesëmbdhjetështa të tjerë e ka okupuar Serbia më 1918, është formuar Jugosllavia – në atë Jugosllavi kanë hyrë të gjithë këta popuj që kanë dalë tash prej saj. Sllavët që janë i kanë të drejtat, i kanë elementet e shumta të barabarta, por Kosova ka qenë e okupuar. Më parë ka hyrë ushtria franceze këtu nga fronti i Selanikut për ta qetësuar popullsinë shqiptare dhe për ta mashtruar, të them drejt. Gjenerali francez u ka thënë: Ne jemi këtu, jua kemi sjellë lirinë, vëllazërinë dhe të gjitha të mirat, do të vijmë pas dy-tri ditësh edhe ushtria serbe, por ajo do të pushojë dy-tri ditë dhe do të nisët për Mal të Zi. Në realitet ka ndodhur e kundërta, pas dy- tri ditësh ka shkuar armata franceze, por ka mbetur deri në fund të qershorit ose kah mesi i qershorit të vitit 1999 këtu në Kosovë, do me thënë Koshtunicës e të gjithëve duhet t'u thuhet se ju jeni okupatorë, ju doni ta mbani Kosovën koloni, një koloni në zemër të Evropës, kurse kolonitë e tjera e kanë marrë pavarësinë e tyre motij. Edhe këto shtete që sot po luftojnë si Serbia ta kenë një ingjencë sa më të gjerë në Kosovë, ato vet kanë hequr dorë nga kolonitë e tyre të mbajtura. Sot duket se ne, kam përshtypje se po i vjen keq diplomacisë evropiane që ta korigjlinjë gabimin historik të ish-kolegëve të tyre më 1913 në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, kur është coptuar Shqipëria etnike, kështu që sot më se 65 mijë kilometra të territorit të Shqipërisë etnike janë jashtë kufirit të shtetit shqiptar. Ne nuk e kërkojmë këtë korigjim tash për tash, por i kërkojmë të drejtat tona, që të jemi të barabartë të kemi të drejtën e vetëvendosjes, e cila është një parim ndërkombëtar, që nuk po përmendet, madje na thuhet jo, në qoftë se bëhet ky shtet – duhet të bëhet shtetmulti-etnik kur është një etnitet një popull 90% në territorin e atij shteti. Ne duket se tash jemi njëfarë lloji miu laboratorik për të bërë eksperimente të

ndryshme në dëm të të drejtave tona. Këto komuna serbe, që po kërkohen janë shpesh më i madh, fatkeqësia më e madhe jo vetëm e Kosovës, por edhe e Ballkanit. Kurrësi nuk duhet të pranohen, në asnjë komunë të jetë etnikisht e pastër. Në qoftë se nuk është, edhe sot i kemi disa komuna etnikisht të patra serbe, janë Zubin Potoku, Leposaviqi, Siriliqi etj. ato le t'i kenë, le ta kenë kryetarin; le ta kenë komandantin e policisë e të gjitha të tjerat, por le të jenë edhe katundet serbe aty që kanë qenë edhe që duhen të jenë. Këto komuna serbe, në qoftë se ky decentralizim pranohet, atëherë nesër do ta kemi lidhjen e komunave serbe në Kosovë, pasnesër do ta kemi autonominë e komunave serbe në Kosovë, pastaj do ta kemi edhe një republika sprska në Kosovë me të në kokë. Ju lutem të gjitha këto janë gjëra që preokupojnë, por duhet thënë haptas, duhet të jemi realist gjithmonë edhe në jetën private edhe në jetën publike, ky është një rrezik permanent i paqes në Ballkan. Unë mendoj se Kuvendi duhet t'i marrë ingjerenca në duar bashkë me këtë ekipin negociator dhe t'u drejtohem faktorëve më të rëndësishëm ndërkombëtaë për zgjidhjen e drejtë të çështjes së Kosovës. Jemi për paqë, jemi për drejta të barabarta të gjitha minoriteteve dhe t'i thuhet Evropës: Ne minoriteteve do t'ua japim të gjitha të drejtat që ju po ua jepni minoritete që i keni në kuadër të shtetit tuaj e jo të bëjmë eksperimente me këto enklava, me këto manastire, me këto zona rreth e përqark. Zonat janë jashtëzakonisht problem i madh, sepse një herë kam lexuar në disa gazeta që ka thënë UNMIK-u ku ta shihni këtë shenjë, ishin disa zona tash i kam harruar të cilat, do me thënë kjo është një vërejtje, zona e dytë një vërejtje serioze, zona e tretë – arma, d.m.h. manastiret që kërkojnë që t'u kthehet një pjesë e të drejtave të tyre të feudalizmit mesjetar do të jetë gjithashtu një hap shumë i rrezikshëm për paqen në këtë pjesë të Evropës. Ju faleminderit! Edhe një gjë, serbët në Kosovë mund t'i kenë vetëm ato të drejta që do t'i kenë shqiptarët në Luginën e Preshevës. Ju faleminderit!

**KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA** – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Mahir Yagcilar, le të përgatitet ministri Gjini

**DEPUTETI MAHIR YAGLILAR** - Sayın Başkan, Sayın Bakanlar, Değerli Milletvekilleri

Bilinen bir gerçektir ki, bu gün Kosova oldukça önemli bir dönemden, yani Kosova'nın ilerideki statüsünü ve Kosova'nın geleceğini belirleyecek dönemden geçmektedir. Kosova'nın geleceği ise, yöredeki istikrarlığa, ekonomi ilerlemeye, uluslararası toplulukla işbirliği yapmaya, çoğunluğu oluşturan Arnavut topluluğu ile diğer toplulukların yaşamına bağlıdır. Bunların hepsi, Ahtisari başta olmak üzere, yürütülmekte olan müzakereler sayesinde gerçekleşmeli ve noktalanmalıdır.

Kosova'nın bağımsız devlet olmasıyla ilgili Kosova yurttaşlarının iradesinden ve bizlerin de desteklemiş olduğumuz Kosova Parlamentosu'nun Rezolüsyonu'ndan başlanarak, müzakere ekibi ve onun diğer enstrümanları, bu müzakereler sayesinde, ademi merkezîyetçilik, toplulukların hakları, kültürel mirasların korunması, ekonomi ve buna benzer alanlarda gereken garantileri sağlamalıyız.

Bu doğrultuda, diğer topluluklar da müzakerelerin gidişatı, Kosova'nın statüsü ve kendi topluluklarının statüsüyle ilgilenmektedir.

**Değerli Milletvekilleri**

Hatırlarsanız, bizler daha geçen yıl, Merhum Başkan Rugova tarafından müzakereler ekibinin belirlenmesi sırasında, prensipte desteğimizi sunarak, bu süreci engellemek istemediğimizi, ama sözkonusu süreçte yer almak istediğimizi belirtmiştik.

Fakat ne yazık ki, Danışma Kurulu'nun kurulmasına kadar hiçbir yere katılmış değildik. Danışma Kurulu'nun kurulmasından sonra, sesimizi duyurmaya başladık. Düşünceme göre bizler, uzmanlar ekibinden oluşan strateji politik gurubuna ve bununla birlikte temel ünite ekibine katılmamız gereklidir.

Bu günkü toplantıda görüşülecek olan konular ve bu belgeler hakkında bazı önemli görüşlerimizi sunmaya çalışacağız.

Yurttaşlara daha iyi hizmetin sunulacağı olanağı olarak ademi merkezizetçiliği prensipte destekliyoruz. Aynı zamanda, dengeli ademi merkezizetçilikten yanayız. Buna göre, belediyelerin büyüklüğü ile nüfus sayısı birbirine yakın olmalı ve etnik yapısı karar verici olmamalıdır.

Topluluklarla ilgili belge sözkonusu iken, onun hazırlanması sırasında gereken katkıyı sunmuş olmamıza rağmen, ne yazık ki belgenin hazırlanmasının son safhasında yer almadık. Öyle ki, elimizde varolan belgeyle ilgili bazı önemli uyarılarımız var. Bunlardan en önemlileri, garanti edilen yerler ve dil hakları konusu ile bölümüdür.

Düşüncemize göre, garanti edilen yerler bir dönem daha kalmalıdır. Dil hakları konusuyla ilgili ise oldukça büyük değişimler yapılmıştır. Diğer yandan, sözkonusu belge, yerel özyönetim belgesiyle uyumlu değildir.

Son belge ile bu günkü belge arasında, dillerle ilgili bölümde tam bir sayfa fark vardır. Bu günkü belge, daha doğrusu 8.1 ve 8.2 nokta, Türk topluluğu tarafından uyarıların yapıldığı Dillerle ilgili Yasaya atıfta bulunmaktadır. Bundan sonra, 5.6.2 noktada, Yasadaki değişmelerin, 2/3 oylama ve çifte oylama sürecine göre yapılacağı belirtilmektedir.

Fakat, Dillerle ilgili Yasa, çoğunluğun oylarıyla bir çeşit kabul edildi, yani eski anlaşmaların eş değerinde ve toplulukların, özellikle Türk topluluğunun önceden kazanılmış hak olarak özürü istemleriyle getirildi.

Öyle ki, Dil Yasası orantıyı yüzde 6 ve yüzde 3 olarak, Yerel yönetime ait belge ise yüzde 5 olarak göstermektedir. Topluluklar ise bu yüzdelerinin kaldırılmasını istiyor. Yüzdelerinin kaldırılmasını isterken toplumumuz, Türk dilinin geleneksel özelliğine ve somut belediyelerin varlığına dayanmaktadır. Durs, Priştine ve Selanik'te bu konuda yoğun çalışmalarda bulunduk ve sonunda isabetli bir belge hazırladık. Maalesef, son iki hafta içinde söz konusu belgenin, göze çarpan ve kabul edilmez değişmelere uğradığını gördük.

Bundan dolayı tutum uyumsuzluğunun meydana gelmemesi için Müzakere grubuna ve stratejik-politik grubuna, diğer topluluklardan temsilcilerinin de katılması gerektiğini düşünüyoruz.

Bu münasebetle biz, özellikle bizim koalisyon partnörlerimize ve muhalefet parti arkadaşlarımıza bu görüşlerimizi desteklemeleri için bir çağrıda bulunuyoruz. Biz partnör olmaya hazır olduğumuzu ve sadece haklar konusunda değil, sorumluluklarla da üstleneceğimizi ifade etmiştik. Biz genel olarak bütün Kosova'da kendi topluluğumuzun avukatı olmak ve söz konusu belgelerin hazırlanmasına katılmak istediğimizi söylemiştik. Aynı zamanda Kosova ve Kosova dışındaki ülkemiz çıkarlarının avukatı olmaya hazır olduğumuzu da beyan etmiştik. Dil Yasası konusunda Temas Grubuna verilen söz, Selanik'te sağlanan ortak karar, komisyon ve Başbakan Dairesinin de razı olmasına



rağmen, Dil Yasası'nın oylamaya sunulmasından sonraki davranışlar ve bu çeşit bir işbirliği ile kendi çıkarlarımızı savunamayacağımız bir durumda, Kosova çıkarlarını ne şekilde savunabiliriz diye sormak isterim.

İlerideki dönemde Ünite Gurubu bu konuya özellikle önem vermelidir, çünkü ilerlemeye asla engel olmayacağımızı ifade etmemiz, asla kendi topluluğumuzun hak ve garantileri için savaşmayacağımız anlamına gelemez. Kosova bizim devletimiz, vatanımız ve geleceğimizdir. Biz Kosova'nın inşaatına ve gelişim adımlarına hakeşitli olarak katılmak istiyoruz. Bugünkü tartışmalar ve diğer etkinlik formları bunu kanıtlamaktadır. Kosova karar verici bir dönemden geçmektedir ve bu dönemde Sırp topluluğuna tüm tavizler verilirken, diğer toplulukların da çıkarları unutulmasın istiyoruz.

Bundan dolayı bir daha, Topluluklar hakları belgesinin bu günkü şeklinin, Danışma Kurulu'ndan çıkan bir belge olmadığını şeffaflık ve doğru bilgilendirme adına bildirmek istiyoruz. Yarın olası yanlış anlaşımalar olmasın diye, bunun bu gün burda aramızda görüşerek düzeltilmesini istiyoruz. Eğer buna, Viyana görüşmelerinde müdahale edilirse, o zaman bunun anlamsız olacağını ve hepimizin kayıpta olacağını düşünüyorum. Çünkü Kosovayı nihayi statü ve bağımsızlık bekliyor. Bu süreçte hepimizin yardımcı olması gereklidir. Bu yardımda biz de varız. Teşekkür ederim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: GAZMEND MUHAXHERI – Fjalën e ka Adrian Gjini, anëtar i Grupit –

ADRIAN GJINI – anëtar i Grupit Ju faleminderit! Z. president, z. kryeministër, z. Thaçi, z. Surroi, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës. Unë sot më pak do të jap mendimet e mia rreth çështjeve për të cilat është biseduar këto ditë në Kuvend. Më tepër do të fokusohem që të jap disa shifra të sakta dhe disa fakte. Besoj se do t'u ndihmojnë edhe Kuvendit edhe negociatave edhe të gjithëve neve që jemi të përfshirë në proces. Në të njëjtën kohë, ajo që do të them besoj se do të ndihmojë të sqarohet e gjithë çështja e transparencës dhe e informimit me kohë dhe të saktë, që është trajtuar shumë herë, që është përmendur nga deputetët e Kuvendit të Kosovës ditën e kaluar dhe sot. Negociatat në esencë janë proces paksa më i mbyllur se proceset e tjera të cilat ndodhin. Është e vërtetë se çkado që themi, çdo fjalë që e themi, ndikon në proces diku më shumë e diku më pak. Mirëpo, nuk mund të paramendohet çfarëdo fjale që flitet në Kuvend të Kosovës ose publikisht, në cilëndo formë tjetër dhe të mos ketë ndikim në negociatat dhe në procesin në përgjithësi. Ajo që do të them është e studiuar dhe të gjitha që i them nuk besoj se e dëmtojnë procesin dhe kjo është arsyeja pse e them, mirëpo edhe një here po them – shumë shpesh thashë se çështja është se duhet të kuptohet në këtë formë të lidhjes funksionale në mes asaj që themi dhe negociatave.

Shërbimi ... Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor me kërkesën time e ka nxjerrë sipërfaqet e të gjitha komunave, sipërfaqet e sakta dhe është bërë krahasimi ndërmjet sipërfaqeve që kanë ekzistuar nëpër hartat topografike, me filmime, do të thotë nëpërmjet ajro-fotografisë, me incizime satelitore dhe me përpunimin më të saktë të të dhënave të mundshme, mund t'ju them se Shërbimi i ...GIZLLAJDI i Kosovës është ndër shërbimet më të sakta në Ballkan pa asnjë dyshim. Sipas këtij Shërbimi oferta e Kosovës për decentralizimin e shprehur në përqindje të territorit dhe në kilometra katrorë është si vijon: Komuna me shumicë shqiptare në Kosovë do të menaxhohen si komuna, do të thotë nuk do të jenë sovranë në territor për shkak se sovran është Kosova



në gjithë territorin, por do të menaxhojnë territor prej 85.62% të territorit ose që shkon diku në 9330 kilometra katrorë. Sipas propozimit të UNOSEK-ut ky do të jetë 84.59%, në anën tjetër, komunat me shumicë serbe do të menaxhojnë sipas propozimit të Kosovës 14.38% të territorit të Kosovës, ndërsa sipas propozimit të UNOSEK-ut dhe të kryendërmjetësuesit Ahtisarit 84.50%. Në lidhje me këtë do ta bëj edhe një ndarje tjetër për informatën tuaj: komunat ekzistuese serbe, siç janë: Zubin Potoku, Leposaviqi, Shtërpca, Zveçani dhe Novo Brda aktualisht menaxhojnë 12.4% të territorit të Kosovës të ndarë si vijon: 3.02% Zubin Potoku; 4.91% Leposaviqi, 2.17% Shtërpca; 3.14% Zveçani dhe 1.8% Novo Berda. Ndërsa komunat që krijohen, në fakt që parashihet të krijohen me planin 5+1 do të menaxhojnë 2.37% të territorit shtesë të Kosovës si vijon: 0.23% Klllokoti; 0.26% Parteshi; 0.64% Ranillugu; 0.02 Mitrovica Veriore dhe 1.22% Graçanica. Dallimet për të cilat po flasim janë më pak se 1% dhe menaxhimi shtesë që ka dalë prej procesit të decentralizimit është diku 3% në maksimum, varësisht prej marrëveshjeve që bëhen dhe prej zonave kadastrale që mund të lëvizin prej komunave të ndryshme. Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës këto janë shifrat e sakta dhe me qenëse këtë e thashë besoj edhe ju edhe opinioni publik e dini se jo në të gjitha rastet mund të ndahen të gjitha informatat publikisht, kjo çka them nuk është demagogji, është pjesë përmes të cilës ne e ndihmojmë procesin, ne jemi shumë të kujdesshëm se çka po ndodh me këtë proces. Këto shifra që i thashë unë sot, secili shërbim i interesuar në gjithë botën mund t'i ketë shumë shpejtë për shkak të avancimit të shërbimeve informative sot, do të thotë nuk është diçka e fshehtë, mirëpo fakti që e themi publikisht në rastet e ndryshme mund të ndikojë në percepcion dhe mund të ndikojë në mënyrën se si njerëz të ndryshëm, të cilët e përcjellin mbledhjen e Kuvendit dhe njerëzit e ndryshëm të cilët interesohen për këtë proces, do të mendojnë. Diçka tjetër që kisha dashur ta dini edhe ju këtu, është çështja të zonat mbrojtëse, të cilat do të krijohen rreth manastireve dhe kishave ortodokse serbe në Kosovë. Zonat mbrojtëse janë zona në të cilat rregullohet forma e shfrytëzimit të pasurive natyrore, nuk ndalohej, por rregullohet forma e mbrojtjes dhe forma e shfrytëzimit të këtyre pasurive, çka do të thotë se në një zonë të mbrojtur ekzistojnë aktivitete të caktuara të cilat lejohen të zhvillohen dhe ekzistojnë aktivitete të caktuara të cilat nuk lejohet të zhvillohen. Nëse bën të jam pak më deskriptiv do të thotë se në një zonë të mbrojtur nuk mund të ketë gurthyes ose fabrikë për prodhime kimike, për shembull, mirëpo mund të ketë zhvillim të aktiviteteve turistike dhe aktiviteteve të tjera, të cilat nuk e cenojnë zonën e mbrojtur. Ky është koncepti i zonës mbrojtëse. Diçka tjetër është, se prona private në zonat e mbrojtura nuk cenohet. Ky ka qenë qëndrim i fuqishëm i Ekipit të Unitetit, mirëpo mund t'ju them sinqerisht se as që është kërkuar ndonjëherë prej nesh të lëvizet me pronën në zonat e mbrojtura. Këtë e them me plotë kompetencë, kam marrë pjesë në të gjitha takimet në Vjenë dhe asnjëherë nuk është kërkuar prej nesh nga UNOSEK-u që të lëvizet me pronën. Do të flas diçka shumë shkurt edhe për kompromisin. Është e vërtetë, që ne kërkohet të bëjmë kompromis, shumica prej nesh e kuptojnë marrjen e disa vendimeve të cilat në esencë nuk na pëlqejnë, mirëpo e kemi një arsye ose një tjetër përse i marrim. Në Kosovë kanë ndodhur kompromise, po ndodhin kompromise, mirëpo siç e kanë thënë të gjithë anëtarët e Delegacionit të Kosovës prej presidentit e tjerë siç e tha sot edhe ish-kryeministri Kosumi, janë disa vija të cilat ne i kemi marrë për bazë që janë caktuar nga Grupi i Unitetit edhe nga ky Kuvend i Kosovës që nuk ka kaluar dhe ne besojmë se kompromiset që janë arritur

nuk e cenojnë funksionalitetin e shtetit të Kosovës, është diçka që po përsëritet, pra duhet t'ju them se bindja ekziston se edhe UNOSEK-u edhe kryendërmjetësuesi Ahtisari edhe Grupi i Kontaktit e kanë të njëjtin synim që Kosova të jetë shtet funksional, nuk synojnë të ndërtojnë shtet të dështuar, gjithsesi se perceptioni ynë është se çka ne shohim prej pozicionit tonë dhe çka shohin të tjerët, mund të ketë dallime. E fundit është konsensusi ynë. Kemi punuar me konsensus. Nuk ka ndodhur asnjëherë që dikush të prezantojë dokumente si dokumente të partive, si dokumente të cilat i ka prodhuar një grup apo një tjetër. Është e vërtetë që janë udhëhequr nëngrupet prej individëve të ndryshëm prej kolegëve të ndryshëm të nderuar, prej ekspertëve të ndryshëm. Të gjitha dokumente që kanë dalë, janë dokumente tonat të përbashkëta, çka do të thotë se edhe përgjegjësia edhe meritat do të ndahen. Ky ka qenë vendim i përbashkët i të gjithë kosovarëve në fillim dhe unë shpresoj si individ se kështu do të vazhdojë të jetë. Dhe në fund do ta them një mendim timin pak më ndryshe. Shifrat që i dhashë, dikush mund t'i llogaritë si të drejta, dikush mund t'i llogaritë si të padrejta prej cilës do anë. Nëse dikush më pyet mua se çka mendoj se afër 15 % të territorit do të menaxhohet në kuptimin e menaxhimit komunal prej komunitetit pakicë që përbën 5% ,sa është shumë apo është pak, për hir të korrektësisë politike do t'ju them se është në fakt më se mjaftueshëm. Ky është një mendim imi në lidhje me këtë, por prapëseprapë do të kem transparence, mirëpo besoj se shembulli që e dhashë tregon se do të duhet të ketë lidhje funksionale në mes institucioneve të Kosovës, në mënyrë që transparenca t'i shërbejë procesit dhe në asnjë mënyrë të mos shërbejë vetëm sa për hir të vetvetës ose e për hir të transparencës. Këto ishin të gjitha z. kryesues. Ju faleminderit"

**KRYESUESI.GAZMEND MUHAXHERI** - Ju faleminderit! E ka fjalën zëvendëskryeministri dhe Ministri i Pushtetit Lokal z. Lutfi Haziri

**LUTFI HAZIRI ZËV.KRYEMINISTRIT DHE MINISTRI I PUSHTETIT LOKAL** - I nderuari z. kryesues, i nderuari z. kryetar, i nderuar z. kryeministër, z. Thaçi, z. Surroi dhe deputetë të nderuar, të dashur kolegë. Me kujdes e kam përcjell debatin javën e kaluar, kur anëtarët e Ekipit Negociator të Kosovës nën mandatin e të cilit punojmë dhe duke u mbështetur nga Ju, folën për ecurinë e procesit të bisedimeve, për organizimin e shoqërisë së Kosovës së pas rregullimit të statusit,t'ju them këtu, deputetë të nderuar, se duhet të rregullohet statusi i minoriteteve në shtetin e Kosovës. Pjesa themelore dhe roli ynë edhe si Qeveri edhe si mandatar është nën ambrellën e Delegacionit të Unitetit që është përgjegjës para juve dhe para popullatës së Kosovës për të dhënë sqarime rreth angazhimeve që kanë të bëjnë me këtë proces. Nga katër temat e ashtuquajtura jostatusore, pjesën më të madhe të debatit nga ana e deputetëve dhe publikut të Kosovës interesimin e ka shtuar decentralizimi apo reforma e pushtetit lokal. Kjo nuk është e rastsishme. Si proces i brendshëm vitin e kaluar ka qenë njëra prej kërkesave që të debatohet në Parlamentin e Kosovës dhe juve ju kujtohet se në mars të vitit të kaluar është diskutuar decentralizimi dhe reforma e pushtetit lokal si proces i brendshëm në Kosovë dhe pas debatit rekomandimeve tuaja dhe angazhimit politik të liderëve të partive më të mëdha dhe partive të koalicionit dhe të partive të tjera politike, është arritur konsensusi, por fatkeqësisht ka qenë i vonshëm, sepse kërkesa për të definimin e statusit ka ndërruar

agjendën e decentralizimit dhe nga një proces i brendshëm, që është filluar herët në vitin 2003, të përfundojë si proces i domosdoshëm që në kohën e definimit të statusit të rumbullakohet. Në këtë rrafsh unë jam kërkua nga presidenti i ndjerë Rugova që të mandatohem dhe të udhëheq grupin e punës për reformën e pushtetit lokal në raport me definimin e statusit në temat e ashtuquajtura jostatusore, që përfshijnë trashëgiminë kulturore, të drejtat e komuniteteve dhe çështjet ekonomike. Duke qenë i vetëdijshëm se mandati i ofruar dhe i mbështetur nga Delegacioni i Unitetit është rikonfirmu nga presidenti Sejdiu dhe Delegacioni i Unitetit, unë kam vazhduar angazhimet në shkallën e tretë të bisedimeve që është grupi i punës që ka koordinuar të gjitha aktivitetet me Grupin politik strategjik dhe me Delegacionin e Unitetit, në mënyrë që procesi të jetë si i tillë dhe kemi arritur më 14 shkurt të adaptojmë dokumentin e parë parimet themelore për reformën e pushtetit lokal, që është dokument i bazik i Delegacionit tonë në bisedime të drejtpërdrejta me Vjenën.

Ministri Gjini ofroi disa të dhëna për të cilat unë e falënderoj edhe pse kanë qenë shifra të cilat ne i kemi shfrytëzuar për interes tonin në bisedime, në negociata si pjesë e strategjisë së kërkuar nga Delegacioni i Unitetit që ne t'i mbrojmë këto interesa, t'i arsyetojmë propozimet tona, ta bindim bashkësinë ndërkombëtare që pakicat në Kosovë në këtë rrafsh, në saje të angazhimit të madh të Delegacionit të Unitetit, pakicat: turke, boshnjake, romë, hashkali dhe egjiptiane këtë proces e kanë pranuar ta ndajnë me shumicën shqiptare dhe të jetë proces i brendshëm, pra mbetet vetëm pjesa e pakicës serbe që në biseda të drejtpërdrejta dhe fatkeqësisht pa përfaqësuar nga serbët e Kosovës, të bisedohet dhe të rregullohet në rrafshin e pushtetit lokal. Po e përsëris, falë angazhimit të Delegacionit të Unitetit dhe përfaqësuesve të pakicave, është pranuar që ata ta kenë të njëjtën brengë që ky proces të jetë proces i brendshëm i Kosovës dhe është punuar në këtë rrafsh deri tani. Tani para se ta jap një qëndrim, më lejoni të ofroj shifra dhe argumente të tjera përveç asaj që u tha nga ministri Gjini.

Ne, që nga shkurti kemi biseduar në rrafshin e krijimit të komunave të reja për 2.6 të menaxhimit të pronave nga komunat e propozuara që të jenë apo t'u bashkëngjiten 5 komunave të tjera, që janë funksionale në Kosovë. Deputeti Kelmendi e përmendi historikun e themelimit të komunave. Është e vërtetë se në riorganizimin e hershëm të vitit 1986 janë krijuar 5 komuna të reja që kanë pasur substancë në parimin etnik po të krijimit të komunave me shumicë serbe që kanë qenë kryesisht komuna dhe kanë mbetur komunat rurale të pazhvilluara, por në përbërjen e vet kanë pasur me shumicë të vogël ose të madhe etnike serbe. Kanë qenë tri çështje që kanë qenë në fokus dhe mbeten në fokus të bisedave me UNOSK-un me presidentin Ahtisari. Sa i përket pushteti lokal kompetencat e komunave në parimin e evoluimit për shtetin ne e kemi siguruar që komunat e Kosovës duke pasur parasysh të gjitha komunat e Kosovës duhet të konfirmohen të gjitha përgjegjësitë dhe kompetencat komunale sipas Rregullores 45/2000 apo dokumenti bazik që komunat sot e kanë fuqi si pjesë të punës. Këto të drejta të garantuara në vitin 2000 që në Kosovë nga shumica edhe në atë kohë janë përcjell me tension. Ne e kemi konfirmuar si pjesë të përgjegjësive ku katër detyra janë kryesore që përfshihen në rrafshin e pushtetit lokal dhe që garantojnë me Ligj nga institucionet qendrore këtu, këto do të jenë: zhvillimi lokal ekonomik, arsimit, shëndetësia dhe menaxhimi i pronave dhe 20 (njëzetë) detyra të tjera të përditshme që ushtrohen nga pushteti lokal dhe kjo nuk është risi. Ky është konfirmim në parim i kompetencave të komunave edhe në gjendjen e passtatusit në Kosovë të pavarur. Nga



katër detyra apo përgjegjësi të deleguara në komunë, ne kemi kërkuar. Kemi pranuar që të jenë edhe dy detyra shtesë. Parimi i delegimit të detyrave në nivel lokal nënkupton vetëm ushtrimin e detyrave sipas ligjit nga autoritetet lokale, ndërsa përgjegjësinë ligjore e mban pushteti qendror. Praktikisht regjistrimi civil dhe dokumentet civile sot janë detyrë që ushtrohen nga komuna, ndërsa është në kompetencë të Ministrisë të Punëve të Brendshme. E kam fjalën për letërnjoftime dhe pasaporta. Kjo detyrë deri para themelimit të kësaj ministrie ka qenë e menaxhuar nga Ministria e Shërbimeve Publike. Ruajtja e pyjeve dhe asistencë sociale sipas ligjit të miratuar në këtë parlament, do të jenë detyra të deleguara në rrafshin e pushtetit lokal.

Asistencë sociale nënkupton që komunat të kenë të drejtë të rishikojnë kartelën sociale në komuna dhe të shpërndajnë fizikisht duke e përfshirë edhe stafin, stafin që aktualisht e ka Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale.

Në segmentin e arsimit, Kosova garanton që arsimi fillor dhe i mesmi menaxhohet nga autoritetet lokale në kuptimin e pronës, të mësimit dhe përgjegjësive të tjera, që janë të përcaktuara sipas ligjit në Kosovë. Garanton që alfabeti dhe gjuha serbe do të jenë e drejtë e garantuar me Kushtetutë, që ushtrohet në pushtetin lokal si gjuhë zyrtare në Kosovë dhe po ashtu u jepet rol kritik komunave në emërimin e drejtorëve në shkollat e mesme dhe fillore që ka qenë problem i pesë vjetëve të fundit apo pesë vjet e gjysmë të fundit nga pushteti lokal.

Në vend të përgjegjësive së ndarë si është sot me ligj e përcaktuar ku ministri i Arsimit e emëron sipas rekomandimit të një paneli profesional.

Te policia janë ruajtur struktura unike, uniforma dhe zinxhiri komandues i Shërbimit Policor të Kosovës dhe gjithçka tjetër është manipulative në këtë segment. Është ruajtur struktura e uniformave dhe zinxhiri komandues, por i njihet e drejta asamblesë komunale, jo kryetarit të komunës, jo individit, asamblesë komunale, ku kryetari i komunës udhëheq që në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme të marrë pjesë në emërimin e komandantit lokal të stacionit të policisë sipas kriterëve që ekzistojnë sot. Ju e dini për shembull njeri nga kriteret që të emërohet një komandant policie në nivel të komunave, duhet të jetë kapiten me gradë, duhet t'i plotësojë kriteret morale dhe të tjera dhe kjo e drejtë ndahet në këtë formë ku një listë e propozuar nga Ministri i Punëve të Brendshme prej tre emrave zgjidhet apo propozohet nga asambleja komunale, në mënyrë që formalizimi dhe emërimi formal i këtij emërimi, ndodh nga Ministria e Punëve të Brendshme. Kjo është risia që në pushtet lokal apo përgjegjësia e ndarë në pushtet lokal dhe fundja është kërkesë e komunave dhe unë dëshiroj ta konfirmoj edhe një herë atë që e kam thënë edhe më parë: do të jetë një Kosovë e pavarur nesër, do të jetë një luftë e hapur dhe e ashpër në mes pushtetit lokal dhe e pushtetit qendror rreth kompetencave ajo do të jetë përditshmëri, por duhet të rregullohet me ligj, të garantohet me ligj dhe funksionaliteti të detyrohet në kuptimin e zbatimit të ligjit.

Nga ne është kërkuar të bisedohet me Delegacionin e Unitetit me atë qëndrim që për komuna me shumicë serbe të shikohet krijimi që ne i kemi quajtur kompetenca shtesë. Ne një lloj asimetrie "të lehtë! kemi pranuar rastin e Mitrovicës dhe do të shpjegoj te kapitulli i komunave të reja, për çfarë motivi. Unë nuk pretendoj të jap sqarime të tjera, sepse janë edhe pesë anëtarë të tjerë të Delegacionit të Unitetit që e kanë përgjegjësinë para jush, sigurisht do të paraqiten me fjalën kryesore, por një rol duke garantuar sipas ligjeve në fuqi në Kosovë autonominë e Universitetit në Veri të Kosovës



për popullatën serbe, duke garantuar autonomi sipas ligjeve, është lejuar që sipas kërkesës udhëheqja e universitetit mund të kërkojë bashkëpunim dhe rol të komunave me shumicë serbe. Mund të kërkojë, sepse kjo pjesë është pjesë e angazhimeve që është biseduar derisa nuk realizohet, sikur kemi bërë edhe me menaxhimin e pronës në shëndetësi sekondare si pjesë e kompetencave shtesë, pjesa tjetër e angazhimeve, kompetencave dhe e përgjegjësisve do të rregullohet me ligj. Gjithçka në fushën e kompetencave thuhet se do të jetë pjesë e legjislacionit të Kosovës dhe do të jetë në përputhje me ligjet e Kosovës.

Forma apo pjesa e bashkëpunimit ndërkomunal ose e asaj që ka pasur pretendime në publik të bëhet me gisht ndaj individëve dhe të nxiten debate të ashpra duke e frikësuar popullatën në kuptimin e asaj që quhet ndarje territoriale e Kosovës, që është pjesë e shqetësimit dhe e angazhimeve tona të përbashkëta ka të bëjë me lejimin e bashkëpunimit ndërkomunal. Krejt dokumenti ynë është i bazuar në Konventën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale si dokument bazik dhe ajo konventë duhet të adaptohet në interes të vendit tonë. Në kuptimin praktik implementimi i kësaj konvente është shumë i gjerë, por çdo shtet Konventën e adapton sipas interesave të vendit të vet. Dokumenti i dytë është Konventa e Madridit për bashkëpunim ndërkufitar. Është pjesë e proceseve integruese konventë e cila lejon që në fushën e kompetencave të veta, komunat krijojnë mundësi bashkëpunimi ndërkufitar pavarësisht etnisë, religjionit dhe fundja këto dy dokumente janë adoptuar nga institucionet evropiane për t'i eliminuar dallimet etnike dhe religjioze që kanë qenë në Evropë. Te ne ka ndodhur që për shkak të parimit etnik të adoptohet kjo konventë dhe të rregullohet apo të garantohet pjesa e bashkëpunimit, ne nuk pranojmë asnjë formë bashkëpunimi, i cili krijon rrethana të tjera në atë që u përmend këtu -ndarja e sovranitetit apo tendencë që në territorin e Kosovës të mos lejohet ushtrimi i pushtetit.

Sipas këtyre kompetencave komunat kanë të drejtë bashkëpunimi vullnetar mbi bazën e interesit. Deri tash në Kosovë komunat me shumicë shqiptare, komunat multietnike dhe komunat etnike të përbëra nga grupet etnike, i kanë 28 forma të bashkëpunimit ndërkomunal, por nuk lejohet që kjo të shtrihet dhe të vijë te konkluzioni ai qëndrim i Grupit të Unitetit që nuk ka lejuar krijimin e rrafshit të tretë të pushtetit lokal.

Në Kosovë sipas këtij parimi nuk mund të ketë rajone, distrike dhe shtresë të tretë të pushtetit të ndërmjet Qeverisë dhe komunave dhe po ashtu ka eliminuar substruktura komunale, njësi nënkomunale dhe format e ushtrimit të pushtetit nënkomuna aktualisht. Këto dy parime kanë sjellë gjendjen që të themelohen detyrimisht më shumë komuna, nëse do ta krijojmë shtresën e tretë të pushtetit ose do të krijojmë substruktura ose të themelojmë komuna më shumë. Ky është qëndrim që është përkrahur dhe i cili mbi bazën të cilën e kemi punuar. Nuk mund t'i aplikojmë standardet e dyfishta në pjesën e themelimit të komunave.

Delegacioni i Serbisë, sipas propozimit të tyre, ka propozuar 18+ themelimin e komuna të reja me shumicë serbe në Kosovë dhe pretendimi ka qenë kryesisht të kontrolli territorial. Ne nuk kemi krijuar apo kemi kërkuar mundësi të afrimit numerikisht në mes të këtyre shifrave absolutisht mund t'ju siguroj se nuk është në asnjë formë e lejuar të shikohet afrimi i atij kompromisi që quhet me shifra. Nuk kemi lejuar që në pjesën e resurseve më të mëdha që Kosova posedon sot, si p.sh. Obiliqi, Vushtrria dhe Mitrovica, të lejohet themelimi i komunave sipas propozimit që ka qenë nga ana e delegacionit tjetër dhe qëndrojmë edhe më tutje prapa këtij propozimi që nuk ka mundësi

reale që Kosova ta rritë numrin më shumë se 5 të themelimit të komunave me shumicë etnike serbe, plus nënkupton zgjerimin i komunës aktuale i Novo Brdes me banorë, sepse gjeografikisht janë të lidhura në drejtim të komunës së Gjilanit dhe të Kamenicës me një popullatë, të cilën do ta sqarojë me dy fjali në fund, pse? – Sepse shtrirja e resurseve natyrore në Rrafshin e Kosovës dhe tendenca që të krijohen korridore përmes Vushtrrisë kanë qenë tendenca të hapura që ne nuk mundemi të pranojmë dhe nuk duhet të lejohet të ndodhin dhe mbesim parapa këtij qëndrimi përkundër, që të kemi një komunitet që jeton në këto vendbanime, i cili pak a shumë në Obiliq dhe Vushtri është i integruar, është pjesë e institucioneve lokale dhe vazhdon të jetë i tillë.

Pse Delegacioni i Unitetit e rriti numrin e komunave prej 3 në 5 duke dashur t'i shmangej çdo forme të presionit dhe kërkesave që kanë qenë të lidhura ngushtë me Mitrovicën. Ne e kemi ardhur te parimi apo tek një marrëveshje që në rajonin e Anamoravës në komunat Gjilan – Kamenicë - Viti jeton komuniteti më i madh serb që në këto vite dha shembuj të mirë jo të dukshëm të integritit me shumicë. Komuna rurale të propozuara, fshatra rurale pa mundësi zhvillimore, jofunksionale dhe shumë vështirë për t' imagjinuar që kanë me qenë të implementueshme, por krejt këtë parim e kemi vendosur duke dashur ta bënim një ofertë dhe reagimet te qytetarët në këto komuna janë më të ashpra. Unë i kuptoj, sepse kam punuar për këta 7 vijet që ta integroja atë komunitet, por tash po del se vullneti i atij komuniteti nuk është të jetë pjesë e shumicës, të cilën nuk mund ta detyrojmë, nuk mundemi ta detyrojmë një fshat që me çdo kusht ta mbajë një komunë me shumicë, kur ai nuk do. Praktikisht këto komuna apo komunat e Kosovës kanë qenë nën presion të ndarjes së drejtë buxhetore, prej 1 deri në 41% komunat e Kosovës çdo vit e kanë të obligueshme nga buxheti i tyre komunal shumë i varfër t' i ndajë për pakica dhe kjo është pjesa tjetër, pjesa e fundit që ka të bëjë me rishikimin e procesit do të jetë regjistrimi i popullatës civile dhe i pronave që do të bëhet pas definimit dhe unë dëshiroj ta konfirmoj se nuk mund të implementohet asnjë pikë, asnjë angazhim yni në këtë proces pa u definuar statusi i Kosovës, pa u qartësuar, pa u vendosur në këtë parlament dhe implementimi do të jetë pjesë juaja. Ju faleminderit!

**KRYESUESIS GAZMEND MUHAXHERI** – Ka kërkesa të kalojmë pak në pushim, jap pushim prej orës 11,00 deri në orën 13,00 për ta kryer edhe drekën. Mirë atëherë marrim gjysmë ore pushim pastaj takohemi.

Deputetë të nderuar, pushimi zgjat deri në orën 13,00.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju lutem t'ia fillojmë punës dhe i lus deputetët t'i zënë vendet e tyre.  
Fjalën e ka deputeti Ylber Hysa.

**DEPUTETI YLBER HUSA**-Që me kohë ndoshta kanë munguar vetëm biletat e aeroplanit, ndoshta kjo edhe i ka ndihmuar dikujt të jetë më i inspiruar për lloj debati, por duket se krahas kësaj transparence ndoshta duhej edhe ndihmë për interpretimin e materialeve që i kemi dorëzuar dhe i kemi parë shumë shpejtë të paraqiten në publik, madje edhe në konferencat e improvizuara për gazetarë, për disa kolegë dhe deputetë tanë, të cilët janë ngutur t'i tregojnë afësitë e tyre në leximin e hartave, që sot.Mund t'ju

them se demanti fatmirësisht po arrin edhe nga Vjena për disa raste si zonat mbrojtëse në Drenicë, rreth Deviqit, ku shihet që në një proces të këtillë të negocimit, përveç transparencës, duhet edhe një lloj njohurie. Unë do të kisha dashur të apeloja në fakt që nëse jemi të gjithë për këtë lloj transparence që e kemi dëshmuar. Atëherë kjo na obligon të gjithëve që d.m.th. të mos ngutemi t'i interpretojmë apo t'i keqinterpretojmë këto materiale dhe në bazë të tyre të bëjmë fushatë. Në fakt ajo që më vonë në debat rrodhi dhe u shpjegua nga disa kolegë këtu të mi dhe në bazë të pyetjeve që u shtruan rrjedhimisht del që sikur të ekzistonte diçka që në shprehje ushtarake quhet: funksionimi i zinxhirit komandues në grupe dhe në parti të caktuara me siguri shumica e pyetjeve që janë shtruar këtu nuk do të përsëriteshin.

Në këtë aspekt unë apeloj edhe në emrin tim edhe të tjerëve që seancat e tilla jo që janë të mirëseardhura për ne, prandaj në asnjë mënyrë nuk iu kemi shmangur dhe nuk do t'i shmangemi, madje sa më përket mua gjithëherë një praktikë e tillë mund të kërkohet nga ne, në miratimin e fundit të dokumenteve nëse doni unë jam madje edhe për referendum. Në fund të këtij procesi gjithsesi, pasi që edhe sot jemi para një rruge madje ndoshta e fundit në Vjenë ne duhet dy orë pas kësaj bisede të jemi në Aeroportin e Prishtinës, gjykuar nga disa dyshime që unë i kam parë këtu nga kolegët e mi, unë kisha dashur që të propozoj këtu të votojmë, të shohim nëse në fakt pas këtij debati na lejohet, apo jo, të shkojmë dhe të vazhdojmë të bisedojmë në Vjenë.

Nëse dikush shpreh dyshimin për atë që po bëhet, atëherë ja ku është momenti. Unë them, sa më përket mua unë nuk kam asnjë motiv turistik për ta vizituar Vjenën, nëse jeni të gatshëm t'ju thërras si kolegë të marrim një vendim të përbashkë, nëse pas gjithë këtij debati duhet të sublimohet dhe duhet të jepet një lloj gjykimi në mënyrë që ky debat mos të jetë shterpë, të shohim nëse duhet të shkojmë në Vjenë apo jo. Prandaj, propozimi im është nuk di sa jemi në sallë, urdhëroni d.m.th. ta shtrojmë në votim, nëse konsideroni që sipas gjithë këtij debati është e nevojshme që ta marrim rrugën për në Vjenë apo jo. Përndryshe, pas të gjitha këtyre komenteve unë nuk dëshiroj ta përfaqësoj dikë me dilema të kësaj natyre që i kemi parë këto ditë. Ju faleminderit

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA-** Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti më fal Numan Baliq e ka fjalën.

**DEPUTETI NUMAN BALIQ** – Dopustite mi najpre da selamim sve prisutne u sali, da kažem nekoliko reči vezano za odnos moje zajednice i moj osobni odnos prema ovom vrlo važnom pitanju. Naravno, da se svi slažemo da se nalazimo u jednom vrlo odgovornom historiskom trenutku i da smo svi veoma zabrinuti za konačni status Kosova u kojem bi svi trebalo da imamo svoje mesto i gde svako ima svoje pravo. Moram da vam kažem da kao čovek sam onaj koji je godinama uključen u ovo pitanje i da delimo ozbiljnu zabrinutost cele kosovske zajednice za to da status Kosova bude pravedno rešen i da bude rešen u skladu sa voljom naroda Kosova. Dakle, pozicija koje smo godinama držali mi smo i dalje na njima i mi podržavamo većinsku volju naroda Kosova u smislu da se postigne pravo i dobro rešenje kosovskog pitanja. Ovde bih naravno napomenuo i neka pitanja koja se tiču nekih principa, odnosno stavova međunarodne zajednice koji su se jako često puta ponavljali ovih dana, zadnjih nekoliko sedmica i meseci. Ti principi



nećete mi zameriti, ali se jako podudaraju i sa stavovima naše zajednice i sa mojim osobnim stavovima. Dakle, stavovi koji se tiču toga da rešenje statusa Kosova treba biti prilagođeno volji, odnosno potrebama većini naroda Kosova apsolutno je tačno i mi ga podržavamo. Naravno, drugi deo te formulacije tiče se toga da status Kosova treba biti takođe prilagođen i svim etničkim zajednicama. U ovom smislu ima možda poneka zaboravljanja ovih stvari tako da se možda olako prelazi preko toga, ali za nas je vrlo bitno da se ne govori samo o pitanjima srpske zajednice nego da treba govoriti o potrebama i zahtevima drugih zajednica, Bošnjaka, Goranaca, Roma, Egipćana itd. Naš stav je da se mora doslovce voditi računa o svi zajednicama i da se treba nastojati zadovoljiti svačije pravo. Ako postoji dobra volja mi smo ubeđeni da je to moguće. Dakle, treba postojati unutrašnji balans, a mi kao predstavnici naše stranke takođe kao i predstavnici grupe „za integraciju“, parlamentarne grupe koja nastoji ostvariti svojevrсни balans u institucijama Kosova, mi smo oni koji se zalažu za to. U vezi sa još nekim stvarima koje želim istaći jeste da poseban značaj, ono što mi želimo istaći, treba dati posebno svetlo manjinskim zajednicama koje sam spomenuo. Veliki je problem što se nažalost, verovatno zbog važnosti tog pitanja, poseban značaj pridaje pitanju srpske zajednice. Zbog toga su možda na određeni način zapostavljena shvatanja, zahtevi stavovi drugih zajednic, Bošnjaka, Roma, Egipćana i ostalih. Mislim da bi se o tome trebalo povesti računa i da je konačno vreme i da je dobro da se neke stvari koje su dosad zapostavljene, zaboravljene nisu uključene da se sada isprave. Bilo je određenih nepravdi prema ovi zajednicama i ja sa najboljim namerama ću dati nekoliko predloga kako da se to prevaziđe. Dakle, jedan od problema koji je postojao, govoriću veoma otvoreno, i kao jedan od vas zajeno sa vama da pokušamo naći problem. Problem postoji, jedan od zahteva manjinskih zajednica bio je da se o našim zahtevima u okviru decentralizacije o opštinama, najpre pilot-opštinama, a kasnije i opštinama o kojima se razgovara u okviru procesa decentralizacije, da se razmatra Beču. Ja se nažalost, ne mogu složiti sa onim što je malopre rekao g. Haziri, jednostavno što to tako ne stoji, mi smo upravo na jednoj od sednica Odbora za konsultacije sa zajednicama govorili o tome gde sam upravo ja govorio, ovo što sada govorim, da je stanovište prema kome su navodno manjinske zajednice, Bošnjaci, Romi, Turci i ostali saglasili sa time da se o njihovim zahtevima razgovara na Kosovu, ustvari jedan stav koji je jednostavno nama saopšten. To je stav koji je prosto saopšten i rečeno je to i to, i o tome se uopšte nije raspravljalo. Dakle, to je pitanje o kome se nije odlučivalo, nije istina da su zajednice o kojima govorim donele odluku, da se o našim zahtevima ne raspravlja u Beču. Na drugoj strani mi smo predlagali da čak iako nije moguće da se razgovara u Beču da se o tom pitanju razgovara unutar procesa Kosova, i ne samo da se razgovara nego da se donesu odluke oko tog pitanja, da se daju odgovori na to pitanje. Kao što znate Bošnjaci kao jedna od zajednica koja traži opštine, tražili smo Vitimiricu, Rečane i Dragaš. Vitimiricu kao de sadašnje opštine Peć, Rečane kao deo sadašnje opštine Prizren i Dragaš u okviru sadašnje opštine Dragaš. Postoje i druge opštine i zahtevi koji su zahtevi Egipćana, Goranaca itd, neću detaljno elabrirati, ali je bitno da smo mi spremni da se napravi dogovor oko tog pitanja, ali uz puno poštovanje i uvažavanje, ali ne uz neko nametanje stavova i izricanje nekakvih odluka o kojima uopšte nismo raspravljali. Dakle, ako se nemože ovo pitanje raspraviti u Beču hoćemo odgovor ovde u Prištini, mi smo dali zahtev za opštinu Vitimirica 19.05. prošle godine, i taj zahtev je upućen i Parlamentu i Vladi i ministru za lokalnu upravu g. Haziriju i svima ostalima. Dakle, hoćemo odgovor na to pitanje, tražimo odgovor za te

opštine, hoćemo li ih dobiti ili ih nećemo dobiti. Mislim da je nepošteno da bude odugovlačno, zamotavano, izbegavano itd. Ako možemo da ih dobijemo, dobijmo ih, ako nemodemo hoćemo odgovor. U svakom slučaju tražimo jedan ravnopravan i pošten odnos pun uvažavanja. Vezano za jedan stav koji smo takođe čuli, isto na sednici odbora, g. Haziri-je tada rekao, mislim da ga je podržavao u određenom smislu ako nešto ne kažem tačno neka mi ne zamere i g. Suroi koji je ovde pred amnom, da će se o tim pitanjima raspravljati nakon završetka statusa. Mislim da to nije dobro, to je u neku ruku oblik diskriminacije, da ako se o zahtevima manjinskih zajednica ne raspravlja i ne rešava u toku i u hodu sa ostalim zahtevima, nego se ostavljaju nakon statusa, u tom slučaju po samom načinu odlučivanja mi smo zapostavljeni i nismo ravnopravni. Na jednoj strani neravnopravnost je u tom pravcu što govori se o petnaest srpskih opština, govori se o 15% teritorije Kosova, mi smo potpuno jasni da mora biti razgovora, da mora biti dogovora, da mora biti kopromisa, ali je nepošteno da se jednoj manjinskoj zajednici daje toliko prostora, a da se prema drugim manjinskim zajednicama odnosni tako, oprostite, kao da se kaže lako ćemo mi sa Bošnjacima, Romima, Turcima itd. Mi jesmo integrisane zajednice, mi jesmo dali znakove za to da podržavamo kosovsko pitanje, ali mislim da nije u redu da se sa nepoštovanjem i neuvažavanjem odnose prema našim zahtevima. Dakle, hoćemo odgovore i to pre rešenja statusa Kosova za naša pitanja i za naše zahteve koje smo dali. U vezi sa još nekim stvarima koje se tiču, da samo kratko napomenem, naši zahtevi od početka bili su da predstavnici ovih zajednica budu obavezno uključeni u glavnu grupu za pregovore. Upravo ovde su pred amnom predstavnici glavne grupe za pregovore i ako mi ne zamere ja ću ih ovom prilikom pozvati da ako se nemože odlučiti o učešću ovih predstavnika u glavnu grupu za pregovore bilo bi veoma dobro, pošteno lepo i dokaz uvažavanja ovih zajednica da se održi bar jedan sastanak ili više sastanka glavne grupe za pregovore sa predstavnicima ovih zajednica. Ako mi možemo svakih mesec dana da se vidamo sa najvišim svetskim predstavnicima i razgovaramo sa njima i sa g. Ahtisarijem i g. Rohanom i svim ostalim koji su dolazili, ne vidim razloga zašto predstavnici ovih zajednica ne bi razgovarali sa glavnom grupom za pregovore. To bi mogao možda biti početak naše pune integracije i punog doprinosa u rešavanju statusa Kosova, mislim da je to moguće i ne zamerite mi što vam direktno upućujem poziv da razgovarate sa predstavnicima ovih zajednica kje sam napomenuo. Drugo vezano za radne grupe, mislim da je veliki nedostatak što u radnim grupama takođe nema predstavnika ovih zajednica. Mislim da je važno da posebno u političkoj –strateškoj grupi budu uključeni predstavnici ovih zajednica, kao treće ponovio bih stavove koje je malopre izneo g. Jagcilar u ime turske zajednice, ono na što smo mi ukazivali mnogo ranije pre njih. Dakle, neka zakonska rešenja koja se tiču ovih zajednica, ne bi se smela doneti na taj način tako da budu na uštrb prava ovih zajednica. Kao što vidimo kod donošenja zakona o jeziku nastalo je do jedne nepravde i da nisu uvaženi zakoni ovih zajednica naravno i drugih zajednica koje sam spomenuo, tako da se mora voditi računa da završni dokument o kome je reč, završni dokument koji precizira pitanje prava ovih zajednica je jako redukovao odluke koje su donete u Solunu i drugim mestima gde se o tome razgovaralo i takođe oko rezervisanih mesta, mislimo da bi rezervisana mesta za određeno vreme trebalo ostati. Ja ću biti veoma praktičan, dozvolite mi da vam prikazem jedno stanje koje postoji među bošnjačkom zajednicom.

Kryetari: 27 kandidat janë të paraqitur deri tash në qoftë se cilit i vazhdohet fjala, do të mësim tanë natën këtu.

Numan Balić: Dakle, pitanje za sve nas je ako je 60% Bošnjaka i Gorana iseljeno van Kosova ili oko 40.000 iseljeno i prognano kako će oni ostvariti svoje pravo da glasaju. Ovo su tačni podaci, mi poznajemo situaciju koja postoji na Kosovu. Dakle, ili ćemo omogućiti tim ljudima da se vrate na Kosovu da glasaju ili ćemo im omogućiti da imaju mogućnost rezervisanih mesta. Verujte mi, ja sam radio za to da na Kosovu stvorimo klimu da se vrate Bošnjaci i Gorani na Kosovu, učinimo to zajedno, do sada nisu dati dokazi za to, učinimo zajednički napor da imamo osećaja za prava Bošnjaka i Goranaca i da ponovim poziv koji je dao dr. Agani na početku sednice, trebamo zajedno običi sredine u kojima se razgovara o decentralizaciji i severnu Mitrovisu i Bošnjačku mahalalu i Vitomiricu i Dragaš zajedno sa predstavnicima koji tamo žive i da zajednički govorimo o tom problemu, mislim da se možemo dogovoriti. Hvala vam!

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Bajram Rexhepi, le të përgatitet deputeti Naim Maloku.

**DEPUTETI BAJRAM REXHEPI** – Ju faleminderit z. kryetar, mendoj se ndoshta debate është pak i vonuar, megjithatë është mirë të ketë më tepër transparencë të informohen edhe disa deputetë, por edhe qytetarët e Kosovës për një problem që na brengos të gjithëve.

Unë do të provoj të diskutoj shkurtë, por megjithatë e ndiej obligim për hir edhe të korrektësisë edhe të transparencës t'i bëjë edhe disa sqarime se nga disa nga parafolësit, dolën edhe disa çështje që nuk qëndrojnë bashkë në atë mënyrë dhe do të filloj pak si në mënyrë kronologjike.

Ju e dini se gjatë qeverisjes Rexhepi, ne kemi filluar diku në maj 2004- kemi formuar grupin që ka përgatitur një dokument, kornizë ku kanë qenë përfshirë edhe Ministria e Shërbimeve Publike, kryeministria e UMINK-u, organizata të ndryshme, Këshilli i Evropës, përfaqësues të komunitetit serb të Kosovës dhe ka pasur mundësi që nga Serbia të ketë ekspertë, në cilësinë e këshilltarëve.

Ai dokument kornizë është përgatitur edhe vlerësimi, edhe tash mendoj se ka qenë një dokument i mirë që nuk ka vend të t'i bëhen shumë kritika, mirëpo më vonë në qeverisjen e koalicionit pak a shumë edhe ka ndërruar koncepti dhe deri sa në atë qeverisje që ne e kemi udhëhequr ka qenë një ndër prioritetet në qeverinë e ardhshme pasuese ka qenë top- prioritet, ndoshta jo me dëshirën e tyre. por situata ka qenë e tillë që ka dalë si super standard dhe shumica e energjisë është harxhuar në këtë proces të decentralizimit.

Megjithatë ne jemi në një proces ku edhe si opozitë nuk ka qenë lehtë të jemi konstruktivë në Ekipin e Unitetit dhe nganjëherë kemi marrë përgjegjësi edhe më tepër seç na takonte si opozitë, me qëllimin më të mirë që këtë proces bashkërisht ta përfundojmë si është më së miri. Mendoj se në përgjithësi në procesin e decentralizimit sigurisht që



mund të bëhet edhe më mirë, është edhe kërkesa që të realizohet shtetësia e Kosovës, që të bëhen edhe disa lëshime, disa prioritete, për komunitetet minoritare, në këtë rast për komunitetin serb.

Unë do të ndërlihem pak, meqenëse u përmenden në mënyrë indirekte shëndetësia sekondare dhe arsimit superior që lidhen pak a shumë me Mitrovicën. Këto çështje janë zgjidhur në kuadër të procesit të decentralizimit dhe jo në mënyrë specifike në planin e Mitrovicës, sepse nuk i takon Kuvendit Komunal të merret me këto. Mirëpo, në një mënyrë nuk shoh ndonjë rrezik të madh që të kemi kompetencë asimetrike në shëndetësi, në edukim dhe në çështjet sociale, prandaj ajo nuk duhet të na brengosë shumë edhe pse është pak e dhimbshme për arsye se kapacitetet ekzistojnë në pjesën Veriore.

Është, po ashtu, një çështje që u përmend nga z. Kelmendi, që është dashur të polemizohet që në dokumentin Kornizë në kohën kur na e kemi përgatitur atë dokument nuk është biseduar, as në mënyrë të detajuar asnjë manastir, asnjë kishë, pra kanë qenë parime të reformës së pushtetit lokal e jo të amputohet se jo çështja e manastirit në Banjës ose Sokolicë, e tjera ajo s'ka pasur të bëjë fare me atë dokument ajo ka qenë vetëm parime.

Dhe mund të themi që po ashtu që tri fshatra që iu kanë bashkuar komunës së Zveçanit, sot e asaj dite në mënyrë të heshtur, ato vazhdojnë të jenë por ne sot e kësaj dite konkretisht tash flasë nga aspekti i PDK-së ne nuk kemi degë të PDK-së në komunën e Zveçanit, pra si tilla s'i kemi pranuar, por ato vetëm sa për hir të korrektësisë.

Pak po shtoj për dokumentin ose për planin e Mitrovicës, ju e dini mënyrën se si është kërkuar të përgatishim një draft, atë draft e kemi përgatitur, është diskutuar në Grupin Politik Strategjik, me do korrigjime të vogla, është pranuar si dokument i Ekipit Negociues. Unë nuk dua tash arsyetim as të shfaqëshohem në një mënyrë se ai dokument nëse implementohet do të identifikohet me emrin tim, ndoshta tërë jetën edhe pse formal edhe juridikisht ai është dokument i Ekipit Negociues, as nuk them se është dokumenti më i mirë, por dokumenti ndoshta më real që në një mënyrë faktori ndërkombëtar deri diku është pajtuar me atë qasje, edhe personalisht mendoj se nëse implementohet si i tillë krijon mundësitë të kthehet në normalitet funksionalitet dhe nëse punojmë me mendë që të mos ketë ndarje klasike përndrysh ndarja ka ekzistuar. Koncepti i këtij plani është që të krijohen kushte normale për në fazat të mëvonshme në kuadër të një qyteti të bëhet integrimi i tyre. U përmend edhe nga ish -kryeministri, ndoshta është dashur të krijohen edhe komuna të tjera të propozohen, ajo mundësi ka ekzistuar, mirëpo qasja e ekipit negociues ka qenë që në Vjenë të diskutohet për komunat me shumicë serbe, ndërsa se si riorganizohen komunat me shumicë shqiptare dhe të komuniteteve të tjera do të jetë e drejtë ekskluzive e institucioneve dhe s'do t'i bisedojmë me të huajt, për ndryshe interesi i komunitetit serb në Mitrovicë ka qenë për pjesën urbane qytetit, ndërsa se ne do të mbajmë pjesën jugore edhe atë në fshatrat pjesën veriore 5 komuna tri komuna atyre nuk ju intereson dhe kjo është e drejtë jona, tek e fundit për një vjet sa e kanë pasur mandatin janë mundur të dalë me plane konkrete.

Ishte pak një, ndoshta mosnjohja nga kolegja nga Mitrovica çështja e zonave kadastrale të fshatrave në pjesën veriore, në plan shumë mirë është e precizuar edhe këtu ka qenë në hartë dihet që janë propozuar dy pikë gjashtë kilometra të pjesës urbane dhe gjitha fshatrat në pjesën veriore të Mitrovicës janë bashkë me pjesën jugore. Pra ,aty dilema nuk ka ndoshta është vetëm, s'ka pasur qasje për t' i parë këto, përndryshe janë shumë të qarta.

Dhe po ashtu, edhe kërkesa që ndoshta është dashur plan tjetër më i mirë, ka pasur ide mirëpo për 5 ose 6 vjet sa ka qenë kuvendi komunal, nuk ka dal me ndonjë propozim konkret. Është shumë e vërtetë që z. Kelmendi edhe në një takim që kishim me strukturat komunale të presidenti ku ishit edhe ju shumica prezentë ka dalë me një plan alternativ jo veri, jo lindje perëndim e diçka , por s'ka marrë përkrahje e me sa di unë është diskutuar edhe në Grupin Parlamentar të LDK-së dhe nuk ka marrë përkrahje, kështu që nuk do të thotë që ai është një plan tepër i mirë,por për momentin ka qenë një alternativë që për afërsisht i ka kënaqur në një mënyrë edhe komunitetin ndërkombëtar si një qasje reale.

Edhe një herë po e them, e falënderoj edhe Ekipin Negociator, se sa i përket Mitrovicës ka treguar vendosmëri maksimale dhe në asnjë moment nuk ka lëshuar pe të bëhet ndonjë kompromis për arsye se kompromisi për Mitrovicën është bërë fillimisht. Unë jam shumë i bindur që nuk do të lëshohet pe në këtë çështje, prandaj e ndiej veten mirë për këtë që kam qenë pjesë e këtij ekipi.

Edhe një herë them se, sa i përket shëndetësisë, edukimit dhe çështjes sociale duhet të jemi me të vërtetë pak gjeneroz, ato nuk e rrezikojnë as funksionalitetin e shtetit të Kosovës as nuk e rrezikojnë aspektin territorial por duhet të kemi kujdes vetëm që buxheti t'ju ndahet sipas kokës së banorëve përndryshe nëse Serbia ka mjete të ndërtojë spitale, qoftë edhe nëpër fshatra, është e drejtë e tyre, le ta bëjnë atë, nuk ka gjë të keqe në atë.

Dhe më në fund desha të di se sigurisht edhe në Ekipin e Unitetit edhe çdo kund edhe në plan edhe në gjithë këtë proces ka defekte, mund të ketë defekte dhe asgjë s'ka të përkryer, mirëpo, me gjithat mendoj se është vë një punë serioze dhe nëse ekipi i Unitetit i përmbahet Rezolutës që përmbahet në Parlament, mendoj pikave që kanë dal a jo, duhet edhe ma tutje të vazhdojnë me këtë qëndrim dhe mendoj se pikat që u përmendën edhe nga z. Ramë Buja dhe nga z. Ferid Agani që në një mënyrë mund të gjenden edhe në pjesën e Rezolutës t'u përmbahemi këtyre parimeve dhe mendoj se nuk ka shumë vend për skepticizëm.

Edhe diçka dua të them se në kohën kur delegacioni i Serbisë përpiqet të gjejë pretekst të ndryshëm që të tërheqet nga bisedimet, mendoj se megjithatë ne duhet të jemi në nivelin e detyrës dhe të pjekurisë dhe të jemi të kujdesshëm në lidhje me këtë. Ju faleminderit

**KRYETARI I KUVENDIT TË KOSOVËS** – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Naim Maloku.

DEPUTETI NAIM MALOKU - Ju faleminderit z. kryetar i Kuvendit, i nderuari z. kryetar i Kosovës, z. kryeministër, z. Thaçi, Surroi, të nderuar kolegë deputetë, e mora fjalën jo për të vënë në dyshim përkrahjen time personale dhe të Grupit Parlamentar të AAK-së ..... të bisedimeve dhe grupit të unitetit, konsiderojmë se kemi hy në një fazë të rëndësishme të definimit të fatit të Kosovës dhe të qytetarëve të saj, por më lejoni të nderur kolegë, kryetari i Kosovës, i nderuar Grupi i Unitetit, të shpreh një shqetësim timin personal për faktin se sipas mendimit tim Grupi i Unitetit dhe Grupi Politik Strategjik dhe grupet e tjera teknike që janë ngritur në lidhje me procesin për të cilin është fjala sot, pak janë marrë me çështjen e sigurisë në Kosovë me mekanizmat e sigurisë të cilët do t'i ketë Kosova si shtet. Unë nuk jam i njoftuar se është ngritur grupi teknik për çështjet e sigurisë dhe deri ku kanë arritur përgatitjet dhe çka është kërkesa, dhe si janë formuluar kërkesa dhe oferta e palës kosovare për këtë çështje, e di se ndoshta mund të thoni se për këto tema nuk është biseduar gjër më tani në Vjenë, mirëpo më lejoni të them se ne po synojmë që procesi i definimit të statusit të përfundojë gjatë këtij viti dhe se janë edhe tre muaj e gjysmë kohë, ndërkaq mendoj se për këtë çështje pak është punuar, por edhe më pak janë njoftuar Kuvendi edhe qytetarët e Kosovës.

Më lejoni të nderuar deputetë të them se me rëndësi është se çfarë shteti dhe çfarë shteti të pavarur do ta fitojë Kosova dhe çfarë shteti i pavarur do të jetë Kosova.

Kosova duhet të synojë të jetë shtet i cili do të garantojë siguri për qytetarët e vet, por edhe do të marrë pjesë aktive në stabilitetin e rajonit. Pra, do të jetë faktor stabiliteti në rajon, një Kosovë e cila do të dalë me një status që do të krijojë probleme të brendshme në aspektin e sigurisë, nuk do të jetë faktor stabiliteti jo për qytetarët e vet, por as edhe për rajonin. Janë mekanizma të sigurisë policia, ushtria dhe shërbimi sekret i Kosovës, çfarë mekanizmave, çfarë strukture do të jetë strukturë kontrollimi dhe rregullimi i brendshëm i mekanizmave të sigurisë, janë të rëndësishëm, Unë falënderoj zëvendëskryeministrin dhe ministër i pushtetit lokal z. Haziri që dha disa sqarime si do të duket policia e Kosovës, Ne e kemi marrë një material, komizë për mbrojtjen e komuniteteve, ku kapitulli i shtatë ka të bëjë me policinë, sigurinë dhe lirinë e lëvizjes, por është kufizuar vetëm për komunitetet. Neve na intereson, të nderuar anëtarë të Grupit të Unitetit për sigurinë e qytetarëve të Kosovës dhe për sigurinë e Kosovës dhe për stabilitetin e Kosovës.

Më lejoni të nderuar deputetë, të shpreh brengosjen time para jush për dy çështje, 1. Decentralizimi në vija etnike dhe krijimi i komunave duke marrë për bazë vijat etnike në Kosovë, mendoj se do të jetë burim i krijimit të destabilitetit dhe josigurisë në Kosovë dhe së bashku me të Kosova në të ardhmen, institucionet e Kosovës do të detyrohen të merren shumë me probleme të brendshme, më lejoni të shpreh brengosjen time edhe në një çështje tjetër.

Lidhjet që po i kërkon Serbia me komunat si po thonë ata serbe në Kosovë mendoj se do të jenë burim i destabilitetit dhe bazë që Serbia në të ardhmen të ndërhyjë në punët e brendshme të Kosovës dhe të jetë një burim ngritjes së pasigurisë në Kosovë dhe



destabilitetit të brendshëm. Ju lus që në këto dy çështje Grupi i Unitetit të jetë këmbëngulës dhe të mos lejojë zgjidhje të tjera jashtë parimeve të zgjidhjeve që janë të përkrahura dhe të zbatuara, edhe në Bashkësinë Ekonomike Evropiane. Lidhjet e Serbisë me komunat siç kërkojnë ata dhe siç proklamojnë serbe, në Kosovë nuk duhet të jenë më të ndryshme se sa lidhjet e Hungarisë me komunat që janë me shumicë hungareze në Vojvodinë apo të Kosovës me komunat që do të mbeten me shumicë shqiptare në Serbi apo të Rumanisë me vllahët në krahinën e Timokut apo të Kroacisë me kroatët dhe komunat me shumicë kroate në Serbi, ose të Bosnjës me komunat me shumicë myslimane, që janë dhe do të mbeten me Serbi. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit, Behxhet Brajshori e ka fjalën.

**DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI** – Ju faleminderit z. kryetar i Kuvendit, i nderuari z. president, kryeministër, ministra kolegë deputetë, anëtarë të Ekipit Negociator. Unë do të bëj përpjekje që të flas shkurtë mëqë shumë gjëra i thanë parafolësit, megjithatë mendoj se ky debat i sotëm dhe i para disa ditëve është mjaft i mirë edhe pse patjetër i vonuar, mirëpo për një vonesë të këtillë duhet kërkuar si të them fajin të gjithë ne, sepse ne kemi parë që janë zhvilluar disa runde bisedimesh dhe ka kaluar një periudhë kur ne kemi pasur mundësi të takohemi dhe të bisedojmë ndoshta për çështje të caktuara në fazën për të cilat janë paraqitur dhe në takimet e prillit do të thosha edhe të majit, qershorit, korrikut, gushtit etj. dhe në këtë drejtim do të ishim më të fuqishëm.

Takimin e sotëm po ashtu e konsideroj si një ndihmesë të madhe për vet Grupin Negociator. Në vazhdim, ndoshta kemi bërë lëshime në hapa të veprimit, e nëse dikujt i bie ndërmend që ne në bisedat e mëpashme kemi kërkuar ndonjëri prej nesh që ndoshta është shumë e nevojshme që para takimeve të këtu për temat e caktuara, në nivelet e caktuara të Kuvendit të Kosovës të bisedohet për këtë çështje dhe të harmonizohen çështjet së paku në nivelin e grupeve parlamentare, pastaj nuk do të paraqiteshin këto çështje sikur ndoshta në këtë formë që po bisedojmë tash larg dimensionit kohor, pra për disa tema që tashmë kanë kaluar ose janë bërë propozime që nga grupi ynë negociator qoftë nga ndërkombëtarët.

U bashkëngjitem shqetësimeve të atyre që mendojnë se vërtet decentralizimi në vija etnike do të jetë destabilizim i vazhdueshëm i Kosovës dhe ngritja e komunave të reja etnikisht të pastra ose së paku me shumicë absolute, sepse jemi dëshmitarë të një kaluarë e cila nuk është shumë e largët që vazhdimisht ballafaqohemi me probleme të këtu dhe me destabilizim të situatës brendapërbrenda vendit. Ajo që po ashtu dua të potencoj është çështja e financave lokale, ose bashkëpunimi me Beogradin ose donacionet. Ne të gjithë e dimë se e kemi një sistem të menaxhimit të financave publike në Kosovë, mendoj se sikur të ishte në praktikë me gjithë donatorët, e tërë bota që tash e praktikojmë ne sistemin tonë të menaxhimit absolutisht asnjë donacion as nga Beogradi nuk mund të kalojë në forma të tjera pa kaluar përmes Thesarit të Kosovës, se do të ishte një transparencë më e madhe në kuptim të menaxhimit të financave publike dhe të rritjes së asaj që ne i themi pasuri kombëtare në përgjithësi. Një praktikë e tillë sot aplikohet tek ne me donatorët e tjerë, prandaj një formë e tillë do të jetë e nevojshme edhe për

donacionet që mund të hyjnë nga Beogradi dhe që mund të ndihmojnë në këtë rast ,pra ato komuna të cilat po themelohen ose do të themelohen në të ardhmen e që për mendimin tim duhet të ketë kontroll tepër të rreptë.

Dhe krejt e fundit, për zonat e mbrojtura, kishat, manastiret e tjera, duhet të kemi kujdes . Me gjithë sqarimet e dhëna sot ose më herët mendoj se territoret e përfshira do të shkaktohen në këto zona mbrojtëse do të kemi telashe, do të thotë edhe pronarët ,sepse lexoni dokumentin e UNOSEK-ut në një vërejtje atje ku thuhet se gjithmonë duhet të ketë një lloj leje oseleje, ose pëlqimi, qoftë nga autoritetet kishtare, qoftë nga komuna ku janë zonat që të hyhet pra në ato zona të mbrojtura. Kjo do t'u sjellë pa dyshim pronarëve të tokave që do t'i zë ato toka - hapësira dhe do të kenë telashe në atë drejtim,

Është një propozim imi për Mitrovicën, përkatësisht për pjesën Veriore, me gjithë këto ecje dhe përpjekje thjeshtë për të ndërtuar do të thosha një funksionalizim sa më të mirë ,pra edhe një përkushtim sa më të madh për mbrojtjen e drejtave të pakicave në këtë drejtim do të thosha të pakicës serbe.

Mendoj se një çështje është e gabuar në këtë drejtim formimi i bordit të këtillë dhe i dy njësive komunale në Mitrovicë. Qasja që unë e preferoj dhe do t'i sugjeroja grupit tonë negociator dhe bashkësisë ndërkombëtare, më e mira është të kthehen në shtëpitë e veta , qoftë në pjesën jugore dhe qoftë veriore dhe të mos kemi as dy komuna as tri ,por të kemi një Mitrovicë dhe qytetarët të jetojnë në pronat e veta se të kemi lëvizje të popullsisë në këtë rast banorët e pjesës veriore në pjesën jugore ose anasjelltas. E di se nuk është lehtë sepse për të qenë Mitrovica e ndarë është punuar së paku qe 7 vjet, por duhet bërë përpjekje dhe Mitrovica duhet të unifikuar në këtë drejtim, nuk do të kemi pastaj zona të ndara as zonën e veriut, nuk do të kemi as rrezikun e bashkëngjitjes së një komune me tjetrën, por thjeshtë do të kemi një unifikim të shtetit dhe veprim dhe jetë të përbashkët të qytetarëve të Mitrovicës, ashtu siç kanë jetuar edhe më herët. Ju faleminderit .

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit!, deputeti Ragip Zekolli, le të përgatitet deputeti Xhezair Murat

**DEPUTETI RAGIP ZEKOLLI** – Ju faleminderit z. kryetar, i nderuar president i Kosovës, Grup Negociator, të nderuar kolegë,

Unë do të bëj përpjekje të diskutoj një çështje tejte të ndjeshme që ndoshta më pak u prek këtu e trashëgimisë kulturore dhe të paktën ato çka do të mundohem t'i them do të jenë çështje e bazuar në burimet e kohës dhe atë të autoriteteve serbe të cilat janë marrë edhe me historinë e tyre.

U përmend çështja e zonave mbrojtëse dhe në materialin i cili na është dërguar neve po flas për materialin e 18 korrikut që është i pafaqosur të shënimet e rëndësishme, përmendet edhe një çështje tejte e rëndësishme që është mbajtur takimi në Manastirin e Deçanit më 12 edhe 13 që nuk thuhet cilit vit apo cilit muaj ,prandaj do të ishte mirë që dikush nga anëtarët e Grupit Negociator të na sqarojë se për çfarë marrëveshjeje ka qenë

fjala, me kusht që ne si deputetë të kemi të paktën pak më shumë të dhëna lidhur me këtë çështje.

Ndërsa ato institucione fetare të cilat hyjnë në zonën mbrojtëse, e janë gjithsejtë 12, përmendet si e 13 Hoqa e madhe sipas marrëveshjes, por ne nuk dimë se për çfarë marrëveshje është fjala. Është mirë d.m.th. të kemi informacion lidhur me këtë çështje, ndërsa propozimi i Grupit të Kosovës është që të formohet këshilli për trashëgimi kulturore edhe ai prej 7 personash në bazë të këtij dokumentacioni kur thuhet se duhet të jetë ekspert i shquar i arteve bizantine. Pastaj nuk po hy më tutje, sepse për neve nuk mund të themi otoman, por është mirë të thuhet ekspert i Perandorisë Osmane, ata nuk mund të thonë Osmane, ju lutem del se Kosova vërtet është mesjetare dhe në tokën e Kosovës nuk ka pasur diçka antike. Do të ishte mirë të ketë ndoshta ndonjë ekspert nga antikiteti.

Mirëpo, për mos me u kënaqur me këtë këshill të trashëgimisë kulturore atëherë UNOSEK-ë propozon krejt diçka tjetër, propozon komision implementues monitorues. Nëse merret ky komision implementues monitorues ju lutem është fjala për një institucion, i cili në Kosovë do të merret vetëm me kishat ortodokse serbe dhe përbërja e tij nuk do të varet as nga deputetët e këtij Parlamenti, mirëpo do të jetë nën mbikëqyrje të komisionit civil ndërkombëtar, përkatësisht UNMIK-ut, do të thotë janë situata të cilët na japin të kuptojmë diçka që vërtet është tejet e rëndë dhe mendoj se Grupi duhet t'i ketë parasysh këto, ndërsa te e katërta, kur është fjala për kthimin e objekteve të marruara në Kosovë, ju lutem na del një diçka se vërtetë ata i kanë marrë me çfarë një ekspozitë atje, edhe është mirë që të thuhet në fakte gjithçka se çka ka ndodhë dhe si ka ndodhë. Ne kemi marrë dokumentet vërtet për kishat dhe manastiret edhe në një version po them që kanë qenë me ngjyra, mirëpo brenga ime shkon edhe dikund tjetër, për arsye se në dokumentin në fjalë, kur paraqiten të dhënat pyes si do të zbatohen këto? Këshilli për trashëgimi kulturore, detyrat e tij, kush i jep leje dhe cilat janë prioritetet, na ndodh vërtet e kam shtuar te njëshi 1. a, që në Kosovë nuk ka ndodhur asgjë tjetër „nuk është shkatërruar asnjë element i kulturës qoftë islame kur dihet që minaret e xhamive kanë qenë pikërisht hapi parë i altelerisë serbe për shkatërrimin e tyre dhe të objekteve të tjera kulturore, unë nuk po e shoh ministrin e Kulturës, por të paktën çka ka ndodhur me qarshitë në Gjakovë, Pejë që kanë qenë objekte shumë të lashta dhe nuk thuhet asnjë fjali që vërtet duhet të kërkohet një kompensim, sepse ato janë shkatërruar. Ndërsa në fund të dokumentit unë po citoj vetëm atë nën 5 ku thuhet Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore është dëshmitar kur në qershor të vitit „...“ në një dokument i cili do të shkojë edhe në Kombet e Bashkuara i mungon viti, faktikisht kur kanë ndodhur ato gjëra, d.m.th. thuhet data e kthimit të jetë 30 shtatori, atëherë mendoj se është mirë që të kemi edhe një qasje tjetër.

Unë e përgëzoj ministrin Gjini që tha vërtetë kemi një aparaturë të shkëlqyeshme për vlerësim të këtyre gjërave, por unë i lëshova një sy, vetëm hartës së komunës sime dhe asaj harte në të cilën janë monumentet kulturore, gërmimet arkeologjike dhe shtëpitë karakteristike e kështu me radhë. Më vjen keq por mund të them që në atë hartë nuk ndodhet p.sh. qoftë edhe një kishë që është ndërtuar në dy mijëvjetorin e krishterimit në Samadrazhdë nuk ndodhet një xhami që është në aftë fshat dhe mungojnë objektet e



kultit të cilat vërtet 6 të tilla kanë qenë edhe para luftës, andaj është mirë që në këto raste ju lus ta konsultoni pushtetin lokal se dilni më të fuqishëm. Unë po e përmendi vetëm një rast që në momentin kur jemi konsultuar në Mitrovicë për çështjen e të zhdukurve ka dalë që 15 veta nuk kanë figuruar as në listat e Kryqit të Kuq as diku tjetër, por kanë qenë të vendosur aty.

Dhe krejt në fund, unë po e citoj një autor i cili quhet Miodrag Popović dhe ka shkruar një libër "Vidovdan i çasni krst", kërkoj falje pse e thashë në origjinal, por ju lutem aty thotë në detaje se: Të gjitha objektet kulturore të cilat janë ndodhur jashtë Serbisë janë ruajtur shumë më mirë se sa në Serbi dua të jap vetëm një fakt se në libër citohet që pikërisht manastiret dhe kishat janë ruajtur me shekuj nga shqiptarët, ndërsa të tilla sot nuk ekzistojnë në Mal të Zi, sepse janë shndëruar qoftë në koteca për dhi apo për dele apo diçka tjetër, por me të tillët i ka qeruar hesapet pushteti serb në vitin 45 ose 47 ku vetë shokët e Qosiqit i kanë shkatërruar, ndërsa në Kosovë kur janë ruajtur me shekuj ne duam t'i krijojmë ato zona dhe vërtet është diçka që del si shumë e dhimbshme. Në fund kisha dashur që për këto gjëra të konsultohen më gjerë institucionet dhe të jetë d.m.th. një prezantim çfarë e meriton, do të thotë edhe vetë Grupi Negociatorë edhe pjesëmarrësit në këtë takim. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Xhezair Murat,

**DEPUTETI SABRI HAMITI** – Mora fjalën, kam të drejtë për procedurë ta marrë fjalën, ju e keni drejtë t'i jepni fjalën kujt doni, por në bazë të procedurës nuk është mirë t'i jepet fjala dy herë, për të njëjtën temë edhe të riciklojmë dhe ta humbim kohën. Pa marrë parasysh kush është, nëse hyjmë në ciklin e ri të diskutimeve dyfish që nuk është mirë, ky është sugjerimi im,

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Unë kërkoj falje nëse është dyfish kjo, për kohën sa kam qenë unë, për jashtë nuk e di se kush ka folur, urdhëroni,

**DEPUTETI XHEZAIR MURATI** – Evo ja çu ponoviti poštovanje predsjedniče Skupštine, g. predsjedniče Kosova, g. Sejdiu, članovi jedinstvene pregovaračke ekipe Kosova, kolege, gosti, ja sam koristio vreme u petak da govorim kao šef parlamentarne grupe, ovoga puta neću zloupotrebljavati Skupštinsku govornicu i govoriti o procesu pregovora nego upoznati Skupštinu sa jednom odlukom parlamentarne grupe 6+, čije sam šef, i prema tome nije ponovna diskusija o istoj temi, jer ste vi onoga dana g. Sabri govorili pet šest puta u krugu a ja se nisam javio da protestujem, nekoliko puta ste govorili i vi još nekoliko članova Skupštine o istom pitanju ste govorili više puta, meni nije na pamet bilo da protestujem, ali sigurno ste dali doprinos pa vam je predsjednik dozvolio, a sada ja saopštavam jednu odluku kao šef parlamentarne grupe, tako da ovo uopšte nema dodirne tačke sa vašim protestom da ponovo govorim o pregovaračkom procesu. Toliko.

Parlamentarna grupa 6+ na sastanku održanom 06.09.2006. u vreme skupštinske pauze nakon detaljnog razmatranja problema i analize procesa pregovaranja o konačnom statusu Kosova i analiziranja događaja došla je do zaključka da zbog ne konsultovanja

parlamentrane grupe 6+ od strane pregovaračke ekipe jedinstva i konsultativnog saveta oko određivanja članova pregovaračke ekipe u Beču i razloga na ozbiljne primedbe koje smo izneli i u petak i danas, a koje se tiču poslednje verzije dokumenta o pravima zajednica. Smatramo da našim učešćem nećemo dovoljno doprineti ni samom pregovaračkom procesu, a ni zahtevima naših zajednica. Sa velikim žaljenjem vas obavestavam da nećemo moći uzeti učešće na pregovorima 7 i 8 septembra u Beču i takvu odluku je donela parlamentarna grupa 6+, odluka je jedinstvena. Nakon saopštenja danas predsedniku Skupštine Kosova Kolju, ja sam poslušao njegovu sugestiju i imao kraći razgovor sa predsednikom Kosova g. Sejdiuom koji mi je sugerisao da malo pričekamo, da bi možda bilo kontraproduktivno da ishitreno takvu odluku donesemo itd, pa smo mi nanovo imali sastanak dok je trajao nastavak Skupštine i Parlamentarna grupa 6+ je ponovila takvu odluku. Mislim nećete pogrešno da nas shvatite, ali zadnjih sednica smo imali nekoliko rasprava na temu naših problema i poteškoća, tako da nije bilo uvek dovoljno shvatanja i razumevanja. Dakle, ja ponavljam još jednom žaljenje, ali sigurno ćemo na greškama da se učimo i da nastavimo ono što smo započeli i čemu težimo sve zajednice Kosova, većinska pa i zajednica kojom ja predsedavam. Ponovljena je odluka u punom potpisu. Izvolite g. predsedniče.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** - Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Berat Luzha

#### REPLIKË

**DEPUTETI SABRI HAMITI** - Zotëri kryetar i Kuvendit, tema është e rëndësishme, prandaj desha të kërkoja rregull dhe procedurë. Kemi vendosur t'i zbatojmë procedurat, rregullat dhe ky është insistimi im, unë do të thosha një insistim shumë legjitim edhe për shkak të kohës që po humbet në diskutime. Po ju them edhe një herë se ka shumë retorikë rreth problemeve.

Unë po të kisha pas dëshirë ta marrë fjalën nuk dua të ndërhyjë, më është përmendur emri edhe atë ditë tri -katër herë edhe sot do të flitsha, kësaj radhe më duhet ta them edhe një herë, megjithatë është e njëjta pikë e rendit të ditës, me rregullat në fuqi nuk flet dy herë deputeti, pos nëse vendoset t' i jepet fjala dhe ta them ta demantojë një të pavërtetë. Unë kam dalë një herë në këtë foltore e kam shfrytëzuar kohën time dhe asnjë herë tjetër. Nëse ju kanë shumëzuar në krye këtij Murati që kam fol disa herë është problem i tij, ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA**, Pajtohem, urdhëroni deputeti Berat Luzha, le të përgatitet Bislim Hoti.

**DEPUTETI BERAT LUZHA** - Ju faleminderit z. kryetar, ky debat formal po bëhet me shumë vonesë, se tash Kuvendi nuk mund t'i ndryshojë rrjedhat që kanë devijuar një kohë të gjatë. Delegacioni i Kosovës sot pas pak do të nisët për Vjenë, kurse debati bëhet krejt i padobishëm, sepse jo rastësisht është shtyrë mbledhja në mënyrë që ajo të mos prodhojë efekte të pa- dëshiruara për negociatorë.

Kuvendi nga Grupi për Negociata është përfillë vazhdimisht ai është vënë jashtë rrethave të zhvillimeve politike për statusin e Kosovës, kurse mbledhja e sotme paraqet edhe një farsë sa për t'ia larë fytyrën Grupit se gjëja, çështjet e bisedimeve kanë kaluar përmes Kuvendit. Dy herë me radhë Kuvendit me fjalim ju ka drejtuar kryetari Sejdiu e kujtoj kryetarin se detyra e tij është jo t'i drejtohet dhe jo të mbajë fjalime patetike, por t'i raportojë dhe t'i japë llogari Kuvendit për të gjitha çështjet që janë me interes për institucionin më të lartë të vendit dhe më interes për Kosovën. Është paradoksale se si asnjë dokument i Grupit deri tash nuk është miratuar dhe nuk është paraqitur në Kuvend. Grupi Negociator nuk ka të drejtë dhe as mandat të formojë krye në vete komuna e të dhurojë territoret e Kosovës sikur ato territore të ishin prona të tij. Këtë të drejtë e ka vetëm Kuvendi i Kosovës. Procesi i quajtur decentralizim ka filluar prapsht nga Qeveria e sotme, kurse ka të ngjarë të përfundojë tragjikisht. Ju kujtohet se si deklaroheshin njerëzit tanë kur ktheheshin nga Vjena, si e kanë mundur Serbinë, sipas tyre Serbinë e kemi mundur jo më pak se tetë më hiq, por e vërteta është krejt ndryshe.

Të nderuar kolegë deputetë edhe pse përditë e më tepër përsëritet refreni se ndarje të Kosovës nuk do të ketë, megjithatë ndarje në baza etnike sipas dokumenteve që janë paraqitur duket se është e pashmangshme, mirëpo kjo ndarje po kamuflohet me decentralizimin, që nuk është tjetër pos një mashtrim. Ky proces i imponuar edhe nga faktori ndërkombëtar dihet se po bëhet me presion, por gjithnjë me pajtimin tonë dhe sipas planit se për ndarjen e Kosovës, që përngjjet aq shumë në modelin e ndarjes së Bosnjës para 10 vjetëve, kur serbëve iu dhuruan hiq më pak se gjysma e territorit dhe u përlligj spastrimi etnik i territoreve.

Në rastin tonë Serbisë mund t'i dhurohen mbi 25% të territorit, duke vizatuar e qëndisur nëpër Kosovë kufij absurd të përmasave etnike si ata në Bosnje, u tha me të drejtë se Serbia nuk ka të drejtë të përcaktojë formula për statusin e Kosovës, por realiteti paraqitet ndryshe, Serbia edhe pse nuk e ka këtë të drejtë ajo po e ndan Kosovën sipas kutit të vet.

Për të bërë një ndarje të re administrative të Kosovës do të duhej përfillej disa parakushte gjatë zhvillimeve për statusin e ardhshëm të Kosovës, që decentralizimi apo më saktë ndarja e re e administrative e Kosovës të bëhej vetëm pas zgjidhjes së statusit, do të duhej të bëhej në tërë territorin e Kosovës dhe nuk duhet të kishte karakter të ndarjes etnike. Ndarja administrative duhet të bëhet pas regjistrimit të popullsisë, pas miratimit të kushtetutës dhe pas miratimit të ligjeve përkatëse.

Ligjet për organizimin territorial dhe ligjet për qeverisjen lokale.

Vendimin për ndarjen e re administrative dhe kriteret e kësaj ndarjeje duhet t'i përcaktonte Kuvendi i Kosovës si organi i vetëm legjitim për këtë çështje. Me rastin e ndarjes së re administrative duhej të abrogohej sistemi i deri -tashëm i komunave dhe në vend të tij të konstituoheshin tri nivele të pushtetit, me ç'rast shërbime do t'u ofroheshin të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim etnie. Nuk duhej të formoheshin komuna asimetrike me ekstra kompetenca, nuk duhej të formoheshin ekstra territore të sigurisë, por për mbrojtjen e monumenteve fetare apo të trashëgimisë kulturore duhet të gjenden forma të tjera ligjore që janë efikase. Për t'iu shmangur ndarjeve të projektuara nga



Serbia Kuvendi i Kosovës duhet të merret më shumë përgjegjësi dhe t'i mbikëqyrë të gjitha zhvillimet politike që po bëhen. Kuvendi i Kosovës nuk duhet të lejojë lidhjen horizontale të komunave etnike përmes formimit të këshillit të komunitetit serb që në perspektivë do të paraqiste një "republika serpska" të dytë dhe as lidhjen vertikale me Beogradin: përmes financimit të këtyre komunave.

Kuvendi i Kosovës duhet ta shpallë pavarësinë e Kosovës dhe pastaj ta thërret popullin në referendum si shprehjen më të ligjshme dhe më demokratike të mundshme.

Një ndarje e tashme dhe e pjesshme territoriale mbi kriteret etnike me mundësitë të lidhjeve horizontale dhe vertikale, ashtu siç po planifikohet të bëhet, po e përsëris që është e pashmangshme aty ku nuk dëshiron askush prej nesh. Kurse me këtë rast nuk do të bëhej ndonjë zgjidhje e përshtatshme as për bashkësinë serbe as për shqiptare.

Mund të paragjykohet me të drejtë se problemet etnike edhe pas kësaj ndarjeje do të rriten edhe më tepër, kurse si pasojë do të kemi një Kosovë jostabile, jofunksionale dhe jodemokratike, një Kosovë ashtu si e do Serbia.

Mund të inskenohen vazhdimisht konflikte incidente ngjarje të ndryshme kurse përgjegjësia gjithmonë si deri tash do të bjerë mbi ne, në këtë mënyrë do të fajsoheshim edhe për terrorizëm për paaftësi e për çka jo tjetër në përfundimin se gjëja se ne nuk dimë dhe nuk mundemi ta bëjmë shtetin, se Kosova nuk meriton dhe nuk duhet të bëhet shtet tjerë. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Fjalën e ka Bislim Hoti, le të përgatitet deputeti Xhevdet Neziraj.

**DEPUTETI BISLIM HOTI** – Ju faleminderit zoti kryetar, respekt për kryetarin e Kosovës z. Sejdiu, kryeministrin, ministrat dhe ju kolegë të çmuar deputetë,

Meqenëse u shterr për mua pothuajse i tërë diskutimi që pata ndërmend, sepse parafolësit e mi i thanë shumë çështje, por unë duhet të ndalem në disa çështje që janë shumë me rëndësi, por në fillim po ia nisim me gëzimin e Grupit Negociator dhe dëshpërimin e tij. Ishte një gëzim i Grupit Negociator pas bisedimeve të para kur u kthyen nga Vjena i pamë të qeshur, të gëzuar, sa që takimin në bisedime e vlerësuan si fitore futbollistike me rezultat dy zero dhe unë e shpresova që do ta marrim edhe kupën, por për kundrazi u zhgënjyem sepse ata dy gola në fund paskan qenë autogola, edhe nga kjo ditë deri më sot të gjitha takimet e bisedimeve, ne nuk jemi njoftuar, vetëm nëpër mediave elektronike që Grupi i Unitetit mbetet në heshtje pa referuar për rezultatin humbës apo mungesën e kapaciteteve për të mos i kuptuar nëse janë duke u kuptuar në esencë gjërat, pasi puna ishte duke u kryer. Referimet që dëgjuam para katër ditëve nga ky grup uniteti, sollëni pakënaqësi jo vetëm te ne, por edhe te të gjithë qytetarët e Kosovës një mos besim për të vazhduar punën me tutje, kurse presidenti i Kosovës në referimin e tij platformën e pushtetit lokal e bazoi në frymën tolerante të ndërkombëtarve e jo në frymën e kosovarëve.

Kryeministri Kosovës, z. Çeku, lavdëroi OKB-në, gjoja se institucionit të Kosovës po tregojnë rezultatin e implementimin të standarde sipas kërkesave të tyre e jo sipas kërkesave që ka sot nevojë Kosova, Kryetari i PDK-së z. Thaçi tha se mosgjetyja e mekanizmave të përbashkët për ruajtjen e unitetit të Grupit , më shumë i ngjan se ishte një fushatë parazgjedhore, ndërsa babai i pakicave kombëtare z. Surroi, ndošta jo edhe për pakicën tone, sepse komuniteti shqiptar egjiptiani ka edhe babën edhe nënën, jo Kosova, por Shqipëria, sipas z. Veton Surroi, paska bërë aq shumë për pakica sa që në fund me përfundimin e statusit të Kosovës pakicat po deshkan ta udhëheqin shumicën në Kosovë. Unë nuk do të ndalem vetëm me dy çështje shkurt, për të drejtat dhe interesat e komuniteteve edhe për decentralizim.

Ia kemi bërë me dije disa herë z. Veton Surroit si kryetar të këtij Këshilli që komuniteti ynë egjiptas në asnjë moment të mos futet në thes me komunitetin rom, sepse kanë harruar se gjuhë, kulturë, traditë për mua është gjuha shqipe e jo gjuha romë. Ne gjithmonë e kemi pasur këtë kërkesë, por prapëprapë po del me praktikën e vjetër, po përdoren ato formula nga Rezoluta 1244 dhe asgjë nuk është bërë e re nga Grupi i Unitetit. Do të thotë janë caktuar vendet e rezervuara pa u bërë regjistrimi i popullatës si p.sh nesër me regjistrimin e popullatës del më tepër se turqit apo boshnjakët edhe pse unë dal më tepër do ta kemë një vend, kurse turqit dhe boshnjakët do t'i kenë nga 4-5 vende, prandaj nuk është punuar ajo çka është kërkuar. Sa i përket çështjes së decentralizimit, Grupi i Unitetit nuk e sheh të arsyeshme që të krijojë komuna edhe për mazhorancën. U tha para 4 ditësh nga kolegja Nekibe Kelemendi dhe dikush tjetër që është formuar një komunë shqiptare "Juniku", nuk është e vërtetë që Juniku është formuar që u takon shqiptarëve. Juniku është formuar komunë politikisht, një Junik në vitet e 90-ta janë ndërtuar 1000 shtëpi për refugjatët serbë nga Bosnja, prandaj sot Habitatit punon me të madhe që t'i largojë të strehuarit atje, prandaj së shpejti pritet që në Junik të kthehen edhe 5.000 serbë. Pra, ja pse është bërë Juniku kuvend komunal. E vetmja kërkesë për t'u bërë një kuvend komunal ka ardhur nga komuniteti ynë që e hasim në rrethinë me të gjitha kushtet, me gjithë projektin që i është dorëzuar Petersenit, i është dorëzuar z. Lutfi Haziri, i është dorëzuar z. Veton Surroit edhe ne nuk kemi marrë përgjigje. Andaj dua të them që dy kërkesat tona nga Grupi i Unitetit duhet t'i kemi parasysh që neve në çdo dokument ku shkruhet të mos na përziejnë atje ku figuron komuniteti rom dhe e dyta që të marrë përgjigje pse një komunë shqiptare nuk ka mundësi të bëhet me 20.000 banorë, kurse për këtë mund të them se unë jam shumë i zhgënjyer. Në Grupin e Unitetit, nuk shoh profesionalizëm, sepse kam menduar se ky grup në Kosovë do të krijojë një identitet të vetëm kosovar e kjo nuk arrihet përderisa në Kosovë, në shtetin e ri të Kosovës të mos krijohet liri, lejohet krijimi i partieve mbi baza etnike, krijimi i komunave mbi baza etnike, trajtohen të okupuara objekte fetare me zona të mbrojtura, paralelizma. Unë e pyes Grupin e Unitetit, a është kjo Kosovë multietnike? Jo. Unë kësaj i them Kosovë multianetike, sepse kështu do të ndodhë. Kur t'i kemi parasysh të gjitha këto çka po them unë me të vërtetë këtë nuk mund ta quaj Grup Uniteti, por grup xhepi për veti.

U diskutua dhe u dëgjua nga parafolëtist tanë se këtë grup e ka formuar ish- presidenti i ndjerë z. Ibrahim Rugova, por sot Grupi është në krizë, sikur të ishte presidenti gjallë do të dinte se si do të dilte nga kriza. Unë mendoj se ky grup nuk ka kapacitete të mjaftueshme, andaj kërkoj që t'i kenë parasysh të gjitha këto diskutime që ne sot po i

bëjmë dhe ato deklarata që i përkraen z. Buja dhe z. Agani që të harmonizohen dhe të koordinohen dhe në fund të kemi konkluzione të përbashkëta që ta kemi një Kosovë të pavarur dhe pakurrëfarë bishti prapa.

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj, kurse le të përgatitet deputetja Selviqe Halimi.

DEPUTETI XHEVDET NEZIRAJ - Faleminderit kryetar i Kuvendit, i respektuari kryetari Sejdiu, liderë të opozitës z. Thaçi dhe z. Surroi, IRDK-ja që në fillim dhe komuniteti egjiptas ka përshëndetur dhe ka përkrahur se bisedat duhet të zhvillohen me palën serbe dhe me një letër që i është dërguar z. Rugova në mes tjerash kemi aturoizuar që z. Rugova të jaë një përgjegjësi jo vetëm përgjegjësi, por është përgjegjës edhe për komunitetin egjiptas për arsye se është president i Unitetit dhe i të gjithë qytetarëve të Kosovës. Çështja e decentralizimit është një pikë që kemi menduar të gjithë qytetarët se me decentralizim do të jetë një funksionalitet, efikasitet dhe stabilitet që do të përfitojnë të gjithë qytetarët e Kosovës. Unë nga kjo foltore do të them se decentralizimi për momentin është duke ndodhur vetëm për komunitetin serb, prandaj është e mirë që i tërë opinioni dhe popullata të dinë se nuk është duke u bërë për minoritetet e tjera, por është duke u bërë faktikisht për komunitetin serb ,që është duke punuar në atë drejtim për një decentralizim në vija etnike. Unë nuk do të ndalem më tepër në decentralizim, por do të ndalesha edhe në këshillin konsultativ të komuniteteve ku kemi marrë pjesë për 6 muaj rresht dhe kemi punuar në document dhe në disa rregullore që mbrojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Është punuar mjaft edhe në Durrës edhe në Selanik, në Shkup, por edhe në Prishtinë dhe disa versione që janë parashtruar nga komunitetet në dokument zyrtar dalin disi të tjera dhe mund të themi se një pikë që është kërkuar dhe ka qenë e vetmja pikë nga komuniteti egjiptas ajo nuk është realizuar dhe ka mbetur ashtu siç ka qenë në Kornizën Kushtetuese se kush ka qenë në themelimin e saj është në nenin 9 ku bëhet vendi i rezervuar dhe për të gjitha komunitetet caktohet çdo vend, ndërsa për komunitetin rom, egjiptas dhe ashkanli caktohet një kuotë e caktuar prej 4 ku në mënyrë juridike interpretohet si një komunitet me 3 apo 4 subjekte politike, prandaj edhe pse nuk jamë jurist, po mri me juristë dhe po mësohem të bëj komentime juridike, prandaj komuniteti egjiptas do ta kundërshtojë me çdo kusht këtë formulë dhe besojmë se në dokumentin përfundimtar do të jetë ashtu siç kemi kërkuar.

Në lidhje me bisedat të cilat janë duke u zhvilluar në Vjen, këshilli konsultativ ka caktuar disa herë z. Sadik Idriz në fund edhe z. Merxha dhe më duket se selektor në të gjitha këto ka qenë z. Surroi, se kush do të marrë pjesë në këto takime nga ana e komuniteteve edhe pse është paraparë dhe është folur që të jem në Grupin për çështje të ekonomisë, nuk jam ftuar. Arsyet nuk i di as unë, por me siguri nuk do të ketë përgjigje as Grupi i Unitetit.

Unë do të ndalem edhe në sferën ekonomike. Nuk di se Grupi i Unitetit a është duke e parë se në Kosovë të gjithë kursimtarët të cilët kanë dorëzuar mjete të majme nëpër banka të Serbisë, sot edhe kësaj dite janë duke i nxjerrë ato të holla me 50%, do të thotë se shteti serb është duke përfituar nga qytetarët e Kosovës dhe deri kur do të vazhdojnë këto përfitime të shtetit të Serbisë në llogari të qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit.



KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI – Fjalën e ka deputetja Selviqe Halimi, kurse le të përgatitet deputeti Nazim Jashari.

DEPUTETJA SELVIQE HALIMI - I nderuari kryesues, të nderuar naëtarë të Grupit të Unitetit, të nderuar deputetë.

Është fakt se të gjitha problemet, pa marrë parasysh se të çfarë natyre janë dhe çfarë rëndësie kanë për zgjidhjen e tyre duhet të kalohet në një fazë apo përmes një procedure që zakonisht e quajmë proces. Proceset janë të mirëseardhura dhe duhet të mbështeten, mirëpo që ato të mbështeten kërkohet përgjegjësi, përgjegjshmëri dhe transparencë, po që se plotësohen këto tri kritere, atëherë do të kenë mundësi edhe deputetët edhe qytetarët e Kosovës të dinë çka është duke ndodhur në vendin e tyre, me qëllim që të ndihmojnë ata të cilët janë duke i prirë procesit dhe duke zhvilluar negociatën.

Të nderuar kolegë deputetë, para një vit e gjysmë këtu është diskutuar për decentralizimin dhe kryesisht për pilot-njësitë komunale që deputetët e PDK-së kanë ngritur zërin se cilat komuna janë zhgjedhur që të realizohet projekti për njësi komunale, ende pa u bërë asnjë tekst se sa funksionuan ato njësi komunale të cekura nëpër media se u formua kjo apo ajo njësi komunale, po formohen komuna të reja pa e ditur askush çka dhe si, dhe kur raportohet nga të kihyerit nga Vjena merret roli i reporterëve të lojërave kombëtare apo ndërkombëtare, unë mendoj se me procesin e decentralizimit i kemi ikur shprehjes apo kuptimit real të fjalës decentralizim dhe këtë e kemi shndërruar në etnicitet, u kemi ikur fjalëve reformë e pushtetit lokal dhe këtë e kemi shndërruar në kufij kadastralë të komunave të Kosovës. Pse për këtë nuk bisedohet në kuvendete komunale, pse për këtë nuk diskutohet me qytetarët, kush duhet ta mbajë përgjegjësinë nesër, madje kush duhet ta marrë përgjegjësinë po që se një fshat etnikisht shqiptar bashkohet me një komunë me 2 apo 3 fshatra shumicë serbe. A nuk kemi këtu një rrezikim të lëvizjes së shqiptarëve që do të mbesin pakicë në ato komuna? A është kjo çështje për t'u diskutuar, pse u ngutëm kaq shumë me decentralizim dhe komuna të reja, ku u kërkua para një vit e gjysmë që të hartohet Ligji për pushtetin lokal, për financa publike, që të bëhet paraprakisht regjistrimi i popullsisë, mirëpo të gjitha këto u shtyn. Të nderuar qeveritarë, këtu është një përgjigje që neve nuk na bëhet publike, por gjithmonë kur diçka nuk bëhet publike historia na ka treguar se e dimë se çka ka pasur prej saj, nuk duhet të harrojmë se standard mbi standarde është relaizimi i të drejtave të të gjithë qytetarët në Kosovë. Askujt nuk mund t'i jepet më shumë e as t'i merret më shumë, askujt nuk mund t'i jepet më pak, as t'i merret më pak se ajo që i takon dhe që është e mbrojtur me konventa ndërkombëtare, 6 apo 7 vjet pas luftës ende me eksperimente dhe asnjëherë asnjë rezultat nuk shkoi në dobi të qytetarëve të Kosovës. Mostransparenca e vazhdueshme e institucioneve të Kosovës e edhe e Kuvendit e edhe e atyre institucioneve që dolën nga Kuvendi i ka zhgënjyer qytetarët. Kemi përgjegjësi politike para tyre, kemi edhe përgjegjësi morale. Kërkoj të bëhet respektimi i plotë i Rezolutës së nëntorit të vitit të kaluar e nxjerrë nga ky Kuvend, të kemi përgjegjësi dhe përgjegjshmëri dhe transparencë për të cilat gjëra edhe PDK-ja ka pranuar që të jetë në këtë grup negociator. Ju faleminderit.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Nazim Jashari, kurse le të përgatitet deputeti Fetah Berisha.

DEPUTETETI NAZIM JASHARI - Të nderuar anëtarë të Ekipit të Ufütetit, të nderuar anëtarë të Qeverisë, të nderuar kolegë deputetë.

Tek sot jemi të kompletuar me materiale dhe mund ta zhvillojmë debatin lidhur me raportin e Grupit të Unitetit në Kuvend të Kosovës dhe për çudi diskutimet në këtë seancë shkojnë të një diskutimi në parim dhe aspak nuk ndalemi në dokument që na është prezentuar, pasi jemi mësuar të bisedojmë në mënyra jokonkrete dhe të diskutojmë në mënyrë të përgjithësuar dhe jo të ndalemi në zgjidhje të veçanta për problematika të cilat definitivisht e përcaktojnë të ardhmen e qytetarëve të Kosovës tash e prapa. Shumë po bazohemi në Rezolutën e 17 nëntorit. Ajo është një rezolutë në vazhden e shumë rezolutave që është miratuar në këtë Kuvend. Diku si me turp në pikën 10 thotë se Kuvendi i Kosovës, duke e mbështetur Delegacionin e Kosovës do të përcjellë gjithë procesin e punës së tij dhe çdo vendim për të ardhmen e Kosovës do të ratifikohet në Kuvend. Kuvendi i Kosovës nuk e ka kryer punën e vet. Pra, përcjellja e punës nuk është bërë, sepse ky Kuvend nuk ia ka dalë që ta shtrojë problemin e mbarëvajtjes së negociatave në mënyrën e duhur deri në këtë seancë dhe këtë e kemi sqaruar në ditën e promte dhe nuk dua t'i kthehem përsëri kësaj problematike.

Është thënë nga ndërkombëtarët, nga ardhja në vitin 1999 se Kosova do të jetë multietnike dhe kusht për të ardhmen e saj është multietniciteti. Të nderuar kolegë deputetë, më duhet ta shpreh këtu një zhgënjim timin, Kosovë multietnike me komuna monoetnike nuk ka, në qoftë se Kosova ndahet nëpër bashkësi komunale njëetnike, që është mundësia për t'u organizuar multietniciteti në Kosovë, në këtë rast dhe gjatë kësaj fjale time, flas si deputet, por më shumë flas si qytetar i brengosur i Kosovës dhe qytetarët e posaçërisht në Anamoravë janë shumë të brengosur me këtë proces të negociatave me theks të veçantë në decentralizim.

Kolegë të nderuar deputet, udhëheqësi i ekipit të negociatave për decentralizimin edhe vetë i Anamoravës - i komunës së Gjilanit -dhe e keni hartën përpara dhe mund ta shihni se çka i ka bërë komunës së vet. Bërthama urbane e Gjilanit kufizohet me komunën rurale të Novobërdës. Nuk kam asgjë kundër që t'u jepen të drejtat serbëve për t'u vetëqeverisur, por kemi thënë edhe në fillim, çdo zgjidhje e cila nuk e dëmton funksionalitetin e Kosovës është zgjidhje e pranueshme, kjo duhet të vlejë edhe për qendra urbane në Kosovë. I kemi 7 qendra urbane në Kosovë, çdo zgjidhje e cila nuk e dëmton funksionalitetin e qendrave urbane do të duhej të ishte edhe ky një parim themelor, sepse nuk di sa e njihni Gjilanin, është një rrugë qarkore, fshati Koretishtë vjen deri te rruga qarkore, fshati Stanishor po ashtu është njësoj sikur t'ia heqësh Gërminë Prishtinës, pjesa në të cilën gjithë qyteti del për rekreacion, për ajër të pastër dhe t'ia marrësh atë pjesë qytetit .d.m.th. ta zhveshësh komunën nga perspektiva për zhvillim. Në qoftë se për asgjë tjetër rajoni i Anamoravës është shquar për një tolerancë larg mbi mesatarën e tolerancës në Kosovë, serbët keni mund t'i shihni në pikë të natës me regjistrime të vjetra që mund t'i krahasosh sikur endën me flamur të Serbisë nëpër Kosovë pa asnjë incident të vetëm, incidentet ku kanë qenë në formë fushate kanë qenë në gjithë Kosovën e kanë përfshirë edhe Anamoravën dhe tash kjo ndarje që po u bëhet etnive, unë nuk e di se a bie të mria apo të këqija, mbetet të shihet, mirëpo mënyra se si është paralizuar Gjilani është një qendër urbane e cila përkah pozita e vet gjeografike mund të jetë qendër rajonale për më shumë se 6 komuna, për 3 komuna në Serbi, për një komunë në Maqedoni edhe për tri komuna të tjera përveç vetes në Anamoravë. I

pamundësohet rritja nga veriu, një komunë e cila thjesht bëhet një qendër e dytë apo e tretë në Kosovë edhe për nga potenciali i vet zhvillimor, me një veprim që për mua është krejtësisht i pakuptimë: Koretishta, Kufca dhe Stanishori janë tri fshatra që i janë 3 kilometra larg qendrës së komunës dhe i bashkangjiten asaj, ku duhet të udhëtojnë në skajin tjetër të komunës së re dhe e kanë rrugën 30 kilometra. Unë nuk e di, ndonjë nuk keni pasur rrugë tjetër, e keni humbur përparësinë e krijuar me 12 qershor 1999 me veprime ose me mosveprimet tona dhe kemi ardhur në situatë ku presioni ka qenë i papërballueshëm. Mirëpo kjo mënyrë dhe kjo zgjidhje mendoj se nuk janë të tolerueshme dhe mendoj të lihet mundësia e rishikimit. E keni thënë diku nëpër dokumente që pas tre vitesh, mirëpo kjo duhet të forcohet shumë në tekstin përcjellës, sepse, kolegë të nderuar deputetë, nëse nuk insistohet në të drejtën për ta rishikuar funksionalitetin e këtyre komunave, atëherë kjo do të jetë diçka që është punë e kryer, sepse këto komuna të reja që po formohen realisht, nëse i marrim përkaq numri i banorëve janë të vogla- minore. Komuna aktuale e Novobërdës që propozohet i ka 39 banorë me 1 kilometër katror, ndërsa që mesatarja e Kosovës është diku 250 banorë në një kilometër katror, pra ky është decentralizim territorial e jo decentralizim i pushtetit. Këtu po luftohet për territore dhe po insistohet në territore pikërisht në zonat ku janë më afër kufirit me Serbinë, prandaj asgjë e mirë nuk u shkruhet këtyre komunave të reja dhe as Kosovës me to.

Do të ndalem te parimet e decentralizimit, në dokumentin e 29 gushtit thuhet, të cilin ne nuk e trajtuam fare dhe i cili fatkeqësisht për mua ka disa momente që janë të paqarta dhe të pamundshme për funksionalitet të mirëfillt të Kosovës. Në pikën 3 te kompetencat që: "Çdo rishikim i akteve komunale nga autoritetet e Kosovës në fushën e kompetencave vetiake, do të kufizohet me sigurimin e përputhshmërisë, kurse autoriteti mbikëqyrës administrativ nuk ka të drejtë të suspendojë ekzekutimin e vendimit komunal, mirëpo mund të kërkojë që komuna që e ka nxjerrë vendimin ta rishikojë atë, e nëse komuna e pranon kërkesën ekzekutimi i vendimit suspendohet, nëse komuna e refuzon kërkesën atëherë duhet t'i drejtohem gjykatës". Nuk thuhet që trajtimi i vendimit në gjykatë a mund ta suspendojë ekzekutimin e një vendimi të tillë, apo e shtyn deri te vendimi i gjykatës në vendim përfundimtar. Mendoj se kjo duhet gjithsesi të përfshihet, sepse është ndonjë vendim i cili thjesht bie ndesh me interesat e shumicës së qytetarëve të Kosovës. Kjo duhet të precizohet në dokument.

Është edhe aspekti i zgjidhjes së policisë ose i kryeshefit të policisë në këtë dokument, i cili deri në gjysmën e korrikut ja ka dalë t'i rezistojë një logjike elementare funksionale të një organizate hierarkike, siç është policia ku është kërkuar që policia ose vetë udhëheqësit e policisë së Kosovës të propozojnë, kurse kuvendi komunal t'i miratojë propozimet e udhëheqësve të policisë, kurse tash kalohet në variantin tjetër ku komandantët e policisë lokale po zgjidhen në bazë të një procesi bashkëpunues dhe pas konsultimit të kuvendit komunal dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku Kuvendi komunal i propozon dy emra për shef të stacionit lokal të policisë dhe kur nuk thotë fare se ata dy emra duhet të jenë staf i policisë së Kosovës, e thotë te zhvillimi i tretë, ku thotë: " brenda 15 dite pas pranimit të këtij propozimi nga ana e kuvendit komunal Ministria e Punëve të Brendshme nuk e bën emërimin, atëherë propozohen dy emra të tjerë dhe në qoftë se edhe pas propozimit të dytë vie propozimi i tretë dhe vetëm atëherë thuhet se duhet të jenë nga shërbimi ekzistues i Shërbimit Policor të Kosovës" duket se nuk është e rëndësishme, por është shumë e rëndësishme, sepse në dokumente të



shkruara duhet të precizohen gjërat ,përndryshe këto shtrohen në interpretime të ndryshme dhe tek interpretimet kemi gjithmonë situatën që dominon ai që është më këmbëngulës ose ai që e ka pozicionin më të mirë negociator dhe në këto situata sigurisht që pakica serbe e ka pozicionin më të fortë, sepse ne me të bërat apo të pabërat tona ia kemi mundësuar ofensivën diplomatike Beogradit, në rend të parë dhe sigurisht përfaqësuesve të saj në Kosovë. Mendoj se në këtë kontekst ky dokument i cili ka ardhur këtu si përfundimtar dhe që i ka shkuar z. Ahtisari duhet të rishikohet, të përmirësohet dhe duhet që të jetë plotësisht i qartë në aspektin e pozicioneve, sepse mund të sjellë komplikime të cilat janë të panevojshme për pozitën e Kosovës. Ju faleminderit.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI – Fjalën e ka deputeti Fetah Berisha, kurse le të përrgatitet deputeti Jakup Krasniqi.

DEPUTETI FETAH BERISHA – Ju faleminderit z. kryesues. I nderuar president i Kosovës Sejdiu, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë dhe të gjithë ata që e përcjellin këtë seancë.

Sot në këtë seancë po bisedohet për parimet themelore të reformës së pushtetit lokal në Kosovë. Bisedimet në Vjenë dhe bisedimet sot në Kuvend për këtë çështje janë historike dhe shumë të vështira. Grupi Negociator i Kosovës, përfaqësuesit tanë e patët të vështirë në Vjenë të bisedoni me palën serbe në praninë e përfaqësuesve ndërkombëtarë, sepse shqiptarët për herë të parë në historinë e tyre u ulën në sofrën diplomatike ndërkombëtare, të flasin për çështjen e vet. E patët vështirë ,sepse fqinji ynë Serbia kurrë nuk pajtohet të ulet në bisedime të barabarta me përfaqësuesit e Kosovës, koloni e tani e lirë, gjithashtu e patët të vështirë ngase dolën edhe gojkëqinjë duke shikuar lojën tuaj në **sallën politike** e që mendojnë se dinë ta luajnë më mirë se ju, por sikur të hyjnë në lojë nuk do të dinin të luanin as për afër juve, megjithatë që nga viti 1990, presidenti Rugova thoshte se me Serbinë duhet biseduar në praninë e palës ndërkombëtare, e ne po bisedojmë ,sepse serbët dhe shqiptarët janë dhe do të jenë fqinjë shekullorë, kjo fqinjësi në 100 vjetëshin e fundit nuk u respektua na regjimet policore ushtarake serbe, ato edhe pas pushtimit të Kosovës më 1912 edhe pas 45-tës edhe pas viteve 90-të, plaçkitën shqiptarët, rrahën, vranë, burgosën dhe denuan me shumë vjet burg, helmuan e në luftën e fundit na i dogjën edhe shtëpitë, na masakruan në masë dhe rreth 1 milion shqiptarë i dëbuan nga trojet e tyre për ta bërë pastrimin etnik të Kosovës. Sot impunohet një pyetje, cilët e kanë më vështirë, fqinjët serbë, që plaçkitën dhe vranë plot një shekull fqinjët shqiptarë apo shqiptarët e gjakosur nga serbët plot një shekull? Kjo nuk do koment, e fqinjin serb ende nuk e vret ndërgjegjia të tregojë se në clat gropa të trollit të tyre i kanë hudhur shqiptarët fqinjë të masakruar e ne të kemi bile së paku ku të vëjmë një tufë lule përkujtimore. Megjithatë reformën e pushtetit lokal e mbështesim, por le të ketë mbështetje në parime ndërkombëtare dhe në specifikat e Kosovës. Ju, Grupi Negociator jeni mbështetur në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, Konventën për Mbrojtjen e Pakidave Kombëtare, dokumentet kornizë për reformën e pushtetit lokal, por në dokumentet e Grupit Negociator nuk shihet të jetë përmendur ideja e presidentit Rugova se decentralizimi më i mirë do të bëhet pas pavarësisë së Kosovës dhe pas regjistrimit të popullsisë së Kosovës dhe gjithashtu nuk është përmedur asnjë praktikë e një shteti rajonal apo evropian për reformën e pushtetit lokal.

Shqiptarët shumicë në Kosovë kanë marrë përgjegjësinë për realizimin e të drejtave të pakicave, anipse regjimi serb rreth një shekull 95% të shqiptarëve në Kosovë i quante "Albanska nacionalna manjina" dhe riorganizimin e pushtetit lokal e mbështesim nga se bartja e ca kompetencave nga pushteti qendror në atë lokal, pakicat i ofron afër vendimmarrjes, trasitë rrugën për integrimin e tyre në strukturat demokratike të Kosovës, ku realizojnë identitetin e tyre edhe etnik, fetar, kulturor, gjuhësor, mirëpo nuk dihet të jetë bërë kaq shumë zhurmë për ndonjë minoritet në ndonjë shtet si për minoritetin serb, nuk dihet për ndonjë minoritet në ndonjë shtet të botës të jetë kaq i privilegjuar, apo edhe i padëgjueshëm si minoriteti serb në Kosovë. Edhe 7 vjet pas çlirimit të Kosovës, politika paternaliste e regjimit të Beogradit dërgon dhe manipulon minoritetin serb në Kosovë të mos pranohet realiteti i ri në Kosovë dhe me shqiptarët nuk mund të bashkëjetohet në paqe dhe në fqinjësi të mirë. Pra, minoriteti serb në Kosovë i frymëzuar nga politika destruktive e Beogradit ,nuk integrohet, nuk merr pjesë në zgjedhje, nuk njih instoitutionet e Kosovës as në Parlament nuk merr pjesë, nuk i paguan as obligimet, ndërsa Qeveria e Kosovës u ka ndërtuar shtëpitë, ata nuk duan të kthehen. P.sh në fshatin Zoqishtë të Rahovecit shtëpitë e ndërëtuara të reja presin banuesit e tyre. Në Kosovë tani ka edhe qetësi edhe siguri nuk mund të manipulohet më me këtë, a thua cila është përvoja e shteteve të tjera të cilat kanë kaq pakë minoritete në shtetin e tyre e privilegjet ndaj minoritetit serb e të padëgjueshëm cilat janë.

Tri parimet ndërkombëtare për Kosovën: nuk ka ndryshim kufijsh, nuk ka ndarje të Kosovës, Kosova nuk lejohet të bashkohet me asnjë shtet, Kosova nuk kthehet në vitet 1990. Këto parime Qeveria e Beogradit nuk i pranon, politika serbe po synon të realizojë një ndarje të brendshme të Kosovës, pasi i ka dështuar kjo tjetra, kërkon sa më shumë komuna serbe etnikisht të pastra dhe të mbajë gjendjen e tensionuar në veri të Mitrovicës me struktura paralele, të krijojë enklava serbe që nuk do të integrohen në realitetin e ri të Kosovës së lirë. Keni bindjen pa lëkundje se reforma reale e pushtetit lokal dhe pavarësia e Kosovës do të ndihmojnë procesin e integritit të minoriteteve në veçanti minoritetin serb në jetën institucionale normale të Kosovës dhe nuk do të lejojnë që në të ardhmen shteti i Kosovës t'i lejojë strukturat paralele serbe, por as strukturat e bandave serbe në Veri të Mitrovicës, qëllimi të cilëve është ta ndajnë Mitrovicën së paku të marrin diçka nga ajo që u ka mbetur sipas tyre. Integrimi i minoriteteve të tjera në jetën institucionale në Kosovë si e minoritetit turk, goran, musliman, rom, ashkanlinjë, egjiptas është për t'u lavdëruar, por privilegjet e tepruara për minoritetin serb edhe këta do t'i fyejë dhe revoltojë.

Të nderuar deputetë dhe të nderuar anëtarë të Grupit Negociator, gjithashtu mendoj se duhet të mbështet ideja e presidentit Mahti Ahtisarit që gjatë bisedimeve me serbët të vihen në përdorim edhe faktet historike, prandaj historikisht dihet se sllavët në Ballkan kanë ardhur në shekullin e VII, ata na mëson historia në themelet e kishave bizantine kanë ngritur kishat e tyre, ndërtimi dhe adoptimi i kishave ortodokse serbe në të gjitha kohët është bërë në rrethana të jashtëzakonshme politike, te përcjella me dhunë ndaj popullatës autoktone shqiptare. Kështu ndodhi edhe me ndërtimin e kishës ortodokse serbe në Prishtinë në kompleksin kulturor e shkencor të qytetit, në rrethana të caktuara Serbia ka vënë në veprim për - vetësimin e fakteve historike shkencore. Kështu ndodhi edhe me plaçkitjen e Muzeut të Kosovës, sidomos të thesarit arkeologjik të Kosovës më 1998, kur i mori 571 artfakte dhe i vuri në Muzeun Arkeologjik të Beogradit meqë

procesi për reformën e pushtetit lokal është mjaft kompleks, por i rëndësishëm për integrimin e pakicave, kërkohej edhe kohë edhe durim për implementimin e tij. Grupi Negociator, përfaqësues të Kosovës në bisedime me përfaqësuesit e Serbisë nuk na duket se keni më pak dhembje se ne për Kosovën, prandaj qëndroni unikë, fshijeni nga shiriti i mendjes çdo interes që tenton t'jua zë rrugën dhe mbani reformën për pushtetin lokal, mbështetuni në prime ndërkombëtare dhe specifika të Kosovës, sepse nuk i lëndoni as minoritetet, as fqinjët tonë serbë. Gjithashtu të mos lejoni të lëndohen realiteti, sovraniteti dhe e ardhmja e Kosovës sonë. Tani për herë të jemi në pozitë të barabartë me fqinjin tonë shekullor Serbinë, qëndroni profesionalisht e mos i pranoni manipulimet. Kemi besim në ju se do të qëndroni drejt pingul në këmbë, pa e lakuar kurrizin para sfidave që mund të dalin, ndërsa ne ju mbështesim ashtu siç e mbështesim procesin, pa kompromise që e lëndojnë procesin e Kosovës drejtë pavarësisë. Ju faleminderit.

**KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI** – E ka fjalën deputeti Jakup Krasniqi, kurse le të përgaditet deputeti Alush Gashi.

**DEPUTETI JAKUP KRASNIQI** – Z. kryesues, z. kryetar, z. Veton Surroi znj. dhe z. deputet.

Kam respekt për të gjitha diskutimet e deputetëve, se secili në formën e tij ka ngritur shqetësimet që i ka, shqetësimet që i kanë zgjedhësit e tij dhe qytetarët e Kosovës, por kisha dëshiruar që t'ua përkujtoj disa deputetëve se Kosova sot gjendet më shumë se 7 vite pas qershorit të vitit 1999, nuk është para 7 viteve të vitit 1999. Mendoj që është mirë të kihet parasysh ky fakt dhe është fakt që nuk mund ta mohojë askush, as në këtë sallë dhe as jashtë saj, është një e vërtetë e madhe që i kemi shqetësimet tona dhe shqetësimet në të shumtën e rasteve janë të arsyeshme, por të mos të harrojmë se ne kemi përpara një dokument i cili ka tri – katër forma, ka me ngjyra të kuqe, ngjyra të gjelbëra, me kurziv dhe nuk është një dokument që ka përfunduar, por është një dokument në diskutim dhe do të diskutohet përsëri gjatë këtyre ditëve. Ne dëgjuam edhe kërkesat e Grupit Parlamentar të PDK-së edhe kërkesën e Grupit për Integritet, por me gjithë atë mendoj që ky Parlament në këto momente e ka vështirë të hartojë një dokument më të mirë, më të qëndrueshëm se Rezolutën e 17 nëntorit të vitit 2005. Në këto momente mendoj se ne si Parlament duhet në një formë nëse veç duam ta ndihmojmë Grupin Negociator në këto bisedime. Unë dua t'i them dy fjalë për këtë grup. Është një e vërtetë e madhe se shpeshherë te ne këshilltarët, ata që punojnë kritikohen më shumë. Mendoj që ky grup në këtë përbërje me gjithë trupat punues gjatë këtij viti ka punuar shumë sipas mundësive të veta dhe mendoj që nuk kanë dalë nga objektiva që i kemi përcaktuar me Rezolutën e 17 nëntorit të vitit 2005, prandaj kisha kërkuar që ose ta mbështesin edhe shefat e tjerë të grupeve parlamentare, që ta bëjmë një rikonfirmim të asaj rezolute që të kërkojmë nga Grupi i Unitetit ta respektojë në tërësi atë rezolutë dhe ta ketë parasysh sidomos pikën 10 për t'i njoftuar edhe Kuvendin edhe opinionin për të gjitha zhvillimet që do të ndodhin gjatë këtyre bisedimeve, që janë duke u zhvilluar në Vjenë për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran.

Ju faleminderit.

**KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI** – Fjalën e ka deputeti Alush Gashi, kurse le të përgaditet deputetja Gjylnaze Sylja.



**DEPUTETI ALUSH GASHI** – Faleminderit z. kryesues, i nderuari z. president Sejdiu, të nderuar anëtarë të Delegacionit të Unitetit, znj. dhe z. deputetë.

Kemi kërkuar këtë debat duke u mbështetur në pikën 10 të Rezolutës së Kuvendit të Kosovës, të miratuar më 17 nëntor të vitit 2005. Më lejoni që në fillim ta rikonfirmojë mbështetjen e Grupit Parlamentar të LDK-së për të gjitha 10 pikat e kësaj rezolute. Znj. dhe z. shqetësimet janë legjitime, sepse në mes Kosovës dhe Serbisë gjendet gjenocidi që ka ndodhur këtu, andaj është edhe i gjithë ky angazhim i madh i bashkësisë ndërkombëtare në procesin e negociatave për të gjetur zgjidhje e cila do ta kënaqte lirinë dhe pavarësinë. Fatmirësisht shumica e qytetarëve të Kosovës, si dhe përfaqësuesit e saj janë të përcaktuar dhe të mandatuara nga Kuvendi për zgjidhje që do të na mundësojë një jetë në paqe të brendshme në Kosovën e pavarur, si dhe marrëdhënie të mira me fqinjët, që Kosova e pavarur të jetë faktor stabiliteti. Siç e dini Kosova ka hyrë në negociata, andaj më lejoni të përkujtoj se në negociata nuk e fiton atë që e meriton, por atë që e negocion. Nisur nga kjo kërkojmë që puna dhe debati të jenë në rrafshin real të mundësive tona, duke pasur parasysh fuqinë tonë politike, ekonomike dhe ushtarke të vendit tonë. Të gjitha këto tregojnë se në boën e sotme e në veçanti në rastin tonë, ne nuk e kemi vullnetin, por as nuk e kemi mundësinë e qëndrimeve tona ultimative, andaj duhet pasur kujdes, sepse atje nuk do të ndodhë vetëm ajo që ne dëshirojmë, është proces negociues.

Atë çka mund të bëjmë dhe çka fuqimisht kërkohet është të jemi seriozë dhe të bashkëpunojmë. Z. kryetar i Delegacionit të Unitetit, të vetmën gjë që e kërkojmë dhe mendojmë që është e mundshme të jetë një disiplinë e pjesëve që dalin nga ky grup i delegacionit dhe të gjithë të flasim në emër të vendit tonë, të jetë një disiplinë në këtë proces që të jetë deklarimi i tyre dhe veprimi i tyre publik në përputhje të plotë me vendimet që i merr Delegacioni i Unitetit.

Grupi Parlamentar i PDK-së është i përkushtuar për bashkëpunim intenziv me Delegacionin e Unitetit në të mirë të paqes, sovranitetit të vendit tonë. Mendoj se grupi i ynë e mbështet propozimin e dhënë nga PDK-ja. Ne mund të bëjmë eventualisht një pauzë apo ta rrumbullakësojmë këtë debat pasi që orë të fundit është një ripërsëritje, një retorikë e cila nuk mbështetet shumë në fakte. Ju faleminderit.

**KRYESUESI GAZMENT MUHAXHERI** – Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

**DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA** – Ju faleminderit z. kryesues, i nderuari z. president, z. Thaçi, z. Surroi, z. zëvendëskryeministër, ministra, deputetë të nderuar.

Në fjalimin tim në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së të premtën unë kam theksuar në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së mbështetjen për Delegacionin e Kosovës, megjithatë në punën e mëtejshme Grupi Parlamentar i AAK-së i propozon Kuvendit të Kosovës rekomandime në vijim që janë përfshirë në 5 pika.

1. Kuvendi i Kosovës merr rol më aktiv në procesin e mëtejshëm të negociatave për statusin final të Kosovës, duke u njoftuar me kohë nga Delegacioni i Kosovës me të gjitha dokumentet për statusin final të Kosovës dhe duke debatuar sa herë që është e nevojshme.

2. Delegacioni i Kosovës, Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës të organizojnë debate me qytetarët e Kosovës që t'i informojnë dhe t'ju shpjegojnë për procesin e negociatave.
3. Për çështjen më të ndjeshme në procesin e bërjes së shtetit të Kosovës, pozitën e komunitetit serb në shtetin e ardhshëm të Kosovës, Delegacioni i Kosovës të ofrojë dhe përkrah të gjitha zgjidhjet për komunitetin serb, si dhe për të gjitha komunitetet e tjera etnike të cilat nuk cenojnë bërjen, funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e shtetit të Kosovës dhe të stabilitetit në rajon.
4. Delegacioni i Kosovës të rishikojë disa nga zgjidhjet e ofruara deri më tani si çështja e Mitrovicës, krijimi i komunave etnike dhe zonat mbrojtëse të zgjeruara tejmase përreth objekteve fetare në pajtim me pikën e mësipërme.
5. Kuvendi i Kosovës mbështet Delegacionin e Kosovës, parimet udhëzuese të Grupit të Kontaktit për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe angazhohet që procesi të përfundojë në pajtim me vullnetin e shumicës brenda këtij viti.

Në fund edhe ne e mbështesim, ashtu siç kemi qenë pjesëmarrës të Rezolutës për rikonfirmimin e vullnetit politik të popullit të Kosovës për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran, gjithashtu i rekomandojmë Kuvendit që rekomandimet e përmendura nga Grupi Parlamentar i AAK-së të votohen për punën e mëtejme. Ju faleminderit.

**KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI** – Fjalën e ka deputetja Teuta Sahataqija, kurse le të përgaditet Xhezair Murati.

**DEPUTETJA TEUTA SAHATQIU** – Duke iu referuar kërkesave të shefave të grupeve parlamentare të LDK-së, AAK-së, të cilët edhe janë propozues të këtij debati, mendojmë që debati sidomos kohën e fundit ka qenë shpesh përsëritje, ka pasur debate të cilat më tepër kanë qenë patriotike, historike e të mos them poetike dhe pak ka pasur substanciale, të cilat do ta ndihmonin Grupin Negociator të Kosovës me propozimet konkrete, të cilat do ta udhëzonin Grupin në bisedime në Vjenë. Mendojmë që përkundër asaj që Ora është çdo herë për zgjatjen e debatit për aq sa ka nevojë, mendojmë që me këtë është shterrur kjo çështje dhe e përkrahim përmbylljen e këtij debati si grup parlamentar. Ne si grup parlamentar mendojmë që këto rekomandime do të duhej të merren nga Grupi Negociator dhe të gjitha delegacionet të cilat shkojnë në bisedime në Vjenë dhe përsëri si grup parlamentar ne e mbështesim Grupin Negociator dhe delegacionet dhe i përkrahim në vazhdimin e bisedimeve. Ju faleminderit.

**KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI** – Fjalën e ka deputeti Xhezair Murati.

**POSLANIK DŽEZAIR MURATI** – Poštovani predsjedavajući ja u ime Parlamentarne grupe 6+ navodim još jednom da čemo kao i do sada i u buduće principiëlno i suštinski podržavati Kosovsku pregovaračku ekipu ili tim, podržavamo donetu rezoluciju i u buduće zahtevamo da trebamo biti transparentni uz neophodne i blagovremeno informacije koje trebamo legitimno da dobijemo od pregovaračkog tima, a ne kako je to do sada bilo, zahtevamo stvarno podršku konsultativnog saveta ali i odluke koje budu na njemu donete a da na njemu donesemo određene odluke a kasnije da budu one izmenjene, takođe zahtjevamo da se uvažavaju odluke koje budu u buduće donošene na

konsultativnom savetu a posebno odluke konferencije u Solunu, gde su bili prisutni svi relevantni Kosovski faktori i medunarodni predstavnici, mi smo bili i otačemo konstruktivni u svom radu, ali uz našu legitimno i aktivno učesće, današnju odluku upravo donjeli jer je naš glas u posljednje vrijeme počeo manje da se čuje. Hvala.

KRYESUESI GAZMENT MUHAXHERI – Faleminderit, pasi që prej shefave të grupeve parlamentare kemi kërkesa.....

Fjalën e kërkon shefi i Grupit për Integrim, Ferid Agani.

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit z. kryesues. Grupi Parlamentar për Integrim mendon se kjo nuk është mënyrë e drejtë e përfundimit të këtij debati. Mendoj se debati duhet të vazhdojë dhe t'u jepet rasti të gjithë deputetëve të paraqitur që t'i shprehin mendimet e tyre pa marrë parasysh përmbajtjen dhe mënyrën si do ta bëjnë ata këtë. Mendoj se kjo mënyrë e përfundimit të seancës është vetëm në vazhden e politikës së deritanishme pasive që e përmenda në fjalën time. Pa inisiativa origjinale politike, thjesht një defetizëm që e dëgjuam edhe nga shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, i cili tha se qenkemi në proces të negociatave dhe se natyrisht nuk do të mund të fitojmë tërë atë që kemi pritur dhe që kemi kërkuar, mendoj se është në kundërshtim me Rezolutën e Kuvendit e cila statusin e pavarur dhe sovran të Kosovës e shpall të panegociushëm dhe mendoj se këtu është momenti kyç që ky debat duhet t'i vazhdojë më tutje dhe do të sqarohen gjërat. Propozimdeklarata e Grupit Parlamentar për Integrim ka qenë një ofertë, një rast që ky Kuvend të korrigjojë gabimet e bëra në procesin e kaluar njëvjeçar, lëshimet evidente si rezultat në radhë të parë, siç u dëshmuua edhe nga debati i një procesi jotransparent të Grupit të Unitetit, por edhe një rast që Kuvendi ta marrë përgjegjësinë e vet historike në të cilën u bazuan shumë deputetë gjatë këtij debati. Në këtë deklaratë kanë qenë të parapara 4 pika, të cilat unë mendoj se Kuvendi nuk ka asnjë arsye të mos i mbështesë dhe që janë plotësisht në pajtim me Rezolutën e Kuvendit për pavarësinë dhe rikonfirmimin e pavarësisë së Kosovës.

1. Kuvendi i Kosovës fuqimisht mbështet procesin e bisedimeve lidhur me përcaktimin e statusit politik të Kosovës, nën udhëheqjen e të dërguarit special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara presidentit Ahtisari.

2. Kuvendi i Kosovës konstaton se zgjidhjet e ofruara nga Grupi i Unitetit gjatë bisedimeve teknike në Vjenë mund të jenë të pranueshme për popullin e Kosovës dhe të zbatueshme në praktikë vetëm në situatën e sigurimit të përfaqësimit të Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara si shtet i pavarur me sovranitet të plotë dhe të drejta të barabarta edhe me shtetet e tjera anëtare të OKB-së, kjo nuk është kërkesë ultimative, kjo është plotësisht në pajtim me vullnetin politik të popullit të Kosovës për të cilën janë dhënë viktima, mijëra njerëz dhe është derdhur gjak.

3. Kuvendi i Kosovës shpreh gatishmërinë që të mbështes çdo lloj të mbikëqyrjes dhe të mbështetjes ndërkombëtare në këtë drejtim dhe

4. Kuvendi i Kosovës pret nga Grupi i Kontaktit dhe anëtarët e tjerë të Këshillit të Sigurimit përkrahje të plotë për qëndrimin e tij si tregues të interesit të përbashkët për të gjetur zgjidhje afatgjata dhe të balancuara që do të kënaq interesat politike të popullatës



shumicë në Kosovë dhe interesat e komuniteteve etnike dhe minoritare. Këto 4 pika mendoj se nuk janë fare të diskutueshme, se secili prej nesh do t'i mbështet dhe unë mendoj se do të paraqesin një impuls në procesin e ardhshëm politik në Kosovë.

Po e përfundoj duke kërkuar edhe një herë që debati lidhur me këtë çështje të vazhdojë dhe t'u japim mundësi të gjithë deputetëve që t'i shprehin mendimet e tyre. Ju faleminderit.

**KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI** – Ju faleminderit, pasi që kërkesat e shefave të grupeve parlamentare nuk janë në harmoni, kemi dy mundësi, njëra është të japim 15 minuta pauzë dhe pas tyre ju jepet mundësi shefave të grupeve parlamentare t'i harmonizojnë kërkesat e tyre. Nëse nuk pajtohen t'i harmonizojnë sipas rregullës 30 të mocioneve procedurale, jam i detyruar që mocionin procedural nga shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së dhe LDK-së ta hedh në votim.

Jap 15 minuta pause, në mënyrë që shefat e grupeve parlamentare me kryetarin e Kuvendit t'i harmonizojnë qëndrimet e tyre dhe pastaj e hedhim në votim propozimin.

#### **P a u z ë prej 15,00 deri në orën 15,15 minuta**

Vazhdimi i seancës pas pauzës.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Lus deputetët që t'i zënë vendet e tyre. Pa pretendime që t'ia marr të drejtën dikujt të flasë, kam një lutje të jemi pak më racionalë në diskutime, gjërat kanë filluar të përsëriten, pra, t'i japim mundësi që edhe Grupit të Unitetit ta marrë fjalën në fund, nëse pajtoheni të gjithë. Fjalën e ka deputeti Nexhat Rexha, kurse të përgatitet Safete Hadrgjonaj.

**DEPUTETI NEXHAT REXHA** – Faleminderit z. Kryetar, i nderuari president i Kosovës, kryeministër, Ekip i Unitetit, ministra dhe kolegë deputet. Shpërndarja e materialeve të datës 1 shtator 2006 jep mundësi që ne sot t'u qasemi më përsafërimi problemeve aktuale, mirëpo edhe më tej unë si deputet besoj se edhe një pjesë e kolegëve të mi jemi të hendikepuar me njohje paraprake të shumë çështjeve kyçe rreth decentralizimit, e sidomos për disa komuna nga vijmë ne si deputetë. Të gjitha materialet e shpërndara deri më sot nuk e kam pasur rastin të njoftohem me shkrim apo me gojë për zhvillimet e procesit të decentralizimit për komunën e Kamenicës apo Dardanës, nga vij unë. Kam lexuar në gazetën Ekspres të datës 1 shtator 2006 një plan për disa komuna e në mesin e tyre edhe për pjesën e komunës së Kamenicës ku do t'i merren 4 fshatra kryesisht serbe dhe t'i bashkëngjiten komunës ekzistuese të Novobërdës si dhe 9 fshatra të komunës së Gjilanit për të krijuar pastaj vija të reja strategjike për Serbinë. Sot këto që i kam lexuar në Ekspres i kam në materiale, d.m.th ai shkrim është më i hershëm. Po kështu shihet se paraprojekti shumë i dëmshëm me 14 lokalitete apo fshatra që do ta formojnë komunën e Ranillugut duke e njohur këtë hapësirë në të gjitha dimensionet ekzistuese, konsideroj se para projektplani është shumë statik dhe kjo nuk ka të bëjë as me pluralizëm, as me demokraci dhe as me krijim të stabilitetit dhe paqes në këtë komunë dhe në Kosovë e në rajon. Edhe ne vendorët dhe

ndërkombëtarët flasim dhe punojmë për demokraci, mirëpo me këto paraprojekte, siç është ky për këtë komunë nuk ka të bëjë asgjë me favorizimin e të ardhmes tonë. Pse në komunën e Kamenicës, komunë të re, kur dihet se pikërisht kjo komunë edhe ashtu e varfër pa ekonomi dhe kështu si është nuk mund t'u shërbejë qytetarëve të saj krahas standardeve lokale. Edhe një çështje tjetër që duhet përmendur se pikërisht banorët e kësaj komune, me shembullin e tyre praktik kanë dëshmuar më së miri tolerancën, mirëkuptimin dhe bashkëjetesën pikërisht ashtu siç kërkojnë standardet evropiane. Ndërsa hartën të cilën e kam para vetes sot dëshmon diçka tjetër sepse 4 fshatra kryesisht serbe duke filluar nga Domorovci, Korminjani i Poshtëm, Korminjani i Epërm, Ranilluku dhe Glllogovci kufizohen me Serbi dhe kjo më shton shumë dilema, prandaj e kam përshtypjen se edhe më tej politika serbe me gishtat e saj të ish-diktatorit Millosheviq dhe fundërrinave të mbetura nga elaboratet e tij famëkeqe, të cilat po gjejnë vend aty ku nuk duhet të kenë vend edhe sikur krijojnë përshtypjen si në një lojë të shahut, kur një person luan rolin e dy personave dhe figurat e shahut i vendos si dëshiron ai. Kështu vendbanimet marrin rolin e figurave të këtij shahu eksperimental. Po shihet se Kosova edhe kështu siç është në rrugë të mbarë drejt statusit final të saj për pavarësi, mbeturinat e të kaluarës po taktizojnë në mënyrën më të keqe për ta ngulfatur atë. Me këto variante dhe strategji nuk i ndihmohet të ardhmes sonë për një Kosovë të përbashkët e për të gjithë qytetarët e saj. Nëse lexohen me vëmendje materialet e shpërndara shumë lehtë mund të konstatojmë se qytetarët e Kosovës së bashku me institucionet e udhëhequra në këta 7 vjet nga ndërkombëtarët dhe vendorët shihet se këto kritere në përqindje më të madhe janë plotësuar. P.sh nëse me kujdes lexohen parimet themelore të reformës së pushtetit lokal në Kosovë të miratuara nga Delegacioni i Kosovës më 14 shkurt 2006 në Prishtinë, konstatojmë se në këtë dokument Kosova ka avancim evropian në aspektin politik, kurse i mbetet që të zhvillojë në të ardhmen pjesën ekonomike, pastaj korniza për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve në Kosovë paraqet fakte dhe argumente të bollshme për të ardhmen e të gjithë qytetarëve të saj, pra edhe për të drejtat e komuniteteve, p.sh kapitulli "C" të drejtat e posaçme, faqe 18 radhitja 9.3 citoj:

"E drejta për të themeluar dhe mbajtur kontakte të lira dhe paqësore përtej kufijve me persona të cilët kanë një identitet të përbashkët, etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar, apo trashëgimi të përbashkët kulturore, ligji i veçantë do të garantojë pjesëmarrjen efektive të përbashkët të personave që u përkasin komuniteteve në jetën kulturore". Nëse e bëjmë një krahasim qytetarët e komunave kryesisht me popullatë shqiptare në Serbi si Presheva, Bujanovci dhe Medvegja nuk i gëzojnë këto të drejta, kjo dëshmon shumë qartë dhe pasqyron për një demokraci më të avancuar në shtetin e Kosovës se sa në atë të Serbisë. Vështrim të vëmendshëm të jep e mund të kuptosh se edhe raporti i Këshillit konsultativ i komuniteteve drejtuar Kuvendit të Kosovës me 31 gusht 2006 nuk është shumë funksional, sepse pala serbe jo që nuk i ka përmbushur kriteret se është e gatshme t'i avancojë procesin përpara, por edhe më tej ajo e neglizhon çështjet tona të cilat edhe më tej i keqpërdor duke u munduar kështu ta verbojë edhe Bashkësinë Ndërkombëtare me kutet e saja të absurditetit me qëllim që çdo vonesë të shkojë në favorin e saj. Ndërsa Ekipit të Unitetit i duhet të ruaj dhe kultivojë edhe më tej të drejtën për stabilizim të mëtutjeshëm duke kërkuar nga të gjithë këtë zhvillim të vendit me të gjitha pikëpamjet si në atë ekonomik, kulturor dhe me qëllim të avancimit me teknologji bashkohore me kohën dhe për të gjithë qytetarët e saj. Pra konsideroj se Ekipi i Unitetit e ka marr besimin nga subjektet e veta politike, të cilin besoj se e ruan dhe ai unitet edhe më tej duhet të

reflektoj më shumë në praktikë dhe duhet të ketë shtrirje më të madhe të masave të gjëra popullore, sepse të gjithë jemi këtu për të ardhmen e përbashkët e përgjegjësitë peshohen sot e nesër në bazë të funksionit që bartin të gjithë, por askush nuk mund të mbetet pa përgjegjësi në zgjidhjet që mund e duhet të zgjidhen në këtë kohë për Kosovën. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Safete Hadraxonaj, kurse le të përgatitet deputeti Hydajet Hyseni.

**DEPUTETJA SAFETE HADRXHONAJ** – I nderuari z. kryetar, të nderuar deputetë. Kosova hyri në procesin e negociatave në kohën kur Qeveria aktuale e koalicionit me këtë qeverisjen e saj kishte arritur në shkallën më të lartë të korrupsionit, ku gati të gjithë treguesit makroekonomikë ishin në rënie që rrezikonin funksionimin e institucioneve, hyri në procesin e negociatave pa qartësim të orientimeve strategjike në politikën e jashtme dhe pa përgatitjen e duhur politike e teknike për negociatën. U formua Grupi Negociator shpejt e shpejt nga kryetari i atëhershëm pa konsultimet paraprake. U mor vendimi në Parlament pa konsensus, duke u treguar forca vendimmarrëse e koalicionit qeverisës, pa e ditur se çfarë do të negociojë ky grup. U bënë kalkulime politike duke harruar se çështja e statusit politik të Kosovës është çështje e vendimeve historike të deputetëve të zgjedhur nga populli, të cilët duhet të marrin vendime të rëndësishme dhe jo të jetë një çështje e spektakleve ceremoniale. Kur një proces fillon keq, pa dëshmi se është e logjikshme të vazhdojë keq. Dua t'ia kujtoj koalicionit qeverisës se në pikën e dytë të rendit të ditës në seancën e datës 28 shtator 2005 që kishte të bënte me miratimin e deklaratës së kryetarit të Kosovës lidhur me ekipin për bisedime eventuale për statusin përfundimtar të Kosovës, kryetari i atëhershëm i Parlamentit e përmbylli kështu: "Nuk ka mundësi për debat asnjë sekond, ju lutem mos ja ulni vlerën seancës shumica janë për. E bëjmë një pauzë 20 minutëshe" se kush ishte për e kush kundër nuk ishte me rëndësi, pozita vetë vendosi e vet vulosi, në vend të një vendimi demokratik konsensual në mënyrën më autarkike, pa votën e opozitës vendosi për formimin e Ekipit Negociator u shkel rregulla e 12 e Rregullores së punës së Kuvendit, ju mor e drejta për të debatuar deputetëve, sepse debati për çështje kaq madhore gjëja se ia ulte vlerën seancës. Askush nga pozita nuk reagoi, askush nuk kërkoi të debatohej pse po formohet ky grup, për çfarë do të diskutohet, cila është platforma e bisedimeve, cila është taktika dhe strategjia e veprimt?

Ne nuk u pajtuam me një vendim që u mor keq, sepse ishim të bindur se përgjegjësia historike e Grupit Negociator ishte e jashtëzakonshme. Grupi po merrte mbi vete përgjegjësinë për të drejtuar një mision, për të përmbushur një synim, për të arritur një objektivë madhore për popullin e Kosovës për të cilin ka sakrifikuar për më shumë se një shekull, sakrificë të cilën e ka paguar edhe me humbje njerëzore edhe me humbje materiale. Me gjithë mospajtimet tona Partia Demokratike e Kosovës mori vendimin pragmatik për të qenë pjesë aktive e procesit politik për Kosovën shtet të pavarur e sovran dhe jo pengues të procesit, por më parë kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës inicioi nxjerrjen e Rezolutës për rikonfirmimin e vullnetit politik të popullit të Kosovës, për shtet të pavarur dhe sovran, që u miratua me konsensus në Parlament pas 45 ditë pune, të bindur se e drejta e qytetarëve për shtet të pavarur dhe sovran nuk duhet t'u lihej në dorë 5 liderëve politikë të cilët në momente të caktuara, ndonjëri edhe mund të



lakohej. Diskutimet e koalicionit qeverisës duken pak sa imituese, tani kur po i afrohem fundit të negociatave. Të flasësh e t'ua bësh mjegull qytetarëve për tërë procesin është e lehtë, por nuk duhet të jetë e vështirë të pranohet përgjegjësia për dështimet, për veprimet dhe vendimet e marra, kritikohet decentralizimi nga koalicioni qeverisës, kurse vetë koalicioni është nismëtar apo projektues i decentralizimit në baza etnike. Ju kujtohet projekti për formimin e 5 komunave të cilat kishin kryesisht përbërje etnike. Në seancën për decentralizim koalicioni qeverisës nuk ka pranuar të marrë vendime dhe nuk ka pranuar që konkluzionet në lidhje me decentralizimin të hyjnë në votim.

Të nderuar deputetë është shqetësuese, pse Ekipi Negociator punoi pa rregullore të punës dhe nuk pati transparencë për shfrytëzimin e mjeteve nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, pse Grupi i ashtuquajtur i Unitetit nuk ishte sa duhet aktiv i hapur, bashkëpunues, nuk kishte transparencën e duhur as ndaj Kuvendit as ndaj qytetarit, qoftë për të ashtuquajturin decentralizim që në fakt nuk është decentralizim, qoftë për krijimin e zonave mbrojtëse afër manastireve, sidomos në komunën e Deçanit, ku shumë pronarë po privohen nga trojet e tyre pa u pyetur për kthimin e minoriteteve apo për çështje ekonomike dhe pronësore. Pse Grupi i Unitetit e stërngarkoi me shumë detyra kryetarin e grupit politik, strategjik për decentralizim i cili nuk e kishte përgatitjen e duhur profesionale dhe përvojën negociuese, për pasojë plani për decentralizim i të cilit po i kushton Kosovës në legalizimin e enklavave serebe. Pse Grupi i Unitetit nuk arriti të punojë si një ekip ku anëtarët e tij të përfaqësojnë më shumë interesat e ekipit se sa të institucioneve nga vijnë, pse nuk mundi t'i shmanget abuzimit partiak kur kur u shfaq individualizim, apo më mirë të them liderizmi.

Të nderuar deputetë meqenëse për më gjëra është bërë vonë, është e domosdoshme ë së pari Grupi Negociator të ketë adresën e përgjegjësive, së dyti të respektohet rezoluta e Kuvendit të Kosovës që çdo vendim për të ardhmen e Kosovës të ratifikohet në Kuvend apo nëpërmjet referendumit, të përkrahet kërkesa e kryetarit të grupit parlamentar të PD të Kosovës që Grupi Negociues t'i ketë parasysh 7 kërkesat e parashtruara nga ky grup që garantojnë shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës në tërësinë territoriale të saj. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Deputeti Bajram Kosumi ka replikë.

**DEPUTETI BAJRAM KOSUMI** – Faleminderit kryetar, meqenëse disa herë, u theksua i decentralizimit në lidhje me Qeverinë dhe për -komunat atëherë detyrimisht kërkoi të zgjidhej çështja.

Në Kosovë ka pasur dhe janë dy koncepte për decentralizimin: koncepti i parë është i Qeverisë, i illuar nga Qeveria Rexhepi i vazhduar nga Qeveria Haradinaj dhe Qeverinë që e kam udhëhequr unë me disa ndryshime të vogla, sipas këtij koncepti çështja e decentralizimit është pjesë e reformës së pushtetit lokal dhe është detyrë e Qeverisë dhe e Kuvendit të Kosovës dhe baza e këtij decentralizimi ka qenë decentralizimi i pushtetit nga Qeveria qendrore te komunale, fatkeqësisht 2-3 muaj para fillimit të bisedave për statusin final të Kosovës, disa politikanë dhe një pjesë e opozitës doli me qëndrime se Qeveria duhet të heqë dorë nga decentralizimi dhe decentralizimi të bartej si temë kryesore e negociatave për statusin final të Kosovës dhe ky koncept fitoi dhe shkoi puna

si ka shkuar dhe decentralizimi tash ka përfunduar gati se në baza të një decentralizimi të territoreve dhe decentralizimi etnik. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni – Kaloshi, kurse të përgatitet deputeti Ymer Halimi.

**DEPUTETI HYDAJET HYSENI-KALOSHI** – Faleminderit z. kryetar znj. dhe z. Deputetë, më lejoni kësaj radhe që në mënyrë të veçantë t'i përhëndes anëtarët e Grupit të Unitetit. Më pëlqen uniteti, na duhet uniteti, por dua ta theksoj se uniteti na duhet për të ecur përpara, për të shtyrë qerren përpara dhe jo tatëpjetë, kurse debati i sotëm mendoj se do duhej kuptuar si një karton i verdhë ose të them ndryshe portokalli, do të ishte mirë që të mos bëhet i kuq, ne e shtymë debatin me kërkesë që të kemi materiale të nevojshme. I kemi disa, por disa u detyruam t'i marrim nga mediat, le të jetë një vërejtje, me gjithë atë procesi duhet të mbetet në institucione. Edhe ky debat na ka vënë në mes dy alternativave, të flasim me logjikën okej, okej, lepe-peqe dhe anasjelltas, pastaj lavdrata, komplimente, janë fliksibël, kooperues, do të sillte edhe do poena politikë, ndoshta edhe diçka tjetër. Dhe alternativa tjetër të flasim drejt, parimisht me përgjegjësi dhe kjo do të na bënte të rrezikojmë edhe të anatemohemi se jemi radikalë, ekstremistë, frigidë etj. etj. Megjithatë për të hequr çdo keqkuptim unë dua të them si grupi parlamentar në të cilin bëj pjesë. Kam qenë dhe mbetem për paqe, për pajtim, për normalizim të raporteve ndëretnike, ndërshtetërore, por megjithë atë nuk mund të jam në dakord me procesin kështu si po rrjedh që për mendimin tim nuk është as dialog as normalizim, as afrim e pajtim, as ndëretnik dhe as ndërshtetëror. Jam në parim për reforma të pushtetit lokal e madje edhe për decentralizim të vërtetë, por jam kundër këtij pseudo-centralizimi që po imponohet, jam për mbrojtje të monumenteve fetare, kulturore të të gjithëve pa dallim, por jam kundër abuzimit të këtyre, kundër shndërrimit të tyre në monumente politike e politizuese ekskluzivisht etnike, madje edhe më shumë se sa ajo që bëhet ndonjëherë në Beograd, jam sepse jam i bindur se kjo është kontraproduktive se kështu nuk mbrohet as toleranca as bashkëjetesa dhe as trashëgimia kulturore. Ju e dini znj dhe z. meselenë e gozhdës së Nasradinit, e kërkonte thonë fillimisht vetëm një gozhdë në murin e odës që pretendonte, fillimisht sa për të varur festën, pastaj trastën, pastaj pushkën e më vonë edhe për t'u thanë të tjerëve bujrun në odën time. Znj. dhe z. me dashje dhe pa dashje ne kemi lejuar një mozaik të tërë gozhdash të Nasradinit në hartën e Kosovës tonë aq sa do të mund harta jonë të konkurronte edhe në atë të artistit shqiptar që po konkurron për librin e Ginisit. Megjithatë nëse ju kujtohet në debatin e mëparshëm unë nuk kam diskutuar, s'kam dhënë vlerësime, kam bërë pyetje, nuk kam marrë përgjigje, megjithatë do të dëshiroja edhe me këtë rast të shtroj disa pyetje. Në agjendë ne sot kemi procesin e negociatave për statusin e Kosovës, pyetja ime është: "A janë negociata a çka janë këto që po ndodhin në Vjenë". Negociatat janë tregtim, pazar çdo fjalor kështu e thotë, atëherë çka po tregtojmë ne në Vjenë, çka apo shesim e çka po blejmë, çka fituam, çka u bë me të pagjeturit, me gjenocidin, me dëmet e luftës, plaçkitjet, deponimet e depërtimet, pensionet etj. Përshtypja është se ne në këtë proces kryesisht po falim, po japim të gatshmen për veresi. Nëse kjo është e vërtetë shtrohet pyetja: "A ka kush të drejtë të falë sa po fal e çka po fal", mund të falet diçka nga e kaluara, por a mund të falet e ardhmja?. Ky Kuvend e ka mandatar Ekipin e Unitetit për të biseduar për çështje teknike. Për sa i përket të ardhmes së pavarur ajo ka qenë shprehimisht dhe energjikisht kundër çdofarë

lloj pazaresh. Ky ka qenë edhe qëndrim i të gjitha forcave relevante politike, për çka po negociohet tash në Vjenë, për çështje teknike apo për statusin, në agjendë e kemi statusin, herë shitet çështjes teknike si çështje për statusin e herë kjo e fundit si mbulesë për çështje teknike. Të ambalazhohen çështjet politike si çështje teknike dhe ato pastaj të na servilen të mbështjellura me pak gazetë pavarësie. Kjo është jo vetëm e papranueshme, por konsideroj se mund të jetë edhe e rrezikshme. Pyetja tjetër: "Negociata me kë" herë thuhet me Serbinë, herë me serbët e herë me bashkësinë ndërkombëtare, nëse janë me bashkësinë ndërkombëtare, pse është përballë Serbia, nëse ajo është si pjesë e bashkësisë ndërkombëtare pse nuk është Shqipëria dhe pse nuk janë vendet e tjera, nëse janë negociata të Prishtinës me Beogradin, pse kolegët tanë ulen përballë Prishtinës, përballë nesh dhe pse Ekipi ynë pranon këtë si paradoks tejet absurd tejet pa precedent. Nëse janë negociata shqiptaro-serbe që do të ishte një absurd i llojit të vet, pra mbi baza etnike pse nuk janë aty shqiptarët e Preshevës, Bujanovcit, Medvegjes, pse nuk janë në tavolinë problemet dhe kërkesat e tyre, standardet nuk njohin dy kute, nuk maten me dy kute. Pyetja tjetër: "Negociatat si" cili është pozicioni negociues dhe cilat janë variantet rezervë, cila është përgjigja në përpjekjet sistematike jo gjithmonë pa sukses për të paraqitur pavarësinë si opSION maksimalisht e licitues dhe për të kërkuar sërish. E keni dëgjuar Esat Toptan të ri midis shqiptarëve, a është pavarësia zgjidhja më e mirë për shqiptarët, siç po thuhet, a është ajo e vetmja zgjidhje e vërtetë, a ka zgjidhje edhe më të mira për shqiptarët dhe pse nuk e themi? Pse nuk i nxjerrim edhe në tavolinë siç bëri profesori. Të gjitha partitë relevante e kanë në programin e tyre vetëvendosjen dhe aspiratën historike shqiptare për liri të plotë dhe bashkim kombëtar. Pse e fshchin këtë, pse nuk e trajtojmë me plotë gojën pavarësinë si zgjidhje kompromisi si zgjidhje minimaliste si zgjidhje të palicitueshme, të panegociueshme, kontestimi i së cilës nuk qon në zgjidhje edhe më të reduktuara, por çon në zgjidhje më të avancuara.

U tha këtu se Ekipi ynë synon afrimin e qëndrimeve me UNOSEKUN, ekipin e Ahtisarit, kjo ma kujton atë taktikën e Çaplinit me arbitrin në ndeshjen e boksit, arbitri znj. dhe z është ndërmjetësuesi, arbitri nuk shënon golë. A ka ndodhur ndonjëherë që duke u identifikuar me Ahtisarin dhe ndërmjetësuesit e tjerë që vejmë ata në pozitë të vështirë dhe t'i detyrojmë që ta ulin edhe më shumë pazarin duke kërkuar zgjidhje kompromisi midis kompromisit tonë dhe zgjidhjeve ekstreme dhe sidomos ajo që po ndodh me decentralizimin shtron shumë pyetje. A është çështje teknike apo statusore, çka është thënë në fillim për decentralizimin dhe çka po thuhet tash, reforma e pushtetit lokal, jo decentralizim, jo decentralizim etnik, jo komuna etnike bile jo fare komuna të reja, por njësi nënkomunale dhe ato jo etnike. Reformë e pushtetit lokal thuhej për t'u ofruar shërbimeve qytetarëve, sot u shtrua pyetja: "A afrohen qytetarët që janë paralagje e Gjilanit duke i qar 20 kilometra larg pas 7 malesh dhe nuk është fjala vetëm për Stanishorin serb, por është fjala edhe për Stanishorin shqiptar aty, as nuk ndihmohen serbët dhe pamundësohen dhe bllokohen shqiptarët. Është thënë se janë arsye praktike, por jo politike etnike, por tash vetëm në Anamoravë 3 komuna e gjysmë të reja etnike. Pse pikërisht në Anamoravë, se ministri është i asaj ane dhe është ashtu siç është, ai është kumbarë i tri komunave për mendimin tim jo vetëm pa perspektivë, por edhe me sherr, por unë pyes çka po ndodh me mos ndryshimin e kufijve si parim që është edhe kushtetues, pse po përdoren ato harta që po përdoren, pse në to mungojnë lokalitete shqiptare dhe pse fryhen harta serbe. Nëse duhet të bëhen komuna të reja, pse nuk mund të bëhet komunë Hogoshti, Rogana, Koretini, Pograxha, Zhegra ose ta zëmë Konçuli,



Dóbrocini me të njëjtin këtë me të njëjtin standard, cili është kriteri, cila është përgjigjja. Anamorava këtu u tha se e kishte një model pozitiv. Si legjitimohet decentralizimi duke e legjitimuar centralizmin me Beogradin siç po ndodh në shumë fusha dhe duke legjitimuar etnicizimin edhe të gjyqësisë, policisë dhe të tjera që për fat të keq po ndodh. Kam për fund vetëm një lutje. Ju na keni bindur vazhdimisht se keni fituar vazhdimisht dhe sa herë që ju keni fituar, Kosovës i është shtrënguar laku. Kam një lutje. Fitoni më pak ju lutem, fitoni më pak lavdërata që të mund të jemi ne pak më të lirë dhe i lini pak hapësirë edhe Beogradit le të fitojë me atë strategjinë e ofertës agresive, po edhe nëse nuk është shumë agresive le të bëjnë ata pak lëshime dhe le të fitojnë lavdërata dhe poena politike dhe të tjera. Mendoj se do të ishte në të mirën e procesit. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Z. Hyseni, unë e kam një pyetje për juve. Një kohë kemi qenë së bashku në Komision Legjislativ, ju kryetar ku jeni edhe tash, kurse unë nënkryetar juaj. Kishim një rast miratimit e listës së gjykatësve. Ju e dhatë pëlqimin, ose pse e dhatë pëlqimin për kandidatin për të cilin flitej se 8 mijë punëtorë i ka larguar nga puna. Vazhdojmë me diskutimet e tjera. Fjalën e ka Hydajet Hyseni.

**DEPUTETI HYDAJETE HYSENI** – S'mund t'ju falënderoj z. kryetar për mundësinë që po ma jepni për ta marrë fjalën përsëri, sepse nuk është koha tash për fjalë të tepërta, megjithatë unë përgjigjen e kam bërë publike për këtë Kuvend nuk kam çka i shtoj, jam i gatshëm që për këtë çështje dhe për çdo çështje tjetër të pranoj, bile do të kërkoja debat publik në cilëndo nga mediat të shkruara ose elektronike dhe do të kishim hapësirë e kohë për t'i elaboruar në hollësi, do t'i isha falënderuar shumë secilit që ma ofron këtë kënaqësi.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ymer Halimi, kurse le të përgatitet Hajredin Hyseni.

**DEPUTETI YMER HALIMI** – Faleminderit z. Kryetar, përshëndetje për të gjithë të pranishmit.

Me që bota demokratike ishte përkrah luftës për liri të popullit shumicë të Kosovës, prezenca e saj sot këtu, si edhe zhvillimi i bisedimeve në Vjenë për 'çështja teknike' të Kosovës, janë fakte notare se do të hiqet kolonia e fundit në Evropë.

Kjo është një arritje e demokracisë dhe veçmas e popullit të Kosovës.

Pa hyrë në analizën se si u ulëm për bisedime në Vjenë, si raportoi Grupi i Unitetit dhe disa anëtarë të delegacionit në Kuvend. Me këndë bisedohet e si bisedohet. Dhe sa ishte e sa është transparent Grupi i Unitetit në këtë Kuvend.

Unë do flas kryesisht mbi bazën e materialeve të Këshillit të Komuniteteve, dhe materialit për decentralizim, përkatësisht Reformimin e Pushtetit Lokal.

Nga këto dy materiale kuptohet saktë kahu i lëvizjes së proceseve për statusin e Kosovës, dhe në një masë, shihet silueta e vendimit përfundimtar- struktura e shtetit.

Unë do të flas për dis "cikrrime", që besoj flasin për tërsinë.

Në fjalorin politik, ka lind një term i ri 'diskriminim pozitiv'. Thënë saktë, kjo qëndron kështu, kur Komunitetet i fitojnë disa avantazhe që nuk ua njohin as konventat Evropiane e ndërkombëtare, por u janë dhënë te ne, dhe shumica nuk i ndjen efektet negativ te këtyre avantazheve. Kjo është domethënëse për kujdesin e shumicës ndaj Komuniteteve.

Konkretisht Komunitet (pakicat) duhet ti kanë vendet në Kuvend komfor vendeve te përparuara Evropjane. Kuvendi nuk duhet të këtë votë asimetrike.

Të jetë e çart, ky 'diskriminim pozitiv' në mënyrë implicite, popullatën shumicën në Kosovë e akuzon, për diçka. Pse?

Më pastaj, 'zonat e sigurisë', për rreth Manastireve Ortodokse serbe, janë paradoksale në botë. Thënë sinqerisht, të bëjnë të habitësh. Habisin edhe përshkrimet juridike-menaxhuese të këtyre hapësirave dhe parashikimet për to.

Kisha thënë, për ata që i menduan dhe aprovuan këto zona, fjalën e Krishtit: "O zot falu mëkatet..."

Ju lutem, 1100 të vërteta janë, që ato zona si te tilla të mos ekzistojnë, e një gjysmë e vërtetë i pohon.

Ne me shekuj i ruajtëm!? I ruajtëm - edhe atëherë kur serbet i lan vetëm.

Objektet e Kultit Ortodoks serb, do të janë të sigurta aq sa ka siguri vetë Kosova.

Për këto zona mbrojtëse nuk ekziston shkasi.  
Por, për këto zona është qellim.

Në politikë nuk hynë veprimet e mëdha në porta të hapura, por për vrima dere.

Deputet te nderuar,

Nga Materiali për Reformimin e Pushtetit Lokal i dorëzuar nga Ministri Haziri, shihet në mënyrë eksplicite, se si pala Kosovare e humbë ekuilibrin psikik dhe rrëshqet në planin e bisedimeve, prej hapi në hap.

Kjo është një përshtatje e tepruar. Ndoshta dikujt i nevojitet për mbijetesë politike. Shumë gjëra që ministri Haziri i ekspozoi më para do të pësojnë ndryshime rrënjësore. Do të bindeni.

Kjo është shqetësuese, por momenti nuk është për panik.

Pjesa e materialit "për decentralizim" që Delegacioni i Kosovës e dorëzon më 20 Shkurt 2006 në Vjen, në procese të më vonshme, pëson aq metamorfozë, ashtu si procesi biologjik kur krimbi arrin të shëndrrohet në krijesë tjetër.

Në faqen e 2-të të këtij Dokumenti të "Parimet themelore" te pika 1.4. shkruan: "Reforma e pushtetit lokal do të respektojë karakterin shumë-etnik të shoqërisë Kosovare. Ky karakter do të reflektoj në mënyrë të duhur, në nivelin komunal nëpërmjet ekzistencës dhe formimit të njërive shumë-etnike të qeverisjes lokale".

Çka ndodhë te Dokumenti i 29 Gusht 2006 i Grupit punues të delegacioni!? Pranon të formohen Komuna te reja mbi bazën e etnik 100% Serbe, e nuk e përfshin asnjë fshat me popullatë shqiptare dhe pse pozicioni gjeografik e imponon, por edhe anasjelltas. Te Komunat me shumicë shqiptare mundësisht nuk len asnjë fshat serb. A nuk u shkel parimi themelor që e promovoj Grupi politik? A nuk është ky segregacion etnik territoriale.

Kryesorja, për ironi, rreth 90% e serbëve grupohen ne territore te caktuar në një anë e ne anën tjetër po ashtu edhe shqiptaret. Ky është lternjohtimi i Kosoves nesër, dashtem nuk dashtem.

Nuk matet interesi i Kosoves mbi atë vlerë që folen ministrat më parë. Ishte irituase.

Sa i përket kompetencave unë po e marr vetëm një shembull që i deshifron disa rrafshve vepruese politike e juridike në planin e decentralizimit.

Psh. "Parimet e decentralizimit". Pjesa A dhe E. Sqarim teksti: "Paraqet mirëkuptimin e Prishtinës mbi projekt marrëveshjen e Statusit/ Decentralizimit në mes të UNOSEK-ut dhe Prishtinës, siç është diskutuar me 23 e deri më 25 Gusht 2006".

Pika 9. Paragrafi (e) shkruan: "Në pajtim me legjislacionin kornizë të Kosovës, komuna me shumicë serbe e Mitrovicës së Veriut do to jetë përgjegjëse për Universitetin publik serb" A nuk e demanton kjo Ministrin Haziri.

A nuk e deshifron kjo tërësinë e qëllimit përfundimtar (!?).

Vetëm miopet nuk e shohin.

Prandaj, të më lejoni që të shprehë mendimin, që duket si në digresion nga ky debat, por megjithatë konvergjon saktë.

**E gjithë përmbajtja e këtyre materialeve shpreh: "një pavarësi po, por të defaktorizuar, një pavarësi po, por mbi segregacion etnik". (E stornuar)**

Dhe ta kemi të çartë, pavarësia nuk është kuptime abstrakt. Është vlerë që matet me parametra në mënyrë të saktë. Aç sa më pak kemi nevojë për të tjerët, aç sa më pak kemi presion nga të tjerët dhe aç sa më pak bëjmë presione mbi të tjerët, aç sa më shumë e zbatojmë ligjin dhe e luftojmë krimin, aç sa më të afte jemi ta mbrojmë vetë, aç sa më funksionale janë tërësitë tona të brendshme, aç më të pavarur jemi si individ dhe shtet.

Këta parametra a i fuqizuan në këto shtatë vite. Si do të funksionoj Kosova nesër. Askush nuk e ka të çartë, sepse sa duket tepër jemi te transformuashem ?!

**Deputetë të nderuar**, veprimet e transformojnë botën e jo llafet. Kështu mësohet në filozofi, nese nuk e keni haruar. Tash të tjerët veprojnë, kur ne nuk vepruam mençur.

Grupi Politik duhet mbështet në arritjen sigurimit që Kosova ta ketë pavarësinë e plotë në të gjitha rrafshet.

Lëshimet te decentralizimi nuk justifikon më me asgjë tjetër.

Popujt kurrë nuk lodhur në luftë për liri.



Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Hajredin Hyseni, le të përgatitet deputeti Ramadan Musliu.

DEPUTETI HAJREDIN HYSENI – Ju faleminderit z. kryetar, anëtarë të Grupit Negociator, ministra dhe deputetë të pranishëm,

Kosova në rrugën e vet për liri dhe pavarësi ka pasur sfida të shumta, të cilat shpesh i ka kaluar me sukses, por ka ndodhur edhe shpesh ka humbur hapin për të vepruar në kohë, që të realizojë synimet e saj dhe këto synime janë shtyrë për një kohë tjetër. Sukseset e saj në rrugën e lirisë kanë qenë evidente sa herë që udhëheqja e sajë politike ka ditur të artikulonte dhe kanalizonte vullnetin qytetar, ndërsa dështimet dhe vonesat në këtë rrugë kanë qenë çdoherë kur udhëheqja e saj nuk ka dëgjuar zërin qytetar ka nënvlerësuar këtë zë dhe është dashur që vërtet të vijmë njerëz të tjerë për të artikuluar drejtë këtë vullnet, për ta sjell deri në këtë fazë Kosovën, në një gjendje ku forcat politike po të ishin më të angazhuara dhe serioze do të mund ta materializonin vullnetin qytetar dhe ky proces do të duhej të ishte tani i mbyllur. Zonja dhe zotërinj procesi i definimit të statusit politik të Kosovës u imponua përmes një dialogu që po vazhdon në mes Kosovës dhe Serbisë, një dialog i cili do të duhej të ishte dhe të zhvillohej për njohjen e Kosovës shtet të pavarur, nga ana e Serbisë. Për këtë do të duhej të bisedojë me Beogradin e jo për organizimin e brendshëm të Kosovës. Mandati i Delegacionit të Kosovës është realizimi i vullnetit të qytetarëve për shtetin e Kosovës me një rezolutë të miratuar edhe nga ky Parlament, Delegacioni i Kosovës për veprimet e veta duhej të ishte transparentë jo vetëm para Parlamentit por edhe para qytetarëve.

Parlamenti s' do të duhej të ishte vendi ku vihet dhe informohet, por vend vendimmarrës për çdo vendim të rëndësishëm, vendi ku dokumentet e Delegacionit do të merrnin dritën e gjelbër për t'u prezantuar edhe në Vjenë edhe ku do tjetër.

Zonja dhe zotërinj deputetë. Kjo nuk ndodh, krijohen komuna, shtohen komuna, prekët në substancën e funksionimit të shtetit dhe në Parlamentin e Kosovës, jo që s'e pyet kush as që e informon kush. Fatkeqësisht procesi negociator në Kosovë është i mbyllur jo vetëm për qytetarët, por edhe për vetë këtë Parlament, a do të duhej të ishte kështu, mendoj se jo. Ky Parlament duhej ta marrë përgjegjësinë që e takon që ia kanë dhënë qytetarëve, të rikujtojmë se ky Parlament ka theksuar dhe ritheksuar se në Kosovë nuk do të lejohet ndarje në vija etnike. Shikoni procesin e ashtuquajtur të decentralizimit ,formohen komuna etnike, 24% të territorit të Kosovës dhe unë pyes z. Lutfi Haziri i cili është në krye të këtij procesi si do të funksionon shteti i Kosovës pa pushtetin në këto komuna monoetnike, a kanë kërkuar që të njëjtën gjë ta kenë shqiptarët në Preshevë, Medvegjës e Bujanocit , të vlejné parimet e njëjta dhe mos të lihet kjo në mëshirën pushtetit serbë se mëshira e tyre është e njohur se ende kullojnë plagët me mija të pagjetur të ndodhur në Serbi të cilët nuk na i kthejnë duke manipuluar politikisht.

Dhe për të cilët edhe Delegacioni do të duhej të ngrinte zërin më fuqishëm e të bëjë pjesë agjendës së tyre në këto bisedime. Suksesi i Delegacionit të Kosovës nuk duhet të më tej

me fjalët miradije si i tllotë ndonjë diplomatë në fluturimet e tyre, por me krijimin e mundësive dhe funksionimit të shtetit të Kosovës. Delegacioni ka vetëm këtë mandat edhe për këtë vlerësimin duhet ta japin vetë qytetarët e Kosovës. Dua t'ju përkujtojë se ky Parlament ka diskutuar për decentralizimin dhe ka qenë kundër ndarjes në vija etnike, dua t'ju përkujtojë se ky parlament ka aprovuar një rezolutë të nisur nga PDK-ja me çka janë pajtuar të gjitha grupet parlamentare që i jep mandat Grupit Negociator ta realizojë pavarësinë e Kosovës. Dua t'ju përkujtojë që kjo rezolutë kërkon që dokumentet të aprovohen në Parlament dhe kjo duhet të respektohet. Këtë duhet bërë edhe për decentralizimin e jo të luhet nga njerëz që janë arkitektë të decentralizimit me opinionin kjo është e pa falshme dhe më shumë se hipokrizi, dua të kuptojmë se vendimet dhe hapat që marrim në sot përcaktojnë të ardhmen e Kosovës, për këtë duhet të jemi të vetëdijshëm dhe mos të luhet për përfitime politike, përfitimi i vetëm duhet të jetë Kosova e pa varur të nderuar deputetë.

Zonja dhe zotërinj, duke dëgjuar debatin në Parlament del se të gjithë jemi kundër decentralizimit, në qoftë se nuk janë hipokrizi këto që thuhet këtu atëherë pse të vazhdohet me tutje në këtë, pse dikush të vendos pa legjitimitetin tonë, kur Kuvendi është ai që duhet të vendos mbi çdo ndryshim të rregullimit dhe të funksionimit të shtetit dhe kjo është obligim që duhet të respektohet çdo përfaqësues që fletë në emër të Kosovës. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** - Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Ramadan Musliu, le të përgatitet Bajrush Xhemali.

**DEPUTETI RAMADAN MUSLIU** - I nderuar ekip i Unitetit me në krye presidentin Sejdiu, të nderuar deputetë dhe i nderuar ministër.

Ka 7 vjet që ka filluar një proces politik, i cili shpie nga zgjidhja e statusit final të Kosovës. Prej fillimit është thanë se do të ballafaqohemi me një kompromis, ai kompromis është në horizont, sa më shumë që ofrohet kompromisi na ndjehemi si them, jemi në një situatë të pakëndshme dhe ajo era e kompromisit na e zë frymën, zëri i protestës është gjithnjë më i fuqishëm, Në njërën anë e kemi palën shqiptare të cilës i është bërë një pa-drejtësi historike, nuk i është një kompensim moral i gjithë për ato dëme edhe gjatë luftës edhe për para mund të bëjmë ankesa të ndryshme edhe te institucionet që kanë qenë nën kontroll të UNMIK-ut e kryesisht të UNMIK-ut, se drejtësia nuk është vënë në vend se nuk është marrë me hetimin dhe gjykimin e krimeve, se nuk është gjykuar rasti i Dubravës se ekziston problemi i të pakthyerve, krahas problemeve të tjera që ekzistojnë problemet e rënda sociale dhe ekonomike etj.

Në anën tjetër është popullata pakicë të cilës po i bënë koncesioni ndoshta për logjikën tonë të pa kuptueshme, është një popullatë, e cila është në një pozicion të tillë të reagimit për shkak se ka një edukacion jo vetëm nacionalist, por shovinist të skajshëm, të cilin edukacion e ka bërë inteligjencia në radhë të parë. Ka literaturë dhe projekte të ndryshme gjenocidale e tjera. Si palë tjetër është pala ndërkombëtare e nga e cila na kërkojmë që ta sjellë drejtësinë në vend që të realizojë aspiratat tona historike që të bëjë një

kompensim të dëmit tonë edhe moral, edhe material ,edhe gjitha dëmeve jo vetëm historike po të viteve të fundit.

Mirëpo, në anën tjetër ekzistojnë disa parime me të cilat funksionon politika ndërkombëtare, sidomos në Evropë ekziston parimi real i politikës e cila nuk merret me kompensime të dëmeve morale. Prej ardhjes së UNMIK-ut edhe KFOR-it këtu prej ndërhyrjes ndërkombëtare d.m.th. që 7 vjet dihen cilat kanë qenë kërkesat e palës ndërkombëtare. Në anën tjetër nuk është lehtë të hyhet në agjentët ndërkombëtare si një popull i vogël, si një territor i vogël, me kapacitete dhe potenciale shumë të vogla, mirëpo deshi zoti dhe fati historik që të jemi në atë agjendë historike dhe duhet normalisht të japim gjithçka që ta shfrytëzojmë dhe që të zgjidhet problemi i Kosovës. Siç thashë pot ë ishte reale politika evropiane merret me të kaluarën me kompensimin e histories. me zgjidhjen e problemeve morale po merret me realitetin që ekziston, krijon balance që duhet të ndërtojnë jo vetëm të ardhmen, por duhet të ndërtojnë edhe balancet të tashmes të gjejnë një zgjidhje qoftë ajo edhe si një stabilitet të ashtuquajtur negativ.

Pikërisht të gjithë ne kemi frikë nga ky stabilitet negativ që mund të pasojë pas këtij kompromisi, i cili çdo kompromis e nënkupton një lloj stabiliteti një zgjidhje, që mund të jetë edhe negative.

Gjithë këtë negativiteti, ne nesër do ta kemi si droje se çfarë do të bëhet pikërisht prej problemit të decentralizimit, ku shpie problemi i decentralizimit, ndarja në baza etnike, se po bëhet një decentralizim në baza etnike dihet prej para 7 vjetëve ekziston kërkesa që në Kosovë të funksionojë një shtet multietik. E përmendi edhe Gjergj Dedaj në diskutimin e tij se duke u mbështetur në kë tri vjetëve është dashur të bëhet një zgjidhje, ka ndodhur 5 vjet, d.m.th. me 2004 ka filluar të shtrohet problemi i decentralizimit, mirëpo pse pas 5 vjetëve se dihet se mandati i forcave të OKB-së edhe institucioneve ndërkombëtare nuk mund të jetë i përjetshëm, kanë pritur që ne të bëjmë zgjidhje, ato zgjidhjet tona për arsye ndoshta edhe objective, për shkak traumës së luftës për shkak të ekzibicioneve të ndryshme që i kemi pasur edhe gjatë historisë në aktualitet nuk kemi arritur t'i bëjmë.

Në anën tjetër, besimi tonë ia kemi akredituar Ekipit Negociator që po e quajmë si Ekip i Unitetit ,është i zgjedhur, është legjitim dhe normalisht e ka mandatin që ta çojë procesin deri në fund. Unë e kam parë se nga dokumentet që i kemi marrë janë përfillur të gjitha, çdo dokument vendor që është bërë, është bërë me pajtim me dokumentet ndërkombëtare, duke filluar nga Karta Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare, skica e konventës evropiane për bashkëpunim kufitar etj. po ashtu edhe dokumentet rajonale dhe të brendshme. Nga këto dokumente shohim se gjatë decentralizimit dhe zgjidhjes së problemeve të komunitetit, s'do të ketë korridore etnike, nuk do të ketë enklava të ashtuquajtura as ndarje përgjatë linjave etnike. Në anën tjetër po ballafaqohemi me një realitet krejtësisht tjetër, mirëpo në këtë realitet duhet të shohim edhe reagimin e popullatës vendore, reagimin e qytetarëve ndaj projekteve politike që i bënë edhe Ekipi i Unitetit ,por edhe ndaj politikës që bëhet këtu në Kuvend. Jam i detyruar,si përfaqësuesi i elektoratit të Vitisë, ta përmend rastin e



reagimit të qytetarëve të Vitisë ndaj një decentralizimi, i cili e ndan komunën e Vitisë në tri pjesë, ndahet në komunën e re të Kllokotit të ashtuquajtur me të cilën nuk pajtohen as qytetarët e asaj pjese, edhe mbesin disa fshatra të shkëputura për shkak se arteriet e komunikimit në këtë ndarje bëjnë një shkëputje të tillë që nuk do të dihet a do të mbesin të lidhura me komunën e Parteshit s' do t'i pranojë as komuna e Kllokotit, po ashtu janë të shkëputura nga komuna e Vitisë. Me këtë desha të them se ekziston një vullnet i mirë i popullatës që të provohet edhe një herë koncepti i multietnicitetit dhe praktika e integritit të popullatës serbe në jetën e përditshme ,pa ndarje të tillë. Unë mendoj se ka nevojë të bëhet një konsultim edhe i bazës, dhe i përfaqësuesve të pushtetit lokal atje edhe i popullatës, por normalisht edhe i popullatës serbe ,që nuk është shumë e disponuar së paku për komunën e Kllokotit të jetë komunë e pavarur.

Në anën tjetër, duke e shikuar decentralizimin edhe nëpër komunat e tjera ekziston ajo frika reale se mund të ketë reagime të ndryshme në lidhje vertikale me Serbinë, se mund të ketë opkstruksione të ndryshme, bojkote .Bojkoti tashmë ekziston, do të ketë bllokada sikurse që ka pasur, edhe mund të ketë probleme të ndryshme. Shtrohet problemi si mund dhe sa është e aftë jo vetëm Qeveria apo në përgjithësi sa jemi të aftë si Kosovë që brenda kufijve tanë të kemi kontroll të plotë?. Pra, unë nuk i kam të qarta nga dokumentet që i kam pasur në dispozicion , cilat janë ato garancionet ndërkombëtare që do të mundësojnë që Kosova nesër të jetë një shtet funksional? Çfarë do të jetë forca mbrojtëse, sa do të participojë, fjala vjen NATO se dikush duhet të merret me TMK-në, ta modernizojë që nesër të bëhet partner i NATO-s për shkak se synimet e Kosovës janë për një partneritet evropian me të gjitha strukturat e saj.

Edhe unë mendoj se ka nevojë të shikohet çfarë strategjie duhet të bëhet për një integrim të tillë dhe cilat janë ato garancione ndërkombëtare. Në anën tjetër e shoh se në të gjitha diskutimet e deritashme asnjë nuk janë shprehur se cila do të jetë ajo kërkesa kryesore, a do t'i japin përkrahje Ekipit të Unitetit apo jo? Unë mendoj se puna e deritashme, përkundër shumë vërejtjeve që janë bërë, sidomos vërejtjet mund të bëhen në kornizën për mbrojtjen e të drejtave, ka mjaft vërejtje se krijohen këshilla të ndryshme, këshilla mbi këshilla ,me të cilët besoj që më së shumti do të ketë probleme vetë minoriteti që t'i realizojë të drejtat e veta. Mirëpo unë mendoj që Grupi i Unitetit deri tash ka treguar rezultate edhe normalisht se duhet të mësohemi me realpolitikën, si t'i zgjidhim problemet tash edhe në ardhmen, jo të merremi me të kaluarën dhe të dimë ta ruajmë rolin e partneritetit edhe me palën.... Ju faleminderit

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Bajrush Xhemaili ,le të përgatitet deputeti Hilmi Ahmeti

**DEPUTETI BAJRUSH XHEMAILI** – Ju faleminderit z. kryetar, përshëndetje për Grupin Negociator, z. Surroi ,po mungon, përshëndes në veçanti ministrin Rexhepi që ka kurajë i vetmi nga kabineti qeverisës që të na dëgjojë dhe të marrë pjesë aktive, përshëndetje për ju kolegë deputetë të nderuar. Kur flasim për çështje kaq jetike për këtë nënqiell, sigurisht që duhet të jemi seriozë dhe përgjegjës jo vetëm për fjalët që i flasim këtu, por edhe për fjalët që kemi folur përpara në këtë Kuvend. Mu për këtë diskutimin tim do ta filloj me tri

citete nga seanca e qershorit 2005, ku patëm diskutuar për decentralizimin apo siç thuhej atëherë për reformimin e pushtetit lokal.

1. Kryeministri i atëhershëm i Kosovës z. Kosumi thoshte, po citoj në faqen 8 të transkriptit: Nuk do të ketë komuna artificiale njëetnike dhe nuk do të ketë copëtim apo enklavizim të ri të territorit të komunave" mbaron citati. Sot së paku ashtu e mora unë, ish -kryeministri thotë se është i pajetërsueshëm pikërisht e pajetërsueshme ndarja në baza etnike .
2. Atëherë zëvendësministri i Pushtetit Lokal dhe tani edhe, atëherë ministri i pushtetit lokal dhe tani zëvendëskryeministri i Qeverisë së Kosovës, z. Lutfi Haziri thoshte. Po citoj faqen 10: Qëllimet e përgjithshme strategjike të projektit për reformën vetëqeverisëse lokale janë që kjo reformë t'i përmirësojë shërbimet në nivelin lokal, dhe me këtë i kontribuohet sigurimit të Qeverisë së qëndrueshme për kushte të të jetesës për të gjithë njerëzit e Kosovës, për integritet të të gjitha komuniteteve në strukturat demokratike të Kosovës, për themelimin dhe konsolidimin e institucioneve funksionale demokratike në Kosovë" mbaron citati.

Në atë kohë ato që kanë thënë nuk kam çka i shtoj vetëm po citoj në faqen 65 të transkriptit se kam thënë se këtë: nëse e bëjmë këtë do të thotë decentralizimin, në fakt ne ndihmojmë dhe realizojmë konceptin serb për ndarjen e një pjese sa më të madhe të Kosovës, në fakt në emër të decentralizimit kështu siç po bëhet është duke u futur kontrabandë ndarja e Kosovës. Ndoshta dikush i gatshëm ta bëjë edhe këtë qoftë për t'ia bërë qejfin dikujt apo për t'u ndier më mirë në karrigen pushtetore, por unë nuk jam i gatshëm t'ia bëjë qejfin askujt, në këtë rast as bashkësisë ndërkombëtare në dëm të Kosovës". Mbyllet citati.

Kjo që është thënë atëherë nga kryeministri dhe ministri i Pushtetit Lokal doli plotësisht mashtrim, sepse ka dalë e kundërta e saj që është thënë, u pa se ky decentralizim as që ka diçka të përbashkët me përmirësimin e shërbimeve qytetare në nivel lokal, prandaj ishte absurde që kryetari i Kosovës z. Sejdiu edhe këto ditë me rastin e vizitës në Skenderaj të përsëriste një mashtrim të tillë. E gjithë oferta e decentralizimit kishte të bënte për të kënaqur apetitet e minoritetit serb që të formohen komuna të reja me shumicë serbe dhe vija etnike, me kompetenca të veçanta në raport me komunat e tjera. Në fakt serbët e Kosovës dalëngadalë përmes decentralizimit të tillë po rumbullaksojnë autonominë e tyre kulturore territoriale dhe politike si entitet në vete, me një sipërfaqe që ata e synojnë me 33% aq sa e kanë kërkuar që në fillim, 24% është pranuar në kuadër të numrit të komunave që po u njihen që tani. Ministri Gjini përmendi 15% por nuk e përmendi edhe pjesën e territorit që ka të bëjë me zonat e mbrojtura, që gjithësi po them bëjnë 24%, pastaj serbët do të kenë vota të dyfishta, vende të rezervuara në Kuvend etj. por mos harroni procesin nuk ka përfunduar ende ka kohë për të lëshuar pe edhe për lidhjet vertikale të komunave serbe me Beogradin, me përfitim të komunave të reja etj. sidomos për faktin se nuk po bëhet rezistencë e nevojshme në raport me ofertën dhe bashkësinë ndërkombëtare. Përkundër krejt kësaj dalin deputetë të koalicionit qeverisës, në veçanti të LDK-së për më tepër edhe shefi i Grupit Parlamentar dhe na thonë se nuk pranojnë ndarje në vija etnike, duke harruar se pikërisht koalicioni qeverisës ka udhëhequr procesin e decentralizimit dhe negociatat në këtë fushë, madje ministri i Pushtetit Lokal, tani zëvendëskryeministër në këtë drejtim nuk ka pushuar së vepruari

dhe ka folur vazhdimisht në mediat elektronike, duke u munduar të na e mbushë mendjen se këto veprime janë të drejta, prandaj të kesh kryetarin e Kosovës udhëheqës të negociatave nga radhët e partisë, të kesh kryetarin e Parlamentit anëtar të Grupit Negociator nga po ajo parti, të kesh zëvendës -kryeministrin dhe njëkohësisht ministrin e Pushtetit Lokal, udhëheqës të decentralizimit, nga po ajo parti dhe që te tre pasi të kenë udhëhequr dhe pranuar ndarjen etnike për procesin negociator, kurse në anën tjetër nga i njëjti subjekt të dilet në seancë sa për opinion se gjëja partia nuk pranua ndarjen në vija etnike, është me drejtë, siç u tha- hipokrizi. Mirëpo unë mendoj edhe më shumë, e nëse nuk është hipokrizi që ka mundësi të mos jetë, po kundërshtohen realisht nga partia e tyre atëherë duhet të shtrohet një pyetje fundamentale; A kanë legjitimitet nga subjekti që përfaqësojnë kryetari, kryeparlamentari dhe zëvendëskryeministri? Por sot tha z. Alush Gashi në seancë, kanë, po atëherë po del që është një lojë që bëhet në opinionin publik.

Ndërsa anëtarët e Ekipit Negociator nga subjekti ORA, dua t'i them se ka gabuar rendin dhe vendin se ku duhet thënë gjërat, nuk ka nevojë që para neve ta thotë nevojën për reciprocitetin e dhënies së të drejtave si serbëve këtu në Kosovë ashtu edhe shqiptarëve në Kosovën Lindore apo në Luginën e Preshevës, si po thuhet. Zotëri Surroi para se ta thotë këtu nëse ka qenë e drejtë, që unë mendoj se është e drejtë që në negociata të përfshihet edhe çështja e atyre territoreve, atëherë ka qenë dashur t'i bëjnë ato si pjesë kërkesave të Grupit Negociator dhe pjesë e dokumenteve në bisedime, jo këtu para nesh t'ua qajë hallin atyre, sa për ndonjë poen politik e atje ku duhet dhe ku vendosen çështjet të mos i përmend fare. Unë mendoj se edhe kjo është hipokrizi. Në fund, me qasjen që ka Grupi Negociator nuk mund të realizojë synimet për shtet të pavarur dhe sovran, prandaj për të dalur nga kjo gjendje e procesit të negociimit duhet përkrahur rekomandimet në rend të parë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike që z. Jakup Krasniqi i ka numëruar këtu. Është edhe një shans i mirë që në këtë mënyrë të shpëtohet procesi negociato, në të kundërtën nëse bashkësia ndërkombëtare vazhdon t'i plotësojë apetitet serbe, pa asnjë model -pa asnjë shembull në botë, siç është duke vepruar atëherë e rrezikon të ardhmen e Kosovës dhe perspektivën e saj. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Iلمي Ahmeti, le të përgatitet deputeti Jusuf Sutaj,

**DEPUTETI ILMİ AHMETI** – I nderuari z. kryetar, i nderuari z. president, i nderuar kryeministër, deputetë dhe ministra. Fillimisht falënderoj Ekipin e Unitetit për raportin e bërë para këtij Kuvendi për bisedimet që po zhvillohen në Vjenë, njëherit edhe për materialet edhe pse disa shumë me vonesë janë sjellë.

Nga e gjithë ajo që i është prezantuar këtij Kuvendi dhe në bazë të materialeve të ofruara për rrjedhën e bisedimeve deri më tash, del se decentralizimi ose reformimi i pushtetit lokal si po quhet në Kosovë, është standard mbi standardet dhe më i rëndësishmi deri më tash. Decentralizimi do të kishte kuptimin e vet sikur të merrej më bartjen e kompetencave nga niveli qendror i pushtetit në atë lokal, por ky shkoj edhe më larg si process. Fillimisht u muarr me krijimin e komunave të reja gati monoetnike, ku është marrë për bazë vetëm një çelës ,ai i bashkimit në komuna të reja të zonave kadastrale të



vendbanimeve serbe, përmenden edhe kriteret e tjera, por që shumë pak janë përfillur .Faza e dytë e këtij procesi që ka të bëjë me kompetencat do të mund të arsyetohej deri diku sikur të mos kishin një ndarje të tillë të zonave katastrale. Lufta e Serbisë për ndarje territoriale të Kosovës ka ndërruar formën ,ajo tash kërkon që këtë ta bëjë përmes reformës së pushtetit lokal në Kosovë për të krijuar një Kosovë me dy entitete. Kjo është shqetësuese për shumicën e qytetarëve të Kosovës, sepse në këtë formë të reformimit të pushtetit lokal do të kemi një shtet jo funksional.

Në shumë vende në materialet e ofruara është thënë se kufijtë administrativë të komunave do të caktohen pas regjistrimit të popullsisë dhe të ekonomive familjare dhe në bazë të ligjit për pushtetin lokal nga ana e Kuvendit të Kosovës. Kjo tashmë ka ndodhur, janë publikuar hartat e kufijve administrativë komunaë për komunat e reja dhe zgjerimi e një komune tjetër, me këtë lloj decentralizimi. Parimi i pushtetit lokal afër qytetarit e humb kuptimin dhe del se kjo reformë po adreson shqetësimet siç thuhet legale të pakicës serbe në Kosovë. Është menduar se krijimi i komunave të reja do të mundësojë kthimin e qytetarëve në vendet ku kanë jetuar më parë, në realitet kjo për serbët po ndodh, por për shqiptarët e Mitrovicës jo që nuk do të ndodhë, por do të vështërsonte ,për të mos thenë të pamundësonte kthimin e tyre në shtëpitë e tyre.

Oferta e palës kosovare për Mitrovicën një qytet me dy njësi komunal të barabarta si duket është e imponuar nga realiteti i krijuar pasluftë, realitet që dihet si dhe nga kush është krijuar.Nuk do të mundësohet realizimi i asaj çka pretendohet- bordi i paraparë të krijohet për qytetin e Mitrovicës është i kufizuar në kompetenca dhe se kompetencat më të mëdha do t'u takojnë dy njësive komunale- po të kihen parasysh kompetencat e zgjeruara të komunave bordi udhëheqës i qytetit, i paraparë do të ketë kompetenca shumë të reduktuara dhe vështirë do të realizojë atë çka synohet. Janë kompetencat në fushën e policies e të drejtësisë dhe të financave, ato që në masën më të madhe do ta mundësojnë funksionimi normal të shoqërisë në shtetin e Kosovës, në një sistem unik për tërë territorin e Kosovës në këto tri fusha kjo do të arrihej. Në të kundërtën, fragmentalizimi i policisë, I drejtësisë dhe ndihma financiare e pakontrolluar që vjen nga Beogradi për komunat serbe, do të prodhojnë jostabilitet dhe një shtet jo funksional. Jam më se i bindur se Delegacioni i Kosovës në bisedimet e Vjenës do të argumentojë fuqishëm se kompetencat në këto fusha do të duhej të mbeteshin,... për të krijuar një shtet demokratik stabil dhe funksional.Pra,të mos harrojmë se janë financimet nga Beogradi që mbajnë një strukturë paralele policore ..... për situatën e krijuar që nga pas lufta në Mitrovicë. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Jusuf Sutaj ,le të përgatitet Xhevat Bislimi

**DEPUTETI JUSUF SUTAJ** – I nderuari kryetar i Kuvendit, i nderuari kryetar i Kosovës dhe ju Grupi i Unitetit.

Procesi i decentralizimit në nivelin e kuptimit teorik dhe të definicionit dhe në nivelin e interpretimit të tij në bisedimet që zhvillohen në Vjenë, janë diku diametralisht gati të papërputhura. Që në fillim këtë process, ndoshta edhe me fajin tonë si deputetë, ndoshta

edhe me fajin e dikujt tjetër, e mbuloi një vello e mosinformimit dhe e mosinterpretimit në Kuvend dhe në popull, që duhej ta kishim dokumentacion shumë më herët.

Mirëpo parimet themelore janë këto që janë thënë për decentralizimin nga përfaqësuesit tanë të zgjedhur nga Grupi i Unitetit nga faktorët të tjerë për negociata. Është thënë se nuk do të ketë kurrsesi ndarje, ose krijim të komunave të reja që bazë do ta kenë etnicitetin, por ndodhi e kundërta, se krejt ndarja u bë në baza etnike. Fatkeqësia më e madhe është se komunave të krijuara do të mundësohen të gjitha llojet e lidhjeve si lidhje vertikale, horizontale me Beogradin dhe që këto lidhje do të jenë shumë të forta, si në aspektin ekonomik në aspektin e arsimit, në aspektin e shëndetësisë dhe në aspekte të tjera. Lidhja me Prishtinën e komunave të reja që do të krijohen do të jetë gati fakultetative ose e parëndësishme, këtu nëpërmjet të asaj që thuhet se Beogradi ka të drejtë të financojë gjoja me donacione, mirëpo edhe me forma të tjera, komunat që do të krijohen, atëherë vihet në dyshim se mos në të ardhmen do të jetë një aversion fiskal që e dëmton ekonominë e Kosovës, e destabilizon deri në fund.

Edhe ndarja sipërfaqësore e Kosovës, pasi po ndodh ndarja etnike edhe ndarja sipërfaqësore disi po shkon në dëm të shqiptarëve, sepse taburizimi po bëhet, por po bëhet edhe ndarja sipërfaqësore. Kjo ndarje sipërfaqësore po apostrofohet se do të jetë diku 20% e dikush 30%, e dikush 35% e dikush ka përmendur 15%, do të thotë do të jetë mesatarisht 22 ose 23%, e unë po e zvogëloj pak nuk po e çoj në 30.

Unë për këto gjëra që tani i përmenda shkarazi, them sinqerisht folën edhe të tjerët, por do të flas për zonën mbrojtëse e cila është krijuar rreth manastirit të Deçanit, që është një prej zonave mbrojtëse më strikte dhe më e zgjeruara për fat të keq se kjo zonë mbrojtëse do të influencojë negativisht edhe në të ardhmen, UNESCO-ja u ngut ta shpallë monumentin fetar ortodoks manastirin e Deçanit një monument të 150-tin të UNESCO-s në botë, që pak besoj që mund të mbërijmë në atë shkallë të reagimit të monumenteve fetare dhe kulturore. Zona mbrojtëse në komunën e Deçanit diku ka 830, 840 hektarë që do të thotë një sipërfaqe shumë bllokues për Grykën e Deçanit që përfshinë diku 8.3 km. katrorë. Aty është një pronë e përzier, pronë shoqërore për ma tepër në atë zonë mbrojtëse është pronë private.

Aty thuhet se do të kenë të drejtë të shfrytëzimit të pronës private, por në kushte të një dinamike të kufizuar, që do të thotë nuk do të kenë drejtë të ndërtimit të ndonjë objekti kapital që krijon të mira materiale, por kanë të drejtë ta shfrytëzojnë atë tokë në forma klasike, sikurse e kanë shfrytëzuar deri sot për ta marrë ndonjë thupër apo diçka të ngjashme. A ka pasur nevojë të ishte ajo zonë, unë besoj se nuk ka pasur nevojë e as më pak të jetë një zonë aq e madhe, sepse zonat mbrojtëse nuk i mbrojnë monumente, por përkundrazi e irritojnë popullatën, në momente mund të jenë si faktorë që t'i rrezikojnë ato monumente.

Z. kryetar pasi që interpretova në pika të shkurtra unë nuk do ta zgjas, pasi më tjerët e thane. Ju falënderoj për fjalën.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Xhevat Bislimi, le të përgatitet deputetja Flora Brovina

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Zonja dhe zotërinjë deputetë, zotërinj qeveritar, unë këtu kam dy dokumente, në njërin dorë kam dokumentin e miratuar nga Kuvendi i Serbisë më 29 prill 2004-tën dhe në dorën tjetër kam hartat po ashtu të Beogradit dhe të Serbisë që na i ka sjellë Kryesia e Kuvendit dhe Grupi Negociator pa pikë respekti, sepse janë të gjitha hartat e Beogradit dhe në gjuhën serbe, prandaj këto do t'ia dorëzoj menjëherë Kryesisë, kurse sa i përket këtij dokumenti ky dokument është në faqen zyrtare "Vlada Srbije", është i botuar edhe në gjuhën shqipe besoj që ju e keni pas të gjithë dhe secili prej jush le ta krahasojë këtë dokument në dokumentet përfundimtare që i ka miratuar Grupi Negociator dhe le të më thotë ku dallohet ky dokument i miratuar nga Kuvendi i Serbisë dy vjet më parë nga dokumentet që na ka ofruar Grupi Negociator i Kosovës.

Prandaj, unë konsideroj që ky grup e ka humbur të drejtën morale dhe politike, por edhe institucionale, që ta përfaqësojë edhe më tej Kosovën, sepse ka zbatuar një plan që ka miratuar Kuvendi i Serbisë. Po e përsëris me 29 prill 2004.. dhe nëse këtë dokument dhe këto dokumente, këtë plan të Serbisë e miraton edhe ky Kuvend, atëherë edhe ky Kuvend do të bëhet pjesë e Skupshtinës të Serbisë, që do të më vinte shumë keq. Do të dëshiroja që ky Kuvend ta ndërpresë traditën e turpshme që ka pasur dikur kur ka votuar kundër Kosovës, kundër vendit të vet dhe e keni këtë shans të fundit, nuk besoj se do të keni shans tjetër të votoni kundër këtyre dokumenteve, sepse ky është projekti më i rrezikshëm që është miratuar ndonjëherë për Kosovën. Ky është projekti që do ta destabilizojë edhe në të ardhmen Kosovën, kurse përgjegjësinë këta njerëz po duan ta ndajnë me Kuvendin e Kosovës, bile këto dy ditë ka kalemxhinj që po shkruajnë nëpër gazeta të paguara a të porositur nuk e di, se i gjithë populli i Kosovës është fajtor, të gjithë jemi fajtorë, prandaj nuk kemi çka bëjmë siç u tha sot nga kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së në emër të katër grupeve kryesore parlamentare që e ngriti flamurin e bardhë dhe tha: "se ne nuk kemi çka të bëjmë më shumë, jemi të pafuqishëm çka të na japin le të na japin". Kjo burra, megjithatë ishte burrëri nga Alush Gashi që e shpalli botërisht se ne kemi kapitulluar para Serbisë. Kumbar i këtij dokumenti ka qenë Ahtisari dhe është me qarqe të caktuara ndërkombëtare. Ju lutem atyre shumë që nuk e kanë parë le ta marrin e ta shfletojnë dhe ta krahasojnë me dokumentet që u janë dhënë nga Kryesia e Kuvendit. Prandaj unë, mendoj dhe propozoj që ky Kuvend të dalë kundër këtyre dokumenteve. Është shanci i fundit që ta lajnë vetveten dhe brezave që vijnë të mos u lëmë konflikte, sepse në emër të paqes po përgatitet një luftë e tmerrshme, në emër të dialogut po përgatitet një konflikt i tmerrshëm, në emër të decentralizimit është krijuar një territor i pastër etnik serb në Kosovë, një Serbi po krijohet në Kosovë për këtë jeni të gjithë të bindur, jam shumë i bindur edhe unë, pavarësisht se nuk e thoni. Në vend që të bashkohet territori serb që kontrollohet nga Serbia, në Kosovën Veriore dhe në Kosovë po krijohet edhe një territor tjetër i pastër serb, por kësaj radhe me pëlqimin e Grupit Negociator dhe të përfaqësuesve që ne i kemi quajtur tanët, por nuk paskan qenë tanët, por po del se nuk kanë qenë tanët. Më vjen keq që nuk kanë qenë tanat dhe që po na përsëritet historia kaq e kaq herë dhe asnjëherë nuk nxorëm mësim. Nuk e di kur do të nxjerrim mësim ne shqiptarët e Kosovës dhe



gjithë kombi shqiptar. Prandaj, në qoftë se ky Kuvend sot i miraton këto dokumente, unë e ftoj popullin e Kosovës të mos i bindet më as Kuvendit e as përfaqësuesve të tij. Ju faleminderit!

**KRYETARI I KUENDIT, KOLË BERISHA** –Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Flora Brovina , le të përgatitet deputeti Fadil Geci

**DEPUTETJA FLORA BROVINA** – I nderuari kryetar, kolegë dhe kolege –të drejtën ta them tani të gjithë jemi në një tension për shkak të mungesës edhe të kohës , sepse ky vazhdim i debatit për një çështje shumë delikate u shty pikërisht para nisjes së Delegacionit për në Vjenë dhe në përgjithësi e humb kuptimin edhe të debatuarit, sepse njeriu e kupton, para veti e ka dilemën të diskutojë apo të mos diskutojë, nëse nuk mund të ndikojë sa duhet. Megjithatë, unë nuk mund të rri indiferente para këtij momenti kaq delikat dhe me përgjegjësi individuale padyshim dhe t'i lejoj vetvetes që të hesht. Kështu e kam kuptuar dhe e kam vlerësuar edhe prezencën e opozitës, gjegjësisht Partisë Demokratike të Kosovës me z. Hashim Thaçin, në krye në Grupin e Unitetit si pjesëmarrje e ndërtimit të unitetit më se të domosdoshëm dhe të nevojshëm për momentin kaq delikat si një strategji të ndarjes së punës më ndikim, përgjegjësisë së fajësisë, por edhe ndarjes të suksesit edhe pse opozita me pjesëmarrje . sigurisht që e humb rolin e vet real. Vlerësoj këtë unitet të burrave në Grupin për bisedime ose Grupin e Unitetit. E theksova unitet të burrave, sepse as ndërrimet që u bënë nuk u përmirësua struktura, duke mos pasur as një përfaqësues së gjysmës së popullatës të prezantojë të paktën mendimin e tyre. Edhe në Grupin teknik ose grupin e ekspertëve gjithashtu gratë janë fare simbolikisht të përfaqësuara edhe pse në të kaluarën ato dëshmuuan se dinë të sakrifikojnë në çdo kohë dhe çdo herë për lirinë e Kosovës, se kanë nivel të dijës politike dhe vullnet për dialog dhe bashkëpunim që mund të japin shumë për kontribut në ndërtimin institucional dhe shoqëror të Kosovës.

Prezantimi i anëtarëve të Grupit të Unitetit dëshmoi harmoni dhe bashkëpunim, por ishte fare formal. Ndërkaq materialet e ofruara me shumë vonesë dëshmuuan joseriozitet dhe lanë përshtypje të keqe për opinionin dhe për neve ishin pengesë .sepse nuk mund të ishim efikas në mbledhjen e parë dhe ja tani po diskutojmë me vonesë. Kuvendi në të vërtetë nuk respektoj vetveten duke mos qenë në rolin dhe detyrën e vet në momentin kaq delikat. Këto çështje nuk diskutohen kështu shkel e shko dhe përngutë ,sepse ja u nis treni dhe nuk mund ta vazhdojmë. Shumë kohë, shumë gjenerata dhe shumë jetëra janë sakrifikuar për këtë debat, për këtë moment jetik dhe historik.

I bashkangjitem diskutimit të kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe kërkoj që parimet e propozuara nga Grupi ynë parlamentar të votohen ose të aprovohen. Njëherit kërkoj nga ju z. kryetar i Parlamentit që deputetët të informohen më mirë në çdo kohë që të kemi mundësi të jemi në rolin tonë të deputeit dhe të dimë të reagojmë me kohë ashtu si duhet dhe si pritet nga ne. Ky Kuvend para sa kohësh ka nxjerrë Rezolutën, ka nxjerrë edhe vendime të caktuara edhe këtu veçoj Rezolutën për pavarësinë, Rezolutën për të Zhdukurit, për decentralizimin e të tjera, që obligojnë Kuvendin, por obligohen në veçanti Grupin e Unitetit dhe gjithë ata që marrin pjesë në bisedime. Nuk ka bisedime me Serbinë për pavarësinë, për sovranitetin e Kosovës, për

çështjet e brendshme të saj siç është decentralizimi. Nuk ka bisedime pa u zbardhur fati i të rrëmbyerve dhe të zhdukurve gjatë luftës. Faktori ynë politik nuk bëri presion të duhur që të ndriçohet kjo çështje kaq e dhimbshme dhe kaq gjatë. Bisedimet për të zhdukurit gjatë luftës mbeten peng në nivelin më të ulët të bisedimeve në nivelin teknik. Kjo çështje nuk u ngritë në nivelin e bisedimeve në Vjenë edhe pse duhet të arrinte para se të fillonin bisedimet e njëanshme ose një -nacionale për monumentet kulturore, për mua të pakuptimta nëse diskutohet vetëm për kishat ortodokse e për sigurinë e tyre dhe për decentralizimin etnik, e ju si Grup i Unitetit anashkaluat çështjen e të zhdukurve edhe pse patët mjaft argumente dhe dëshmi se ata u masakruan dhe u rrëmbyen të gjallë nga organet institucionale të Serbisë që kishin synim gjenocidin në Kosovë. Siguria dhe bashkëjetesa nuk bëhen pa u thënë gjërat në sy, pa u thënë e vërteta, heshtja nuk do të thotë harrim, e harrimi nuk duhet të ndodh.

Bashkëjetesa nuk realizohet me shantazhe, me presione, me kërcënime me ofendime, me veçime ose me pozita të privileguara të një komuniteti, i cili nuk dha dëshmi se do të jetojë me popullin shumicë dhe me të tjerët. Dora jonë e zgjatur që të jetojmë bashkë dhe garancioni për të drejtat e barabarta të të gjithëve, pra edhe të serbëve, është dëshira dhe vullneti për një Kosovë të të barabartëve e jo për një Kosovë të enklavizuar. Bashkëjetesa nuk ndërtohet me izolim dhe synime të dështuara me shekuj, në synime pas shpine, ajo shihet kur flitet për decentralizimin etnik dhe kompetencat e minishteteve-enklava. Një Kosovë e tillë nuk mund të funksionojë, një Kosovë leopard me minoritetin serb në enklava gjithsej 5% në përbërje të përgjithshme të popullatës duke menaxhuar 24 si u tha e unë besoj 30% të territorit të Kosovës e nuk mund të funksionojë. Kosova ka një dendësi shumë të lartë të popullatës më të lartë se shtetet e Beneluksit, prandaj kjo nuk është pasqyrë e një tolerance dhe as e multietnicitetit por është mundësi e pakënaqësive të mëdha dhe mundësi e një konflikti.

Të freskët të gjithë e kemi buzëqeshjen e gëzimin fëmijorë të udhëheqësit të Grupit të decentralizimit, këtij politikani të ri kur në mënyrë diletante na e kumtoj rezultatin e bisedave, e citoj: "tetë me zero". Sot para vete kemi hartat, e kjo flet për qasjen joserioze, mosnjohjen dhe mospërgatitjen e duhur në rolin të cilin ia kishim besuar. Sot para vetit i kemi hartat dhe ofertën për mini-enklavat e mini-shtetet enklava etnike. Hartat e shteteve kur nuk bëhen me entuziastë e tifoz, me entuziazmin e tifozllëkut të futbollit. Këto harta për sigurinë e kishave ortodokse dhe enklavat e legjitimuara si komuna etnike nuk do t'i pranonte asnjë shtet demokratik, ato nuk do të funksiononin në asnjë ish-koloni të çliruar dhe këto e bëjnë jofunksional edhe shtetin e Kosovës. Ne kemi dhe duhet ta mbrojmë ofertën më humane të mundshme në botë të garantojmë dhe secili të përpiqet ta aplikojë këtë garanti për qytetarët e barabartë të Kosovës, për qytetarët e lirë ku sundojnë ligji, toleranca dhe siguria për secilin. Pse kjo pasiguri dhe mungesë e dinjitetit të atyre që hynë në bisedime? Jo nuk keni të drejtë të silleni pa këtë dinjitet, nëse Serbia ka të drejtë të jetë paternaliste për serbët e Kosovës, pse ju nuk e shfrytëzues dhe të merrni mbi vete paternalizmin për shqiptarët në Kosovën Lindore? A u është garantuar atyre e njëjta e drejtë, i njëjti decentralizim me kompetenca shtetërore si në Kosovë që u garantohet serbëve, barazia e gjuhës, e kulturës, arsimimi, mbrojtja, gjyqësia dhe kthimi natyrisht. Mos lejoni që të shantazhoheni me Mitrovicën. Ju duhet të interesoheni për pozitën e shqiptarëve në Serbi tani kur po zhvillohen bisedimet e jo të bisedoni vetëm për konsumim ditor në media. Ju keni nevojë për përforsim profesional edhe për një strategji ndryshe që do të qëndroni vertikal me të drejtën e argumentit.

Shumë gjëra kanë filluar mbrapshtë. Kosova ishte koloni e Serbisë pa dëshirën e popullit shumicë, u çlirua në mes nesh ndodhen luftëra dhe një luftë e ndyrë dhe e përgjakshme, ndodhi gjenocidi, Kosova më nuk është koloni, ajo është një projekt që nuk bënë të dështojë jo vetëm për shkak të neve shqiptarëve shumicë, porse në këtë projekt bota investoi shumë dhe arritëm këtu ku jemi. Kosova duhet të shërbejë si shembull pozitiv i një vendi ku fitoi e drejta mbi të keqen, ku populli i çliruar nga kolonizimi më në fund...

**KRYETARI I KUENDIT, KOLË BERISHA** –Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Nait Hasani, le të përgatitet Myrvete Dreshaj

**DEPUETI NAIT HASANI** - I nderuara kryetar, i nderuar Ekipi i Unitetit, të nderuar kolegë, deputetë, e di se jeni lodhur – bukur gjatë ka zgjatur ky debat , por mendoj se ai që është dashur të diskutonte për decentralizimin ka fluturuar për Vjenë. Unë nuk do të zgjatem shumë, me ato që u thanë. Mbështes fjalën e kolegut Bajrushit dhe sekretarit të shefit të Grupit Parlamentar, por unë kam disa pyetje pikërisht për kryesuesin e këtij ekipi për decentralizimin dhe për çështjen e statusit. Unë e kam një hartë të Kosovës e cila është e ndarë në- unë them është një kasaphane një masakër që i është bërë Kosovës me te dhe nuk di cili shqiptar, cili qytetar është në gjendje ta pranojë këtë ndarje brenda Kosovës. Ju lutem, le të përgjigjen ata të cilët e kanë bërë këtë, se vetëm hartën e Graçanicës e cila është në qendër të Kosovës dhe e bënë një ndarje thuajse një bllokim të arterieve kryesore të Kosovës, e bllokoi rrugën për Gjilan, e bllokoi rrugën për Shkup, Prizren dhe e bllokoi rrugën për Pejë. Mendoj se me këtë bllokadë na mbetet rruga vetëm për Beograd. Prandaj, e bëj në pyetje tjetër po ky Ekip negociues a e ka bërë ndonjëherë ndonjë kërkesë që sa shqiptarë jetojnë në Beograd ,sipas shifrave zyrtare të Beogradit diku 70 mijë shqiptarë jetojnë vetëm në qytetin e Beogradit? A kanë fare të drejte, a kanë ndonjë institucion që kujdeset për ta? A ka kush që është i interesuar për ta? Apo vetëm ne të interesohemi dhe të bëjmë lëshime sigurisht se kërkojnë për çështjen e 5% të serbëve këtu? Mendoj që Ekipi Negociues nuk do ta ketë atë të drejtë që t'i harrojë shqiptarët në Beograd apo shqiptarët në përgjithësi edhe nuk ka të drejtë askush ta bëjë këtë masakër në Kosovë me këto harta me këto që e bëjnë. Mendoj se duhet të kemi parasysh dhe duhet të dalim tek ajo gjendje, pikërisht sepse qytetarët janë ata që do të vendosin, prandaj për çështjet e decentralizimit kërkoj që Ekipi Negociues, ky Kuvend t'ia kthejë qytetarëve me anë të referendumit që ata të vendosin për zgjidhjen e decentralizimit. Ju faleminderit!

**KRYETARI I KUENDIT, KOLË BERISHA** –Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Myrvete Dreshaj, le te përgatitet deputeti Ymer Muhaxheri

**DEPUTETJA MYRVETE DRESHAJ- BALIU** - I nderuari kryetar, Grup i Unitetit, kolegë deputetë – sikur mund të shihet prej zhvillimeve të deritashme projektet për Kosovën qofshin ato administrative, ekonomike apo kulturore, bisedimet mes përfaqësuesëve shqiptarë e serbë dhe të ridërmjetësuesve ndërkombëtarë po sillen ekskluzivisht rreth karakterit politik dhe po kanë të bëjnë krejtësisht me ndarjen e interesave nacionale mes serbëve dhe shqiptarëve. Sot, deklaratat për interesin social e



kulturor të decentralizimit për gjithë qytetarët do të kishin kuptim vetëm nëse decentralizimi do të ishte çështje e gjithë territorit të Kosovës, pra edhe pjesës Veriore të saj. Çështje e të gjithë qytetarëve të saj dhe jo vetëm e serbëve, çështje para së gjithash dhe e qyteteve të mëdha, pra e Prishtinës dhe jo fshatrave të qena e të paqena. Kjo na bën të konstatojmë se bisedimet për decentralizimin në mes Kosovës dhe Serbisë nuk po bëhen për qytetarët e Kosovës po për territoret e saj. Krijimi i komunave edhe atje ku nuk ka banorë të mjaftueshëm apo bashkimi i fshatrave etnike serbe dhe zgjerimi i komunave të krijuara dhe me fshatrat e tjera, na bëjnë të konstatojmë se decentralizimi po bëhet mbi tri platforma themelore: mbi zgjerimin e komunave ekzistueses, krijimin e komunave të reja nën ombrellën e zonave të objekteve fetare dhe së fundi mbi krijimin e komunave të reja apo zgjerimin e tyre në mbështetje të zonave të ashtuquajtura historike. Rëndësinë e decentralizimit dhe interesin e gjithë qytetarëve të Kosovës prej tij më sa duket do ta shohim dhe ta ndiejmë vetëm përtej një decentralizimit të ndërtuar nga jashtë sikur po bëhet. Prej materialeve të sjella për diskutim dhe prej numrit të madh të copëzave dhe të hartave, disa prej të cilave madje të përpunuara në Institutin Ushtarak të Beogradit shohim hapësira të tëra mbrojtëse për kishat dhe manastiret serbe, kjo na krijon përshtypjen sikur Kosova është hapësirë pronash vetëm e monumenteve kishtarë serbe për të cilat kërkohet mbrojtja dhe vetëvetiu na imponohet pyetja: A do të mbetet qoftë vetëm edhe një rrugë krejt anësore e Kosovës pa ndalesa teknike policore për shkak se diku afër paska një fshat a një faltore serbe? A nuk po na mjaftojnë këto që janë krijuar deri me tash? Me këtë nuk dua t'i mohoj vlerat shpirtërore dhe materiale të popullit serb, por kërkojmë që këto materiale -trashëgimia kulturore e Kosovës të jetë unike qoftë ajo e antikitetit e mesjetës, rilindjes apo kohës më të re. Trashëgimia kulturore e Kosovës mund të quhet e prejardhjes serbe apo shqiptare, por jo edhe jo lindore, perëndimore, fetare jofetare, duke shquar njërin më shumë se tjetrin. Çfarëdo identifikimi i skajshëm me njerëz përjashton tjetrin, krijon ndarje refuzime të tjera me pasoja. Në këto harta është ndërfutur edhe një pjesë harte me memorialin e Gazimestanit. Zonja dhe zotërinj, ne e dimë se Gazimestani ka qenë dhe ka mbetur sinonim i luftës mes etnive dhe besimeve në Kosovë, prandaj ky memorial nuk mund të shquhet në këto dokumente nëse duam që Kosovën ta bëjmë shembull të paqes në shekullin 21, ndoshta më mirë do të ishte që në vend të tij të ndërtohet një park i paqes ballkanike, një shenjë e re, një sinonim i mendimit të ri në Ballkan.

Në këtë linjë bisedimesh sigurisht ka edhe shumë anë të njohura të panjohura për të cilat anëtarët e Delegacionit dhe ekspertët e angazhuar mund të jenë më transparent përballë qytetarëve të tyre. Për të dhënat e deritashme nuk mund të thuhet se opinionit i janë afruar informata të mundshme dhe aq më pak analiza, komente të nevojshme, por ka edhe premisa të këtyre bisedimeve. Bisedimet mes shqiptarëve dhe serbëve nuk mbulohej me deklarata sado parimore qofshin ato. Opinionit i duhen më shumë të dhëna nga faktori që janë obliguar të flasin mbi gjendjen faktike të gjërave mbi përvojën historike të këtyre projekteve dhe lidhur me këtë Grupit të Unitetit i sugjerojnë edhe pse vërejtje dhe sugjerime pati edhe më parë, por megjithatë mendoj që të gjitha kanë shprehur shqetësimin e njëjtë tonin këto, që të gjitha dokumentet dhe statusit final pasi të kenë kaluar fazën e quajtur sekrete, do me thënë nga momenti kur ato i dorëzohen zyrtarisht UNOSEK-ut ose pranohet zyrtarisht prej UNOSEK-ut t'u dorëzohen zyrtarisht deputetëve, ministrave dhe kryetarëve të partive politike që participojnë në kuvendet komunale. Pastaj organizohen debate me qytetarët për procesin e negociatave, dëgjohej

dhe marrin mendimin edhe të institucioneve tona shkencore dhe ky Grup i Unitetit të shqyrtojë mundësinë e zgjerimit, sepse me këtë vetëm mund të pasurohet. Së fundi duke u mbështetur në Grupin e Unitetit njëkohësisht ne ia kujtojmë se duam më shumë transparencë nga ai dhe ekspertët e tij. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUENDIT, KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ymer Muhaxheri, le te përgatitet Zef Morina  
Kërkoj falje, profesor Muhaxheri

DEPUTETI YMER MUHAXHERI – Kuvend i nderuar, z. kryetar, diskutimi im do të përqendrohet kryekëput në trashëgimi të quajtur fushëzonat e mbrojtura edhe pse kam vërejtje edhe për Grupin për decentralizimit, i cili kujtoj se ka ardhur me nguti. Ka edhe vërejtje paraprake, pra mendoj se ofertat e këtij grupi bëhen ad-hoc, varësisht prej ofertës së UNOSEK-ut apo të palës së Beogradit. Si vërejtjet janë veprimet transparentete të Ekipit të Unitetit, gjegjësisht të nënekipeve të tjera negociuse, në këtë rast Komisioni i ekspertëve. Është e papranueshme për një deputet në Kuvend të Kosovës që informacionet për pozicionin e Grupit të Unitetit për të gjitha takimet që bëhen përmes mediave, i vetëdijshëm se një pjesë e saj është e lejueshme për informim. Delegacioni kosovar në takimin e 18 korrikut të këtij viti, aty ku flitet për vendosjen e kritereve që janë tri, unë e citoj kriterin e tretë: "koncepti funksional është zona toksore që ekonomikisht, socialist apo në mënyrë kulturore është e lidhur me monumentin e mbrojtjes." Për çudi, ky kriter disi nuk përputhet me vijat e zonave të mbrojtura të vendosura nga UNOSEK-u, por as nga vetë Grupi Negociator i Kosovës kur them se kam parasysh hartat topografike dhe ato ortofotot që në janë ofruar nga fundi i javës së kaluar, konkretisht sipas këtyre vijave të UNOSEK-ut për shembull zona e mbrojtjes të patrikanës të Pejës kalon në kodrat mbi lagjen e Kapishnicës në hartë e shënuar në pozicionin një, përfshin shtegun që çon te livadhet e Sapjes, pozicioni dy prej siç e quajmë ne në Pejë Horomoqat në pozicionin e tretë dhe gjarpëron deri te rruga për bjeshkët e Malishevës pozicioni i katërt. Në kuadër të këtyre vijave është futur edhe fshati Livoç – pozicioni i pestë. Habit edhe Grupi ynë Negociator që bënë një ofertë natyrisht mendoj se është galante e skajshme jo e qëllume shkaku se në këtë rast në vijat e fundit të zonave mbrojtëse vullnetshëm ia mundëson kësaj kishe sanksionimin institucional të mbështetur në autoritetet ndërkombëtar atë rolin represiv që e ka pasur gjatë këtyre katër vërejtjeve drejtpërsëdrejti e ka penguar zhvillimin ekonomik të komunës të Pejës. Nga dokumenti i katërt: qasja në ndërtesa, vende dhe patundësitë e trashëgimisë kulturore pika 4-3 ,gjegjësisht pika 4 "Kisha mund të kërkojë masa më të rrepta sigurie gjatë kohës të festave e tjera e tjera" Këto dy pika jepin të kuptojnë se kapaciteti menaxhues i tyre mund të përdoret si t'iu teket, ta bllokojë qarkullimin e lirë të qytetarëve pa ndonjë kriter të shkruar. Në kuadër të kësaj zone kalon rruga me rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik të qytetit. Sipas planit zhvillimor komunal në dy versionet e paraqitura të qytetit të Pejës – zona e Bjeshkëve të Rugovës është e rëndësisë së dyfishtë, atje parashihet të zhvillohet një turizëm ekskluziv, por edhe dy -tri hidrocentrale të cilat do të prodhojnë rrymë. Idetë dhe planet e mëhershme të studiuara mirë nga ekipet elite të ekspertëve të asaj kohe kanë ekzistuar edhe më parë. Zona e mbrojtur me ligj e dëmton zhvillimin ekonomik të qytetit dhe të rajonit. Kufijtë

e dy këtyre propozimeve do të fusin në frazë të mirë rrugën përmes Çakorit në Mal të Zi brenda zonës mbrojtëse. Prandaj, kufijtë e vendosur kësajsoj që lyp propozimi e UNOSEK-ut dhe e Grupit të Unitetit e dëmtojnë interesin ekonomik, zhvillimor të kësaj pjese të shoqërisë kosovare. Në anën e djathtë të rrjedhës së lumit tek pozicioni gjashtë i njohur në popullatë te Sharra fillon linja e kanalit të irigacionit, kanal që gjarpëron rreth kodrave përballë Patriarkanës së Pejës. A është ky kanal që e dërgon ujin për ujitjen e një pjese më të madhe të rrafshit të Pejës, duke përfshirë këtu edhe fshatrat deri te Lugu i Baranit. Një nga çështjet e rëndësishme me peshë të veçantë është, se në kuadër të kufijve të zonës te dy pozicioneve të cilat janë të përmendura hyjnë asetet e ujësjellësit rajonal, kjo është edhe një nga arsyet që lidhen me pikën një, pra kapaciteti menaxhues i zonave në fjalë, pra dokumenti katër: qasja në ndërtesa, vende dhe tërësitë e trashëgimisë kulturore pika 4, 3 pika 4,4 Propozim: në vend që propozimet për kufijtë e zonës mbrojtëse si në rastin e Pejës ashtu edhe në rastin me siguri të Deçanit që punohen nga punëtorët e UNMIK-ut që vijnë nga Amerika Latine , nga ekspertët e Beogradit që vazhdojnë në harta topografike apo ndonjë qytetar preshevar që nuk është i kësaj ane të Kosovës dhe nuk e njih gjendjen faktike në terren si qytetar dhe si përfaqësues i kësaj ane në këtë Kuvend të Kosovës, propozoj rivlerësim. Rruga që kërkon në Grykën e Rugovës, gjegjësisht përmes Çakorit lidhet me Malin e Zi e që kalon përbri Patrikanës së Pejës të mos futet brenda kufijve të zonës mbrojtëse.

2. Kanali i ujitjes të mbetet jashtë zonës së mbrojtjes së Patrikanës së Pejës.

3. Resurset e ujësjellësit gjithashtu të kursehen nga futja e zonës mbrojtëse.

4. Të punohet dokumenti rregullativ për administrimin e zonave të mbrojtura me theks të veçantë te objektet e zonat e mbrojtura duhet të shpallen si objekte të rëndësishme së veçantë pa ndonjë .....

5. Zona e mbrojtur e Patrikanës së Pejës përfshinë: Zonë e mbrojtur e Patrikanës së Pejës përfshinë zonën që është nën kontrollin e KFORI-it e që në kujtesën popullit ,është perceptuar si zonë e kufizuese me mure të larta Patrikana.

6.Në Livadhet të Popit pozicioni 6 dhe livadhet në anën e djathtë të rrjedhës së lumit pozicioni i shtatë përballë hyrjes së Kishës të mbetet jashtë zonës mbrojtëse e jo ashtu siç ka vepruar Ekipi Negociator për këtë çështje. Vijat e gjelbëra duke përfshirë të dy brigjet e rrjedhës së lumit. Kuvendi i Kosovës nuk ka mandat të vendos për..... të drejtat për të qenë i lirë dhe për të shfrytëzuar dhuntitë dhe resurset natyrore. Këto limite padrejtësisht ua kufizojnë implementimin e kësaj të drejte. I vetëdijshëm se Qendrdat e vendosjes do ta imponojë versionin e tyre të zgjedhjes në rastin konkret, Kuvendi i Kosovës nuk ka mundësi ta kundërshtojë këtë vendim në parimin "vis major". Mendoj se në rastin e Patrikanës ky Kuvend të distancohet nga rasti i theksuar me mbështetje të imperativit kategorik ndërkombëtar mbrojtja e të drejtave universale të njeriut.

#### **Arsyetimi:**

Roli represiv i Kishës – dikur Patrica – tani nuk ekziston. Ajo e vendosur në hyrje të Grykës së Rugovës gjatë 40 vjetëve të fundit e ka ndaluar zhvillimin ekonomik të qytetit të Pejës.

Ka ndaluar ndërtimin e magjstralës Ibër kah Gryka e Rugovës edhe pse kjo rrugë prej lashtësisë ( Vija ignatia) ka funksionuar.



Ka ndaluar ndërtimin e Hidrocentraleve, që kanë qenë të parapara me strategjinë e mëhershme për ndërtimin tyre.

Kohëve të fundit, para 22 viteve ka ndaluar ndërtimin e Ski liftit për shfrytëzimin e shtpative të Rugovës. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BEREISHA** – Fjalën e ka deputeti Zef Morina, kurse le të përgatitet deputeti Emrush Xhemajli.

**DEPUTETI ZEF MORINA** – Faleminderit z. kryetar. I nderuari z. president i Kosovës z. kryeministër, anëtarë të Grupit Negociues z. Thaçi, z. Surroi kolegë deputetë.

Jemi të vetëdijshëm se nga vetë fakti që jemi pajtuar për të biseduar dhe negociuar për statusin e Kosovës me faktorin ndërkombëtar rruga gjërë pavarësia do të jetë e mundimshme, por asesi në dëm të Kosovës. Në raportin e punës të Grupit Negociues janë paraqitur parimet themelore për reformimin e pushtetit lokal, materiali është i përgjithshur, gjegjësisht nuk ka të dhëna që vërtetë parimet të vlejné për reformimin e pushtetit lokal e jo për kantonizimin e Kosovës. Grupi Negociues është duke e bërë punën e vetë me përkushtim edhe përkundër pengesave dhe vështirësive me të cilat është duke u ballafaquar, nga njëra anë, obstrukcioni i palës serbe për të bllokuar zgjedhjen e statusit të Kosovës dhe nga ana tjetër, presionin e vazhdueshëm të faktorit ndërkombëtar për të qenë më fleksibël. Nëse analizohen propozimet e palës serbe për decentralizimin shihet qartë se qëllimi i Beogradit është që në Kosovë të krijohen lidhje horizontale, korridore lidhëse të cilat do të jenë vatra krize për ta destabilizuar politikisht dhe ekonomikisht Kosovën. Pas zgjedhjes së statusit të Kosovës, gjegjësisht pas pavarësisht Kosova ka nevojë për investime të huaja për t'u zhvilluar ekonomikisht. Investitorët e huaj dëshirojnë që investimet e tyre të jenë të siguruara, e një siguri e tillë do të jetë e vështirë po që se lejohet krijimi i enklavave serbe dhe korridoreve lidhëse, të cilat në çdo kohë do të krijojnë kriza dhe destabilitet. Në këtë mënyrë Kosova nuk do të jetë vend i dëshirueshëm për investime, kështu që edhe si vend i pavarur, prapë do të jetë ndër vendet e varfëra dhe me probleme sociale, ekonomike dhe politike. aAo që unë dua të them qoftë si qytetar i Kosovës, qoftë si deputet i Parlamentit dhe si përfaqësues i PSHDK-së kërkoj në radhë të parë nga Grupi Negociator, nga Qeveria dhe Parlamenti që në asnjë mënyrë të mos pranojnë enklavizimin e Kosovës dhe të mos kënaqemi vetëm me fjalën pavarësi, por Kosova të bëhet vërtetë shtet i pavarur me sovranitet të plotë dhe anëtarë në Kombet e Bashkuara sikur të gjitha shtetet e njohura ndërkombëtarisht. Më mirë është që procesi negociator të vazhdojë edhe në vitin 2007 sesa të zgjidhet një lloj statusi që nuk pranohet nga shumica e popullit të Kosovës. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli, kurse le të përgatitet deputeti Gjergj Dedaj.

**DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI** – Z. kryetar, i nderuari për kandidat të kryetar të LDK-së z. Fatmir Sejdiu, i nderuari kryeministri Çeku. Z. Thaçi dhe gjithë Grupi për Negociata.

Unë kam dë skutuar herën e kaluar. U panë këtu diskutimet, më vjen shumë keq që pak më herët u bë një tentativë për ta mbyllur debatin në mënyrë jo të hijshme në Kuvendin e

Kosovës dhe apeloj që kjo mos të ndodh në mënyrat që ka ndodhur deri më tash, por propozimet që u dhanë këtu, ato propozime dihen, këtu si administratë janë sa e di unë 140 administratoë që duhet t'i evidentojnë së paku propozimet kryesore dhe t'ua ofrojnë juve dhe një nga një të hidhen në votim pa insistuar që të dominoj propozimi i caktuar. Apeloj që votimi të jetë elektronik e jo përmes ngritjes së duarve si formë e presionit që është praktikuar jo një herë këtu. Unë gjithashtu kërkoj që pos asaj që kamë propozuar që të vëhet në votëbesim Grupi për bisedime i Kosovës, jam sidomos kategorik që kryetari i Kuvendit të Kosovës z. Kolë Berisha vetë të japë dorëheqje nga ky grup dhe të jetë i paanshëm me gjykimet e veta dhe jo këtu që në cilësinë e kryetarit të Kuvendit ta merrë një njëanshmëri të plotë në debat. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit z. Xhemajli, fjalën e ka deputeti Gjergj Dedaj, kurse le të përgatitet deputetja Sala Berisha – Shala.

**DEPUTETI GJERGJ DEDAJ** – Faleminderit shumë z. kryetar, nuk bëhet nami të flas edhe 4-5 minuta, jemi duke pritur që 7 dhe 70 vjet. I nderuari z. president, z. kryeministër, z. Thaçi, z. Surroi dhe të gjithë ju kolegë.

Në malësitë tona ka qenë zakon kur vdiske dikush e vajtonin gratë e pastaj e merrnin arkivolin pas atij vajtimi dhe e varrosnin. Është mirë që ky Kuvend që përfaqëson vullnetin e popullit të Kosovës të mos shndërrohet në vajtime publike vetëm të shpenzojmë energji e gjoja se dikush këtu është më patriot e dikush më pak se tjetri. Nuk është qëllimi aty, as nuk e duam asnjëri më tepër se tjetri Kosovën, por qëllimi është që gjërat t'i themi drejt, konkret me emër dhe mbiemër. Kam dëgjuar disa herë se po bisedohet në Vjenë për çështje teknike, por ky është një mashtrim i madh se nuk mund të jetë çështje teknike rregullimi i brendshëm administrativ –territorial i Kosovës, çështje teknike është nëse bisedohet a të aterojnë aeroplanat e JATIT në Aeroportin e Prishtinës, si të rregullohen hekurudhat ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe çështje të tjera të mos i përmend se janë shumë, ndërsa çështja e organizimit dhe e krijimit të komunave të reja monoetnike për qëllime që Kosova gjithmonë të jetë një bombë e kurdisur në rajon, d.m.th është krejtësisht çështje politike dhe këtu mendoj se e ka bërë gafin e parë Ekipi Negociator i Kosovës. Gafin e dytë të pafalshëm sipas mendimit tim si deputet i Partisë Liberale të Kosovës dhe flas në emrin tim personal d.m.th si përfaqësues i liberalëve, gafin e dytë e ka bërë duke thënë se nuk do të bisedohet për Kosovën me Serbinë, për statusin e Kosovës a në fakt kanë biseduar me Serbinë dhe janë duke biseduar për çdo ditë edhe nesër prapë për statusin politik dhe të ardhmen e Kosovës, organizimin tonë të brendshëm që është problem yni dhe i këtij Kuvendi, d.m.th edhe kjo është dhe po më vjen keq se unë kam shumë respekt për anëtarët e delegacionit. Më besoni se kam shumë respekt për të gjithë, por pa tjetër më shumë kam respekt për Kosovën e d.m.th është një mashtrim i llojit të vet, mashtrim i cili nuk do të duhej të ndodhte dhe mashtrim i cili do të duhej të ndërpritet urgjent, në mënyrë që të mos dalim në individualisht e të na imponohet edhe dorëheqja se nuk bëhet nami nga Kuvendi i Kosovës, sepse fëmijët tanë, se tash kur po i dëgjoj këto që 7 vjet që i kam dëgjuar unë po mendoj se tash duhet t'i kërkojmë falje Serbisë pse je lodhur duke ma vlarë familjen time, pse je lodhur duke i vra fëmijët e Kosovës dhe pse je lodhur duke e vra Kosovën, sepse ajo tash po paraqitet si palë që duhet të lëshojë pe, t'i jepen favore, që përseri të bëjë çka të dojë me Kosovën, sepse logjika e robit ndaj sundimtarit edhe kjo vazhdon nga logjika e deles që

plagoset nga ujku që kur e plagos në qafë vrapon pas ujkut dhe hyn në mal . Kjo logjikë mendoj se është koha e fundit të ndryshohet dhe prapë qëndroj pranë asaj që e kam thënë ditën e parë, kërkoj pushimin që moratorium tingëllon politikisht shumë keq, pushimin e aktivitetit të Grupit Negociator deri sa Kuvendi i Kosovës të mos i caktojë detyrat, detyrimet dhe përgjegjësitë dhe në rastin më të keq nëse nuk hëdodh kjo kërkoj shkarkimin e Ekipit Negociator dhe të gjitha përgjegjësitë t'i marrin institucionet e Kosovës, të cilat e kanë marrë votën e popullit. Duke premtuar këto që nuk i kanë bërë dhe nuk janë të gatshëm t'i bëjnë dhe nuk do t'i bëjnë, sepse nuk duhet të përmendi emra për të mos u bërë tendencioz, por dikush nga shëfat e grupeve parlamentare në një farë mënyre i çoi duart lart sikur në ring dhe tha se ne jemi të dorëzuar, të marrim çka të na japin. Mirë se na japin a mendoj se ne nuk i kemi pasur fjalët kështu dhe zgjedhjet nuk i kemi fituar, ata që kanë fituar, kanë fituar duke thënë se do ta bëjmë realitet pavarësinë e Kosovës bile në vitin 2005, pastaj në qershor të vitit 2006, tash u dëgjua pak edhe në vitin 2007, 2008 dhe dikur hiq, d.m.th nuk kam dal t'i shes mend askujt, por si qytetar që t'i shpreh mendimet e mia demokratike dhe legjitime edhe një herë mos të jetë ky debat sikur që ka ndodhur për Universitetin, për decentralizimin vetëm të flitet bukur dhe të duket në televizion mirë dhe asgjë tjetër, por le të jetë kjo d.m.th që të dijet me qëndrime konkrete, le të bëhet një grup nga grupet parlamentare dhe të gjitha propozimet që u dëgjuan këtu veç e veç le të hudhen në Kuvend se nuk duam ta marrim përgjegjësinë kolektive, dikush mund e ka lëkurën e trashë dhe duron gjithçka, dikush nuk mund, nuk kemi nevojë dhe as nuk jemi të gatshëm disa e unë mendoj se shumica prej jush të pranojmë një tradhëti të re edhe një mashtrim të madh për Kosovën.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit, profesori replikë, Mark Krasniqi ka replikë.

**DEPUTETI MARK KRASNIQI** - Faleminderit z. kryetar, replikë kam në lidhje me paraqitjen e rrejshme të Zef Morinës në këtë Parlament. Zef Morina këtu u paraqit në emër të Partisë Shqiptare Demokristiane, prej së cilës ka gati 2 vjet që është përjashtuar për qëndrimet dhe veprimet e tij të pandershme në parti. Ai nuk e përfaqëson në asnjë mënyrë dhe në asnjë vend Partinë Shqiptare Demokristiane, të cilën e përfaqësoj unë në këtë Parlament. Zef Morina edhe për shkak të veprimeve të tilla ka qenë i përjashtuar edhe si ministër, prandaj unë nuk e di se ku e ka fytyrën ai që paraqitet rrejshëm edhe në këtë seancë të Parlamentit. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Fjalën e ka Zef Morina.

**DEPUTETI ZEF MORINA** - Faleminderit z. kryetar e falënderoj edhe profesor Markun për këto etiketime që po m'i bëjnë, që vërtet për shkak të moshës unë nuk kisha pasur dëshirë as me repliku, por si do që të jetë më vjen shumë keq që për hir të moshës deri më tash e kemi toleruar, por nuk mund ta tolerojmë me këto veprime të tij jo të drejta dhe jopërimore dhe jonjerëzore. Mund t'i them sinqerisht që unë jam kryetar i Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës, pamvarësisht të pëlqen apo nuk të pëlqen, jam deputet i Parlamentit të Kosovës dhe qytetar i Kosovës dhe për këtë arsye as nuk ta përmenda emrin as nuk të thashë asgjë, por nëse nuk të pëlqen këtë do ta vërtetojmë shumë shpejt në zgjedhjet e ardhshme. Ju faleminderit.



KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Me qenë se nuk ka diskutues të tjerë të parqitur, lus përfaqësuesit e Grupit Negociator kush do ta marrë fjalën. Z. Surroi.

DEPUTETI VETON SURROI, anëtar i Ekipit të Unitetit – Të nderuar znj. dhe z. ,të nderuar kolegë ishte një ditë e gjatë në të cilën ne si Ekip i Unitetit mësuam për hallet, për preokupimet, për perceptcionet e asaj që ne si ekip negociator po përpiqemi ta prezentojmë si qëndrim i Kosovës. Këtë seancë e kemi mirëpritur dhe këtë e them, besoj ,në emër të të gjithëve, e kemi mirëpritur në Ekipin e Unitetit unikë dhe e kemi mirëpritur në kuptimin e nevojës së komunikimit me Parlamentin e Kosovës dhe obligimet që i kemi si Ekip i Unitetit për t'i prezentuar qëndrimet tona, punën tonë dhe për të verifikuar para këtij Parlamenti ,i cili edhe përfundimisht duhet ta japë fjalën në këtë proces negociator. Nuk ekziston anjë anëtar i Ekipit të Uniteti, i cili nuk beson se në fund të këtij procesi Parlamenti është ai i cili duhet të vendosë se ne jemi vetëm përçues të mesazhit të cilin ky Parlament fundja edhe e krijon.

Negociatat znj. dhe z. reflektojnë realitetin, jo këtë realitet të sotëm, por realitetin e 7 vjetëve të kaluara. Negociatat nuk janë vetëm shkuarja në Vjenë, negociatat nuk janë vetëm sajim i dokumenteve, negociatë është përditshmëria jonë, mënyra se si sillemi, mënyra se si kalojmë nëpër proceset zgjedhore, mënyra se si qeverisim. Të gjitha këto shkojnë së bashku dhe së fundi reflektohen në një proces negociator. Kosova po të ishte në gjendje në vitin 1999 të menaxhonte vetveten do të ishte e pavarur, nuk ka ndodhur asokohe kemi kaluar nëpër një periudhë ngritjeje, tash kemi ardhur në një proces negociator. Ajo çka më duket se duhet të ekzistonte është një komunikim më i afërt me realitetin, një komunikim jo vetëm për sa i përket Ekipit të Unitetit, por një komunikim më i afërt me realitetin edhe i Parlamentit të Kosovës, duhet të jemi shumë më afër asaj që është gjendje faktike, reale në jetën tonë jo vetëm projeksioni i dëshirave tona, se dëshirat tona janë të projektuara shumë më herët, nuk ka nevojë të riprojektojmë çdoherë dhe në çdo proces.

Pjesë e këtij realiteti është procesi i decentralizimit dhe kjo nuk është asgjë e re, për këtë proces ne kemi ngritur zërin qysh më herët, ne si anëtarë të Kuvendit, çdo njëri prej nesh në formën e vet, ne si aktivist ose ne si njerëz të jetës publike. Procesi i decentralizimit nuk është shpikur sot, mënyra e këtij procesi të decentralizimi nuk është sajuar nga një apo anëtar i tjetër i Delegacionit të Kosovës, ky është fryt i përbashkët, është fryt i përbashkët për të mirë, është fryt i përbashkët për të keq dhe këtë duhet ta bajmë me shëndet të gjithë, çështja është vetëm se si ky proces të integrohet në një projeksion të realitetit të ardhshëm të Kosovës si një shtet i pavarur funksional. Është folur për komunat e komuniteteve se si ky proces favorizon vetëm një komunitet, që është e vërteta dhe për hir të komunikimit me Kuvendin duhet theksuar se Këshilli konsultativ për komunitete ka marrë dhe ka adresur çështjet e komunave të reja për nevojat e komuniteteve të tjera joserbe dhe është pajtuar në nivel të Ekipit të Unitetit që kjo çështje të mos shtrohet në Vjenë. Nuk do të ishte e hijshme që në Vjenë të bisedojmë për komunën e Deçanit p.sh ose të Vitomiricës si projekt dhe këto çështje i kemi shtruar në një procedurë të rregullt me zëvendëskryeministrin, gjegjësisht me ministrin e Pushtetit Lokal, d.m.th është inicuar procedura politike për të shikuar validitetin e këtyre komunave në të ardhmen. Këtu është theksuar se dokumenti për komunitete nuk reflekton një apo tjetër dëshirë dhe për këtë më duhet të theksoj se dokumenti për komunitete nuk

reflekton dëshirat individuale, është fryt i konsensusit, konsensus do të thotë ose marrëves, do të thotë kalim nëpër së paku 3 filtra të ndryshëm të marrëveshjes. Filtri i parë i marrëveshjes është këshilli konsultativ i komuniteteve ku të gjitha komunitetet e japin mendimin e vet, ku të gjitha komunitetet projektojnë identitetet e tyre dhe nevojat e tyre. Filtri i dytë ka të bëjë me bashkësinë ndërkombëtare dhe me mënyrën si kombinohet, integrohet nevoja e komuniteteve tona me nevojat, me mendimet ose me vlerësimet e fillimisht me parimet e bashkësisë ndërkombëtare që kanë të bëjnë me rregullimin e çështjes së shumicës me komunitetet dhe fundja e fundit ka të bëjë me marrëveshjen brendashqiptare. Ky dokument do të duhej të kalonte dhe ka kaluar nëpër filtrin e katër partive kryesore shqiptare të përfaqësuara në këtë Kuvend, së paku në nivel të liderëve të tyre. Kur kalon nëpër këso filtrimesh dokumenti krijon emërtuesin e përbashkët dhe ky dokument ka qenë emërtues i përbashkët i punës së komuniteteve, i punës së grupeve më të forta parlamentare në Kuvend dhe i punës së UNOSEKU-t, gjegjësisht të ekspertëve të UNOSEKU-t. Është kërkuar këtu që të ruhen disa prej zgjidhjeve që kanë ekzistuar në Kornizën Kushtetuese, që është e vërteta kjo është ende çështje e debatit, është ende proces negociator, mund t'ju them atë që përfaqësoj unë në emër të Grupit të Unitetit ajo është se disa zgjidhje që ekzistojnë në Kornizën Kushtetuese nuk duhet të jenë të aplikueshme në realitetin e ardhshëm kushtetues – juridik të Kosovës. Mund të jenë pjesë e marrëveshjes politike, implementuese, por Kosova nuk bën të hyjë me një kushtetutë të re në të cilën thuhet: “se një ministër duhet të jetë serb, një ministër duhet të jetë boshnjak, apo një ministër duhet të jetë i një komuniteti tjetër”. Kosova nuk guxon të ketë kushtetutë libaneze, Kosova duhet të ketë kushtetutën e shtetit të pavarur të qytetarëve të vet në të cilën theksohet qartazi se qeveritë do të ndërtohen në bazë të kualiconeve, kualicionet duhet të ndërtohen në bazë të interesave, pjesë e atyre interesave do të jenë edhe interesat etnike të cilat duhet të përfaqësohen në atë ardhmëri, në zbatimin e marrëveshjes politike mund të kemi nevojë për zgjidhje compromise. Ekipi i Unitetit nuk ka hezituuar që të ketë zgjidhje kompromisi, por për sa i përket realitetit kushtetues – juridik nuk do të ketë kompromis dhe ky është qëndrim i përbashkët i ekipit tonë. Është përmendur këtu çështja e sovranitetit dhe nevojës së sovranitetit të plotë, mendoj se duhet të ndaj me ju një përshtypje, një mendim dhe një analizë. Kjo është se ky Kuvend i Kosovës në momentin kur ka pranuar të hyjë në proces negociator ka hyrë në këtë proces me ndarjen e sovranitetit me bashkësinë ndërkombëtare. Parim i Grupit të Kontaktit në këtë proces negociator është që pas zgjidhjes së statusit të Kosovës do të ketë prani ushtarake dhe prani civile ndërkombëtare. Kjo do të thotë ndarje e sovranitetit me bashkësinë ndërkombëtare dhe ky është një lloj i ri i partneritetit dhe kjo është një sfidë e re për të gjithë ne. Sfidë është e këtij lloji, o do të jetë një prani e marr vesh në mes nesh që do të jetë një lloj partneriteti o do të jetë një prani e imponuar në shumë aspekte me të cilat ndoshta në këtë moment nuk do të pajtoheshim, por kjo është një sfidë e procesit negociator dhe kjo është një sfidë e cila varet drejtëpërsëdrejti nga sjellja e këtij Parlamenti dhe të gjitha oinstitucioneve që rrjedhin nga ai. Është përmendur si pjesë e pakos të cilën e kemi punuar, ligji për gjuhët, gjegjësisht mosmarrëveshja e gjuhëve. Më duhet të them që në fillim se unë pajtohem absolutisht me qëndrimet të cilat i kemi marrë në Selanik bashkërisht dhe me të cilat njihet e drejta e përdorimit zyrtar të gjuhëve, boshnjake, turke dhe rome në segmente të veçanta të Kosovës, gjegjësisht në Prizren. Kjo pjesë e marrëveshjes është arritur me konsensus dhe kjo pjesë e marrëveshjes duhet të përkthehet në realitetin juridik të

Kosovës nëpërmjet një marrëveshjeje politike parlamentare, nëpërmjet një procedure parlamentare, ne mund të merremi vesh politikisht në këshillin konsultativ për komunitete për njërin apo tjetrin formë të realitetit të ardhshëm, mirëpo ajo duhet të kalojë këtu në Parlament dhe nuk duhet të ngarkohemi për këto çështje në këshillin konsultativ për komunitete. Kjo varet drejtëpërsëdrejti, në këtë rast, prej partnerëve të koalicionit qeverisës, të cilët kanë mundësi dhe fuqi që këto t'i kalojnë dhe t'i kthejnë në realitet,

sfidat dhe tri problemet të cilat mendoj se do të ballafaqohemi në të ardhmen:

**E para,** është çështja e pranisë së ardhshme ndërkombëtare që është ende një enigmë, një e panjohur në të cilën nuk kemi hyrë në procesin negociator, ajo që është e parashikueshme është që sovraniteti ynë të jetë i kufizuar drejtëpërsëdrejti në gjyqësi për shkak të viteve të kaluara, mund të jetë e mundshme që sovraniteti ynë të jetë i kufizuar në pranimë e ardhshme ndërkombëtare edhe në segmentet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e komuniteteve pakicë. Kjo është një çështje të cilën prapë them konceptualisht duhet rregulluar si çështje partneriteti në mes institucioneve të Kosovës dhe pranisë së ardhshme ndërkombëtare e jo të tolerohet si një çështje imponimi, sepse kjo do të na sillte një zvarritje në arritjen e pavarësisë sonë.

**Svida e dytë** është ajo e Mitrovicës. Ende jemi në projektin një qytet dy komuna në procesin negociator dhe për këtë duhet të jemi të hapur. Ende nuk ka thellësi të këtij projekti, gjegjësisht garanci të mjaftueshme nëse ky projekt mund të ecën ashtu siç duhet, ky është obligim i Ekipit të Unitetit që çështjen e Mitrovicës ta çojë aty ku duhet, gjegjësisht në unifikimin e këtij qyteti si etnitet funksional, si qytet.

**Sfida e tretë** është formulimi për lidhje vertikale. Ekipi i Unitetit ka rezistuar, ka ndërmend të rezistojë dhe kjo është një vijë e kuqe e pakalueshme e kjo është e drejta e komunave në baza etnike që të lidhen drejtëpërsëdrejti me pushtetin e Beogradit, kjo është e patolerueshme, e palejueshme. Këtë çështje nuk do ta pranojmë në asnjë mënyrë, por po them se kjo është një sfidë të cilën duhet tejkaluar në formën e negociatave.

Është thënë në mënyrë hipotetike nuk paraqes unë personalisht çështjen e Preshevës si çështje të nevojave në Vjenë, nuk është e vërtetë se në dy takime, në" takimin e elefantëve "edhe në takimin e komuniteteve është ngritur nevoja që Beogradi të aplikojë të njejtat formula për mbrojtjen e komuniteteve, interesat e komuniteteve pakicë në Luginën e Preshevës siç e bëjmë ne, e kemi ftuar dhe e kemi sfiduar Beogradin të kyqet në një garë pozitive sa i përket kujdesit ndaj minoriteteve pakicë. Në fund dua t'ju lus që në muajt e ardhshëm që do të jenë më sfidues se në muajt e kaluar, në këtë Kuvend dhe në këtë Ekip të Unitetit të ruhet uniteti. Gjëja e fundit që i nevojitet Ekipit të Unitetit e besoj se edhe Parlamentit të Kosovës është që problemet qoftë në mes partishë, qoftë brenda partish të reflektohen në Kuvend rrjedhimisht edhe në Ekipin e Unitetit. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit z. Surroi, fjalën e ka z. Thaçi.



DEPUTETI HASHIM THAÇI – anëtar i Grupit të Unitetit. Faleminderit z. kryetar, përshëndetje z. president, përshëndetje juve të nderuar deputetë.

Të gjithë i dini kushtet, rrethanat dhe specifikat, por edhe vështirësitë e formimit të Ekipit të Unitetit apo të Delegacionit të Kosovës, por edhe të gjithë i kuptoni dhe besoj i respektoni vështirësitë e funksionimit të këtij ekipi, në veçanti në muajt dhjetor, janar, shkurt, dhjetori i vitit të kaluar, maji dhe shkurti i këtij viti dhe natyrisht vazhdimin në kontinuitet të punës së Delegacionit të Kosovës të spektrit të gjerë politik të Kosovës. Të nderuar deputetë, dua të theksoj se Delegacioni i Kosovës është prezentuar në raport të angazhimeve që i ka pasur me komunitetin ndërkombëtar për mënyrën e ndërtimit të shtetit të Kosovës, në bazë të dokumentit që po ky Parlament e ka nxjerr në nëntor të vitit 2005, d.m.th. të Rezolutës për shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës dhe lirisht mund të them se ne do të vazhdojmë me përgjegjësinë më të lartë kombëtare, politike dhe qytetare ta respektojmë këtë rezolutë që ka rikonfirmuar vullnetin e qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran me pretendime dhe angazhime të sigurta për t'u integruar në strukturat e Bashkimit Evropian dhe në NATO, që të jetë bazë juridike dhe politike në angazhimet dhe në momentin e vendimarrjes për statusin e Kosovës që ne besojmë që do të jetë dhe është e vetmja zgjidhje respektimi i vullnetit të qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran.

Të nderuar deputetë, me respekt më të lartë për të gjithë diskutuesit, për të gjithë ata që u angazhuan për t'i ndihmuar Ekipit të Unitetit edhe për ata që kanë vërejtur ndryshimet dhe i kanë prezantuar në Kuvend edhe për ato mendime të kundërta që u paraqitën, unë kam besim të plotë se këto mendime që u prezantuan edhe në ditët e kaluara, por edhe sot do t'i ndihmojnë Ekipit të Unitetit, do të mund ta forcojnë Ekipin e Unitetit dhe natyrisht se edhe ne do të jemi reflektues ndaj atyre lëshimeve që kanë mund të ndodhin. Ne gjithmonë kemi pasur përgjegjësinë, por edhe gatishmërinë që të jemi në Kuvend dhe do të jemi të gatshëm vazhdimisht që të vijmë në Kuvend, t'ju informojmë, t'ju raportojmë. Statusi politik nuk është pronë e as dëshirë e anëtarëve të Ekipit të Unitetit, statusi politik është shpirti, respekti i sakrificës së qytetarëve të Kosovës dhe vullneti i qytetarëve të Kosovës dhe pjesë kryesore e programit të të gjitha partive politike të Kosovës, prandaj ne si Ekip i Unitetit, do t'i respektojmë në përpikëri të plotë programet tona politike dhe vullnetin e qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran, prandaj ju ftoj të gjithëve të mos kuptohet ky proces me energji negative, të mos kuptohet me një percepticion negativ të panevojshëm, duhet të kemi besim në vetëvete, në energjitë tona siç kemi pasur besim edhe më herët dhe siç kemi fituar. Kosova është Kosovë, Serbia është Serbi. Kosova e ka fituar luftën, do ta fitojë edhe paqen dhe do ta ndërtojë edhe shtetin dhe do të integrohet edhe në Bashkimin Evropian edhe në NATO, por shtetin do ta ndërtojë duke e respektuar të gjithë e jo në fakt duke u lavdëruar dhe dhe respektuar se po i respektojmë të gjithë qytetarët e Kosovës dhe asesi duke u kritikuar prej komunitetit ndërkombëtar se ne nuk i respektojmë të drejtat e të gjithë qytetarëve tonë. Prandaj jemi nisur nga parimi në kuptimin më afirmativ për t'i integruar të gjithë në institucione në shoqëri që të ndërtojë realitetin demokratik të Kosovës së pavarur dhe natyrisht se hapet perspektiva pastaj edhe për zhvillimin ekonomik. Si anëtar i Ekipit Negociator, por në të njëjtën kohë kam edhe besim të plotë se i gjithë Ekipi Negociator është i bindur, siç jeni të bindur se Kosova do të jetë e pavarur dhe e bashkuar, nuk do të ndahet, do të jetë Kosovë e pavarur me Mitrovicë të bashkuar, por në të njëjtën kohë do të punojmë që gjatë kësaj periudhe bashkarisht me komunitetin ndërkombëtar të fillojmë

të ndërtojmë bazën e mirë legale, por edhe të realitetit për zbatimin e standardeve demokratike edhe në kuptimin politik edhe legjislativ dhe ekonomik. Të jeni të sigurt se në çdo angazhim të mëtutjeshëm do të jemi të përgjegjshëm për të respektuar Rezolutën e Kuvendit të Kosovës që rikonfirmon vullnetin e qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA**- Ju faleminderit z. Thaçi, udhëroni z. kryeministër.

**KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU** – anëtar i Ekipit të Unitetit, z. kryetar i Parlamentit z. president i Kosovës, të nderuar deputetë.

Do të përpiqem të jem i shkurtër, unë e përshëndes këtë debat dhe mendoj se ka qenë shumë i dobishëm, sepse e forcon dhe e thekson rolin vendimarrës të këtij Kuvendi në të gjitha proceset nëpër të cilat po kalojmë e sidomos në procesin e definimit të statusit. Roli vendimarrës është i këtij Kuvendi, çka jemi duke bërë ne si Ekip i Unitetit, ne jemi duke bërë oferta, për akomodimin e komuniteteve pakicë në Kosovë, duke e pasur dhe duke e theksuar gjithmonë parimin themelor se asgjë nuk jemi marrë vesh. Derisa nuk merremi vesh për çdo gjë, kjo është puna jonë. Ne edhe si Qeveri edhe si Parlament dhe si institucione të Kosovës jemi duke dëshmuar para faktorit ndërkombëtar se Kosova është e bërë, e kemi bërë Kosovën, Kosova është duke funksionuar si shtet, shtetësia e Kosovës është bërë realitet, po ka diçka që ende nuk është bërë në Kosovë. Ky integrimi i komunitetit pakicë, është integrimi i komunitetit serb në sistemin juridiko kushtetues të Kosovës. Këtë ende s'c kemi bërë dhe çka, kjo na ka mbetur pa u dëshmuar se Kosova mund të funksionojë si shtet dhe është bërë shtet dhe kjo kërkohet nga ne që përmes këtij procesi të bëjmë edhe këtë pjesë, të akomodojmë komunitetin pakicë në Kosovë, duke qenë të kujdesshëm shumë që mos ta akomodojmë edhe Serbinë në Kosovë, kështu që jemi duke bërë këtë përmes decentralizimit, përmes ruajtjes së trashëgimisë kulturore, përmes të drejtave të tyre, jemi duke ju krijuar hapësirë, duke u dhënë mundësi dhe garanci që ata mund të jetojnë një jetë të dinjitetshme në Kosovën shtet edhe të tyre, kjo është ajo çka ne jemi duke e bërë. Është fat i mirë historik që ne jemi në pozitë të japim, të falim sepse jemi fitues në luftën për Kosovën siç tha z. Thaçi, por në këtë proces nuk është vetëm që jemi duke dhënë, ka shumë gjëra që sot si kemi, ne kemi një realitet që në të vërtetë sot nuk është pushteti i kësaj Qeverie apo këtyre institucioneve i shtrir çdokund në Kosovë, nuk është që ne kemi ndikim, kemi kontroll çdokund në Kosovë, ne përmes këtij procesi, duke ju ofruar këtë hapësirë, duke ju ofruar këtë mundësi jemi duke integruar dhe shtrirë pushtetin, sovranitetin në tërë territorin e Kosovës mbi të gjithë qytetarët e Kosovës, kështu që kjo është një realitet që është i krijuar dhe përmes këtij procesi duke u dhënë një ofertë të tillë bujare, gjeneroze në cilësinë e fituesit ne jemi duke e integruar komunitetin pakicë në sistemin kushtetues dhe juridik të Kosovës dhe duke e bërë Kosovën të tërë dhe duke e bërë Kosovën shtet që të njihet ky realitet.

U shtrua pyetja në lidhje me sigurinë. Nuk është temë e harruar, është temë shumë e rëndësishme për Kosovën. Në agjendën që e ka dhënë z. Ahtisari pas takimit që e kemi pasur në Vjenë më 24 korrik, shkruan që edhe dy tema janë që të adresohen. E para është prezenca e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë dhe e fundit është sistemi i sigurisë vendore në Kosovë. Në lidhje me këtë puna ka filluar dhe është duke u hartuar... Nën mbikëqyrjen e UNMIK-ut është zhvilluar një proces i quajtur rishikimi i sektorit të

sigurisë në Kosovë, i cili ka përfunduar, i drejtuar nga gjenerali i pensionuar anglez Tomi Vellsh me një ekip ekspertësh nën drejtimin e një komiteti drejtues ku jemi anëtarë të këtij komiteti të gjithë ne 5, ministri i Drejtësisë, i Punëve të Brendshme, i Financave, drejtues të UNMIK-ut të KFORI-t, përfaqësues të komuniteteve etj. Materiali është përfunduar të premtën, do t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve të Komitetit drejtues, kah fundi i muajit shtator, do të organizohet një takim i këtij Komiteti drejtues ku do të aprovohet, ndryshohet apo refuzohet rekomandimi i këtij sekretariati të rishikimit të sektorit të sigurisë, parashihet që Kosova t'i ketë të gjitha institucionet që çdo vend normal demokratik i ka, duke përfshirë këtu edhe forcën e mbrojtjes, shërbimin inteligjent, policinë financiare, policinë gjyqësore e të tjera struktura që i kemi. Paralelisht me këtë Grupi Negociator më ka ngarkuar mua konkretisht me disa ekspertë që jemi duke e bërë edhe një variant autokton, tonin, të cilin do ta ballafaqojmë me këtë variant të këtij grupi për shikimin e sektorit të sigurisë dhe do të përgatitemi që edhe kjo çështje të diskutohet duke e patur parasysh që Kosova duhet t'i ketë dhe do t'i ketë të gjitha strukturat e veta të sigurisë e cila do të garantonin tërësinë territoriale dhe sigurinë e të gjithë qytetarëve të Kosovës, kështu që kjo temë nuk është harruar, është duke u punuar dhe shumë shpejt do të vijë në rend të ditës. Ju faleminderit.

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Si zakonisht në përmbllje presidenti i Kosovës.

**PRESIDENTI I KOSOVËS Z. FATMIR SEJDIU**, njëherit edhe anëtar i Grupit Negociator.

Faleminderit z. kryetar!

Të nderuar deputetë, të nderuar anëtarë të Ekipit të Unitetit. Unë falënderoj të gjithë deputetët për një debat jashtëzakonisht të frytshëm gjatë këtyre dy ditëve, të them ditën e kaluar dhe sot, me kohë shumë të ngjeshur. Projektimet dhe shqetësimet tuaja që janë pjesë e shqetësimeve të përditshme dhe janë normale që t'i përcillni drejtëpërdrejt edhe atë që mund ta gjeni në pjesën e opinionit që prezantoni dhe që është në mozaikun e përgjithshëm. Është interes i përbashkët që të gjejmë formulën më të mirë të ecjes më tutje.

Kolegët e mi nga Grupi i Unitetit dhanë elemente të mjaftueshme nga ato që kanë qenë pjesë e preokupimeve tona të përditshme dhe mënyrën se si ne kemi ardhur deri te konkluzionet e caktuara. Ripërsëris edhe një herë se gjatë gjithë debatit tonë të brendshëm kemi bërë përpjekje t'i analizojmë të gjitha variantet e mundshme dhe për të ofruar atë që ne e kemi shkruar në pjesën e dokumenteve me një konsensus të plotë dhe që realisht themi, sikur edhe ditën e fillimi, por edhe sot nuk janë dokumente të përfunduara e veçanërisht disa nga çështjet themelore, ku ka një ndeshje të drejtëpërdrejtë të asaj që ne e kemi si vizion dhe të asaj që insistohet të jetë ndryshe. Mendoj se në këtë rrafsh të komunikimeve janë bërë në përcjellje të drejtëpërdrejtë si rezultat i një bashkëpunimi të tillë edhe me grupet apo ekipet e tjera punuese, që kanë reflektuar strukturën e përgjithshme të institucioneve të Kosovës dhe të subjekteve



politike . Me një koordinim të përbashkët kemi arritur, po them deri në këtë nivel të ecjes, apo të lëvizjeve tonë të përgjithshme. Ajo që dua ta them në fillim është shumë e qartë se ky ekip që ka vazhduar mandatin nga periudha e filluar, natyrisht se ka supozuar se do të ketë bisedime, sikur edhe vetë Kuvendi i Kosovës dhe nuk i kemi bishituar dhe nuk do t'i bishitnojmë, por do të jemi konsekuentë që në këto takime të deritanishme dhe që eventualisht mund të ketë, po them eventualisht ,siç është thënë edhe bisedime eventuale, ne do të plasojmë atë që e kemi mandat nga ky Kuvend për çështjen e panegociueshme të pavarësisë së Kosovës. Modalitetet e realizimit të saj, natyrisht se janë përcjellë edhe në këtë proces paralel dhe jam plotësisht dakord me të gjithë ata që thonë se cila nga pjesët e debatuar nuk është kreu i çështje teknike, është çështje që ka edhe elemente politike, sepse është pjesë e sistemit dhe e një përpjekjeje për të ndërtuar formulat apo strukturat e ardhshme të shtetit të Kosovës . Natyrisht, mu në këtë përpjekje dëshirojmë që Kosova e ardhshme të funksionojë në radhë të parë si një shtet modern dhe demokratik që akcepton standartet ndërkombëtare. E them me përgjegjësi dhe besoj edhe ju pajtoheni se Kosova ka nevojën e aderimit në të gjitha konventat ndërkombëtare. Kosova ka nevojën që paralelisht me punën dhe me rregullativën e saj të brendshme ta bëjë me standartet ndërkombëtare të mbështetura në këto premisa ndërkombëtare, pra të konventave ndërkombëtare. U tha më herët se secili vend e ka specifikën e vet, por janë disa formula kyçe, prej të cilave nuk mund të kalojë as Kosova përtej dhe as vendet e tjera. Nuk do të jemi vend i cili do të gravitojë dhe do të shpejtojë të bëjë nënshkrimin e të gjitha konventave ndërkombëtare, për të mos i respektuar ato siç ka ndodhur, por do të jemi një vend, një shtet modern e them sërish, i cili do të gravitojë në to, duke i analizur shumë mirë dhe duke qenë pjesë kreative e proceseve të mëtejshme integruese. Ne kemi një vizion paralel, nuk dua të bëj politikë, por kjo është pjesë e punës, atë që e themi secili prej nesh nevojën e integritetit të Kosovës në rrjedhat evropatlantike. Në rrjedhat evropatlantike nuk mund të shkojmë me standarte të dyfishta, do të shkojmë me standartet e krijimit të një strukture, nomenklature të qëndrueshme shtetërore që respekton edhe vullnetin e shumicës domosdo, por që ka edhe kujdesin për pakicat.

Një çështje e veçantë që u potencua në disa nga variante të bisedave tuaja dhe në mënyrë të arsyeshme mendoj është çështja e asaj që ishte temë bosht nga kryesoret- çështja e decentralizimit të pushtetit lokal apo çështja e reformës së pushtetit lokal. Ne e kemi nisur këtë proces dihet se si, jo pjesë e standardeve për Kosovën, por ka qenë një proces i cili është bashkëngjitur në rrugëtim ka kohë. Çka do të dëshirojmë të bëjmë? Dëshirojmë që ky mekanizëm paralel të jetë në funksion të së ardhmes së qytetarëve të Kosovës. Pra, flas edhe të shumicës edhe të pakicave që mundsisht, sepse ka elemente, të evitojë gjithë atë pjesë të ndasive që nënkupton enklavizimin e brendshëm të njërës komunitet apo të një komuniteti tjetër. Pikërisht për këtë arsye është i nevojshëm ai rrafshi i komunikimit horizontal dhe këtu duhet të kuptohemi drejt edhe në këtë çështje apo segment. Komunikimi horizontal , në radhë të parë midis komunave të Kosovës , nënkupton nxjerrjen nga geotizimi të njërës apo të tjetrës komunë, nëse pretendojnë të kenë diçka të ngjashme. Komunikimi horizontal do të nënkuptojë nevojën e shtrirjes së standardeve të përgjithshme për gjithë nivelin e komunave të Kosovës. Ka dy-tri përjashtime që i ka potencuar edhe z. Haziri si zëvendëskryeministër rreth disa pjesëve të kompetencave shtesë që kanë të bëjnë me shëndetësinë sekundare dhe në Universitetin në gjuhën serbe po e marrim drejtëpërdrejtë. Ka pasur një shoshitje të thellë rreth kësaj problematike. Dha

disa aspekte z. Rexhepi, në fjalën e tij dhe mund të them diçka, nëse ne e kemi pasur këtë përkushtim se Universiteti në gjuhën serbe në Kosovë duhet t'i nënshtrohet legjisllacionit të Kosovës që nënkupton që Qeveria e Kosovës e Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është bosi kryesor në proces, pjesa e menaxhimit të brendshëm, a do të menaxhohet nga Universiteti për të pasur autonominë universitare, univerzale që e kanë universitetet apo do t'ia delegojë në bashkëpunim komunës së Mitrovicës së Veriut në këtë rast, është një problem që duhet zgjidhur në hapin e mëtejshëm si edhe çështja e shëndetësisë që nuk do të ndalem më gjatë. Këtu është njëra nga pjesët më të ndieshme që ne kemi insistuar që e tha edhe z. Surroi dhe u potencua edhe nga z. Thaçi dhe z. Çeku në proces.

Çështja e raporteve të komunave të Kosovës me ato jashtë Kosovës. E themi paralelisht, të gjitha komunat e Kosovës, them gati të gjitha kanë krijuar raporte binjakzuese apo raporte të ndërsjella të komunikimit me komunat e vendeve të tjera, si me Brukselin, me Parisin, Uashingtonin, Nju Jorkun apo me ndonjë qendër tjetër evropiane. Komunat e Kosovës kanë krijuar relacione edhe të vendeve fqinje që është krejt normale. Në raportet e tilla të cilat do të jenë pjesë e mbështetjes edhe të administrimit qendror të brendshme, është shumë me rëndësi që Qeveria e Kosovës të ketë kujdesin e veçantë dhe në raport me Serbinë në tendencat që ajo dëshiron t'i nënshtrojë komunat e Kosovës me shumicë serbe nën juridiksionin e saj, nuk mund të ketë kalim, sepse në këtë rast futet thjeshtë qeverisja në integritetin e brendshëm të Kosovës dhe shumëçka tjetër që cenon atë që ne dëshirojmë ta ndërtojmë dhe besoj se nuk do të ndodhë dhe ne do të kemi këtë ballafaqim edhe në etapa të tjera.

Një veçanti që do të jetë pjesë e bisedimeve të mëvonshme dhe që ka hyrë, fatmirësisht falë edhe ekipeve tona, çështjet apo problemet ekonomike, ka hyrë në natyrën e suksesionit. Kosova ka pranuar në takimet e Vjenës dhe në takimet e tjera në Prishtinë ta respektojë atë që e quajmë marrëveshje apo klub i Parisit, që të gjitha investimet që kanë hyrë në Kosovë dhe i janë dedikuar Kosovës dhe janë shfrytëzuar nga kosovarët, të jenë pjesë e borxhit të Kosovës. Asgjë tjetër që është pjesë e manipulimeve të mundshme dhe shumëçka që dëshiron t'i imponohet Kosovës si pjesë e investimeve në Kosovë, nuk do të jetë e pranueshme nga Kosova dhe në këtë drejtim ne do të hyjmë në një proces normal mbi bazë të standardeve ndërkombëtare dhe të ecjeve e të lëvizjeve të tjera. Dhe e fundit ajo që z. Surroi e shtroi në një element të rëndësishëm dhe që u potencua edhe në faza të mëhershme, është çështja e prezencës ndërkombëtare në Kosovë në periudhën që do të pasojë.

Ne kemi thënë Kosova ka nevojë edhe për një periudhë për një prezencë të lehtë ndërkombëtare. Në Kosovë ka nevojë për forcat e NATO-s deri në ngritjen e një force mbrojtëse të Kosovës mbi standartet e NATO-s dhe mbi standartet ndërkombëtare. Do të punojmë në këtë drejtim, do të koncipojmë si partner të rëndësishëm, sepse është ky proces i fillimit që ne do ta quajmë pjesë e bashkëpunimit të ndërsjellë me prezencën e bashkësisë ndërkombëtare, një prezencë e lehtë që nuk duhet të jetë në rolin e UNMIK-ut dhe që të jetë e një periudhe kalimtare – tranzitore.

Unë ju falënderoj edhe një herë të gjithëve dhe përkushtimin e Kuvendit. Do të jemi në komunikim të vazhdueshëm, nuk do të hezitojmë asnjëherë që të jemi bashkë me ju, por mund të them paralelisht atë që e ka thënë dikush prej deputetëve më herët se edhe komunikimet e e përhershme, transparenca përmes televizionit dhe formave të tjera nga takimet e Grupit të Unitetit nuk e ka bishtnuar atë realitet që ne e kemi pasur pjesë të debatit dhe të preokupimeve tuaja.

Ju faleminderit!

**KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA** – Ju faleminderit z. kryetar. Bisedimet dyditore e arsyetojnë plotësisht kërkesën për debat.

Ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje dhe konsideroj se mbledhja mori fund.